



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar i auditimit të ushtruar në “Rezidencën Studentore
Universitare Nr.2, SHA Tiranë”

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

“MBI PËRPUTHSHMËRINË”

në

REZIDENCËN STUDENTORE UNIVERSITARE NR.2, SHA

Tiranë, 2026

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-7
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-6
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	6-7
II.	HYRJA	8-11
1.	Objektivat dhe qëllimi i auditimit	8-8
2.	Identifikimi i çështjes	8-9
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9-9
4.	Përgjegjësitë e audituesve	9-10
5.	Kriteret e vlerësimit	10-10
6.	Standardet e auditimit	10-11
7.	Metodat e auditimit	10-11
8.	Dokumentimi i auditimit	11-11
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	12-140
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	12-12
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:	12-12
2.1.	Mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomik-financiar, në organet drejtuese të shoqërisë si dhe realizimi i tij.	12-22
2.2.	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionin e strukturave drejtuese (Këshilli/Bord Mbikëqyrës dhe Drejtoria), vendimet e marra dhe zbatimi i tyre. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave, shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore.	22-32
2.3.	Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë, dhe blerjet e vogla (shpenzime administrative për automjetet, udhëtime e dieta brenda dhe jashtë vendit, etj.)	32-42
2.4.	Prokurimet me fonde publike -Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik, lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave/ punëve dhe shërbimeve.	42-110
2.5.	Të tjera çështje që mund të dalin gjatë auditimit..	110-131
IV.	REKOMANDIME	131-140

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër për subjektin.

Rezidenca Studentore Universitare, Nr.2, Tiranë, (këtu e më poshtë, RSU Nr.2) është shoqëri aksionare SH.A, e regjistruar me nipt-K51730022L, ku pronari aktual i shoqërisë është Bashkia Tiranë, sipas VKM-së nr.335, datë 04.05.2016 "Për transferimin e 100% të aksioneve të shoqërive aksionare "Rezidenca Studentore Universitare nr.2", Tiranë. Gjithashtu shoqëria funksionon në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligjit 139/2015, datë 17/12/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; VKM nr.335 datë 04.05.2016 "Për transferimin 100% të aksioneve të shoqërive aksionare 'Rezidenca Studentore Universitare nr.1 Sh.A, Tiranë'; "Trajtimi i Studentëve nr. 2 Sh.A. Tiranë"; "Trajtimi i Studentëve nr. 3 Sh.A. Tiranë" nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të Bashkia Tiranë"; Udhëzimit Nr.15, datë 2.5.2018 "Mbi Programet e Zhvillimit Ekonomik të Shoqërive Tregtare me Kapital Shtetëror", Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë me Nr.23, datë 26.08.2020 "Mbi krijimin e grupit të Menaxhimit Strategjik të Shoqërisë "Rezidenca Studentore Universitare Nr.2" SH.A; Administratori është përfaqësues zyrtar i Rezidencës Studentore Universitare Nr. 2, Sh.A. Administratori i RSU nr. 2, e zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me ligjin nr. 7296 datë 20/04/1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", i ndryshuar.

Qëllimi i këtij auditimi është e dhënia e opinionit të përputhshmërisë mbi bazën e një vlerësimi objektiv për zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi lidhur me aktivitetin e RSU Nr.2, konkretisht: *Në trajtimin e studentëve të Fakulteteve të Inxhinierisë së Ndërtimit, Mjekësisë, Infermierisë dhe Universitetit të Sporteve, Tiranë për fjetje dhe shërbime të tjera.*

Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime, me synim marrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjekti i audituar. Në përmbushjen e qëllimit të auditimit janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Mbi hartimin dhe realizimin e buxhetit sipas strukturës së të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe raportimi i tyre.
- Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionin e strukturave drejtuese (Këshilli/Bord Mbikëqyrës dhe Drejtoria), vendimet e marra dhe zbatimi i tyre. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave, shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore.
- Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimit e kontratave, etj.

Metodat për kryerjen e këtij e auditimi janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Nisur nga veçoritë e subjektit të audituar, RSU, Nr.2, funksionon në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligjit 139/2015, datë 17/12/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; VKM nr.335 datë 04.05.2016 "Për transferimin 100% të aksioneve të shoqërive aksionare 'Rezidenca Studentore Universitare nr.1 Sh.A, Tiranë'. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:

b. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe drejtimet e auditimit;

c. *Pyetësorët drejtuar subjektit* - duke marrë informacionet mbi drejtimet bazë të programit të auditimit.

d. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

I.1 Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi në terren.

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni RSU nr.2, Sh.a, për periudhën nën auditim 01.01.2024 deri në 01.10.2025, paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë, trajtuar më poshtë:

Paraqitja e Gjetjeve kryesore nga auditimi në vijim:

1. Nga analizimi i zërit të furnitorëve rezultoi se RSU Nr.2 Sha ka detyrime të prapambetura të krijuara në periudhën 2006-2014, në vlerën 6,271,225 lekë. Këto detyrime përbëhen nga:

- Një detyrim në vlerën 4,504,079.00 lekë ndaj UKT SHA, i cili në kontabilitet rezultoi i krijuar në vitet 2006-2007. Nga auditimi konstatohet se nuk ka një rakordim me Ujësjetës Kanalizime Tiranë, me qëllim saktësimin e këtij detyrimi.

- Detyrime të tjera të krijuara në vitet 2011-2014 janë detyrime të cilat janë lënë në formën e garancisë për punimet që ka kryer secili operator pranë shoqërisë “Trajtim Studenti Nr.2” në vlerën 1,767,146 lekë.

2. Nga auditimi i kryer konstatohet se lidhur me realizimin e parashikimeve të programit ekonomik Janar-Dhjetor 2024, realizimi total i tij është 20%, ku zërat e programit me më pak realizim paraqiten si më poshtë:

- “Mallra, materiale të para dhe të tjera” është parashikuar 24,437,000 lekë dhe është realizuar 11,630,434 lekë, pra 48%,

- “Shpenzime për ekspert” është parashikuar 968,000 lekë dhe është realizuar 441,240 lekë, pra 46%,

- “Amortizim” është parashikuar 63,155,000 lekë dhe është realizuar 40,483,866 lekë, pra 64%,

- “Blerje vegla pune” është parashikuar 253,000 lekë dhe është realizuar 196,980 lekë, pra 78%.

Grupi i auditimit duke ju referuar mosrealizimit të programit ekonomik, konstatoi se RSU Nr.2 sh.a. nuk ka analizuar dhe parashikuar konform nevojave reale të saj.

3. Nga auditimi mbi procedurat e prokurimit publik për periudhën 2024-2025/09, rezultoi se dosjet e prokurimeve nga struktura përgjegjëse për prokurimet, nuk ishin të inventarizuara dhe të arkivuara duke sjellë si pasojë, parregullsi në administrimin e dokumentacionit të tenderit.

4. Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik të llojit “E hapur e Thjeshtuar”, për periudhën 2024-2025/09, rezultoi se, në 8 (tetë) procedura të audituara:

a. “formulimi i përdorur nga Njësia e Prokurimit në dokumentacionin e tenderit, si vijon: “*vlera e xhiros minimale vjetore duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së kontratës*” është në kundërshtim me nenin 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i cili përcakton saktë se kjo vlerë ***nuk mund të tejkalojë 40% vlerës së kontratës***. Si rrjedhojë, ky formulim përbën shkelje të dispozitës ligjore të sipërpërmendur duke sjellë kufizim të konkurrencës, veprime në kundërshtim me nenin 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

b. Formulimi i përdorur: “dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera në vlerën jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit”, bie në kundërshtim me parashikimin e nenit 55 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i cili përcakton se vlera e kërkuar për furnizime të mëparshme nuk duhet të jetë më e madhe se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës. Përdorimi i shprehjes “jo më e vogël se 20%” nënkupton një prag minimal të barabartë ose më të lartë se 20%, duke tejkaluar kufirin maksimal të lejuar ligjërisht. Ky formulim përbën shkelje të dispozitës ligjore të

sipërpërmendur dhe krijon kufizim të konkurrencës, veprime në kundërshtim me nenin 2 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Në procedurat e prokurimit “E Hapur e thjeshtuar”, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

5. Nga auditimi i procedurës së prokurimit e Hapur e Thjeshtuar me objekt “Blerje lëndë djegëse pelet për kaldajat”, me fond limit 5,241,600 lekë pa TVSh, viti 2024 rezultoi se, operatori “A.P” pjesëmarrës në procedurë është kualifikuar dhe shpallur fitues në kushtet kur nuk ka dorëzuar dokumentacionin fizik për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit, veprime në kundërshtim me nenin 76 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 2 pika 2, shkronja (j), nenin 25, nenin 26, pika 6 dhe nenin 82 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

6. Nga auditimi i procedurës së prokurimit e Hapur e Thjeshtuar, me objekt “Blerje materiale elektrike, hidraulike, ndërtimore dhe marangozi”, me fond limit: 3,739,575 lekë u konstatua se, operatori ekonomik fitues, “D.R” me nr. NIPT- është kualifikuar dhe shpallur fitues në kushtet kur nuk ka dorëzuar dokumentacionin fizik për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit, veprime në kundërshtim me nenin 76 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 2 pika 2, shkronja (j), nenin 25, nenin 26, pika 6 dhe nenin 82 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

7. Nga auditimi i 3 procedurave të prokurimit “E hapur e Thjeshtuar” me objekt:

- “Blerje detergjent për pastrim dhe lavanteri” me fond limit 1,011,197 lekë pa TVSH, viti 2025
- “Blerje detergjent për pastrim dhe lavanteri”, me fond limit 842,497 lekë pa tvsh, viti 2024,
- “Blerje lëndë djegëse gazoil për kaldajat”, me fond limit: 3,565,276 lekë pa tvsh, rezultoi se OE Fitues, përkatësisht: “M D”, “B”, “A.T ”, shpk, kanë paraqitur në dosjen fizike:certifikatën ISO të lëshuar nga IAF ShPK, EN-ISO nr. 9001:2015, certifikatën EN-ISO nr. 14001:2015, certifikatën ISO nr. 046/21 të lëshuar nga ICDQ ShPK. Në të 3 rastet organi që ka lëshuar certifikatën ISO për OE fitues nuk rezulton në listën e organeve të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (<https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>). Për sa më sipër, kjo duhet të përbënte shkak për mospranimin e këtij dokumenti.

Kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik në kushtet kur nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar, është në kundërshtim me nenin 76 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 2 pika 2, shkronja (j), nenin 25, nenin 26 pika 6 dhe nenin 82, të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

8. Nga auditimi i urdhër shpenzimeve, për periudhën në auditim, rezultoi se në 8 (tetë) raste, janë kryer likuidime në tejkalim të afatit ligjor 30 ditor, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” i ndryshuar, neni 52, Ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, si dhe UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 184. Megjithatë për likuidimet e mësipërme nuk ka penalitete.

9. Nga auditimi u konstatua se nuk janë lidhur kontrata ndërmjet Anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës në Rezidencën Studentore Universitare nr. 2, për periudhën 2023-2024, me Administratorin e shoqërisë, në kundërshtim me Nenin 16, të Statutit nr. 552/8 prot., datë 18.01.2021 në RSU nr.2. si dhe Nenit 12 , të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

10. Nga verifikimi i procedurave të ndjekura për punësimin e punonjësve me Kod Pune, dhe verifikimi i faqes Web në RSU nr.2 rezulton se subjekti nuk ka shpallur vendet vakante për punësim në faqen zyrtare të internetit apo në mjete të tjera të aksesueshme publikisht, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim, duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe kushtet e rekrutimit, të çfarëdo lloji dege të aktivitetit, e në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, si dhe ngritjen në detyrë. Veprime në kundërshtim me nenin 9, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, neni 12, pika 1.

11. U konstatuan shpenzime pa economicitet, efektivitet dhe eficiencë në vlerën 115,200 lekë, shpenzime përmbartimore, si rezultat i dëmshpërblimit të 4 punonjësve të larguar padrejtësisht nga puna.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si vijon:

1. Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse në bashkëpunim me, të marrë masa për të kryer rakordim me Ujësjellës Kanalizime SHA Tiranë, si dhe të analizohet situata e krijuar duke kryer trajtimin ligjor dhe kontabël të vlerave të detyrimeve të prapambetura.

2. Këshilli Mbikëqyrës si dhe struktura drejtuese e RSU nr. 2 të analizojnë mosrealizimin e zërave të programit ekonomik të vitit 2024 dhe të marra masa lidhur me hartimin e programeve ekonomike në të ardhmen konform nevojave reale të saj. të analizojë mos realizimin e zërave të programit ekonomik të vitit 2024 dhe të marra masa lidhur me hartimin e programeve ekonomike në të ardhmen konform nevojave reale të saj.

3. Njësia e Prokurimit të rishikojë dhe standardizojë formulimin e kriterëve të kualifikimit në dokumentacionin e tenderit, duke respektuar kufirin maksimal ligjor prej 40% të vlerës së kontratës për xhiron minimale vjetore, me qëllim garantimin e konkurrencës së lirë dhe përputhshmërisë ligjore.

4. Autoriteti Kontraktor si dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, përpara shpalljes së Operatorit Ekonomik fitues, të marrë masa që të garantojë verifikimin dhe dokumentimin e plotë të përmbushjes së kriterëve të përgjithshme të kualifikimit për çdo operator ekonomik, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

5. Administratori i Rezidencës Studentore Universitare SHA, nr. 2, si dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, përpara shpalljes së Operatorit Ekonomik fitues, të marrë masa që të garantojë verifikimin dhe dokumentimin e plotë të përmbushjes së kriterëve të përgjithshme të kualifikimit për çdo operator ekonomik, me qëllim garantimin e transparencës dhe barazisë në procesin e vlerësimit.

6. Administratori i Rezidencës Studentore Universitare SHA, nr. 2, si dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të marrë masa për forcimin e kontrollit paraprak dhe të brendshëm gjatë fazës së vlerësimit të dokumentacionit të operatorëve ekonomikë, me qëllim garantimin e respektimit të plotë të kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e prokurimit publik.

7. Sektori i Burimeve Njerëzore në RSU, nr.2, SHA, të marrë masa për shpalljen e vendeve vakante në faqen e saj zyrtare të web-it, për të garantuar transparencë, konkurrencë të hapur dhe trajtim të barabartë të kandidatëve, në përputhje me Kodin e Punës.

8. Administratori i Rezidencës Studentore Universitare SHA , të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë, efektivitet dhe economicitet të buxhetit të RSU. Nr.2, SHA, në vlerën 115,200 lekë e përdorur për kosto të shërbimit përmbartimor.

I.1. Konkluzioni dhe opinionin e auditimit.

Opinion i kualifikuar për auditimin e përputhshmërisë¹.

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Rezidencës Studentore Universitare nr.2, SHA (këtu e më poshtë RSU nr.2) për periudhën e aktivitetit 01.01.2024 deri më 01.10.2025, me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullator dhe rregulloret e marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të publike të këtij institucioni gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se, në veprimtarinë e RSU nr.2, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur *individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura* “dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë**”.

Baza për opinionin e përputhshmërisë.

Ne kemi audituar veprimtarinë e Rezidencës Studentore Universitare nr.2, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, bazuar në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI 100; ISSAI 400-499; ISSAI 4000-4899 dhe 4900), rregulloret, Kodit Etik, etj., të KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar. Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për përgatitjen e **opinionit të kualifikuar**.

Nga auditimi i kryer kanë rezultuar disa mangësi dhe parregullsi, që i referohen kryesisht procedurave të prokurimit publik, sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe detyrimeve të prapambetura të krijuara para periudhës në auditim etj.

Raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara janë si më poshtë:

- Nga analizimi i zërit të furnitorëve rezulton se RSU Nr.2 SHA ka detyrime të prapambetura të krijuara në periudhën 2006 - 2014, në vlerën 6,271,225 lekë, të cilat përbëhen nga: një detyrim në vlerën 4,504,079.00 lekë ndaj UKT SHA, i cili në kontabilitet rezulton i krijuar në vitet 2006-2007. Nga auditimi konstatohet se nuk ka një rakordim me Ujësjellës Kanalizime Tiranë, me qëllim saktësimin e këtij detyrimi.

- Detyrime të mbartura e të krijuara në vitet 2011-2014, të cilat janë lënë në formën e garancisë për punimet që ka kryer secili operator pranë shoqërisë “Trajtim Studenti Nr.2” në vlerën 1,767,146 lekë, pasi ata nuk kanë paraqitur kërkesën për çlirimin e vlerave të garancisë.

- Nga auditimi i 8 (tetë) procedurave të prokurimit të llojit “E hapur e thjeshtuar”, për periudhën në auditim (2024-2025/09), si dhe procedurave të llojit “Blerje e vogël” në RSU nr.2, SH.A (16 procedura) është konstatuar se, jo të gjithë kriteret kualifikuese janë argumentuar ligjërisht në përputhje me natyrën e punës, mallrave apo zërave të preventivit, kjo për sa i përket kriterëve të veçanta në lidhje me xhiron e realizuar dhe përvojave të punëve të ngjashme, duke transformuar interpretimin e drejtë ligjor.

- Nga auditimi i 8 (tetë) procedurave të prokurimit “Blerje Mallra”, në Rezidencën Studentore Universitare nr.2 SHA, nuk janë zbatuar aktet ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave nga KVO, duke kualifikuar OE fitues, në kushtet kur nuk kanë dorëzuar

¹ *Opinion i modifikuar/ kualifikuar* Audituesi duhet të shprehë një opinion të pa kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe jo të përhapura”.

dokumentacionin fizik të plotë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, veprime në kundërshtim me LPP 162/2020, i ndryshuar.

- U konstatuan shpenzime pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficiencë në vlerën 115,200 lekë, shpenzime përmbartimore, si rezultat i dëmshpërblimit të 4 punonjësve të larguar padrejtësisht nga puna.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin Nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1047/1 datë 03.11.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 04.11.2025 deri në datë 19.12.2025, në RSU nr.2 u krye auditimi “Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike-financiare” për periudhën nga data 01.01.2024 deri në 01.10.2025 nga grupi i auditimit me përbërje:

1. E.LL, përgjegjës grupi;
2. I.S, audituese;
3. G.G, audituese;
4. M.N, audituese;
5. E.T, auditues.

Auditimi u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit në:

-Mbi hartimin dhe realizimin e buxhetit sipas strukturës së të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe raportimi i tyre.

- Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionin e strukturave drejtuese (Këshilli/Bord Mbikëqyrës dhe Drejtoria), vendimet e marra dhe zbatimi i tyre. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave, shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore.

- Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimin e kontratave, etj.

Në përfundim të punës audituese në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur akt konstatimet si dhe është organizuar takimi përmblyës në datën 19.12.2025, me përfaqësues të RSU-së sipas funksioneve.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1.Objektivat dhe qëllimi i auditimit.

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit, synohet dhënia e opinionit të auditimit të përputhshmërisë mbi një vlerësim objektiv, profesional dhe të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga RSU nr.2, të rregullave, ligjeve dhe rregullore të vendosura. Qëllimi i tij është përcaktimi i nivelit të zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me aktivitetin e RSU-së, nr.2, për periudhën nën auditim.

Auditimi synon gjithashtu në përcaktimin nga audituesit:

-nëse janë zbatuar detyrimet ligjore në lidhje me hartimin dhe realizimin e buxhetit sipas strukturës së të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe raportimi i tyre në MAS.

-nëse janë kryer veprimet mbi shpenzimet me bankë dhe shpenzimet administrative.

-nëse janë zbatuar kërkesat ligjore për zbatimin e tyre në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, etj.

-dhënien e opinionit të auditimit dhe rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së RSU-së.

2. Identifikimi i çështjes.

Raporti i Auditimit mbi auditimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së RSU-së, nr.2, Sh.A., Tiranë, për periudhën 01.01.2024 deri më 01.10.2025, ka identifikuar sipas kriterëve specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

- a. Përafrimin e strukturës dhe veprimtarisë së Rezidencës Studentore Universitare Nr. 2 Sh. A sipas modeleve të institucioneve homologe të vendeve të BE-së.
- b. Përmirësimin e mëtejshëm të shërbimit duke pasur synim arritjen e standardeve europiane.
- c. Rritjen e nivelit profesional të punonjësve me qëllim rritjen e cilësisë së veprimtarisë së Rezidencës Studentore Universitare Nr.2, Sh.A.
- d. Trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të Rezidencës Studentore Universitare Nr. 2 Sh. A nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në seminare, trajnime apo kurse kualifikimi.
- e. Fuqizimin e infrastrukturës, kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe burimeve financiare të Rezidencës Studentore Universitare Nr.2, përgatitjen e materialeve informuese për kushtet, shërbimin e mirë dhe sigurinë e ofruar në ambientet për strehim që ofron për studentët.
- f. Garantimin e furnizimit me energji elektrike, ujë dhe mbi të gjitha në shlyerjen në kohë të të gjithë detyrimeve financiare përkatëse.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Strukturat drejtuese të RSU-së, nr.2, Sh.A., Tiranë, kanë për detyrë që të përgjigjen për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator në lidhje me bërjen të mundur për fuqizimin e infrastrukturës, kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe burimeve financiare të Rezidencës Studentore Universitare Nr.2, përgatitjen e materialeve informuese për kushtet, shërbimin e mirë dhe sigurinë e ofruar në ambientet për strehim që ofron për studentët.

Gjithashtu, strukturat drejtuese janë përgjegjëse për vënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionit të kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH-së.

4. Përgjegjësitë e audituesve.

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti i njësisë/RSU, nr.2, SHA dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale me kriteret e përcaktuara, i cili shprehet nëpërmjet dhënies së opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), si dhe Kodin e Etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinionit. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike si dhe të planifikojë e kryejë auditimin, me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar. Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-së) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinion mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

-Nëse janë zbatuar dispozitat ligjore për mbledhjen, ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit,

5. Kriteret e vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin përkatës që rregullon çështjet si drejtime të auditimit:

- *Ligji Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;*
- *Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar,*
- *Ligji nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,*

- *Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”*,
- *Ligjit 139/2015, datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;*
- *VKM nr.335 datë 04.05.2016 “Për transferimin 100/% të aksioneve të shoqërive aksionare ‘Rezidenca Studentore Universitare nr.1 Sh.A.Tiranë’;*
- *“Trajtimi i Studentëve nr. 2 Sh.A.Tiranë”; “Trajtimi i Studentëve nr. 3 Sh.A.Tiranë” nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes te Bashkia Tiranë”;*
- *Udhëzimi Nr.15, datë 2.5.2018 "Mbi Programet e Zhvillimit Ekonomik të Shoqërive Tregtare me Kapital Shtetëror"*
- *Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar,*
- *Vendimit nr.511, datë 24.10.2002, të Këshillit të Ministrave, “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, të ndryshuar,*
- *Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr.14, datë 23.11.2022 “Për miratimin e strukturës së Shoqërisë Rezidenca Studentore Universitare nr. 2, Sh.A.*
- *Rregullore për organizimin e brendshëm të punës në shoqërinë Rezidenca Studentore Universitare nr. 2, sh.a, miratuar me Vendimin Nr.15, datë 20.12.2022, “Për miratimin e Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Rezidencën Studentore Universitare nr.2”.*

6. Standardet e auditimit.

Standardet e zbatuara nga grupi i auditimit gjatë kryerjes së angazhimit të auditimit:

- ISSAI 400 (*Parime parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*), që përcakton parimet themelore të ISSAI 100 dhe i zhvillon më tej ato, duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 "*Prezantimi i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*";
- Manuali i Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve/ECA; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*"; etj.;
- Praktikat më të mira të fushës.

7. Metodatat e auditimit.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Nisur nga veçoritë e subjektit të audituar, RSU nr.2, SHA, funksionon në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme:

- Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
- Raportet dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe drejtimet e auditimit;
- Pyetësorët drejtuar subjektit*-duke marrë informacionet mbi numrin e vendimeve të arbitrazhit dhe GJEDNJ për vitin 2023, këmbimin e informacionit me institucionet përgjegjëse/palë interesi në çështje arbitrazhi;
- Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë

siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

8. Dokumentimi i auditimit.

Audituesit e KLSH, mbi bazën e dokumentacionit (evidencave) të kërkuar/a dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me nëpunësit e RSU-së, Nr.2, sha, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit, natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, e-mail-ve, të finalizuar këto në akt konstatimet e mbajtura në subjekt dhe më pas me shqyrtimin e observacioneve të subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raport Auditimi.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

RSU nr. 2 është shoqëri aksionare SH.A, e regjistruar me nipt-K51730022L, ku pronari aktual I shoqërisë është Bashkia Tiranë, sipas VKM-së nr.335, datë 04.05.2016 "Për transferimin e 100% të aksioneve të shoqërive aksionare "Rezidenca Studentore Universitare nr.2", Tiranë. Gjithashtu shoqëria funksionon në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligjit 139/2015, datë 17/12/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; VKM nr.335 datë 04.05.2016 "Për transferimin 100/% të aksioneve të shoqërive aksionare 'Rezidenca Studentore Universitare nr.1 Sh.A.Tiranë'; "Trajtimi i Studentëve nr. 2 Sh.A. Tiranë"; "Trajtimi i Studentëve nr. 3 Sh.A. Tiranë" nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes te Bashkia Tiranë"; Udhëzimit Nr.15, datë 2.5.2018 "Mbi Programet e Zhvillimit Ekonomik të Shoqërive Tregtare me Kapital Shtetëror", Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë me Nr.23, datë 26.08.2020 "Mbi krijimin e grupit të Menaxhimit Strategjik të Shoqërisë "Rezidenca Studentore Universitare Nr.2" SH.A; Administratori është përfaqësues zyrtar i Rezidencës Studentore Universitare Nr. 2, Sh.A.

Administratori i RSU nr. 2, e zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me ligjin nr. 7296 datë 20/04/1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", i ndryshuar.

Organet Drejtues dhe përbërja e Shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Organet Drejtuese të Shoqërisë

- Këshilli Mbikëqyrës
- Administrator
- 1. Përbërja e Shoqërisë
- ZV/Administrator
- As/Administrator
- Psikolog
- Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore
- Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse
- Drejtoria e Hotelerisë
- Drejtoria e Mirë administrimit
- Drejtoria Teknike
- Sektori i Auditit të Brendshëm

Këshilli Mbikëqyrës vëzhgon dhe mbikëqyr administrimin, zbatimin e politikave tregtare nga Administratori dhe kontrollon pajtueshmërinë me kërkesat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe të Statutit.

Funksioni kryesor i RSU nr.2 është:

- Akomodimi i studentëve në konvikte;
- Administrimi i ambienteve dhe shërbimeve sociale;
- Ofrimi i shërbimeve me tarifa të rregulluara nga shteti.
- Menaxhimi i konvikteve sipas standardeve të përcaktuara në ligj, rregullore dhe statut.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:

Në zbatim të programit të auditimit Nr. 1047/1 datë 03.11.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në RSU, nr. 2, SHA, u ushtrua auditim përputhshmërie për periudhën 01.01.2024-01.10.2025, sipas këtyre drejtimeve:

-Hartimi, miratimi dhe realizimi i programit ekonomik-financiar, në organet drejtuese të shoqërisë si dhe realizimi i tij.

-Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionin e strukturave drejtuese (Këshilli/Bord Mbikëqyrës dhe Drejtoria), vendimet e marra dhe zbatimi i tyre. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave, shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore

-Kontabilizimi i detyrimeve dhe masat e marra për ndjekjen dhe likuidimin e tyre, Dokumentimi dhe lëvizja e vlerave materiale dhe monetare, mbajtja e kontabilitetit, etj.

- Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimin e kontratave.

-Probleme të ndryshme që dolën gjatë auditimit.

Auditimi në RSU, nr.2, SHA, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar.

Në këtë subjekt, u evidentuan disa të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi.

2.1. Mbi hartimin, miratimi dhe realizimi i programit ekonomik-financiar, në organet drejtuese të shoqërisë si dhe realizimi i tij.

Mbi auditimin e ushtruar në Rezidencën Studentore Universitare Nr.2, Sh.A (*RSU Nr.2 sh.a*) në bazë të Programit të Auditimit të Përputhshmërisë nr.1047/1 prot, datë 03.11.2025, i mbajtur në datë 19.12.2025. Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit, **“Hartimi, miratimi dhe realizimi i programit ekonomik-financiar, në organet drejtuese të shoqërisë si dhe realizimi i tij”**, u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

1. *Programi ekonomik 2024-2025;*
2. *Relacionet përkatëse*
3. *Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës;*
4. *Vendimet e Asamblesë;*
5. *Analiza vjetore dhe 9-mujore.*

Viti 2024

Me Urdhrin nr. 64, datë 18.09.2023 “Për ngritjen e Grupit të punës për përgatitjen e projekt programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë për vitin 2024” Administratori i Rezidenca Studentore nr. 2 ka ngritur grupin e punës të përbërë nga Grupi i Menaxhimit Strategjik:

1. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse
2. Drejtor i Drejtorisë së Hotelerisë
3. Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore
4. Drejtor i Drejtorisë Teknike
5. Drejtor i Mirë administrimit

Afati i dorëzimit 16.10.2023.

Nga auditimi rezulton se Urdhri i mësipërm është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 15, datë 2.5.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, ku nuk specifikohet që duhet të jetë grupi i menaxhimit strategjik.

Me Shkresën nr. 253/5, datë 19.10.2023 “Relacioni shpjegues i projekt programit të zhvillimit ekonomik për vitin 2024 të Shoqërisë “Rezidenca Studentore nr. 2” Sha” Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse i ka dorëzuar relacioni Administratorit me vonesë dhe jo sipas afatit të përcaktuar në Urdhrin nr. 64, datë 18.09.2023 “Për ngritjen e Grupit të punës për përgatitjen e projekt programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë për vitin 2024”.

Grupi i punës ka dorëzuar me vonesë duke mos respektuar afatin e përcaktuar në Urdhrin nr. 64, datë 18.09.2023 “Për ngritjen e Grupit të punës për përgatitjen e projekt programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë për vitin 2024”.

Me Vendimin nr. 12, datë 27.10.2023 “Mbi programin e zhvillimit ekonomik të vitit 2024” Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar planin vjetor të vitit 2024.

Me shkresën nr. 253, datë 23.11.2023 “Dërgohet për miratim projekt programi i zhvillimit Ekonomik i Shoqërisë RSU nr. 2 për vitin 2024” Administratori i ka dërguar Asamblesë së Përgjithshme për miratim projekt programin.

Me Vendimin nr. 06, datë 12.12.2023 Asambleja ka miratuar Programin e Zhvillimit Ekonomik 2024.

*Në tabelën 1, sipas drejtimit 1, të programit të auditimit, në anekse, jepen **Të ardhurat nga aktiviteti***

Nga auditimi rezulton se të ardhurat për vitin 2024, sipas Buxhetit të vitit 2024, janë parashikuar në vlerën 278,850,000 lekë. Në vitin 2024 u realizuan në vlerën 209,277,402 lekë, mosrealizimi është në vlerën 69,572,598 lekë ose 75%.

- **Zëri “Të ardhurat nga qiraja e studentëve”** në vitin 2024, është realizuar në vlerën **108,452,808.00** lekë, nga **119,062,000** lekë të parashikuara në Projekt-Buxhetin e vitit 2024, mosrealizimi i të ardhurave nga qiraja e studentëve në vlerën 10,609,192 lekë ose realizimi në masën 91% ka ardhur si rezultat: Numri mesatar i studentëve që janë akomoduar pranë ambienteve të Rezidencës Studentore Universitare Nr.2 për periudhën Janar-Korrik dhe Tetor-Dhjetor viti 2024 është 1,654 studentë, dhe 278 studentë për periudhën Gusht-Shtator. Në Projekt-Buxhetin e vitit 2024, ishin parashikuar 1857 studentë dhe për muajin Gusht-Shtator 275 studentë verorë, numri i studentëve ka qenë 203 më pak se kapaciteti.

- **Zëri “Të ardhura nga qiratë e ambienteve”**. Në vitin 2024 është realizuar në vlerën **3,103,440** lekë, nga **3,103,440** lekë të parashikuara në Projekt-Buxhetin e vitit 2024, duke u realizuar në masën 100%.

- **Zëri “Të ardhura të tjera”** (lavanteri, rrobaqepësi, terrenet sportive etj.) nga **2,445,000** lekë parashikuar në Projekt-Buxhetin e vitit 2024, është realizuar në vlerën **2,208,600** lekë, duke u realizuar në vlerën **236,400** lekë, më pakë ose në % janë realizuar në masën 90%. Ky mosrealizim në vlerën 236,400 lekë është më pak, pasi numri i studentëve ka qenë 203 më pak se kapaciteti.

- **Zëri “Rimarrje amortizimi nga investimet”**. Nga **53,918,000** lekë parashikuar në Projekt-Buxhetin e vitit 2024 është realizuar në vlerën **31,512,554** lekë, duke u realizuar në vlerën **22,405,446** lekë, më pakë ose në % janë realizuar në masën 58%. Kjo ka ardhur si rezultati i mos përdorimit për gjithë vitin të aseteve të financuar nga KFË dhe Bashkia Tiranë si dhe mos kalimi i vlerës së godinave Nr.3 dhe Nr.4 sektori Mjekësi të rindërtuara me fondet e tërmetit nga Bashkia Tiranë.

- **Zëri “Të ardhurat nga subvencionit”**. Ne vitin 2024, është realizuar në vlerën **64,000,000** lekë, nga **100,322,000** lekë të parashikuara në Projekt-Buxhetin e vitit 2024, duke mos u akorduar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve vlera **36,322,000** lekë ose realizimi në masën

64%, kalimi i ulët i subvencionit ka dhënë efektin e saj në mos likuidimin e detyrimeve ndaj të tretave (FSHU dhe UKT për detyrimet e prapambetura).

Të ardhura të tjera nga kamatëvonesat dhe interesat janë në vlerën **97,423 lekë**. Në vitin 2024 në zërin të ardhura, është shtuar dhe zëri të ardhura nga subvencionet e shtyra, sipas pasqyrave financiare të vitit 2023 për mbulimin e kamatëvonesave nga Furnizuesi Shërbimit Universal në vlerën 6,672,564 lekë, e cila është paguar bazuar *Akt Marrëveshjes të datës 02.05.2023, protokolluar me Nr.156/Prot, datë 04.05.2023* të lidhur me Furnizuesin e Shërbimit Universal, për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe kamatëvonesave nga Ujësjetës Kanalizime Tiranë në vlerën 1,794,132 lekë e cila është paguar bazuar *Akt Marrëveshjes me Nr.5451 Prot, datë 25.10.2023, protokolluar me Nr.290 Prot, datë 27.10.2023* të lidhur me UKT, për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, *paraqitur në tabelën 2 sipas drejtimit 1, të programit të auditimit, në anekse.*

Të ardhurat në total për vitin 2024, krahasuar me vitin 2023 janë në vlerën **6,722,043 lekë** më shumë, kjo sipas zërave si më poshtë:

- *Zëri “Të ardhura nga qiraja studentëve”*. Për vitin 2024 janë në vlerën 13,083,908 lekë më shumë se vitit 2023, pasi për vitin 2023 kanë funksionuar 6 Godina A, B, C, D Sektori Inxhinieri dhe Nr.1 dhe Nr.2 Sektori Mjekësi, për periudhën Janar-Korrik dhe 8 Godina për periudhën Tetor –Dhjetor 2023, kurse në vitin 2024 funksionuan 4 Godina A, B, C, D Sektori Inxhinieri dhe 4 godina ne sektorin Mjekësi Nr.1, 2, 3, 4.
 - *Zëri “Të ardhura nga qiratë e ambienteve”* për vitin 2023 janë realizuar në të njëjtën vlerë pasi në vitin 2023 dhe në vitin 2024 janë të njëjtat objekte dhe vlera të dhëna me qira.
 - *Zëri “Të ardhura të tjera”*. Janë realizuar në vlerën 325,050 lekë më shumë, pasi në sektorin Inxhinieri për periudhën Shkurt-Dhjetor viti 2023, u vu në funksionim : Lavanteria e Godinave A-B sektori Inxhinieri.
 - *Zëri “Rimarrje amortizimi nga investimet”*. Për vitin 2024 është realizuar në vlerën 31,512,554 lekë, si rezultat dhe i përdorimit të aseteve të financuara nga Projekti KFË dhe Bashkia Tiranë.
 - *Zëri “Të ardhura nga subvencionit”*. Nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve janë realizuar në vlerën 10,100,000 lekë më pak se në vitit 2023.
- paraqitur në tabelën 3 sipas drejtimit 1, të programit të auditimit, në anekse.*

Për vitin 2024, shpenzimet janë në vlerën 54,407,163 lekë më pak, në krahasim me vlerën e parashikuar në Projekt-Buxhetin e vitit 2024, ku kanë ndikuar zërat si më poshtë:

- *Zëri “Shpenzime mallra, materiale të para dhe të tjera”*, janë realizuar në vlerën 11,630,434 lekë nga 24,437,000 lekë të parashikuara në Projekt-Buxhetin e vitit 2024. Gjatë kësaj periudhe totali i blerjeve për këtë zë është në vlerën 15,668,114 lekë, diferenca në vlerën 4,037,680 lekë është gjendje në magazinë. Peshën kryesore e zë “Lëndë djegëse gazoil për Kaldajat”, i cili është konsumuar në vlerën 7,581,985 lekë duke zënë 65% të vlerës totale, ndërsa shpenzimet për materialet elektrike, hidraulike, ndërtime, marangozi, detergjente, shtypshkrime janë në vlerën 4,048,449 lekë ose në masën 35% të totalit.
- *Zëri “Furnitura (energji-ujë, telefon, internet, qira magazine, shërbime postare, bankare etj.)”* për vitit 2024 janë realizuar në vlerën 43,849,699 lekë nga 53,636,000 lekë të parashikuara në Projekt-Buxhetin e vitit 2024, shuma 9,786,301 lekë është më pak se parashikimi i bërë në vitin 2024.
- *Zëri “Paga e personelit”*. Sipas Projekt-Buxhetit të vitit 2024 janë në vlerën 105,182,000 lekë, për vitin 2024 janë realizuar në vlerën 99,915,213 lekë, shuma 5,266,787 lekë është më pak se parashikimi i bërë në vitin 2024.
- *Zëri “Sigurime Shoqërore e Shëndetësore”*. Për vitin 2024 është shpenzuar në vlerën

16,690,412 lekë, nga 17,566,000 lekë të parashikuara në Projekt-Buxhetin e vitit 2024, shuma 875,588 lekë është me pak se parashikimi për të njëjtat arsye si Zëri “Paga e personelit.

- Zëri “*Trajtime, shpërblime, paga Këshilli Mbikëqyrës*”. Për vitin 2024 është realizuar në vlerën 1,189.580 lekë nga 1,479,000 lekë të parashikuara në Projekt - Buxhetin e vitit 2024, shuma 289,420.00 lekë është më pak se parashikimi i bërë në vitin 2024..

- Zëri “*Tatime, taksa (vendore, automjeti)*”. Për vitin 2024 është realizuar në vlerën 605,198 lekë. Gjatë vitit 2024 taksa e ndërtesës është rritur dhe ka shkuar në vlerën totale 480,060 lekë + 86,275 lekë. Në Projekt-Buxhetin e vitit 2024, fondi për zërin “*Shpenzime për taksat vendore*” është parashikuar në vlerën 320,000 lekë me TVSh. Për të plotësuar diferencën që mbetet në këtë zë është përdorur zëri “*Tarifa dhe detyrime hipotekore*” në Projekt-Buxhetin e vitit 2024, i cili është në vlerën 420,000 lekë. Është paguar kësti i parë që ishte me afat deri më datë 20 Prill 2024, kurse kësti i dytë i Taksës së Ndërtesës që është në vlerën 240,030 lekë dhe kishte afat për t’u paguar deri më datë 30 Qershor 2024. Me miratimin e Këshillit Mbikëqyrës, pagesa e Këstit të Dytë të Taksës së Ndërtesës, fondi i mbetur në zërin “*Shpenzime për taksat vendore*” në vlerën 64,970 lekë dhe vlera 175,060 lekë në zërin “*Tarifa dhe detyrime hipotekore*” (64,970 lekë +175,060 lekë) janë përdorur për likuidimin e pagesës në vlerën totale 240,030 lekë. Referuar njoftimit të datës 28.08.2024 “*Njoftim detyrimi*” nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Tiranë, nëpërmjet portalit e-albania detyrimet shtesë për taksën e ndërtesës për vitin 2023 për Shoqërinë “*Rezidenca Studentore Universitare Nr.2*” Sh.a janë në vlerën 86,275 (tetëdhjetë e gjashtëmijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë. Ky detyrim ka dalë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.457, datë 26.7.2023 “*Për disa ndryshime në Vendimin Nr.132, datë 7.3.20218 të Këshillit të Ministrave “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së tatueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesa e bazës së taksës për kategori specifike , natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës si dhe kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës*” i ndryshuar, i cili nuk u vu në zbatim për vitin 2023. Me rishikimin e detyrimeve shtesë të Vendimit Nr.457, datë 26.7.2023 të Këshillit të Ministrave, vënë në zbatim me Vendimin Nr.35, datë 28.03.2024 nga Këshilli Bashkiak i Tiranës “*Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.158, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës*” i ndryshuar, neni 78/1 citohet se: *Përrjashtimisht, detyrimet shtesë që kanë lindur si rezultat i hyrjes në fuqi të vendimit nr. 457, datë 26.07.2023, të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr.132, datë 07.03.2018, të Këshillit të Ministrave “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, të ndryshuar, duhet të shlyhen brenda datës 30 Shtator 2024, ky detyrim u likuidua nga fondi i zëri “Tarifa dhe detyrime hipotekore” i parashikuar në vlerën 420,000 (katërqind e njëzetë mijë) lekë. Nga ky zë është kryer pagesa e Këstit të Dytë të Taksës së Ndërtesës, e cila është likuiduar brenda datës 30 Qershor 2024, për diferencë në vlerën 175,060 (njëqind e shtatëdhjetë e pesëmijë e gjashtëdhjetë) lekë dhe shtesa e taksës së ndërtesës për vitin 2023 në vlerën totale 86,275 (tetëdhjetë e gjashtëmijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.*

- Zëri “*Vendime gjykate*”. Për vitin 2024 është realizuar në vlerën 482,000 lekë nga 2,438.000.00 lekë të parashikuara në Projekt - Buxhetin e vitit 2024. Për vitin 2024 është kryer ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shërbimeve përmbartimore në vlerën 482,000 lekë.

- Zëri “*Shpenzime për ekspertë kontabël për auditimin e Pasqyrave Financiare*”. Është realizuar në vlerën 441,240 lekë, ku është prokuruar zëri i Audituesve të Pasqyrave Financiare për vitin 2023 i parashikuar në vlerën 468,000 lekë.

- Në vitin 2024 në zërin shpenzime, është shtuar dhe zëri kamatëvonesa për Furnizuesin e

Shërbimit Universal dhe Ujësjiellës Kanalizime Tiranë në vlerën 8,466,696 lekë, e cila është paguar bazuar Akt -Marrëveshjes të datës 02/05/2023, protokolluar me Nr. 156 /Prot, datë 04.05.2023 të lidhur me Furnizuesin e Shërbimit Universal dhe Akt - Marrëveshjes të datës 25.10.2023 me Ujësjiellës Kanalizime Tiranë për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

- *Zëri “Amortizim”*. Është llogaritur në vlerën 40,483,867.00 lekë nga 63,155,000 lekë të parashikuara në Projekt-Buxhetin e vitit 2024, kjo bazuar në asetet që janë përdorur gjatë vitit 2024.

Totali i shpenzimeve për periudhën Janar -Dhjetor 2024 është në vlerën totale 224,442,836 -196.980 gjendje në magazinë vegla pune = 224,245,857 lekë, *paraqitur në tabelën 4 sipas drejtimit 1, të programit të auditimit, në anekse.*

Shpenzimet në total për vitin 2024, duke i krahasuar edhe me vitin 2023 janë me një diferencë prej 33,023,936 lekë më shumë. Ku zërat “Mallra, materiale të para, lëndë djegëse dhe të tjera”, furnitura (energji-ujë, telefon internet, shërbime postare, bankare, qira magazine etj) pagat e personelit, sigurime shoqërore e shëndetësore, vendime gjykate dhe shpenzime përmbarimore janë rritur më shumë, si më poshtë :

- *Zëri “Shpenzime mallra, materiale të para dhe të tjera”*. Janë realizuar në vlerën 3,184,765 lekë më shumë se në vitin 2023, kjo për arsye se konsumi i tyre ka qenë më i lartë, pasi në vitin 2024 janë hapur 8 godina nga 6 godina që ishin hapur në vitin 2023 për periudhën Janar-Korrik, si rezultat numri i studentëve të akomoduar është më i lartë, që automatikisht të çon në rritjen e shpenzimeve.

- *Zëri “Furnitura (energji-ujë, telefon, internet, qira magazine, shërbime postare, bankare etj)*. Janë shpenzuar në vlerën 8,981,443 lekë më shumë se në vitin 2023. Kjo për arsye se: Konsumi i tyre ka qenë më i lartë, pasi dhe numri i studentëve është më shumë se në vitin 2023 me hapjen e Godinave Nr.3 dhe Nr.4 sektori Mjekësi, referuar dhe impaktit financiar që pati rritja e çmimit të energjisë elektrike në masën 0.77% dhe e gjithë shërbimeve të tjera.

- *Zëri “Zëri Paga e personelit dhe sigurime shoqërore e shëndetësore”*. Janë realizuar në vlerën 14,424,750.00 lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2023, pasi në muajin Janar 2024, bazuar Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës me Vendimin Nr.11, datë 27.10.2023 u miratua Struktura e Shoqërisë “*Rezidenca Studentore Universitare Nr.2*”, Sh.A me 156 punonjës, sipas pozicioneve përkatëse dhe u miratua efekti financiar i fondit të pagave të Shoqërisë për vitin 2024, duke filluar zbatimin nga data 01 Janar 2024, si dhe zbatimit të ndryshimeve të bëra sipas VKM nr.503, datë 1.8.2024 “*Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.5.2023 të Këshillit të Ministrave, për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësisve të vetëqeverisjes vendore*”, pika 3/ç janë bërë ndryshimet në “*Kategoritë dhe klasat për pozicionin e punës, element përbërës të pagës të pagës bruto mujore dhe vlerën për secilën element për funksionarët e kabineteve dhe për nëpunësin civil*” dhe “*Ndryshimet mbi llogaritjen e vjetërsisë së punonjësve në punë*”, bazuar Vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës Nr.11, datë 25.09.2024 si dhe rritjen e pagave të punonjësve për periudhën Tetor-Dhjetor bazuar Vendimit Nr.12, datë 23.10.2024 të Këshillit Mbikëqyrës.

- *Zëri “Trajtime, shpërblime, paga Këshillit Mbikëqyrës”*. Është realizuar në vlerën 30,316 lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2023. Pasi për periudhën Tetor- Dhjetor bazuar Vendimit Nr.12, datë 23.10.2024 të Këshillit Mbikëqyrës masa e shpërblimit u rritë edhe për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës.

1. *Zëri “Tatime, taksa (vendore+ automjeti)”*. Është realizuar në vlerën 293,117 lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2023, për arsye se taksa e ndërtesës për vitin 2024 është rritur në zbatim të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për Sistemin e Taksave Vendore*” i ndryshuar, VKM nr.132 dt.07.03.2018 “*Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të*

pasurisë së paluajtshme 'ndërtesa', e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.158, datë 26.12.201“Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në qytetin e Tiranës” i ndryshuar dhe Ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Me rishikimin e detyrimeve shtesë të Vendimit Nr.457, datë 26.7.2023 të Këshillit të Ministrave, vënë në zbatim me Vendimin Nr.35, datë 28.03.2024 nga Këshilli Bashkiak i Tiranës për detyrime shtesë për vitin 2023.

2. Zëri “Shpenzime për ekspertë kontabël për auditimin e Pasqyrave Financiare”. Është realizuar në vlerën 141,243 lekë, më shumë se viti 2023, për arsye se në vitin 2024 vlera e Aktivit + të ardhurat si kriter për orët e punës së audituesit të PF për vitin 2023 u parashikuan mbi 1-1.4 miliardë lekë me nivel referues (100-160) orë pune, tarifë/ore 3,000 lekë pa TVSH.

- Zëri “Vendime gjykate”. Është realizuar në vlerën 502,186 lekë më pak se e njëjta periudhë e vitit 2023, pasi është ekzekutuar vetëm një vendim gjykate për këtë periudhë.

- Në vitin 2024 zëri kamatëvonesa për Furnizuesin e Shërbimit Universal dhe Ujësjetës Kanalizime Tiranë është në vlerën 3,713,297 lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2023, kjo pasi Akt - Marrëveshjes të datës 02/05/2023, protokolluar me 156/Prot, datë 04.05.2023 të lidhur me Furnizuesin e Shërbimit Universal dhe Akt - Marrëveshjes të datës 25.10.2023 me Ujësjetës Kanalizime Tiranë për likuidimin e detyrimeve të prapambetura për vitin 2024 janë zbatuar që nga muaji Janar, kurse në vitin 2023 Akt - Marrëveshjes me Furnizuesin e Shërbimit Universal u vu në zbatim në Maj të vitit 2023, kurse Akt-Marrëveshjes me Ujësjetës Kanalizime Tiranë në muajin Nëntor të vitit 2023. Për vitin 2024 këto marrëveshje u zbatuan për periudhën Janar-Dhjetor 2024.

Viti 2025

Aktiviteti është bazuar edhe mbi programin vjetor të hartuar dhe të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë Nr.06, datë 13.11.2024 dhe nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve të Shoqërisë Nr.06, datë 05.12.2024 për vitin 2025, *paraqitur në tabelën 5 sipas drejtimit 1, të programit të auditimit, në anekse.*

Të ardhurat për 9/mujorin e vitit 2024 nga 204,238,5000 lekë të parashikuar në Projekt-Buxhetin e vitit 2024, u realizuan në vlerën 158,148,504 lekë, duke mos u realizuar në vlerën 46,089,997 ose janë realizuar në masën 77%.

Të analizuar zërat si më poshtë:

Zëri “Të ardhurat nga qiraja e studentëve” në 9/mujorin e vitit 2024, nga **84,400,000 lekë** parashikuar në Projekt- Buxhetin e vitit 2024 është realizuar në vlerën **76,581,508 lekë**, duke mos u realizuar në vlerën **7,818,492 lekë** ose në % janë realizuar në masën 91%. Realizimi i të ardhurave nga qiraja e studentëve në masën 91%, ka ardhur si rezultat se gjatë kësaj periudhe kanë funksionuar të 8 (tetë) godinat që ka në administrim Shoqëria, numri mesatar i studentëve që janë akomoduar për periudhën Janar-Korrik viti 2024 është 1,638 Studentë nga 1,857 që është kapaciteti dhe studentë verorë për periudhën Gusht-Shtator janë akomoduar 278 studentë, *paraqitur në tabelën 6 sipas drejtimit 1, të programit të auditimit, në anekse.*

- **Zëri “Të ardhura nga qiratë e ambienteve”** nga **2,327,000.00 lekë** parashikuar në Projekt-Buxhetin e vitit 2024 është realizuar në vlerën **2,327,580.00 lekë**, duke u realizuar në vlerën e parashikuar ose në % janë realizuar në masën 100%.

- **Zëri “Të ardhura të tjera”**(lavanteri, rrobaqepësi, terrenet sportive etj) nga **1,833,000.00 lekë** parashikuar në Projekt-Buxhetin e vitit 2024 është realizuar në vlerën **1,605,000.00 lekë**, duke mos u realizuar në vlerën **228,000,00 lekë**, ose në % janë realizuar në masën 88%. Ky

mosrealizim në vlerën 228,000.00 lekë është më pak, pasi numri i studentëve ka qenë 219 më pak se kapaciteti.

- **Zëri “Të ardhurat nga subvencionit”** nga **75,240,000.00 lekë** parashikuar në Projekt Buxhetin e vitit 2024 për periudhën Janar-Shtator viti 2024, Ministria e Arsimit dhe Sporteve ka kaluar vlerën **54,000,000.00 lekë**, pra **21,240,000.00 lekë** më pak ose në % janë realizuar në masën 72%.

- **Zëri “Rimarrje amortizimi nga investimet”** në 9/mujorin e vitit 2024, sipas Projekt Buxhetit të vitit 2024 janë parashikuar në vlerën **40,438,500.00 lekë**, për 9/mujorin e vitit 2024 është 23.634.416.00 në bazë të përdorimit të bazës materiale mbi të cilën llogaritet ky zë .

- Të ardhurat në total për këtë periudhë janë në vlerën **158,148,504.00** sipas Tab.nr1/1+ të ardhurat nga subvencionit i shtyrë për likuidim të kamatëvonesave në vlerën **6,350,022.00 lekë** + të ardhura nga kamatëvonesat në vlerën **68,226.00 lekë** = **164,566,752.00 lekë**, *paraqitur në tabelën 7 sipas drejtimit 1, të programit të auditimit, në anekse.*

Të ardhurat për 9/mujorin e vitit 2025, sipas Projekt Buxhetit të vitit 2025 janë parashikuar në vlerën 212,053,750.00 lekë, për 9/mujorin e vitit 2025 u realizuan në vlerën 170,045,449.00 lekë, duke mos u realizuar në vlerën 42,008,301.00 lekë ose janë realizuar në masën 80%.

Të analizuar zërat e tabelës si më poshtë:

- **Zëri “Të ardhurat nga qiraja e studentëve”** në 9/mujorin e vitit 2025, sipas Projekt Buxhetit të vitit 2025 janë parashikuar në vlerën **84,862,000.00 lekë**, për 9/mujorin e vitit 2025 u realizuan në vlerën 79,551,378.00 lekë, duke mos u realizuar në vlerën 5,310,622.00 lekë ose janë realizuar në masën 94%. Numri mesatar i studentëve që janë akomoduar për periudhën Janar-Korrik viti 2025 është 1,719 studentë, kurse sipas Projekt Buxhetit të vitit 2025 janë parashikuar të akomodohen 1,857 studentë faktikisht janë 138 studentë më pak, kjo si rezultat i mosfunksionimit me kapacitet të plotë i Godinave Nr.1 dhe Nr.2 Sektori Mjekësi, të cilat janë të vjetra dhe me bazë materiale të amortizuara sipas tabelës si më poshtë: dhe studentë verorë për periudhën Gusht-Shtator janë akomoduar 238 studentë, *paraqitur në tabelën 8 sipas drejtimit 1, të programit të auditimit, në anekse.*

- **Zëri “Të ardhura nga qiratë e ambienteve”** për 9/mujorin e viti 2025, sipas Projekt Buxhetit të vitit 2025 janë parashikuar në vlerën **2,327,000.00 lekë**, për 9/mujorin e vitit 2025 u realizuan në vlerën **2,327,580.00 lekë**, pasi janë të njëjtat ambiente të dhëna me qira, në Sektorin Inxhinieri objektin “Mencë” dhe ambientin e jashtëm “Kioskë” në Godinën Nr.1 Sektori Mjekësi.

- **Zëri “Të ardhura të tjera”** (lavanteri, rrobaqepësi, terrenet sportive, vërtetime etj) në 9/mujorin e vitit 2025, sipas Projekt Buxhetit të vitit 2025 janë parashikuar në vlerën **1,833,000.00 lekë**, për 9/mujorin e vitit 2025 u realizuan në vlerën **1,552,100.00 lekë**, duke mos u realizuar në vlerën 281,100.00 lekë. Kjo si rezultat i mosfunksionimit me kapacitet të plotë i Godinave Nr.1 dhe Nr.2 Sektori Mjekësi të cilat janë të vjetra dhe me bazë materiale të amortizuara

- **Zëri “Të ardhurat nga subvencionit”** në 9/mujorin e vitit 2025, sipas Projekt Buxhetit të vitit 2025 janë parashikuar **81,263,000.00 lekë**, Ministria e Arsimit dhe Sporteve për periudhën Janar –Shtator 2025 ka kaluar vlerën **54,000,000.00 lekë**, pra **27,263,000.00 lekë** më pak nga parashikimi ose janë realizuar në masën 66%.

- **Zëri “Të ardhura të tjera (subvencion i shtyrë, penalitete)”** në 9/mujorin e vitit 2025, sipas Projekt Buxhetit të vitit 2025 janë parashikuar në vlerën **6,350,000.00 lekë**, për 9/mujorin e vitit 2025 u realizuan në vlerën **6,350,022.00 lekë**, si dhe një rritje nga parashikimi në vlerën **55,496.00 lekë** si rezultat i kamatëvonesave të likuidimit me vonesë të faturave nga dy subjektet C. C., J. P. dhe penalitete të tjera.

- **Zëri “Rimarrje amortizimi nga investimet”** në 9/mujorin e vitit 2025, sipas Projekt Buxhetit të vitit 2025 janë parashikuar në vlerën **35,418,750.00** lekë, për 9/mujorin e vitit 2025 është, 26,264,369,00 lekë dhe do të saktësohet në fund të vitit në bazë të përdorimit të bazës materiale mbi të cilën llogaritet ky zë.

Të ardhurat në total për këtë periudhë janë në vlerën **170,100,945.00** lekë, *paraqitur në tabelën 9 sipas drejtimit 1, të programit të auditimit, në anekse.*

Sipas tabelës të ardhurat në total për 9/mujorin e vitit 2025, krahasuar me 9/mujorin e vitit 2024 janë në vlerën **5,546,923.98** lekë më shumë, kjo sipas zërave si më poshtë:

- **Zëri “Të ardhura nga qiraja e studentëve”** për 9/mujorin e vitit 2025 janë në vlerën **2,,969,870.00** lekë më shumë se 9/mujori i vitit 2024. Numri mesatar i studentëve që janë akomoduar për periudhën Janar-Korrik viti 2025 është 1,719 studentë, kurse për periudhën Janar-Korrik viti 2024 ishte 1,638 studentë, pra 81 studentë më shumë se në vitin 2024.

- **Zëri “Të ardhura nga qiratë e ambienteve”** për 9/mujorin e vitit 2025 janë realizuar në vlerën **2,327,580** lekë, ky zë nuk ka ndryshim me vitin 2024, pasi janë të njëjta ambiente të dhëna me qira, në Sektorin Inxhinieri objektin “Mencë” dhe ambientin e jashtëm “Kioskë” në Godinën Nr.1 Sektori Mjekësi.

- **Zëri “Të ardhura të tjera”** (lavanteri, rrobaqepësi, terrenet sportive, vërtetime) janë realizuar në vlerën **52,900** lekë më pakë se viti 2024, pasi lavanteria e godinës nr. 2 sektori mjekësi nuk ka funksionuar për arsye të amortizimit të makinave larëse dhe tharëse.

- **Zëri “Të ardhura nga subvencioni”** nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve janë në vlerën të njëjtë. Nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, nuk ka pasur mbështetje për të kaluar vlerën e plotë të subvencionit të kërkuar nga Shoqëria “Rezidencës Studentore Universitare Nr.2” Sh.a.

- **Zëri “Të ardhura të tjera (subvencion i shtyrë, penalitete)”** janë realizuar në vlerën **29,250,00** lekë më shumë se viti 2024, pasi vlera e kamatëvonesave të llogaritura është më shumë.

Zëri “Ri marrje amortizimi nga investimet” për vitin 2025 është e llogaritur në vlerën 2,629,953.98 leke më shumë, pasi llogaritet mbi vlerën e mbetur në fund të vitit 2024 me metodën lineare si dhe asetëve që janë në përdorim gjatë vitit ushtrimor, *paraqitur në tabelën 10 sipas drejtimit 1, të programit të auditimit, në anekse.*

Për periudhën Janar-Shtator viti 2025, shpenzimet janë në vlerën **38,851,403.32** lekë më pak, në krahasim me vlerën e parashikuar në Projekt Buxhetin e vitit 2025, ku kanë ndikuar zërat si më poshtë:

- **Zëri “Shpenzime mallra, materiale të para dhe të tjera”**, janë realizuar në vlerën **9,204,240.00** lekë nga **14,990,000.00** lekë të parashikuara në Projekt Buxhetin e vitit 2025, shuma **5,182,273.23** lekë është më pak se parashikimi i bërë në vitin 2025. Për 9/mujorin e vitit 2025 nga procedurat e prokurimit janë realizuar zëri lënda djegëse gazoil për Kaldajat e Godinave Nr.1 dhe Nr.2 Sektori Mjekësi, lëndë djegëse pelet për Kaldajat e Godinave Nr.3 dhe Nr.4 Sektori Mjekësi, pjesë këmbimi për kaldajat e mjetet e transportit si dhe materiale të tjera në vlerën. Nga gjendja e magazinës më datë 31.12.2024, totali i shpenzimit për këtë zë si 9/mujor është 603,486.77 ne total ky shpenzim është 9,204,240 + 603,486.77 = 9,807,726.77 lekë.

- **Zëri “Furnitura (energji-ujë, telefon, internet, qira magazine, shërbime postare, bankare etj)”** për 9/mujorin e vitit 2025 janë realizuar në vlerën **28,210,077.90** lekë nga **37,005,000.00** lekë të parashikuara në Projekt Buxhetin e vitit 2025, shuma **8,794,922.10** lekë është më pak se parashikimi i bërë në vitin 2025.

- **Zëri “Paga e personelit ”** në 9/mujorin e vitit 2025 sipas Projekt Buxhetit të vitit 2025 janë në vlerën **87,904,500.00** lekë, për 9/mujorin e vitit 2025 janë realizuar në vlerën **80,131,504.00** lekë, shuma **7,772,996.00** është më pak se parashikimi i bërë në vitin 2025, pasi kjo ka ardhur

si rezultat i raporteve mjekësore të paguara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, leje barrë lindje dhe lëvizjes së punonjësve.

- **Zëri “Sigurime Shoqërore e Shëndetësore”** për 9/mujorin parë të vitit 2025 është shpenzuar në vlerën **13,383,260.00** lekë, nga **14,679,000.00** lekë të parashikuara në Projekt-Buxhetin e vitit 2025, shuma **1,295,739.59** është më pak se parashikimi i bërë në vitin 2025, për të njëjtat arsye si zëri “Paga e personelit”.
- **Zëri “Trajtime, shpërblime, paga Këshilli Mbikëqyrës”** për 9/mujorin parë të vitit 2025 është realizuar në vlerën **824,500.00** lekë, nga **938,000.00** lekë të parashikuar në Projekt Buxhetin e vitit 2025, shuma **113,500.00** lekë është më pak se parashikimi i bërë në vitin 2025, pasi personat që ishin parashikuar për të dalë në pension, për nevojat e shoqërisë iu është shtyrë dalja në pension.
- **Zëri “Tatime, taksa (vendore + automjeti)”** për 9/mujorin e vitit 2025 është realizuar në vlerën **519,753.00** lekë nga **520,000.00** lekë të parashikuar në Projekt Buxhetin e vitit 2025, shuma **247.00** lekë është më pak se parashikimi i bërë në vitin 2025.
- **Zëri “Vendime gjykatë”** për 9/mujorin e vitit 2025 është realizuar në vlerën **977,836.00** lekë nga **2,448,000.00** lekë të parashikuara në Projekt Buxhetin e vitit 2025, **1,470,164.00** lekë është më pak se parashikimi i bërë në vitin 2025. Për 9/mujorin e vitit 2025 është kryer ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shërbimeve përmbarimore në vlerën **977,836.00** lekë.
- **Zëri “Shpenzime për ekspertë kontabël për auditimin e Pasqyrave Financiare”** për 9/mujorin e vitit 2025 është realizuar në vlerën **360,000.00** lekë, ku është prokuruar zëri i Audituesve të Pasqyrave Financiare për vitin 2025 i parashikuar në vlerën **468,000.00** lekë, duke u realizuar në vlerën **108,000.00** lekë më pak.
- Në 9/mujorin e vitit 2025, është dhe **Zëri Kamatëvonesa për Furnizuesin e Shërbimit Universal dhe Ujësjiellës Kanalizime Tiranë** në vlerën **6,350,022.00** lekë, e cila është paguar bazuar Akt Marrëveshjes të datës 02.05.2023, protokolluar me Nr. 156/Prot., datë 04.05.2023 të lidhur me Furnizuesin e Shërbimit Universal dhe Akt Marrëveshjes të datës 25.10.2023 me Ujësjiellës Kanalizime Tiranë për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Totali i shpenzimeve për periudhën Janar-Shtator 2025 është në vlerën totale **174,004,096.68** lekë., paraqitur në tabelën 11 sipas drejtimit 1, të programit të auditimit, në anekse.

Shpenzimet në total për 9/mujorin e vitit 2025, krahasuar me 9/mujorin e vitit 2024, janë në vlerën **12,690,673.77** lekë më shumë, kjo sipas zërave si më poshtë:

- **Zëri “Shpenzime mallra, materiale të para dhe të tjera”** janë realizuar në vlerën **2,241,673.77** lekë më shumë se në 9 /mujorin e vitit 2024, kjo për arsye se numri i studentëve të akomoduar është më i lartë.
- **Zëri “Furnitura (energji-ujë, telefon, internet, qira magazine, shërbime postare, bankare etj)** janë shpenzuar në vlerën **2,546,889.6** lekë më pak se në vitin 2024.
- **Zëri “Paga e personelit dhe sigurime shoqërore e shëndetësore”** janë realizuar në vlerën **8,029,972** lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2024, pasi në muajin Janar 2025, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me Vendimin Nr.12, datë.23.10.2024. Fondi total i pagave + sigurime për vitin 2025 është parashikuar në vlerën **136,779,402** lekë.
- **Zëri “Trajtime, shpërblime, paga Këshillit Mbikëqyrës”** është realizuar në vlerën **54,900** lekë më pak se e njëjta periudhë e vitit 2024, pasi në vitin 2025 vetëm një person ka dalë në pension.
- **Zëri “Tatime, taksa (vendore + automjeti)”** është realizuar në **85,445** lekë më shumë ky detyrim ka dalë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.457, datë 26.7.2023 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr.132, datë 7.3.20218 të Këshillit të Ministrave “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së tatueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesa e bazës së taksës për

kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës si dhe kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” i ndryshuar, i cili nuk u vu në zbatim për vitin 2023. Me rishikimin e detyrimeve shtesë të Vendimit Nr.457, datë 26.7.2023 të Këshillit të Ministrave, vënë në zbatim me Vendimin Nr.35, datë 28.03.2024 nga Këshilli Bashkiak i Tiranës “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.158, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” i ndryshuar, neni 78/1 citohet se: *Përfundimisht, detyrimet shtesë që kanë lindur si rezultat i hyrjes në fuqi të vendimit nr. 457, datë 26.07.2023, të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr.132, datë 07.03.2018, të Këshillit të Ministrave “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, të ndryshuar, duhet të shlyhen brenda datës 30 shtator 2024, ky detyrim është likuiduar nga fondi i zëri “Tarifa dhe detyrime hipotekore” i parashikuar në vlerën 420,000.00 (katërqind e njëzetë mijë) lekë*

- **Zëri “Shpenzime për ekspertë kontabël për auditimin e Pasqyrave Financiare”** është realizuar në vlerën **81,240 lekë**, më pak se e njëjta periudhë e vitit 2024.
- **Zëri “Vendime gjykate”** është realizuar në vlerën **495,836 lekë** më shumë, pasi në vitin 2024 është ekzekutuar vetëm një vendim gjykate, ndërsa për vitin 2025 janë ekzekutuar tre vendime gjykate.

Në përfundim të pasqyrimit të gjithë zërave, të ardhura dhe shpenzime shikojmë që rezultati financiar për 9/mujorin e vitit 2025 rezulton me humbje.

Totali i të ardhurave, 170,045,449 lekë.

Totali i shpenzimeve, 174,004,097 lekë.

Rezultati 3,958,648 lekë.

Shoqëria Rezidenca Studentore Universitare Nr.2 Sh.A për 9/mujorin e vitit ushtrimor 2025, rezulton me humbje në vlerën 3,958,648.00 lekë si rezultat i muajve Gusht-Shtator ku studentet largohen të ardhurat janë të ulëta por shpenzimet rriten si rezultat i shërbimeve që bëhen për përgatitjen e ambienteve për fillimin e vitit të ri akademik.

Detyrimet e RSU nr. 2, SHA, deri më datë 31.12.2024, sipas pasqyrave financiare të vitit 2024.

Nga RSU nr. 2, është ndjekur i gjithë sistemi i pagesave që kanë të bëjnë me likuidimet e detyrimeve ndaj shoqërisë si dhe janë realizuar pagesat për detyrimet ndaj të tretëve dhe personelit të punësuar në shoqërinë. Trajtimi financiar me paga, sigurime shoqërore e shëndetësore, brenda afateve të përcaktuara në kontratën dhe legjislacionit tatimor në fuqi si më poshtë:

- Kryerja e të gjitha pagesave të personelit ku përfshihen trajtimi financiar me paga, sigurime shoqërore e shëndetësore, tatimi në burim të cilat janë kryer brenda afateve.

Kryerja e pagesave ndaj të tretëve, janë likuiduar brenda afateve ligjore të gjitha detyrimet e lindura në viti 2024 ndaj Furnizuesit të Shërbimit Universal, Ujësjiellës Kanalizime Tiranë, furnitorit të gazoilit, peletit, siguracionit të automjeteve, taksës së automjeteve, taksat vendore etj. Gjithashtu Shoqëria duke qenë në një situatë likuiditeti më të mirë se vitet e kaluara, ka bërë të mundur likuidimin e detyrimeve të mbartura nga vitet e kaluara. Lista e detyrimeve në pritje për t’u likuiduar, *paraqitur në tabelën 12 sipas drejtimit 1, të programit të auditimit, në anekse.*

Detyrime të tjera afatshkurtër është dhe garancia e objektit “Kioskë” të dhënë me qira në vlerën 39,000.00 lekë.

Zëri FSHU detyrime sipas Akt--Marrëveshjes në vlerën 37,626,305 lekë likuidohen sipas aktmarrëveshjes me këste mujore në vlerën 940,660 lekë dhe është në vazhdim duke likuiduar këstet/mujore rregullisht.

Zëri UKT detyrime sipas Akt-Marrëveshjes likuidohen sipas aktmarrëveshjes me këste mujore në vlerën 615,334.01 lekë e cila është mbyllur me sukses në muajin tetor 2025.

Zërat nga 3-11 janë faturime të muajit Dhjetor dhe janë likuiduar brenda afatit ligjor (Janar 2025), *paraqitur në tabelën 13 sipas drejtimit 1, të programit të auditimit, në anekse.*

Këto detyrime janë të pasqyruara në tabelën e mësipërme me vlerën e detyrimit dhe sipas periudhës që është krijuar ky detyrim. Në lidhje me zërin ujësjellës ekziston një detyrim në vlerën 4,504,079.00 lekë, i cili në kontabilitet rezulton që nga vitet 2006-2007.

Nga auditimi konstatohet se nuk ka një rakordim me Ujësjellës Kanalizime Tiranë, me qëllim saktësimin e këtij detyrimi.

Detyrimet të cilat janë të pasqyruara nga vitet 2011, 2012, 2013 janë detyrime të cilat janë lënë në formën e garancisë për punimet që ka kryer secili operator pranë shoqërisë "Trajtim Studenti Nr.2", *paraqitur në tabelën 14 sipas drejtimit 1, të programit të auditimit, në anekse.*

Shënim: Detyrimet për personelin Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore dhe TAP për muajin Dhjetor 2024 në vlerën 3,107,915.00 lekë, janë likuiduar në Janar të vitit 2025 brenda afatit kohor.

Sipas tabelës nr.15 janë të pasqyruara detyrimet e të tretëve nga subjekte për ambientet e dhëna me qira nga Shoqëria. Ky detyrim ka lindur si rezultat i prishjes së kontratës me subjektin "G. P." dhe nuk është likuiduar, pasi subjekti është në proces gjyqësor.

2.2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionin e strukturave drejtuese (Këshilli/Bord Mbikëqyrës dhe Drejtoria), vendimet e marra dhe zbatimi i tyre. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave, shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore.

-Auditimi i këtij drejtimi të programit u bazua në shqyrtimin e dokumentacionit si më poshtë:

-*Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin;*

-*Rregullore për organizimin e brendshëm të punës në shoqërinë Rezenca Studentore Universitare nr. 2, sh.a, miratuar me Vendimin Nr.15, datë 20.12.2022, "Për miratimin e Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Rezidencën Studentore Universitare nr.2".*

-*Trajtimin e punonjësve të RSU nr.2, të ndara në kategori të veçanta;*

-*Procedurat e emërimeve dhe largimeve në punë;*

-*Listë pagesat dhe libri i pagave;*

-*Dosjet e personelit;*

-*Zbatimi i vendimeve gjyqësore mbi punonjësit e larguar nga puna dhe ekzekutimi i tyre",*

- Statutit nr. 552/8 prot., datë 18.01.2021.

Shoqëria Aksionare "Rezenca Studentore Universitare Nr. 2", Sh.A., ka ushtruar veprimtarinë e saj organizative, administrative dhe vendimmarrëse në përputhje dhe mbi bazën e Statutit të miratuar nga Asambleja e Aksionarëve, datë 18.01.2021, i hartuar në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Vështrim i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Shoqëria është themeluar si shoqëri anonime me emrin tregtar "Trajtimi i Studentëve nr. 2, SH. A", Tiranë, në datë 20.06.2005 me Urdhër të Ministrit të Ekonomisë nr. 186, datë 20.06.2005, në zbatim të ligjit nr. 7926, datë 20.04.1995 "Për transferimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", regjistruar si person juridik në regjistrat tregtarë me Vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nr. 33932, dt. 07.09.2005.

Bazuar në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Shoqëria tregtare ka ndryshuar formën ligjore nga shoqëri anonime në shoqëri aksionare dhe me Vendim nr. 6, datë 30.05.2018 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, është bërë ndryshimi i emërimit tregtar nga "Shoqëria "Trajtimi i Studentëve nr. 2" Sh. A, Tiranë", në "Rezidenca Studentore Universitare nr. 2 Sh.A, Tiranë" me akronimin RSU nr.2.

Pronari aktual i shoqërisë, është "Bashkia Tiranë" në zbatim të VKM nr. 335, datë 04.05.2016 "Për transferimin e 100% të aksioneve të shoqërive aksionare "Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1" SHA Tiranë, "Trajtimi i Studentëve Nr. 2" SHA, Tiranë dhe "Trajtimi i Studentëve Nr. 3" SHA, Tiranë, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes te Bashkia Tiranë", me seli "Bashkia Tiranë", Sheshi "Skënderbej". Tirana 1000.

➤ **Funksionimi i Këshillit Mbikëqyrës të RSU nr.2 dhe veprimtaria e tij gjatë vitit 2024-2025:**

Bazuar në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar; Ligjit 139/2015, datë 17/12/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.335 datë 04.05.2016 "Për transferimin 100/% të aksioneve të shoqërive aksionare "Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 Sh.a Tiranë"; "Trajtimi i Studentëve Nr.2 Sh.A. Tiranë"; "Trajtimi i Studentëve Nr.3 Sh.A, Tiranë" nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes te Bashkia Tiranë; Strukturës së Shoqërisë miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës Nr.11 Prot., datë 27.10.2023 "Për miratimin e strukturës së Shoqërisë Rezidenca Studentore Universitare Nr.2", Sh.A dhe Rregullores së Brendshme të Shoqërisë të "Rezidenca Studentore Universitare Nr.2" Sh.A, miratuar me Nr.400/1 Prot, datë 20.12.2022, pasi shqyrtoi Planin Vjetor të Punës për vitin 2024 për "Rezidencën Studentore Universitare Nr.2" Sh.A, të paraqitur për miratim me Nr.325/6 Prot, datë 19.01.2024 nga Administratori i Shoqërisë, në cilësinë e Këshillit Mbikëqyrës.

Mbi veprimtarinë e Këshillit Mbikëqyrës , sipas Tabelave respektive (1-4), për periudhën 2024-2025/10, bashkëngjitur anekseve të këtij RPA.

Tabela 1-2, në anekse, pasqyrojnë vendimet e marra nga Këshilli Mbikëqyrës gjatë vitit 2024, duke përfshirë datën e mbledhjeve, numrin e anëtarëve të pranishëm. Në mbledhjet e zhvilluara për vitin 2024 janë mbajtur 10 proces verbale përkatëse në të cilat janë zbardhur vendimet përkatëse të Këshillit Mbikëqyrës.

Tabela 3-4, në anekse, pasqyrojnë vendimet e marra nga Këshilli Mbikëqyrës gjatë vitit 2025, duke përfshirë datën e mbledhjeve, numrin e anëtarëve të pranishëm. Në mbledhjet e zhvilluara për vitin 2025 janë mbajtur 10 proces verbalet përkatëse në të cilat janë zbardhur vendimet përkatëse të Këshillit Mbikëqyrës.

Me shkresën nr.41 prot., datë 20.01.2023 është vënë në dijeni për mbarimin e mandatit të Këshillit Mbikëqyrës, kryetari i Bashkisë Tiranë.(Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë).

Sipas Udhëzimit Nr.11. datë 04.04.2022. i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë "Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë Aksionare Shtetërore", është nxjerrë Vendimi Nr. 01, datë 25.01.2023 "Për Ri emërimin në detyrë të Anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë "Rezidenca Studentore Universitare NR.2" SH.A.

-Nga auditimi i veprimtarisë së Këshillit Mbikëqyrës u konstatua se, për periudhën 2023-2024, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk kanë lidhur kontrata me Administratorin e shoqërisë, në kundërshtim me Neni 16, të Statutit nr. 552/8 prot., datë 18.01.2021 në RSU nr.2.

si dhe në Neni 12 , të Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Mbikëqyrës-**Rezidenca Studentore Universitare nr. 2**, ka hartuar Rregulloren e Brendshme, miratuar me Vendimin Nr.15, datë 20.12.2022, “Për miratimin e Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Rezidencës Studentore Universitare nr.2 ” e cila ka shfuqizuar Rregulloren e Brendshme të mëparshme “Për organizimin dhe funksionimin e RSU nr.2”, miratuar me Vendimin nr. 02 , datë 13.01.2021.

Konkluzion:

Pra Rezidenca Studentore Universitare nr. 2, ka hartuar Rregulloren e Brendshme, miratuar me Vendimin Nr.15, datë 20.12.2022, “Për miratimin e Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Rezidencën Studentore Universitare nr.2 ” e cila ka shfuqizuar Rregulloren e Brendshme të mëparshme “Për organizimin dhe funksionimin e RSU nr.2”, miratuar me Vendimin nr. 02 , datë 13.01.2021. Për periudhën nga viti 2022 e në vazhdim RSU ka funksionuar sipas rregullores që ka në fuqi. Në këtë hark kohor prej 2 vitesh nuk ka pasur një Rregullore të re për t’iu përshtatur ndryshimeve strukturore të kryera.

Me ndryshimet strukturore organizative të saj, u konstatua se kjo rregullore nuk është përditësuar sipas ndryshime të ndodhura. Nuk ka një ndryshim, përditësim në rregulloren me të cilën RSU nr.2 ka operuar për 2 vitesh, ka munguar përshkrimi i punës për sektorët si pjesë e Drejtorive të RSU nr.2, në kundërshtim me VKM nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar ”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 9/ pika 4, Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues, ku citohet se: *Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore: a) propozimin të nëpunësi autorizues i njësisë publike të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetorë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në njësi; b) hartimin e objektivave dhe zbatimin e planeve strategjike dhe vjetore, në përputhje me objektivat e miratuar nga titullari i njësisë publike; Pika 4 a) propozimin të nëpunësi autorizues i njësisë publike të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, si dhe Pika 4/f) Ndarjen e përgjegjësisë që lidhen me vendimmarrjen, kontrollin, zbatimin dhe vendosjen e linjave të raportimit, në përputhje me përgjegjësitë e deleguara.*

➤ **Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin.**

Në drejtim të objektivave të institucionit, struktura organizative në Rezidencën Studentore Universitare nr.2 ka funksionuar sipas Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës Nr.11, datë 27.10.2023, dhe Urdhrit të Administratorit Nr.77, datë 30.10.2023 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Rezidencës Studentore Universitare nr.2”, sipas së cilës numri i punonjëseve është **156**.

Nga auditimi:

-Për vitin 2024, numri total i punonjësve në strukturë është **156** punonjës (**plani**) ndërsa numri **faktik** i punonjësve rezulton **151** (fakti).

-Për vitin 2025 numri total i punonjësve në strukturë është **156** punonjës (**plani**) ndërsa numri **faktik** i punonjësve rezulton **148** (fakti).

-Referuar të dhënave të marra nga *Spektori i burimeve njerëzore*, për vitin **2024**, numri i vendeve të lira/vakante në Rezidenca Studentore Universitare nr. 2 është **5**, nga këto vetëm për administratën, vende të lira/vakante është **1**.

-Referuar të dhënave të marra nga *Sektori i burimeve njerëzore*, për vitin **2025 (Janar-Shtator)**, numri i vendeve të lira/vakante në Rezidenca Studentore Universitare nr.2 është **8**, nga këto vetëm për administratën, vende të lira/vakante është **5**.

Referuar strukturës së miratuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës, duke mos pësuar ndryshime të tjera strukturore, plani dhe fakti i rekrutimeve për periudhën e audituar është:

-Për vitin 2024 plani i rekrutimeve, në zbatim të Kodit të Punës është **6** vende (**plani**) ku janë realizuar **14** procedura rekrutimi, nga të cilat:

- **4** vende vakante për dalje në pension,
- **7** vende vakante si pasoje largime me dorëheqje,
- **1** vend vakant si pasojë e largim nga detyra me masë disiplinore dhe **1** vend vakant për ndarje nga jeta.

-Për vitin 2025 plani i rekrutimeve në zbatim të Kodit të Punës është **5** vende (**plani**). Deri në fund të 3/mujorit të tretë, janë realizuar **8** procedura rekrutimi, nga të cilat:

- **1** dalje në pension,
- **1** raport leje- lindje,
- **8** largime me dorëheqje.

Vendet vakante	Viti 2024	Viti 2025
	5	8

Konstatimi:

Nga auditimi mbi strukturën organizative dhe burimet njerëzore të Rezidencës Studentore Universitare nr.2 (RSU nr.2), u konstatua se, pavarësisht miratimit të strukturës të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës Nr.11, datë 27.10.2023, dhe Urdhrit të Administratorit Nr.77, datë 30.10.2023 “*Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Rezidencën Studentore Universitare nr.2*, struktura nuk është plotësuar sipas organikës ku:

-Për vitin 2024, në një total prej **156** pozicioneve të planifikuara në strukturë, numri faktik i punonjësve ka qenë **151**, duke rezultuar në **5** pozicione vakante.

-Për vitin 2025, në një total prej **156** pozicioneve të planifikuara në strukturë, numri faktik i punonjësve ka qenë **148** duke rezultuar në **8** pozicione vakante.

Kjo situatë tregon një mospërputhje të vazhdueshme ndërmjet numrit të planifikuar dhe atij real të punonjësve, e cila mund të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në:

- eficiencën e funksionimit të RSU nr.2.
 - realizimin në kohë dhe me cilësi të objektivave institucionale,
- si dhe në mbingarkesën e mundshme të punës për stafin ekzistues,

Konstatimi: Nga verifikimi i procedurave të ndjekura për punësimin e punonjësve me Kod Pune, dhe verifikimi i faqes web në RSU nr.2 rezulton se subjekti nuk ka shpallur vendet vakante për punësim në faqen zyrtare të internetit apo në mjete të tjera të aksesueshme publikisht. Kjo praktikë nuk është në përputhje me parimet e transparencës, barazisë dhe mos diskriminimit në punësim, të parashikuara në nenin 9 dhe nenin 10 të Kodit të Punës, sipas të cilave ndalohej çdo formë diskriminimi në punësim dhe garantohet trajtimi i barabartë i kandidatëve. Gjithashtu, në zbatim të nenit 12 të Kodit të Punës, punëdhënësi është i detyruar të respektojë parimet e punësimit të drejtë dhe të ndershëm. Mos shpallja e vendeve vakante kufizon konkurrencën e hapur dhe aksesin e barabartë të individëve të interesuar për punësim, duke cenuar parimet e praktikave të mira të administrimit të burimeve njerëzore.

- **Aftësitë profesionale të punonjësve:**

Në zbatim të rregullores së brendshme, stafi përgjegjës për trajnimin e punonjësve të RSU nr.2, ka hartuar planin vjetor të trajnimit të punonjësve për vitin 2024 dhe 2025, me qëllim përvetësimin e njohurive të reja dhe përmirësimin e aftësive profesionale të punonjësve në fushat përkatëse të punës.

-Për vitin 2024 në Rezenca Studentore Universitare nr.2 Drejtoria Juridike dhe Burimet Njerëzore me memo nr. 12 prot., datë 16.01.2024 ka hartuar planin vjetor të trajnimeve.

-Për vitin 2025 në Rezenca Studentore Universitare nr.2 Drejtoria Juridike dhe Burimet Njerëzore me memo nr. 49 prot., datë 10.02.2025 ka hartuar planin vjetor të trajnimeve.

-Rezenca Studentore Universitare nr.2, gjatë vitit 2024 ka realizuar këto trajnime:

Trajnimi dhe certifikimi i punonjësve të Drejtorisë Teknike për sigurimin teknik.

Trajnime të brendshme të stafit: Përmirësimi i njohurive dhe aftësive të punonjësve për të rritur efektivitetin në realizimin e detyrave, si dhe për të ndryshuar qëndrimet ose sjelljet. Inkurajimi i punonjësve për shkëmbim të njohurive dhe eksperiencës mes njëri-tjetrit në përmbushjen e detyrave të përditshme, paraqitur në tabelën 5, të Drejtimit 2, në anekse.

Gjithashtu nga RSU nr.2, gjatë vitit 2024 janë realizuar këto trajnime:

Trajnimi dhe certifikimi i punonjësve të Drejtorisë Teknike për sigurimin teknik.

Trajnime të brendshme të stafit: Përmirësimi i njohurive dhe aftësive të punonjësve për të rritur efektivitetin në realizimin e detyrave, si dhe për të ndryshuar qëndrimet ose sjelljet. Inkurajimi i punonjësve për shkëmbim të njohurive dhe eksperiencës mes njëri-tjetrit në përmbushjen e detyrave të përditshme. Njohja dhe zbatimi i Rregullores së Brendshme të Shoqërisë. Puna në grup punonjësit duhet të jenë të aftë të punojnë në grup duke iu përshtatur kërkesave të punës, me qëllim arritjen e objektivave dhe rritjes së nivelit të shërbimit. Komunikimi si baza e suksesit të çdo individi në veçanti dhe Institucionit në tërësi, konflikteve apo mosmarrëveshjet mes punonjësve, Kodi i Sjelljes dhe Etikës.

Gjatë vitit 2025 janë realizuar trajnime nga RSU nr.2:

Trajnimi dhe certifikimi i punonjësve të Drejtorisë Teknike për sigurimin teknik.

RSU2 ka zhvilluar trajnimin e nevojshëm për pajisjen me certifikatë mbi sigurimin teknik. Secili punonjës është pajisur me një kopje të certifikatës. Trajnimi u zhvillua për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në ambientet e punës, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksidente. Në përfundim të trajnimit janë pajisur me certifikata sigurie 10 punonjës të specialiteteve të ndryshme.

Trajnime të brendshme të stafit: Përmirësimi i njohurive dhe aftësive të punonjësve për të rritur efektivitetin në realizimin e detyrave, si dhe për të ndryshuar qëndrimet ose sjelljet. Inkurajimi i punonjësve për shkëmbim të njohurive dhe eksperiencës mes njëri-tjetrit në përmbushjen e detyrave të përditshme për: Njohja dhe zbatimi i Rregullores së Brendshme të Shoqërisë. Puna në grup punonjësit duhet të jenë të aftë të punojnë në grup duke iu përshtatur kërkesave të punës, me qëllim arritjen e objektivave dhe rritjes së nivelit të shërbimit. Komunikimi si baza e suksesit të çdo individi në veçanti dhe Institucionit në tërësi. Konflikteve apo mosmarrëveshjet mes punonjësve. Kodi i Sjelljes dhe Etikës.

Gjatë vitit 2025 nga ASPA janë dërguar tema të ndryshme, ku qëllimi kryesor i trajnimeve online nga ASPA është:

1.Rritja e kapaciteteve profesionale.

2.Rritja e koherencës në punën administrative.

3.Ndërgjegjësimi mbi rreziqet dhe sfidat moderne.

4. Mbështetja e procesit të integritimit evropian. Fokusi kryesor i trajnimeve on line të zhvilluara është përgatitja e stafit për tu përballuar me sfidat që vijnë nga digjitalizimi, rregulloret e reja evropiane dhe dinamika e shërbimeve publike. Përafrimi i kulturës institucionale me standarde

e BE, të paraqitura të përmbledhura si trajnime në tabelën 6, të drejtimit 2, të programit të auditimit, në anekse.

Në lidhje me rekrutimin (punësimin) e punonjësve pranë RSU nr.2.

Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion, rezulton se gjatë vitit 2024, RSU nr.2 janë emëruar **14** punonjës të rinj. Ndryshimet e ndodhura si emërim apo largime janë të paraqitura në tabelën 7, të drejtimit 2, të programit të auditimit, në anekse.

Procedura e rekrutimit nga RSU nr.2, kryhet duke u mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në rregulloren për “Për personelin e RSU nr.2, ku përshkruhet mënyra e punësimit në RSU nr.2, dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqitet pranë institucionit, si dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët.

Sa më sipër, nga auditimi i dokumentacionit mbi procedurat e rekrutimeve në RSU nr.2 për vitin 2024 janë kryer **14** procedura punësimi, nga të cilat ka rezultuar me emërimin e **1** (një) - Drejtor i Drejtorisë Juridike, dhe **13** (trembëdhjetë) emërim në Drejtorinë e Përgjithshme të RSU nr.2 të pasqyruara në tabelën 8, të drejtimit 2, të programit të auditimit, në anekse.

Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga RSU nr.2, rezulton se gjatë vitit 2025, janë emëruar **8** (tetë) punonjës të rinj, të pasqyruara në tabelën 9, të drejtimit 2, të programit të auditimit, në anekse.

Procedura e rekrutimit kryhet duke u mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në rregulloren për “Për personelin e RSU nr.2, ku përshkruhet mënyra e punësimit në RSU nr.2, dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqitet pranë institucionit, si dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët.

Sa më sipër, nga auditimi i dokumentacionit mbi procedurat e rekrutimeve në RSU nr.2, për vitin 2025 janë kryer **8** (tetë) procedura punësimi, nga të cilat ka rezultuar me emërimin **1**-(një) Drejtor i Drejtorisë Juridike, dhe **7** (shtatë) emërim në Drejtorinë e Përgjithshme të RSU nr.2 të pasqyruara në tabelën 10, të drejtimit 2, të programit të auditimit, në anekse.

-Procedurat e largimeve nga punë:

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2024, ka pasur punonjës që janë larguar duke paraqitur dorëheqjen. Nga RSU nr.2 janë ndjekur procedurat ligjore që parashikon Kodi i Punës, ku punëmarrësit kanë paraqitur kërkesë dorëheqje nga puna brenda afateve ligjore, në varësi të kohës së punësimit pranë Rezidencës Studentore Universitare Nr.2, Sha, të paraqitur në tabelën 11, të drejtimit 2, të programit të auditimit, në anekse.

Gjatë vitit 2024 janë larguar me dorëheqje nga puna gjithsej **7** (shtatë) punonjës, **1** (një) punonjës me masë disiplinore si dhe **1** (një) punonjës është ndarë nga jeta.

-Punonjësit që kanë dalë në pension. RSU nr.2 ka përgatitur procedurat e njoftimit dhe zgjidhjes së kontratës:

Sektori i Burimeve Njerëzore ka plotësuar dokumentacionin e nevojshëm dhe përgatitjen e praktikave të daljes në pension, të punëmarrësve që mbushin moshën e pensionit, të paraqitur në tabelën 12, të drejtimit 2, të programit të auditimit, në anekse.

P.V, ka mbushur moshën e daljes në pension me 31.10.2022, por me Urdhër Nr.36, datë 20.09.2022 “Për shtyrjen e afatit të daljes në pension”, për shkak të nevojave të Institucionit është shtyrë dalja e tij në pension deri në një urdhër të ri.

-E.M, ka mbushur moshën e daljes në pension me 30.07.2024, por me Urdhër Nr.40, datë 12.04.2024 “Për shtyrjen e afatit të daljes në pension”, për shkak të nevojave të Institucionit është shtyrë dalja e tij në pension deri në një urdhër të ri.

-I.F, ka mbushur moshën e daljes në pension me 19.10.2024, por me Urdhër Nr.71, datë 04.09.2024 “*Për shtyrjen e afatit të daljes në pension*”, për shkak të nevojave të Institucionit është shtyrë dalja e tij në pension për një periudhë 6 mujore.

-E.R, ka mbushur moshën e daljes në pension me 03.11.2024, por me Urdhër Nr.75, datë 16.09.2024 “*Për shtyrjen e afatit të daljes në pension*”, për shkak të nevojave të Institucionit është shtyrë dalja e saj në pension deri në një urdhër të ri.

➤ **Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve. Realizimi i fondit të pagave:**

Marrëdhëniet e pagave të punonjësve së RSU nr.2, rregullohen në përputhje me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, si dhe me Rregulloren “*Për personelin e Rezidencës Studentore Universitare nr.2 SH.A*”, të miratuar me Vendimin nr. 15 datë 20.12.2022, “*Për personelin e RSU nr.2*”, si dhe janë përcaktuar klasat e kategoritë e punës për personelin e Rezidencës Studentore Universitare Nr.2 Sh. A. Çdo punonjësi i është akorduar një klasë, e cila quhet klasa personale e punonjësit, shkallët e karrierës dhe koeficientet. Klasat e punonjësve janë paracaktuar në bazë të eksperiencës së punës, si dhe nivelit të arsimit, e cila i përcaktohet në kontratë ose në vendimin e emërimit të tij, të punës. Në bazë të kërkesave profesionale, kushteve të punës e përgjegjësisë së punës që punonjësi kryen, përcaktohet edhe kategoria përkatëse. Shkallët e karrierës janë rezultat i vlerësimeve vjetore individuale që merr punonjësi dhe propozimet nga eprori i tij për rritje page.

-U verifikuan fizikisht Listë pagesat e Aparatit të RSU nr.2 për vitin 2024 periudha Janar-Qershor. -U verifikuan fizikisht Listë pagesat e Aparatit të RSU nr.2 për vitin 2025 periudha Korrik-Tetor.

Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe fondit të veçantë, për vitet 2024-2025, paraqitur në tabelën 13, të drejtimit 2, të programit të auditimit, në anekse.

-Për vitin 2024 nga fondi i pagave janë dhënë shpërblime për punonjësit që kanë dalë në pension.

Me vendimin nr.41, datë 17.10.2024, RSU nr.2 në bazë të VKM nr.369, datë 13.06.2007, e ndryshuar me pikën 7 të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “*Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë*” është dhënë shpërblim një pagë mujore për daljen në pension në shumën 53,680 lekë.

-Për vitin 2025 nga fondi i pagave janë dhënë shpërblime për punonjësit që kanë dalë në pension. Me vendimin nr.01, datë 08.01.2025 RSU nr.2 në bazë të VKM nr.369, datë 13.06.2007, e ndryshuar me pikën 7 të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “*Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë*” është dhënë shpërblim një pagë mujore për daljen në pension në shumën 55,000 lekë.

Bazuar në Ligjin Nr.7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare" i ndryshuar; Ligjit nr. 9901 datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar; VKM-së nr.335 datë 04.05.2016 "Për transferimin 100% të aksioneve të shoqërive aksionare "Rezidenca Studentore Universitare nr.1 Sh.A. Tiranë"; "Trajtimi i Studentëve nr.2 Sh.A. Tiranë"; "Trajtimi i Studentëve nr.3 Sh.A. Tiranë" nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, tek Bashkia Tirane; Ligjit nr.10296, datë 08/07/2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar; Udhëzimit nr.30 datë 27/12/2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar, Vendimin e Këshillit Nr.11, datë 27.10.2023 "Për miratimin e strukturës së shoqërisë Rezidenca Studentore Universitare Nr.2, SH.A"; VKM nr.503, datë 1.8.2024 "Për disa ndryshime në

vendimin nr. 328, datë 31.5.2023 të Këshillit të Ministrave, për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", pika 3/ç si dhe Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës Nr. 11, datë 25.09.2024 në cilësinë e titullarit:

-Rezidenca Studentore Universitare nr.2 me shkresën nr.209, Prot., datë 25.09.2024 ka nxjerrë Urdhrin nr. 76. datë 25.09.2024, "Mbi vënien në Zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.503, datë 1.8.2024" pika 3/ç" ndryshimet mbi llogaritjen e vjetërsisë së punonjësve në punë":

1. Vënien në zbatim të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës Nr.11, datë 25.09.2024 për hyrjen në fuqi të VKM nr.503, datë 1.8.2024, pika 3/ç "Ndryshimet mbi llogaritjen e vjetërsisë së punonjësve në punë".

2. Efektet financiare për këtë ndryshim, fillojnë më datë 01 Shtator 2024, sipas Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës Nr. 11, datë 25.09.2024.

-Rezidenca Studentore Universitare nr. 2 me shkresën nr.189/2, Prot., datë 25.09.2024 ka nxjerrë Vendimin Nr.11, datë 25.09.2024:

1. Shoqëria RSU2 të zbatojë Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.503, datë 1.8.2024, pika 3/ "Ndryshimet mbi llogaritjen e vjetërsisë së punonjësve në punë" për punonjësit e saj.

2. Sipas VKM Nr.503, date 1.8.2024 pika 3/ç "Ndryshimet mbi llogaritjen e vjetërsisë së punonjësve në punë", efekti financiar fillon më datë 01 Shtator 2024.

Bazuar në Ligjin Nr.7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare" i ndryshuar; Ligjit nr. 9901 datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar; VKM-së nr.335 datë 04.05.2016 "Për transferimin 100% të aksioneve të shoqërive aksionare "Rezidenca Studentore Universitare nr.1 Sh.A. Tiranë"; "Trajtimi i Studentëve nr.2 Sh.A. Tiranë"; "Trajtimi i Studentëve nr.3 Sh.A. Tiranë" nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, tek Bashkia Tiranë; Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës Nr.11, datë 27.10.2023 "Për miratimin e strukturës së shoqërisë Rezidenca Studentore Universitare Nr. 2, SH.A"; VKM nr.503, datë 01.08.2024 "Për disa ndryshime në vendimin Nr. 328, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave, për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" pika 3; VKB Tiranë me nr.86, datë 09.09.2024, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.570, datë 03.10.2018 "Për Këshillat Mbikëqyrëse të Shoqërive Aksionere Shtetërore", pika 6/c; Udhëzimit Nr.11, datë 04.04.2022 i Ministrit të Financave në shoqëritë Aksionere Shtetërore "Për emërimin, funksionimin dhe Shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë Aksionere Shtetërore "pika V/1;VKM nr.325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" lidhja nr.1 e lidhja nr.11/4; si dhe Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës Nr. 12, datë 23.10.2024, në cilësinë e titullarit:

-Rezidenca Studentore Universitare nr.2, me shkresën nr. 223/3 Prot., datë 23.10.2024 ka nxjerrë Urdhrin Nr. 82, datë 23.10.2024, "Mbi vënien në Zbatim të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës " Mbi Rritjen e Pagave të Shoqërisë dhe Rritjen e Shpërblimit të Këshillit Mbikëqyrës" për 3/Mujorin e katërt të vitit 2024 si dhe për vitin 2025".

1. Vënien në zbatim të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës Nr. 12, datë 23.10.2024 si më poshtë: -rritjen e pagës për 56 punonjës me kategori në vlerën 10,000.00 lekë/muaj për çdo punonjës sipas VKM nr.503, datë 1.8.2024, pika 3.

-rritjen e pagës për 100 punonjësit me klasa në vlerën 4,000.00 lekë/muaj për çdo punonjës, sipas Vendimit nr.86, date 09.09.2024 të Këshillit Bashkiak Tiranë pika c.

-Për Kryetarin e Këshillit Mbikëqyrës rritja e shtesës së shpërblimit në vlerën 4,350 lekë/muaj, sipas VKM nr.570, datë 03.10.2018 pika 6/c dhe VKM nr.325, datë 31.05.2023 lidhja nr. 1 e lidhja nr. 11/4.

-Për Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës rritja e shtesës së shpërblimit në vlerën 2,900 lekë/muaj, sipas VKM nr.570, datë 03.10.2018 pika 6/c dhe VKM nr.325, datë 31.05.2023 lidhja nr. 1 e lidhja nr. 11/4.

2. Efektet financiare të llogariten për pagat duke filluar nga data 01.10.2024.

Nga auditimi i pagave të punonjësve për periudhën objekt auditimi rezultoi se me përzgjedhjen rastësore të Listëpagesave (6 listëpagesa për vitin 2024 dhe 6 listëpagesa për periudhën 2025/09) u konstatua se llogaritjet për pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, siguracioni suplementar, si dhe tatimi mbi të ardhurat personale janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e tyre.

➤ **Dosjet e personelit:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjeve fizike, u konstatua se për nëpunësit e RSU nr.2 zbatohen procedurat e legjislacionit për punonjësit me Kod Pune parashikuar për institucionet e administratës shtetërore.

Nga auditimi me përzgjedhje rastësore të dosjeve të personelit, gjithsej (40 dosje) rezultoi se ato administrohen të inventarizuara në zbatim VKM nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”. Në dosjen teknike të punëmarrëseve janë përfshirë: LIDHJA NR 1. “Fletë inventari me listën e gjithë dokumentacionit që ndodhet në dosje dhe

LIDHJA NR 2. “Të dhënat që duhet të përmbajë fleta prezantuese e dosjes teknike të nëpunësit
1. Numri i identifikimit të nëpunësit civil; 2. Emri, atësia, mbiemri; 3. Numri kombëtar i identifikimit; 4. Shtetësia; 5. Gjinia; 6. Datëlindja; 7. Gjendja civile; 8. Përbërja familjare; 9. Adresa e vendbanimit të përhershëm; 10. Adresa e vendbanimit të përkohshëm; 11. Arsimimi; 12. Diploma; 13. Kualifikimi (llojet); 14. Gradë shkencore (titulli); 15. Njohuri gjuhe të huaj; 16. Data e fillimit të punës në pozicionin përkatës;” 17. Trajnimet e ndryshme pranë DAP, nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA).

• Nga kontrolli i dokumentacionit pjesë e dosjeve të personelit, konstatohet se mungon raporti mjeko-ligjor i azhurnuar.

• Gjithashtu për periudhën objekt auditimi vitet 2024-2025, u verifikua nëse është kryer vlerësimi periodik i rezultateve individuale në punë dhe a janë të bashkëlidhura në dosjet e nëpunësve. Është kryer vlerësimi periodik i performancës së punonjësve, në zbatim të VKM nr. 109, datë 26.2.2014, e ndryshuar. Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se, formularët e vlerësimit të punës janë hartuar, sipas (formatit të miratuar në Lidhjen nr. 2, të VKM nr. 109, datë 26.2.2014, e ndryshuar, ku janë materializuar të gjitha rubrikat që kanë të bëjnë me të dhënat personale (ndarja A); të dhënat për kontekstin e punës ku identifikohen objektivat e institucionit dhe të njësisë organizative ku bën pjesë nëpunësi (ndarja B); objektivat dhe matësit e performancës, ku duke mbajtur parasysh përshkrimin e punës, bëhet vlerësimi për çdo objektiv (ndarja C); sjellja profesionale, e cila ka të bëjë me saktësinë në punën e kryer dhe realizimin në kohë, punën në grup e marrëdhëniet me kolegët, kërkesën për këshillim, aftësinë menaxheriale për nëpunësit në pozicionet e nivelit të ulët e të mesëm drejtues (ndarja C); vlerësimi i përgjithshëm i rezultateve në pune ku bëhet një vlerësim i përmblendhur i arritjes së objektivave kryesore të punës nga nëpunësit.

•

Konstatim:

Nga auditimi i dosjeve të personelit, për rekrutimin e stafit në Rezidencën Studentore Universitare nr.2, nuk ka përcaktuar kritere dhe nuk ka ndjekur procedura si, intervista, testim etj., kritere të cilat nuk ishin të administruara në dosjet e personelit. Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit dhe praktikave të ndjekura për rekrutimin e punonjësve me Kod Pune, rezulton se Rezidenca Studentore Universitare nr.2, nuk ka publikuar në faqen e tij zyrtare online shpalljet për vendet e lira të punës, si dhe nuk ka përcaktuar dhe bërë transparente kriteret dhe procedurat e rekrutimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve.

➤ **Zbatimi i vendimeve gjyqësore mbi punonjësit e larguar nga puna dhe ekzekutimi i tyre.**

Baza e të dhënave gjyqësore përfshin: informacionin mbi numrin dhe datën e vendimit gjyqësor, palët ndërgjyqës objektin, diapozitivin e vendimit, aktin e largimit ose lirimit të punonjësve, fakte dhe rrethana të lidhura, në lidhje me pozicionin e punës, pas dhënies së vendimit gjyqësor të formës së prerë etj. Nga auditimi rezultoi se, “Baza e të dhënave gjyqësore” nga kjo njësi është përditësuar rast pas rasti deri në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për gjyqe fituesit.

Në lidhje me ngritjen e Komisionit të Posaçëm, në përputhje me Urdhrin nr.5151, datë 28.10.2025, si dhe të krijojë sekretarinë teknike që do të mbështetës funksionimin e tij, që të sigurohet shqyrtimi i duhur i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, identifikimin e zgjidhjeve alternative dhe minimizimin e kostove shtesë të shkaktuara nga vonesat në ekzekutim.

Konstatim:

Për vitin 2024-2025 objekt auditimi nga Rezidenca Studentore Universitare nr.2, nuk është ngritur komisioni për shqyrtimin dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore, në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe rregullative në fuqi. Mungesa e këtij komisioni ka sjellë mos administrimin dhe mos ndjekjen e rregullt të vendimeve gjyqësore, duke cenuar procesin e zbatimit të tyre, paraqitur në tabelën 14, të drejtimit 2, të programit të auditimit, në anekse.

-Për vitin 2024 janë ekzekutuar vendime gjyqësore për 1 (një) rast, për të cilat Rezidenca Studentore Universitare nr.2, ka likuiduar detyrimet përkatëse ndaj palëve paditëse në përputhje me vendimet e formës së prerë të gjykatës.

Më konkretisht:

- **znj. SH.H:** Është ekzekutuar vendimi nr. 512, datë 26.06.2023 të Gjykatës së Apelit, i cili ka përcaktuar kompensim në masën e 12.5 pagave mujore dhe 7 ditëve pune, në vlerën totale prej 482,000.00 lekë. Kjo përfshin shumën e shpenzimeve të pagës prej 325,000.00 lekë, tarifën përmbartimore prej 33,600.00 lekë dhe shpenzime gjyqësore në vlerën 123,400 lekë. Vendimi është likuiduar në tërësi gjatë vitit 2024.

-Për vitin 2025 janë ekzekutuar vendime gjyqësore për 3 (tre) raste, për të cilat Rezidenca Studentore Universitare nr.2, ka likuiduar detyrimet përkatëse ndaj palëve paditëse në përputhje me vendimet e formës së prerë të gjykatës.

Më konkretisht:

- **znj. N.B:** Është ekzekutuar vendimi nr. 196, datë 18.04.2024 të Gjykatës së Lartë, i cili ka përcaktuar kompensim në masën e 4 pagave mujore dhe 7 ditëve pune, në vlerën totale prej 196,036 lekë. Kjo përfshin shumën shpenzime page prej 169,784.00 lekë, tarifën përmbartimore prej 21,600 lekë dhe shpenzime gjyqësore në vlerën 4,652 lekë. Vendimi është likuiduar në tërësi gjatë vitit 2025.

- **z. A.C:** Është ekzekutuar vendimi nr. 916, datë 13.11.2024 të Gjykatës së Apelit, i cili ka përcaktuar kompensim në masën e 3-10 pagave mujore dhe 7 ditëve pune, në vlerën totale prej 471,900.00 lekë. Kjo përfshin shumën shpenzime page prej 392,000.00 lekë, tarifën përbarimore prej 46,300.00 lekë dhe shpenzime gjyqësore në vlerën 4,652.00 lekë. Vendimi është likuiduar në tërësi gjatë vitit 2025.
- **z. I.A:** Është ekzekutuar vendimi nr. 423, datë 05.05.2025 të Gjykatës së Apelit, i cili ka përcaktuar kompensim në masën e 10 pagave mujore dhe 7 ditëve pune, në vlerën totale prej 309,900.00 lekë. Kjo përfshin shumën shpenzime page prej 280,000.00 lekë, tarifën përbarimore prej 26,400.00 lekë dhe shpenzime gjyqësore në vlerën 3,500.00lekë. Vendimi është likuiduar në tërësi gjatë vitit 2025.

-U konstatua se, në Rezidencën Studentore Universitare nr.2, për periudhën objekt auditimi, janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për 4 punonjës në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Konkretisht, largimet nga puna janë kryer pa respektuar procedurat ligjore për zgjidhjen e kontratës së punës.

*Sektori I Burimeve Njerëzore nuk ka zbatuar procedurat e parashikuara në nenin 143, pika 1, të Kodit të Punës, si dhe nenet 143, 144 dhe 153, pika 8.2, lidhur me procedurat disiplinore, afatet e njoftimit dhe përfundimin e marrëdhënieve të punës, duke mos garantuar njoftimin paraprak, të drejtën e mbrojtjes dhe respektimin e afateve ligjore. Si pasojë e këtyre shkeljeve, janë hapur 4 (katër) çështje gjyqësore nga punonjësit e larguar. Bazuar në vendimet e gjykatës, shuma e kërkuar nga këta punonjës arrin në vlerën **2,695,050 lekë**, e cila ndikon drejtpërdrejt në të ardhurat e shoqërisë dhe sjell efekte negative financiare.*

-Gjithashtu nga auditimi konstatohet, se në rastin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor për gjyqëfituesit për vitin 2024, janë paguar tarifatat përbarimore në vlerën **33,600.00 lekë**.

-Për vitin 2025 për ekzekutimet e vendimeve gjyqësore për gjyqëfituesit, janë paguar tarifatat përbarimore në vlerën **81,600.00 lekë**.

Këto shpenzime përbëjnë kosto shtesë për institucionin dhe konsiderohen **shpenzime joefektive**, pasi nuk janë zbatuar në kohë likuidimet e vendimeve gjyqësore nga ana e institucionit.

Bazuar në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë, nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit” pika 5 ku citon se:

*“Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, bëhet sipas radhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe **grafiku i shlyerjes bëhet publik nëpërmjet publikimit në faqen on-line të njësisë shpenzuese**, apo në forma të tjera të publikimit, që ju bëhen të ditura publikut. Përmbaruesi i përmbahet grafikut të shlyerjes së detyrimit të publikuar”.*

Në respekt të këtij detyrimi ligjor, RSU nr.2 rezultoi se nuk ka publikuar on line në faqen zyrtare të saj, grafikun e shlyerjes së detyrimeve sipas përcaktimit të bërë në këtë udhëzim, e cila fillon me likuidimin e detyrimeve duke njoftuar menjëherë gjyqëfituesin, ku sipas përcaktimit të pikës 2:

“Njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin prej tyre”.

Nuk janë paraqitur observacione në fazën e RPA-së, nga subjekti në auditim.

3. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare gjatë periudhës 01.01.2024-01.10.2025”.

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrje, fletëdalje, faturë, mandat arkëtim, mandat pagesë, urdhër-shpenzim;
- Transaksionet e llogarive bankare;
- Ditar i bankës;
- Dokumentacioni i magazinës.
- Blerjet e vogla për periudhën 2024/01-2025/09.

a) Ligjshmëria dhe saktësia e kryerjes së veprimeve nëpërmjet arkës në lekë dhe valutë.

Nga institucioni është komunikuar se nuk ka asnjë veprim të realizuar nëpërmjet arkës në valutë, të gjithë veprimet financiare janë realizuar nëpërmjet bankës. Në Arkë zhvillohen këto veprime financiare në lekë:

☞ Arkëtime-

Arka kryen arkëtime nga këto burime të të ardhurave:

- Nga Lavanteritë;
- Nga Rrobaqepësitë;
- Nga Terrenet Sportive;
- Nga lëshimi i Vërtetimeve të Studentëve.

☞ Pagesat

-Nga arka kryhen këto lloje pagesash:

- Derdhja në Bankë e të ardhurave të arkëtuara nga shërbimet e mësipërme;
- Pagesa për shërbime të vogla postare;
- Kthimi i siguracionit të studentëve, sipas afatit të përcaktuar në urdhrin e ngritur nga Administratori.

b) Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës.

Nga auditimi me zgjedhje mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër shpenzim, etj.) të realizuara në Rezidencën Studentore Universitare Nr.2, sh.a rezultoi se, veprimet janë kryer konform kërkesave të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konform rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Kontabilizimet janë kryer rregullisht dhe të regjistruara në ditarët përkatës, sipas programit informatik të kontabilitetit “Alpha Web”.

Urdhër-shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues si: (faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, procesverbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve) konform pikës 35, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

c) Kontabilizimi i urdhër shpenzimeve (banka)

- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për vitin 2024 janë në vlerën totale **197,865,591 lekë**;
- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për vitin 2025 deri në muajin Shtator janë në vlerën totale **146,850,160 lekë**.

Nga këto grupi i auditimit, me përzgjedhje auditoi transaksionet sipas urdhër shpenzimeve të realizuara për periudhën *Janar - Qershor 2024/2025*.

Urdhër Shpenzimet e përzgjedhura u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*" veçanërisht sa i takon regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.* Nga auditimi rezultoi se:

- Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit përgjithësisht është bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si: faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve.

- Regjistrimi i dokumenteve në librat e kontabilitetit është kryer në përputhje me pikën 60 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*".

- Pasqyrat financiare të vitit 2024 janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë dërguar në institucionet respektive në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, dhe kërkesave të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar me Udhëzimin e MFE me nr. 5, datë 21.02.2022.

Me shkresën Nr. 82 prot, dt. më 05.03.2025 RSU nr. 2, sha, ka dërguar Pasqyrat Financiare të Shoqërisë për vitin 2024 për njohje dhe firmosje, Administratorit të Shoqërisë.

Rezidenca Studentore Universitare nr.2, sh.a, Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, Drejtorinë e Monitorimit Financiar të Ndërmarrjeve sha, me shkresën Nr. 82/9 prot, dt më 11.04.2025 ka dërguar Pasqyrat Financiare të Shoqërisë për vitin 2024 dhe në Bashkinë Tiranë.

Janë përcjellë për njohje Pasqyrat Financiare, Raportin dhe Rekomandimet e Audituesve Ligjor të Pasqyrave Financiare të Shoqërisë "Rezidenca Studentore Universitare Nr.2 Sh.a për vitin 2024, të miratuara nga organet drejtuese të shoqërisë.

☒ *Pasqyrat Financiare të vitit 2024 me Nr.82/1 Prot, datë 05.03.2025;*

☒ *Raportin e Audituesve të Pavarur të Pasqyrave Financiare për vitin 2024 me Nr.82/3 Prot., datë 19.03.2025;*

☒ *Vendimin e miratimit të Pasqyrave Financiare dhe Raportit të Audituesve të Pavarur të Pasqyrave Financiare për vitin 2024 nga Këshilli Mbikëqyrës me Nr.06, datë 26.03.2025;*

☒ *Vendimin e miratimit të Pasqyrave Financiare dhe Raportit të Audituesve të Pavarur të Pasqyrave Financiare për vitin 2024 nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të Shoqërisë me Nr.05, datë 28.03.2025.*

Me shkresën Nr. 82/10 prot, dt.11.04.2025 Rezidenca Studentore Universitare nr.2, sh.a, Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, Drejtorinë e Monitorimit Financiar të Ndërmarrjeve sha, ka dërguar Pasqyrat Financiare të Shoqërisë për vitin 2024 dhe në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

Nga auditimi me zgjedhje të urdhër shpenzimeve për vitet 2024/2025 (37 për vitin 2024 dhe 27 për vitin 2025) nuk u konstatuan mangësi në lidhje me dokumentacionin justifikues, më poshtë po citojmë disa prej tyre sepse nuk u konstatuan mospërputhshmëri.

- Me Urdhër shpenzimin datë 03.07.2024, në vlerën 470,470,00 lekë është kryer shpenzimi me objekt "*Lëndë djegëse gazoil për kaldajat*". Bashkëlidhur praktikës së urdhër shpenzimit administrohet dokumentacioni vërtetues si; Fletë hyrje në magazinë nr. 12, dt. 29.05.2024; Akt Kolaudim nr. 30/23 dt. 29.05.2024; Faturë nr.932/2024, datë 29.05.2024; memo nr. 172, dt. 28.05.2024 "*Kërkesë për lëndë djegëse gazoil për kaldajat*"; Kontratë nr. 252/8, dt. 30.12.2024.

- Me Urdhër shpenzimin datë 10.07.2024, në vlerën 178,440,00 lekë është kryer shpenzimi me objekt “*Shpenzime për dezinfektim 3 D*”. Bashkëlidhur praktikës së urdhër shpenzimit administrohet dokumentacioni vërtetues si; Faturë nr.177/2024, datë 29.05.2024; Memo nr. 80/13, dt. 22.05.2024 “*Shpenzime për dezinfektim 3 D*”; *proces verbal dt. 30.04.2024*.
- Me Urdhër shpenzimin datë 14.01.2025, në vlerën 204,000 lekë është kryer shpenzimi me objekt “*Blerje uniforma pune për stafin*” në favor të E.Z, person fizik. Bashkëlidhur praktikës së urdhër shpenzimit administrohet dokumentacioni vërtetues si; Fletë hyrje në magazinë; Akt Kolaudim nr. 252/11 dt. 31.12.2024; Faturë nr.388, datë 31.12.2024; Info mbi procedurën e prokurimit “*Blerje uniforma pune për stafin*”; *Kontratë nr. 252/8, dt. 30.12.2024*.
- Me Urdhër shpenzimin datë 26.12.2024, në vlerën 196,980,00 lekë është kryer shpenzimi me objekt “*Blerje materiale punëtorie*”. Bashkëlidhur praktikës së urdhër shpenzimit administrohet dokumentacioni vërtetues si; Fletë hyrje në magazinë nr. 42, dt. 20.12.2024; Akt Kolaudim nr. 246/12 dt. 20.12.2024; Faturë nr.75/2024, datë 20.05.2024, Memo nr. 360, dt 20.11.2024 “*Blerje materiale punëtorie*”.
- Me Urdhër shpenzimin datë 23.01.2025, në vlerën 507,346,00 lekë është kryer shpenzimi me objekt “*Blerje lende djegëse gazoil për kaldajat*” në favor të shoqërisë A.T sh.a. Bashkëlidhur praktikës së urdhër shpenzimit administrohet dokumentacioni vërtetues si; Fletë hyrje në magazinë nr. 46, dt. 27.12.2024; Akt Kolaudim nr. 30/28 dt. 27.12.2024; Faturë nr.388, datë 27.12.2024; Info mbi procedurën e prokurimit “*Blerje lende djegëse gazoil për kaldajat*” nr. 30/15, dt. 26.02.2024; *Kontratë nr. 30/16, dt. 27.02.2024*.
- Me Urdhër shpenzimin datë 06.02.2025, në vlerën 132,162,00 lekë është kryer shpenzimi me objekt “*Blerje shtypshkrime për vitin 2024*” në favor të shoqërisë A.P, shpk. Bashkëlidhur praktikës së urdhër shpenzimit administrohet dokumentacioni vërtetues si; Fletë hyrje në magazinë nr. 39, dt. 17.02.2024; Akt Kolaudim nr. 179/11 dt. 17.12.2024; Faturë nr. 75/2024, datë 17.12.2024; Info mbi procedurën e prokurimit “*Blerje shtypshkrime për vitin 2024*”; *Kontratë nr. 179/6, dt. 09.09.2024*.
- Me Urdhër shpenzimin datë 28.04.2025, në vlerën 117,047,00 lekë është kryer shpenzimi me objekt “*Shpenzime për program kontabiliteti*” në favor të I.M.B shpk, Bashkëlidhur praktikës së urdhër shpenzimit administrohet dokumentacioni vërtetues si; Procesverbal dt. 27.03.2025; Faturë nr. 506/2025, datë 27.03.2025; Info mbi procedurën e prokurimit “*Shpenzime për program kontabiliteti*” nr. 22, dt. 22.01.2025; *Kontratë nr. 92, dt. 18.03.2025*.
- Me Urdhër shpenzimin datë 03.07.2025, në vlerën 287,763,84 lekë është kryer shpenzimi me objekt “*Lëndë djegëse pelet për kaldajat*”. Bashkëlidhur praktikës së urdhër shpenzimit administrohet dokumentacioni vërtetues si; Akt-kolaudimi nr. 50/23, dt. 04.06.2025; Faturë nr. 123/2025, datë 04.06.2025; Info mbi procedurën e prokurimit “*Lëndë djegëse pelet për kaldajat*” nr. 22, dt. 22.01.2025; *Kontratë nr. 50/15, dt. 27.02.2025*.

Nga auditimi i faturave të likuiduara nga ana e RSU Nr.2, sh.a, u konstatua se 8 (tetë) raste janë kryer likuidime në tejkallim të afatit ligjor 30 ditor, veprime në mospërputhje me ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor*” i ndryshuar, neni 52, ligjin nr.48/2014 “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*” neni 7, si dhe UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, pika 184 “*Nëpunësit zbatues të njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik*”. Konkretisht

faturat e likuiduara me vonesë, por për të cilat nuk janë marrë penalitete, paraqiten në tabelën 1, të drejtimit 3 të programit të auditimit në anekse.

Nga auditimi i detyrimeve nga ana e RSU Nr.2, sh.a, u konstatua se detyrimet ndaj furnitorëve më 31.12.2024 janë sipas tabelës 2, të drejtimit 3 të programit të auditimit në anekse.

Këto detyrime të pasqyruara në tabelën 2, në lidhje me zërin “Ujësjiellës” në vlerën 4,504,079.00 lekë, i cili në kontabilitet rezulton që nga vitet 2006-2007. Për këtë arsye nga ana e RSU nr.2 është kërkuar edhe një rakordim i përgjithshëm me Ujësjiellës Kanalizime Tiranë, me qëllim saktësimin e këtij detyrimi. Sipas Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në RSU nr.2 nuk disponojnë asnjë dokument që të merret një vendim për sistemimin e llogarisë kontabël për këtë detyrim.

Detyrimet të cilat janë të pasqyruara për periudhën 2011, 2012, 2013 janë detyrime, të cilat u përkasin operatorëve të ndryshëm që kanë kryer punime në ambientet e shoqërisë RSU2 dhe u është mbajtur 5% në formën e garancisë për punimet që ka kryer secili operator. Këta operatorë nuk janë paraqitur me kërkesë të tyre dhe me dokumentet përkatës sipas situacioneve që kanë dorëzuar pranë Shoqërisë me qëllim tërheqjen e garancisë.

Rezidenca Studentore Universitare nr.2, sh.a, Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, disponon listën mbi pasuritë e paluajtshme në pronësi:

Certifikatë “Për Vërtetim Pronësie” me nr. 1410442 datë 11/05/2016 për Godinat A; B; C; D Sektori Inxhinieri me Nr. pasurie 2/263, Z.K. 8210, volum 24, faqe 4, Sip. Totale 9437, 45 m2. Në dosje administrohen akte kadastralë “*Kartela e Pasurisë së Paluajtshme*”, për pasuritë:

☞ Godina nr. 1 Mjekësi, Z.K.nr. 8120, Nr. Pasurie 7/272, Vol. 33, Faqe 61” Sip. Totale 2163 m2;

☞ Godina nr. 2 Mjekësi, Z.K.nr. 8120, Nr. Pasurie 10/48, Vol. 33, Faqe 62” Sip. Totale 883 m2;

☞ Godina nr. 3 Mjekësi, Z.K.nr. 8120, Nr. Pasurie 10/45, Vol. 33, Faqe 63” Sip. Totale 413 m2;

☞ Godina nr. 4 Mjekësi, Z.K.nr.8120, Nr. Pasurie 10/13, Vol. 33, Faqe 64” Sip. Totale 283,6 m2,

sipas tabelës 3, të drejtimit 3 të programit të auditimit në anekse.

Shoqëria ka marrë në dorëzim për shfrytëzim dhe mirëmbajtje, objektin “Ndërtim i godinës TIP në RSUNr.2 (Nr.3)” dhe objektin “Ndërtim i godinës TIP në RSUNr.2 (Nr.4)”, sipas dokumentacionit të dërguar nga Drejtoria e Investimeve të Punëve Publike Bashkia Tiranë. Regjistrimi i këtyre 2 pronave është në proces nga Bashkia Tiranë ku shoqëria RSU2, i është drejtuar me shkresën nr.36 prot, prot, datë 24.01.2024 “ *Informacion për Godinat Nr.3 dhe Nr.4 Sektori Mjekësi*, znj. I.Q, Drejtor i Përgjithshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Investimeve të punëve Publike /Bashkia Tiranë është kërkuar informacion mbi çregjistrimin dhe regjistrimin e Godinave Nr.3 dhe Nr.4 Sektori Mjekësi si dhe me shkresën Nr.135 Prot, datë 30.05.2024“ *Përditësimi i informacionit në lidhje me asetet e shoqërisë përkatësisht, Godina Nr. 3 dhe Godina Nr. 4 Sektori Mjekësi*”, drejtuar znj. B.P Drejtor i Përgjithshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, për dijeni z. E.V, Kryetar i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të Shoqërisë dhe znj. I.Q, Drejtor i Përgjithshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Investimeve të Punëve Publike/Bashkia Tiranë, është kërkuar nevoja për sistemimin e vlerave kontabël në mënyrë që shoqëria të zbatojë politikën kontabël, ku kërkohet kontabilizimi i vlerave dhe përlllogaritja e saktë e vlerave rrjedhojë e sistemit fiskal dhe tatimor, nga ku shpenzimet e kryera apo planifikuar në buxhetin e vitit 2024 mbi këto asetet, do të duhet të kryhen dhe njihen në momentin kur shoqëria ka në regjistrat e saj dhe në kartelën e asetit vlerën e tij të drejtë, sipas parimit të ligjeve të kontabilitetit.

Gjithashtu sipas Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve i gjithë dokumentacionit ligjor dhe teknik për procedurën në fjalë, nga momenti i prishjes deri tek sistemimi i vlerave për godinat e vjetra Nr. 3 dhe godina Nr.4 Sektori Mjekësi, është nevojë imediate e shoqërisë në mënyrë që të vazhdojë procesi i marrjes në dorëzim përfundimtar të objekteve, sipas afateve të përcaktuara ligjore, njohja e vlerës ku të bëhet raportimi i drejtë, pasqyrimi i gjendjes reale kontabël edhe regjistrat e saj të aktiveve afatgjata materiale dhe pasqyrimi i tyre në pasqyrat financiare e kartelat individuale të aseteve të shoqërisë.

e) Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël.

Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e kryerjes së procesit të inventarizimit sipas Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

RSU Nr.2, sha ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, neni 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësoj një regjistrë kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhura”.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të vëna në dispozicion të grupit të auditimit ka rezultuar se, për periudhën objekt auditimi është realizuar procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve sipas përcaktimeve në paragrafin nr.74, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Hyrja e aktiveve në përgjithësi është dokumentuar me fletë hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, konform pikës 37, të Udhëzimit të MFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”. Dalja e aktiveve në përgjithësi është realizuar konform pikës 38, të Udhëzimit të MFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Referuar Ligjit Nr.10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimit Nr.30, datë 27/12/2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar; Kreu IV “Sistemi i Kontrollit Periodik të Aktiveve” i ndryshuar, Paragrafi “Inventarizimin e Aktiveve” me shkresën Nr. 161 prot, dt. 11.07.2024, është ngritur Urdhri Nr.56 Prot, datë 11.07.2024 “Për inventarizimin e aktiveve afatgjatë në Administratën e Shoqërisë. Janë ngritur komisionet e inventarizimit me Urdhrat e Administratori Nr.56 Prot, datë 11.07.2024 “Për inventarizimin e aktiveve afatgjatë në Administratën e Shoqërisë (Sektori Inxhinieri dhe Sektori Mjekësi), Nr.57 Prot, datë 11.07.2024 “Mbi inventarizimin e aktiveve afatgjata në Sektorin Inxhinieri”, Nr.58 Prot, datë 11.07.2024 “Mbi inventarizimin e aktiveve afatgjata në Godinat në Sektorin Mjekësi.

Çdo komision sipas objektit të inventarizimit në urdhrat përkatës kanë realizuar procesin brenda afatit dhe kanë pasqyruar rezultatin në relacionet dhe proces verbalet si më poshtë:

☞ Proces verbali Nr.161/1 Prot, datë 23.08.2024 dhe relacion me Nr.161/2 Prot, datë 23.08.2024;

☞ Proces-verbal Nr.162/ 1 Prot, datë 25.08.2024 dhe relacion me Nr.162 /1 Prot, datë 25.08.2024;

☞ Proces-verbal Nr.163/ 1 Prot, datë 23.08.2024 dhe relacion me Nr.163/ 2 Prot, datë 23.08.2024.

Për procesin e inventarizimit në zbatim të urdhrave të ngritura nga Administratori, Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, i ka vendosur në dispozicion fletët e inventarizimit, sipas regjistrave kontabël në sasi dhe vlerë për çdo artikull, të cilët janë të numërueshëm dhe

që mundet të inventarizohen nga komisionet. Nuk janë konstatuar diferenca në sasi dhe vlerë. Për çdo zyrë e ambient pune janë mbajtur proces verbale të firmosura nga komisioni dhe përgjegjësit e bazës materiale. Bazuar në inventarët fizike të kryer nga komisionet e Inventarizimit dhe krahasuar këto inventarë me sasinë dhe vlerat kontabël të dhëna nga Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse të datës 01.08.2024, nuk rezultojnë diferenca në sasi dhe në vlera.

Komisionet e inventarizimit, duke iu referuar gjendjes së tyre fizike dhe viteve të përdorimit, kanë propozuar rishikimin nga specialistë të fushës përkatëse për dalje jashtë përdorimit për të zbatuar procedurat e mëtejshme ligjore mbas miratimit. Bazuar në inventarin fizik të kryer krahasuar me vlerën kontabël të dhënë nga Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse nuk kanë rezultuar diferenca.

Janë konstatuar se disa elementë të bazës materiale (vegla pune, mjete sportive, artikuj të shpërndarë te punonjësit e sektorit teknik) janë të dëmtuara, të amortizuara dhe të papërshtatshëm për përdorim. Janë mbajtur proces verbale të firmosura nga përgjegjësit e bazës materiale dhe nga komisioni, duke i propozuar për dalje jashtë përdorimi.

Shuma në total e artikujve që Komisionet e Inventarizimit kanë propozuar për dalje jashtë përdorimit është: **4,783,245 lekë** (katër milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tremijë e dyqind e dyzet e pesë). Sipas Urdhrit të Administratorit Nr.83, Prot.181/1, datë 30.10.2024 “*Mbi rivlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të bazës materiale të Rezidencës Studentore Universitare Nr.2 Sha*” është ngritur komisioni i rivlerësimit për nxjerrje jashtë përdorimit të bazës materiale në “Rezidencën Studentore Universitare” Nr.2 Sh. A për vitin 2023 dhe vitin 2024. Komisioni për rivlerësimin e aktiveve dhe nxjerrjen nga përdorimi ka marrë dokumentacionin përkatës nga Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, duke iu referuar proces verbaleve për vitin 2023 dhe vitin 2024, të mbajtura nga komisionet e inventarizimit dhe pasqyrat e amortizimit me të dhëna për bazën materiale si më poshtë.

Viti 2023:

- a) Proces-verbali nr.224/1prot, datë 30.08.2023 dhe relacionit nr.224/2, prot, datë 30.08.2023;
- b) Proces-verbali nr.225/1prot, datë 29.08.2023 dhe relacionit nr.225/2 prot, datë 29.08.2023;
- c) Proces-verbali nr.226/1prot, datë 30.08.2023 dhe relacionit nr.226/2 prot, datë 30.08.2023.

Viti 2024:

- a) Proces-verbal Inventarizimi nr.161/1 prot, datë 23.08.2024, relacionit nr.161/2 prot, datë 23.08.2024;
- b) Proces-verbal Inventarizimi nr.162/1 prot, datë 25.08.2024, relacionit nr.162/2 prot, datë 25.08.2024;
- c) Proces-verbali nr.163/1prot, datë 23.08.2024, relacionit nr.163/2 prot, datë 23.08.2024.

Ky komision ka kontrolluar fizikisht të gjithë artikujt dhe pasi kanë konstatuar se nuk kishte mangësi në to, ka filluar punën për të rivlerësuar këto materiale të cilat janë grumbulluar në magazinat përkatëse për t'u përcaktuar se cilat prej tyre do të dalin jashtë përdorimit (asgjësim dhe skrap). Gjithashtu ky komision ka konstatuar se për shkak të përdorimit në vite, materialet kishin dëmtime të mëdha, disa nga këto me përmasa të mëdha, të cilat kanë pësuar dëmtime të konsiderueshme për shkak edhe të vjetërsisë së tyre, duke i bërë ato të pariparueshme dhe të papërdorshme. Këto material janë çmontuar nga punonjësit për të bërë të mundur nxjerrjen e tyre nga godinat dhe dërgimin e tyre në magazinë, sipas tabelës 4, të drejtimit 3 të programit të auditimit në anekse, tabela e materialeve për asgjësim dhe skrap

Sipas Buxhetit të vitit 2024, miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës Nr.12, datë 27.10.2023 dhe Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të Shoqërisë, Nr.06, datë 12.12.2023, fondi për zërin “*Dalje jashtë përdorimit*” është në vlerën 500,000 (pesëqind mije) lekë. Vlera neto e dalë nga komisioni i rivlerësimit për daljen jashtë përdorimit, është 491,518 (katërqind e nëntëdhjetë e njëmijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë) lekë dhe është brenda fondit të miratuar për vitin 2024.

RSU2 ka propozuar çregjistrimin e këtyre aktiveve nga kontabiliteti dhe njohjen e rezultatit për vitin Ushtrimor 2024, pas miratimit të Këshillit Mbikëqyrës dhe Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të Shoqërisë. Me shkresën nr.181/3 prot, datë 18.12.2024, kryetari i komisionit të rivlerësimit për nxjerrje jashtë përdorimit ka informuar administratorin e shoqërisë, “*Relacion “Mbi inventarizimin e bazës materiale në “Rezidencën Studentore Universitare” Nr.2 SH. A dhe vlerat e regjistrave të kontabilitetit për vitin 2024*”, i cili e ka kaluar për trajtim në Këshillin Mbikëqyrës dhe në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionerëve të Shoqërisë.

Me shkresën nr.28, prot, datë 15.01.2025 administratori i është drejtuar Këshillit Mbikëqyrës për propozim për vlerën totale të daljeve jashtë përdorimit. Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës me nr.02, datë 22.01.2025, ka miratuar në parim daljet jashtë përdorimit të aktiveve me vlerë fillestare 2,706,366 lekë nga këto:

Ky vendim i është përcjellë për miratim edhe Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të Shoqërisë RSU2 me vendimin nr.01, datë 03.03.2025, miratimin për daljet jashtë përdorimit të aktiveve me vlerë fillestare **2,706,366.00** lekë dhe vlerë të mbetur **491,518.00** lekë nga këto:

☞ Vlera e mbetur e aktiveve për asgjësim **78,659.00** lekë

☞ Vlera e mbetur e aktiveve për skrap **412,859.00** lekë

➤ Sipas vendimit të Asamblesë nr. 1, dt. 03.03.2025 është miratuar dalja jashtë përdorimit të aktiveve. Për aktivet afatgjata materiale, të cilat do të shiten për skrap, Shoqërisë i është lënë detyrë sipas vendimit të Asamblesë të caktojë një Ekspert Vlerësues, për të kryer verifikimin e sasisë dhe të përcaktojë çmimin e skrapit dhe pas përfundimit të vlerësimit, raporti i Ekspertit Vlerësues të dërgohet për miratim në organet drejtuese të shoqërisë (Këshilli Mbikëqyrës si dhe Asambleja e Përgjithshme të Aksionerëve të Shoqërisë) si dhe pas përfundimit të saj, Shoqëria të pasqyrojë rezultatin në Pasqyrat Financiare të vitit 2024 dhe t'i mbajë në ruajtje për vazhdimin e procedurës së mëtejshme.

➤ Administratori i Shoqërisë me Urdhrin Nr.41, datë 03.03.2025 “*Mbi miratimin e daljeve jashtë përdorimit të bazës materiale*” ka urdhëruar Zbatimin e Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të Shoqërisë, Nr.01, datë 03.03.2025, për miratimin e daljeve jashtë përdorimit të bazës materiale të RSU2, për vitin 2023 dhe vitin 2024.

➤ Me urdhrin Nr.54 , datë 28.04.2025 të administratorit të shoqërisë është ngritur Komisioni për grumbullimin dhe asgjësimin e aktiveve afatgjata materiale të dala dhe të miratuar për nxjerrje jashtë përdorimit, i cili do të bëjë grumbullimin e të gjithë bazës materiale të miratuar për nxjerrje jashtë përdorimit (asgjësim +skrap) në Magazinën Rikupero. Komisioni i grumbullimit dhe asgjësimit të aktiveve mbi asgjësimin e aktiveve të dala jashtë përdorimit ka mbajtur proces verbalin me nr.28/8 prot, datë 30.05.2025. Me relacionin nr.28/9 prot, datë 30.05.2025 është informuar administratori nga ky kryetari i komisionit: është bërë grumbullimi i të gjithë bazës materiale të miratuar për nxjerrje jashtë përdorimit (asgjësim+ skrap) në Magazinën Rikupero dhe ky proces është kryer, duke zbatuar urdhrin dhe praktikën e procesit të grumbullimit të bazës materiale për asgjësim. Komisioni në prani të përgjegjësit të bazës materiale, seleksionoi mallin e miratuar për nxjerrje jashtë përdorimit ka plotësuar fletë-daljet për çdo subjekt të firmosur nga komisioni i grumbullimit dhe asgjësimit, dorëzuesi i bazës materiale dhe nga magazinieri i Magazinës Rikupero.

Vlera totale kontabël e miratuar për asgjësim është 390,030 (treqind e nëntëdhjetë mijë e tridhjetë) lekë, ku vlera prej 136,560 (njëqind e tridhjetë e gjashtëmijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë, është vlera kontabël e pajisjeve kompjuterike, të cilat nuk mund të dërgohen për asgjësim pranë Landfieldit të Sharrës "I.E" SHPK, pasi kanë një procedurë që duhet miratuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Këto pajisje janë grumbulluar dhe janë në ruajtje deri në përfundim të procedurave. *Komisioni ka realizuar asgjësimin e materialeve me vlerë kontabël 253,470 (dyqind e pesëdhjetë e tremijë e katërqind e shtatëdhjetë) lekë.*

Ngarkesa e bazës materiale për asgjësim është shoqëruar nga komisioni, duke përdorur foto në momentin e ngarkimit të saj, si dhe shkarkimit në Sharrë. Kjo ngarkesë është pajisur me dokumentin e lëshuar nga Landfieldi i Sharrës me peshën dhe llojin e mallit që u asgjësua.

f. "Mbi inventarizimin e bazës materiale në "Rezidencën Studentore Universitare" Nr.2, SH. A dhe vlerat e regjistruara të kontabilitetit për vitin 2025".

Referuar Ligjit Nr.10296, datë 08/07/2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar; Udhëzimit Nr.30, datë 27/12/2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar; Kreu IV "Sistemi i Kontrollit Periodik të Aktiveve" i ndryshuar, Paragrafi "Inventarizimin e Aktiveve", janë ngritur komisionet e inventarizimit me Urdhrat e Administratori Nr.75 Prot, datë 07.07.2025 "Për inventarizimin e aktiveve afatgjatë e afatshkurtër në Administratën e Shoqërisë (Sektori Inxhinieri dhe Sektori Mjekësi)", Nr.76 Prot, datë 07.07.2025 "Mbi inventarizimin e aktiveve afatgjata e afatshkurtër në Sektorin Inxhinieri", si dhe Nr.77 Prot, datë 07.07.2025 "Mbi inventarizimin e aktiveve afatgjata e afatshkurtër në Sektorin Mjekësi". Çdo komision sipas objektivit të inventarizimit në urdhrat përkatës, realizuan procesin brenda afatit dhe pasqyruan rezultatin në relacionet dhe proces verbalët si më poshtë:

☞ Proces verbal Nr.165/1 Prot, datë 29.08.2025 dhe relacion me Nr.165/2 Prot, datë 29.08.2025;

☞ Proces-verbal Nr.166/1 Prot, datë 29.08.2025 dhe relacion me Nr.166/1 Prot, datë 29.08.2025;

☞ Proces-verbal Nr.167/1 Prot, datë 29.08.2025 dhe relacion me Nr.167/2 Prot, datë 29.08.2025.

Në zbatim të urdhrave të ngritura nga Administratori, Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, ka vendosur në dispozicion fletët e inventarizimit, sipas regjistrave kontabël në sasi dhe vlerë për çdo artikull, të cilët janë të numërueshëm dhe që mundet të inventarizohen nga komisionet. Në zbatim të Urdhrave "Mbi inventarizimin e aktiveve afatgjatë dhe afatshkurtër në Administratën e Shoqërisë Sektori Inxhinieri dhe Sektori Mjekësi", me nr.75,76,77 Prot, datë 17.07.2025 Komisionet e Inventarizimit, bazuar fletëve të inventarizimit të vëna në dispozicion nga Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse më datë 01.08.2025 kanë filluar procesin e inventarizimit. Sipas komisionit të inventarizimit procesi i Inventarizimit është bërë në çdo zyrë të Administratës dhe në çdo ambient të Sektorëve Inxhinieri dhe Mjekësi me numërim zë për zë, me verifikim të bazës materiale, duke i parë në vend dhe në prani të personave përgjegjës të bazës materiale në çdo zyrë. Është konstatuar verifikimi i sasisë të gjendjes fizike të çdo artikulli duke i krahasuar me fletët e inventarizimit. Këto rezultate janë pasqyruar në fletët e inventarizimit (të firmosura nga të gjithë anëtarët e komisionit), përbri të dhënave të marra nga Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse. Gjatë procesit të inventarizimit nuk janë konstatuar diferenca në sasi dhe vlerë. Komisionet kanë konstatuar që disa nga zërat e bazës materiale janë të dëmtuara dhe nuk janë në gjendje pune (të amortizuara dhe jashtë funksioni). Këto materiale janë propozuar për dalje jashtë përdorimit, janë mbajtur proces verbale të firmosura nga komisioni dhe përgjegjësit e bazës materiale. Bazuar në inventarin fizik të kryer nga komisioni dhe krahasuar këtë inventar me

sasinë dhe vlerat kontabël të dhëna nga Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse të datës 01.08.2025, nuk rezultojnë diferenca në sasi dhe në vlera.

Komisionet e inventarizimit, duke iu referuar gjendjes së tyre fizike dhe viteve të përdorimit, propozuan rishikimin nga specialistë të fushës përkatëse për dalje jashtë përdorimit për të zbatuar procedurat e mëtejshme ligjore mbas miratimit. Disa elementë të bazës materiale (vegla pune, mjete sportive, artikuj të shpërndarë te punonjësit e sektorit teknik) kanë qenë të dëmtuar, të amortizuar dhe të papërshtatshëm për përdorim, janë mbajtur proces verbale të firmosura nga përgjegjësit e bazës materiale dhe nga komisioni, duke i propozuar për dalje jashtë përdorimi. Meqenëse disa artikuj si rezultat i amortizimit kanë humbur vlerën e përdorimit, kanë propozuar që këto artikuj të dalin jashtë përdorimit.

Shuma në total e artikujve që komisionet kanë propozuar që do të dalin jashtë përdorimit është: 81,900 (tetëdhjetë e njëmijë e nëntëqind) lekë.

Procesi është në vazhdim dhe të gjithë artikujt do të verifikohen dhe saktësohen nga komisioni i rivlerësimit. Anëtarët e komisionit gjatë kontrollit kanë verifikuar gjithashtu materialet e skrapit dhe të asgjësimit, të cilat janë grumbulluar dhe janë në ruajtje në Magazinën Rikupero për dalje jashtë përdorimit.

Sa më sipër arrihet në konkluzion si vijon:

☑ Në 8 (tetë) raste, rezultoi të jenë kryer likuidime në tejkallim të afatit ligjor 30 ditor, parashikuar në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” i ndryshuar, neni 52, Ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, si dhe UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 184 “Nëpunësit zbatues të njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik”. Megjithatë për likuidimet e mësipërme nuk janë marrë penalitete.

e. Për Karburantin e automjeteve të shoqërisë RSU2

Në zbatim Ligji nr. 9901 datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar; në Ligjin Nr.10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimit Nr.30 datë 27/12/2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kreu IV “Sistemi i Kontrollit Periodik të Aktiveve”, i ndryshuar, si dhe të Urdhrit të Administratorit Nr.07 , datë 07.01.202 “Ngritjen e komisionit për përcaktimin e normativave të konsumit të karburantit për automjetet e shoqërisë, me qëllim përdorimin me efektivitet dhe eficiencë të karburantit”. Është mbajtur proces verbali me nr.07/1 dhe nr.07/2 prot, datë 18.02.2025 i mbajtur nga Komisioni për përcaktimin e normativave të konsumit të karburantit për automjetet e shoqërisë për vitin 2025, ku kanë përcaktuar normativën reale që konsumojnë automjetet brenda dhe jashtë qendrave të banuara në shërbim të Shoqërisë, me targat përkatëse si më poshtë:

- a) Automjet tip Iveco me targë AB 228KG
- b) Automjet tip Hyundai me targë AA 394 JM

Me shkresën me nr.07/3 prot, datë 19.02.2025 është përgatitur “Relacion mbi përcaktimin e normativave të konsumit të karburantit për automjetet e shoqërisë për vitin 2025” drejtuar Administratorit të shoqërisë nga kryetari i komisionit për përcaktimin e normativave të konsumit të karburantit për automjetet e shoqërisë për vitin 2025. Ky grup ka kryer provat për harxhimin e karburantit për automjetet tip IVECO FIAT me targë AB 228 KG me procesverbal Nr.07/1 prot, datë 18.02.2025 dhe automjetin tip HYUNDAI me targë AA 394 JM me procesverbal Nr.07/2 prot, datë 18.02.2025, sipas tabelës 5, të drejtimin 3 të programit të auditimit në anekse.

Automjeti Iveco me targë AB228KG: Nga përlllogaritja rezulton se automjeti tip Iveco me targë AB228KG, si përcaktim të normativës ka një konsum mesatar jashtë qytetit prej afërsisht 16 litra për 100/km dhe brenda qytetit prej afërsisht 22 litra për 100/km.

Automjeti Hyundai me targë AB228KG: Nga përlllogaritja rezulton se automjeti tip Hyundai me targë AA394JM, sipas drejtorisë përkatëse ka përcaktim të normativës një konsum mesatar jashtë qytetit prej afërsisht 7 litra për 100/km dhe brenda qytetit prej afërsisht 10 litra për 100/km. Për sa më sipër automjetet kanë përshkruar rrugë në një itinerar të kombinuar, me autostradë dhe rrugë qyteti e ndërqytetëse, fushore e malore, me ngarkesë dhe kondicioner të aktivizuar. Prova është kryer në këtë mënyrë pasi konsumi faktik i karburantit varet nga lloji i makinës, koha e përdorimit dhe gjendja fiziko teknike e tij, kushtet e rrugëve sipas kategorive, ngarkesës së trafikut si dhe lloji dhe cilësia e karburantit që përdor. Nga komisioni është marrë në konsideratë dhe trafiku i madh që ka qyteti i Tiranës si dhe mungesa e vendeve të parkimit atje ku mjeti shkon me pune duke berë që makina të qëndroj e ndezur në pritje.

Normativa e konsumit të karburantit për automjetet është paraqitur sipas tabelës 6, të drejtimit 3 të programit të auditimit në anekse.

Është ngritur Urdhri i Administratorit të Shoqërisë me nr.37 prot, datë 20.02.2025 për zbatimin e normativave të konsumit të karburantit për automjetet e Shoqërisë për vitin 2025 nga Komisioni drejtuar Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse pranë Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Me Kërkesën “Blerje karburant për automjetet e Shoqërisë ” për vitin 2025 nga Sektori i Shërbimeve Mbështetëse duke u bazuar në Projekt Programin e Zhvillimit Ekonomik të Shoqërisë për vitin 2025, është përcaktuar sasia e karburantit në zërin “Blerje karburanti për automjetet”. Kjo kërkesë mujore i referohet kontratës me nr. 47/3 prot, datë 03.02.2025 “Blerje karburant diesel 10 ppm për automjetet e shoqërisë”, Urdhrit të Administratorit, nr.07, 346/4 prot, datë 07.01.2025 “Mbi zbatimin e normativave të konsumit të karburantit për automjetet e shoqërisë për vitin 2025”, ku kërkohet furnizimi me karburant për automjetet.

Shkarkimi bëhet nga magazina me fletë dalje shoqëruar me urdhër dorëzimi të marrjes të firmosur nga drejtori ekonomik, përgjegjësi i sektorit mbështetës dhe tërheqësi i urdhrit (shoferi). Më pas plotësohet fletë udhëtimi nga shoferi dhe personat që lëvizin me mjetin përkatës. Mbahet ky proces-verbal në fund të muaji për çdo automjet mbi harxhimin e karburantit.

Gjithashtu mbahet evidenca mujore mbi furnizimin dhe konsumin e karburantit të automjetit (konsumi 100/km, e përshkruar, gjendja në fillim të muajit, sasia e furnizuar, sasia e konsumuar dhe gjendja në fund të muajit) të cilat rakordojnë.

Nuk janë paraqitur observacione nga subjekti në auditim në fazën e RPA-së.

2.4. Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik. Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave/ punëve dhe shërbimeve.

Në zbatim të pikës 4, të programit të auditimit, nr. 1047/1 datë 03.11.2025, mbi “Auditimin e Përputhshmërisë në RSU nr.2”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dosjet e prokurimit për periudhën 2024-2025;
- Sistemi elektronik i prokurimeve (SPE) në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit publik;
- Praktikat e likuidimit të kryera nga Sektori i Financës.
- Regjistri i planifikimit dhe realizimeve të prokurimeve për vitet 2024-2025.

Auditimi i këtij drejtimi u bazua në:

-Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe të gjitha aktet e dala në zbatim të tij (VKM, udhëzime etj.)

- Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021” Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

- VKM nr.285, datë 19.05.2021 neni 68, dhe Udhëzimin Nr.3, datë 18.06.2021.

Në lidhje me auditimin e procedurave të prokurimit, grupi i auditimit ka përzgjedhur në bazë të studimit të riskut (vlera më lartë e procedurave të realizuara), **8 procedura të llojit “E hapur e Thjeshtuar”**, pra me vlerë të fondit limit më të madhe se 1 mln lekë. Tabela e procedurave të përzgjedhura dhe përçindja e mbuluar e auditimit jepet në formë të përmbledhur në ankese bashkëlidhur këtij RPA-i si dhe për çdo vit auditimi (2024-2025), është tabela përmbledhëse e procedurave të zgjedhura dhe raporti i tyre mbi totalin e fondeve të përdorura nga RSU nr.2, sha, bazuar në regjistrat e planifikimit të prokurimeve.

Përsa i përket regjistrave të planifikimit dhe të realizimit të prokurimeve ato janë dërguar në APP sipas sistemit elektronik si dhe për çdo ndryshim të kryer në to gjatë vitit financiar janë dërguar edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit Financiar në bashkinë Tiranë, në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik1” i ndryshuar, neni 3 dhe 4.

Në lidhje me sa më sipër janë kërkuar elektronikisht dhe janë vënë në dispozicion regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike për periudhën 2024-2025/09.(Bashkëngjitur në aneksin e këtij PRA-je).

1. Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2024, në RSU nr.2, sipas regjistrat të realizimit janë zhvilluar në total 27 procedura prokurimi me vlerë totale 19,602,730 lekë të fondit limit dhe me vlerë kontrate 14,891,189 lekë, nga të cilat:

- 4 procedura prokurimi të llojit blerje e hapur e thjeshtuar, me vlerë të fondit limit 13,388,948 lekë dhe vlerë kontrate 10,626,586 lekë ose thënë ndryshe, sa 79 % e fondit limit.

Në blerjet me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, u përzgjedhën mbi bazë risku, vlera më e lartë, 4 procedura me vlerë kontrate 13,873,903.46 lekë ose thënë ndryshe, sa 76 % e fondit limit, paraqitur në tabelën nr. .1

- Blerje me vlerë të vogël, 23 procedura me vlerë të fondit limit 6,213,782 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate 4,264,603 lekë.

Në blerjet me vlerë të vogël, u përzgjedhën mbi bazë risku, vlera më e lartë, 10 procedura me vlerë të fondit limit 4,981,325 lekë ose sa 80 % e procedurave të realizuara.

Tabela nr. 1: Përmbledhëse e prokurimeve për vitin 2024:

Nr.	Lloji i procedurës prokurimit	Numri i procedurave	Fondi limit pa TVSH	Vlera e kontratës pa TVSH	përzgjedhur për auditim	Vlera kontratës pa TVSH	% mbi totalin e përzgjedhur
1	Blerje me vlerë mbi 1,000,000 lekë	4	13,388,948	10,626,586	4	10,626,586	100
3	Blerje të vogla	23	6,213,782	4,264,603	10	3,445,840	81
	Totali	27	19,602,730	14,891,189	14	14,072,426	95

Burimi i të dhënave: RSU nr.2, përpunoi grupi i auditimit.

2. Për vitin 2025/09, u konstatua se, në RSU nr.2 janë zhvilluar në total 19 procedura prokurimi, me vlerë të fondit limit 17,852,616 lekë dhe me vlerë kontrate 13,758,856 lekë, nga të cilat:

- 4 procedura prokurimi të llojit blerje e hapur e thjeshtuar, me vlerë të fondit limit 14,042,453, lekë dhe vlerë kontrate 10,906,289 lekë ose thënë ndryshe, sa 78% e fondit limit.

- 15 procedura të llojit *Blerje e vogël*, me vlerë të fondit limit 3,810,163 lekë dhe vlerë kontrate 2,852,567 lekë, ose sa 75% e fondit limit.

Në blerjet me vlerë të vogël, u përzgjedhën mbi bazë risku, vlera më e lartë, 10 procedura me vlerë të fondit limit 3,454,330 lekë dhe vlerë kontrate 2,675,306 lekë ose thënë ndryshe, sa 77 % e fondit limit.

Tabela Nr. 2: Përmbledhëse e prokurimeve për vitin 2025/09

Nr.	Lloji I procedurës prokurimit	Numri i procedurave	Fondi limit pa TVSH	Vlera kontratës pa TVSH	përzgjedhur për auditim	Vlera kontratës pa TVSH	% mbi totalin e përzgjedhur
1	Blerje me vlere mbi 1,000,000 lekë	4	14,042,453	10,906,289	4	10,906,289	100
2	Blerje me vlerë të vogël	15	3,810,163	2,852,567	10	2,675,306	94
	Totali	19	17,852,616	13,758,856	14	13,581,595	99

Burimi i të dhënave: RSU, përpunoi grupi i auditimit.

Për vitet në auditim, RSU ka miratuar regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike sipas Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr.12, datë 27.10.2023 “Për miratimin e projekt programit për vitin 2024” si dhe Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë me nr. 06, datë 12.12.2023 “Për miratimin e Projekt programit të Zhvillimit ekonomik për vitin 2024”.

Gjithashtu për secilin vit auditimi me urdhër të Titullarit të AK, z. J.L, i deleguar, janë caktuar personat përgjegjës për procedurat e prokurimit publik, përkatësisht për vitin 2024 dhe 2025, të cilët janë të njëjtë:

z. A.DH dhe znj. B.K.

Në lidhje me procedurat e përzgjedhura për auditim të llojit “E hapur e Thjeshtuar”, të trajtuara si më poshtë vijon:

I. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, për procedurën e hapur të thjeshtuar me objekt “Objekti i prokurimit “ Blerje lëndë djegëse pelet për kaldajat”, me fond limit: 5,241,600 (pesë milion e dyqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSh dhe REF-93636-01-23-2024”, me të dhënat si më poshtë, u konstatua se:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse pelet për kaldajat”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 15 datë 23.01.2024	3. Njësia e prokurimit A.DH B.K I.G	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Sipas Urdhrit: Nr.17, Datë 23.01.2024 D.M I.F D.M
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 5,241,600 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 3,147,777 lekë (60% e fondit limit)	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 2,093,823 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 05.02.2024	9. Burimi i Financimit Të ardhurat e Shoqërisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 7; 1.A.P Nipt - 2. GH.B Nipt -, 3. I.P Nipt -, 4. S.K Nipt -, 5.S.A Nipt, 6.A. Nipt 7.A.M Nipt b) S’ kualifikuar 0 ; c) Kualifikuar 7.
11. Ankimime JO	12. Përgjigje e ankesës nga AK JO	13. Përgjigje ankesës nga KPP- N/A
b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhje e kontratës	15. Vlera e kontratës (me tvsh)	16. Likuiduar:

nr. 29/16, datë 27.02.2024	3,777,332.4 lekë me TVSH	3,777,332.4 lekë
17. Situacioni përfundimtar /faturë malli/shërbimi datë Sipas listës.	18. Afati i kontratës në ditë Nga data 27.02.2024 deri në 31.12.2024	19. Zgjatja e kontratës me ditë JO

Objekti i prokurimit “Blerje lëndë djegëse pelet për kaldajat”, me fond limit: 5,241,600 (pesë milion e dyqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSh dhe REF-93636-01-23-2024. Sipas shkresës me nr.29/prot, datë 16.01.2024, Drejtoria teknike në RSU nr.2, drejtuar Administratores, znj. Zh. D, përshkruan kërkesën “Për blerje lënde djegëse për kaldajat e godinave 3-4 të fakultetit të Mjekësisë”, për 10 muaj, pasi muajt gusht-shtator nuk është llogaritur konsum sepse godinat janë të mbyllura.

Me urdhrin nr. 29/1.prot, datë 17.01.2024, është ngritur grupi për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit “Blerje lëndë djegëse pelet për kaldajat” dhe me shkresën nr. 29/2.prot, datë 19.01.2024 është kryer hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit për këtë procedurë.

Për argumentimin e fondit limit komisioni është bazuar në testimin e tregut në operatorë të ndryshëm, konkretisht 3 OE: K; A.F & A.P

Grupi i auditimit auditoi dosjen fizike dhe atë elektronike mbi përmbushjen e kriterëve të DST-së dhe konstatoi mospërputhje si më poshtë vijon:

-Sipas **pikës 2.2. “Kapaciteti ekonomik dhe Teknik”**, në proces verbalin tip të NJP me nr. 29/6, datë 23.01.2024/Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, citohet se: 2.2.1. *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore për vitet 2020,2021,2022 e cila duhet të ketë një vlerë jo më pak se 40% të fondit limit që prokurohet... Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: $5,241,600 \times 0.4 = 2,085,840$ (dy milion e tetëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e dyzet) lekë pa TVSh. Kërkohej vlera jo më pak se 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, bazuar në pikë 4, të nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Në të njëjtën logjikë NJP, vazhdon me **kriterin 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale**, ku citon se: 2.3.1.*Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se $5,241,600 \times 0.2 = 1,048,320$ (një milion e dyzet e tetë mijë e treqind e njëzet) lekë pa TVSh, me argumentimin:*

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: $5,241,600 \times 0.2 = 1,048,320$ (një milion e dyzet e tetë mijë e treqind e njëzet) lekë pa TVSh.

NJP nuk interpreton saktë bazën ligjore për të dy kriteret e sipër cituara si për xhiron mesatare të OE për tre vitet ashtu edhe për përvojat në punët e mëparshme, pasi kjo bazuar në të njëjtën bazë ligjore që ata citojnë, në pikën 4 të nenit 40 të VKM nr. 285/2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: [...].4. *Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Po kështu neni 55/ Procedurë e hapur e thjeshtuar, pika 4 i VKM nr. 285/2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, përcakton qartë se:

Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

Si dhe pika 4/b, për përvojat punëve të ngjashme:

Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Konkluzion: Pra NJP dhe më pas KVO kur verifikon ofertat nuk citojnë dhe të zbatojnë me përpikëri pikërisht bazën ligjore në të cilën ata vetë bazohen duke ndryshuar kontekstin si matematikisht ashtu edhe juridikisht në frazën *jo më e vogël se 20%, apo jo më pak se 40%*, ndërkohë ligji citon saktë dhe qartë shprehjen: *nuk mund të tejkalojë që e thënë ndryshe: jo më e madhe ose e barabartë me 40 % për xhiron dhe 20% për përvojat në punë të ngjashme.*

Në procedurat e prokurimit “E Hapur e thjeshtuar”, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret e thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Në datën 05.02.2024, në orën 10.00, e përcaktuar si afati i fundit për pranimin e ofertave, nëpunësi i autorizuar i Njesisë së Prokurimit ka mundësuar përfundimin e fazës “Dorëzimi i ofertave” për këtë procedurë prokurimi.

Anëtarët e Komisionit të Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave në datën 05.02.2024, në portalin e APP <http://ëëë.app.gov.al> kanë hapur procedurën për vlerësim, ku operatorë ekonomikë pjesëmarrës, ishin 7 të pasqyruar në tabelën 1, sipas ofertës në rend rritës:

Tabela 1

Nr.	Emri i Operatorëve Ekonomik	NIPT	Vlera e ofertës e shprehur në lekë pa TVSh
1	A.P	L97619302U	3,147,777.00
2	G.J.B	K31331547R	3,294,720.00
3	I.P	L64715601E	3,669,120.00
4	S.K	K01529003M	3,714,048.00
5	S.A	L64704601S	3,878,784.00
6	A	J91505006Q	3,893,760.00
7	A.M	K36603807B	4,492,800.00

Punoi grupi i auditimit

Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave ka mbajtur Procesverbalin nr.2 datë 05.02.2024, ora 10.00 “Për hapjen publike të ofertave të dorëzuara”.

Në zbatim të nenit 110/ Afatet për ankim, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 94, Kreut XII “Paraqitja e ankesave” të VKM-së nr.285 datë 19.02.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, KVO ka pritur afatin për ankesa të mundshme pranë Rezidencës Studentore Universitare Nr.2, Sh. A , ku rezultoi se nuk ka të tilla.

Sipas KVO-së, dhe shqyrtimit të ofertave të sjellë nga 7 OE, u arrit në konkluzionin se nuk ka operator të s’ kualifikuar dhe OE fitues është shpallur oferta më e vogël ekonomikisht e shoqërisë “A.P”, me nipt- dhe vlerë oferte 3,147,777 lekë ose sa 60% e FL.

Grupi i auditimit verifikoi dosjen fizike të OE, shpallur fitues dhe konstatoi se:

Dokumentacioni i dorëzuar nga operatori fitues “A.P”, me nipt-” ShPK, rezultoi i paplotë, pasi mungonin provat shkresore për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit. Referuar Formularit përmbledhës të vetë deklarimit (Shtojca 8) në DST, parashikohet se: “Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetë deklarimet në formularin përmbledhës të vetë deklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”

Konkretisht dokumentacioni i kërkuar përfshin: Vërtetime nga Gjykata dhe Prokuroria lidhur me gjendjen gjyqësore të subjektit; Vërtetim nga Bashkia për shlyerjen e detyrimeve vendore; Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për pagim detyrimesh; Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për pagesën e detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore; Vërtetim nga FSHU për shlyerjen e detyrimeve për faturat e energjisë elektrike.

Gjithashtu në dosje është edhe prokura e kryer nga administratori i “A.P”, me nipt- sh.p.k, z. E.R, i cili emëron përfaqësues të posaçëm z. R.R (babain e tij) dhe z. S.R (vëllain), me afat të pacaktuar duke i pajisur me tagër të plotë që të dy së bashku ose veç e veç, të kryejnë veprimet për sa i përket çdo nënshkrimi, përfaqësimi në të gjitha institucionet shtetërore.

Por kjo prokurë është vetëm kopje (data nuk lexohet) dhe normalisht duhet të ishte origjinale ose e noterizuar, veprime në kundërshtim me nenin 74, pika gj) Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit, të VKM-së nr. 285 datë 19.02.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku citohet se:

Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit, kryen detyrat e mëposhtme:

Administrimin e dokumentacionit në formë të shkruar, origjinal ose fotokopje të noterizuar të operatorit ekonomik fitues, përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti/enti kontraktor.

Për sa më sipër, kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik në kushtet kur nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar, është në kundërshtim me nenin 76 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 2 pika 2, shkronja (j), nenin 25, nenin 26 pika 6 dhe nenin 82, të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së, janë të detyrueshme për t’u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Këto kriteret synojnë sigurimin e ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës.

Referuar nenit 82, pika 2 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

-“Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;

-“Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.”

Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave: D.M, I.F dhe D.M

Zbatimi i kontratës

Me Operatorin ekonomik fitues “A.P”, me nipt, është lidhur kontrata nr. 29/16 prot., datë 27.02.2024 me vlerë 3,777,332.4 lekë me TVSH, me afat deri në 31.12.2024, nga nënshkrimi i kontratës.

Tabela 2: Likuidimi financiar sipas planit të zbatimit të kontratës.

Emërtimi	Fletë hyrje	Akt Kolaudimi	Vlera me Tvsh	Likuiduar
Fatura nr.30/2024, datë 29.02.2024	nr.04 dt 29.02.2024	Nr.29/20 prot dt 29.02.2024	472*166.55	26.03.2024

Fatura nr.48/2024, datë 21.03.2024	nr.07 dt 21.03.2024	Nr.29/21 prot dt 21.03.2024	354*124.91	04.04.2024
Fatura nr.62/2024, datë 25.04.2024	nr.09 dt 25.04.2024	Nr.29/22 prot dt 25.04.2024	354*124.91	03.06.2024
Fatura nr.85/2024, datë 29.05.2024	nr.11 dt 29.05.2024	Nr.29/23 prot dt 29.05.2024	354*124.91	03.07.2024
Fatura nr.107/2024, datë 26.06.2024	nr.14 dt 26.06.2024	Nr.29/24 prot dt 26.06.2024	236*083.00	05.08.2024
Fatura nr.182/2024, datë 24.07.2024	nr.16 dt 24.07.2024	Nr.29/25 prot dt 24.07.2024	236*083.00	04.09.2024
Fatura nr.254/2024, datë 31.10.2024	nr.33 dt 31.10.2024	Nr.29/26 prot dt 31.10.2024	354*124.74	21.11.2024
Fatura nr.284/2024, datë 26.11.2024	nr.36 dt 26.11.2024	Nr.29/27 prot dt 26.11.2024	472*166.32	20.12.2024
Fatura nr.356/2024, datë 24.12.2024	nr.43 dt 24.12.2024	Nr.29/28 prot dt 24.12.2024	944*333.92	23.01.2025
TOTALI			3,777,332.26	

Punoi grupi i auditimit

Nuk u konstatuan shkelje në zbatimin e kontratës sipas planit të zbatimit të kontratës dhe marrjen në dorëzim të mallit nga magazina.

II. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, për procedurën e hapur të thjeshtuar me objekt “Objekti i prokurimit “Blerje materiale elektrike, hidraulike, ndërtimore dhe marangozi”, me të dhënat si më poshtë, u konstatua se:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materiale elektrike, hidraulike, ndërtimore dhe marangozi”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 50 datë 25.06.2024	3. Njësia e prokurimit A.DH B.K	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Sipas Urdhrit: Nr.53, Datë 25.06.2024
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”		A.M S.K D.L
5. Fondi Limit (pa tvsh) 3,739,575 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 3,266,500 lekë (87.35% e fondit limit)	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 473,075 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 08.07.2024	9. Burimi i Financimit Të ardhurat e Shoqërisë	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 4; 1. D 2. M Nipt 3. A Nipt, 4. B B Nipt, b) S’ kualifikuar M, B.B ; c) Kualifikuar 2.
11. Ankimime JO	12. Përgjigje e ankesës nga AK JO	13. Përgjigje ankesës nga KPP- N/A
b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhje e kontratës nr. 146/14, datë 31.07.2024	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 3,919,800 lekë me TVSH	16. Likuiduar: 3,919,800 lekë
17. Situacioni përfundimtar /faturë malli/shërbimi datë Sipas listës.	18. Afati i kontratës në ditë Nga data 31.07.2024 deri në 31.12.2024	19. Zgjatja e kontratës me ditë JO

Objekti i prokurimit “Blerje materiale elektrike, hidraulike, ndërtimore dhe marangozi”, me fond limit: 3,739,575 (tre milion e shtatëqind e tridhjetë e nëntë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSh dhe REF-11136-06-25-2024.

Në lidhje me planifikimin e procedurës “Blerje materiale elektrike, hidraulike, ndërtimore dhe marangozi”, me fond limit: 3,739,575 lekë, nga Drejtoria Teknike nëpërmjet shkresës me nr. 173/prot, datë 28.05.2024, është parashikuar kërkesa për “Blerje materiale elektrike, hidraulike, ndërtimore dhe marangozi”, në lidhje me shërbimet që duhen kryer në godinat e sektorit Inxhinieri dhe Mjekësi.

Pas shqyrtimit të kërkesës është kryer hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit, referuar VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021, neni 76, sipas shkresës me nr 146/1, datë 21.06.2024, nga Komisioni i përbërë prej 5 anëtarësh: (E.D, Y.Zh, Q.B, A.,V, M.T) ngritur sipas Urdhrit të Titullarit të AK, nr146/prot, datë 14.06.2024. Lidhur me përllogaritjen e fondit limit total në dispozicion, AK argumenton se, ky fond përbëhet nga buxheti i shoqërisë për vitin 2024. Për përllogaritjen e fondit limit, AK i është referuar çmimeve të tregut.

Në lidhje me vendosjen e kriterëve, grupi i auditimit auditoi dosjen fizike dhe atë elektronike mbi hartimin e tyre dhe konstatoi mospërputhje si më poshtë vijon:

-Sipas pikës **2.2.1 Kapaciteti ekonomik dhe teknik**, në proces verbalin tip të NJP me datë 25.06.2024/Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, citohet se: 2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: *Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore për vitet 2021,2022,2023 e cila duhet të ketë një vlerë jo më pak se 40% të fondit limit që prokurohet...*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$3,739,575 \times 0.4 = 1,495,830$ (një milion e katërqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e tridhjetë) lekë pa TVSh.

Kërkohet vlera **jo më pak se 40% të vlerës** së parashikuar të kontratës, bazuar në pikë 4, të nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në të njëjtën logjikë NJP, vazhdon me kriterin 2.3.1 Aftësitë teknike dhe profesionale, ku citon se: *2.3.1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se $3,739,575 \times 0,2 = 747,915$ (shtatëqind e dyzet e shtatë mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSh, me argumentimin:*

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

NJP nuk interpreton saktë bazën ligjore për të dy kriteret e sipër cituara si për xhiron mesatare të OE për tre vitet ashtu edhe për përvojat në punët e mëparshme, pasi kjo bazuar në të njëjtën bazë ligjore që ata citojnë, në pikën 4 te nenit 40 të VKM nr. 285/2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Po kështu neni 55/ Procedurë e hapur e thjeshtuar, pika 4 i VKM nr. 285/2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, përcakton qartë se:

Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi **nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.**

Si dhe pika 4/b, për përvojat punëve të ngjashme:

Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Konkluzion: Pra NJP dhe më pas KVO kur verifikon ofertat nuk citojnë dhe të zbatojnë me përpikëri pikërisht bazën ligjore në të cilën ata vetë bazohen duke ndryshuar kontekstin si

matematikisht ashtu edhe juridikisht në frazën jo më e vogël se 20%, apo jo më pak se 40%, ndërkohë ligji citon saktë dhe qartë shprehjen: *nuk mund të tejkalojë që e thënë ndryshe jo më e madhe ose e barabartë me 40 % për xhiron dhe 20% për përvojat në punë të ngjashme.*

Në datën 08.07.2024, në orën 12.00, e përcaktuar si afati i fundit për pranimin e ofertave, nëpunësi i autorizuar i Njesisë së Prokurimit ka mundësuar përfundimin e fazës “Dorëzimi i ofertave” për këtë procedurë prokurimi.

Anëtarët e Komisionit të Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave në datën 08.07.2024, e përcaktuar si afati i fundit i hapjes së ofertave, në portalin e APP <http://www.app.gov.al>, kanë hapur procedurën për vlerësim, ku rezultoi se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, ishin:

Tabela 1

Nr.	Emri i Operatorëve Ekonomik	NIPT	Vlera e ofertës e shprehur në lekë pa tvsh
1	D.R		3,266,500.00
2	M		3,183,860.00
3	A		3,581,950.00
4	B.B		0

Punoi grupi i auditimit

Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave ka mbajtur Procesverbalin nr.2 datë 08.07.2024, ora 12.00 “Për hapjen publike të ofertave të dorëzuara”.

Operatorët Ekonomik pjesëmarrës, të renditur sipas rendit rritës përkundrejt ofertave të paraqitura:

- ✓ Operatori ekonomik “M” me nr. NIPT K42003004T me ofertë ekonomike në vlerën 3,183,860.00 lekë pa tvsh
- ✓ Operatori ekonomik “D.R” me nr. NIPT K41316001V me ofertë ekonomike në vlerën 3,266,500.00 lekë pa tvsh
- ✓ Operatori ekonomik “A” me nr. NIPT L82523203F me ofertë ekonomike në vlerën 3,581,950.00 lekë pa tvsh
- ✓ Operatori ekonomik “B.B” me nr. NIPT M11313029O me ofertë ekonomike në vlerën 0 lekë pa tvsh.

Shqyrtimi i ofertave të dorëzuara, sipas KVO-së.

Vlerësimi i ofertave bazuar në metodën e paracaktuar të vlerësimit-Çmimi më i ulët, ku anëtarët e KVO-së, kanë parashtruar arsyet e s`kualifikimit të 2 ofertuesve dhe ato të kualifikimit të 2 OE, sipas procesverbalit me nr. 146/9, datë 15.07.2024, ku kanë argumentuar si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “M” me NIPT me ofertë në vlerën 3,183,860 lekë është s`kualifikuar pasi nuk ka paraqitur mostrat e kërkuara për kriterin teknik sipas pikës 2.3.2, çka bie në kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit në Dokumentet Standarde të Tenderit.

Më konkretisht:

-Tek materialet elektrike mostrat e kërkuara me numrin rendor 22,23,24,34 nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

-Tek materialet ndërtimore mostrat e kërkuara me numrin rendor 4,21,39,40 nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

2. Operatori ekonomik “B.B” me nr. NIPT M11313029O me ofertë ekonomike në vlerën 0 lekë, është s`kualifikuar pasi nuk ka ngarkuar në sistem dokumentet provues për plotësimin e Kriteve të përgjithshme dhe Kriteve të Veçanta të Kualifikimit. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur ofertë të vlefshme.

- Janë kualifikuar 2 OE, sipas KVO-së, ku në vendin e parë është:

1. OE “D.R” me nipt-K.....V, dhe vlerë oferte 3,266,500 lekë pa tvsh &

2. OE “A” me nipt- L.....F dhe vlerë oferte 3,581,950.00 lekë pa tvsh.

Në zbatim të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 99/Raporti përmbledhës, VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 84, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ngritur me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr.53 prot, datë 25.06.2024, ka paraqitur për miratim raportin përmbledhës me nr. 146/12, datë 29.07.2024, për procedurën e prokurimit të sipërcituar, pas përfundimit të afateve të ankimit.

Ky raport përmbledhës përmban: objektin e prokurimit; përshkrimin e mallrave; respektimin e kërkesave ligjore në procesin e hapjes së ofertave; vlerën e ofertuesve pjesëmarrës; ofertuesit e s’ kualifikuar dhe arsyet e s kualifikimit; ofertuesit e kualifikuar; korrigjimin e gabimeve aritmetike dhe ofertat anomalisht të ulëta (nëse ka pasur të tilla); ofertuesin e renditur të parin; çdo informacion tjetër a korrespondencë që lidhet me vlerësimin e ofertave si dhe informacion nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrjen në lidhje me to, si vijon:

Në zbatim të nenit 110, afatet për ankim, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 94, Kreut XII “Paraqitja e ankesave” të VKM-së nr.285 datë 19.02.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është pritur afati për ankesa të mundshme pranë Rezidencës Studentore Universitare Nr.2, Sh. A dhe rezultoi se nuk ka të tilla.

Ky raport është hartuar në datën 29.07.2024, si dhe është nënshkruar rregullisht nga anëtarët e KVO-së me përbërje: A.M, Kryetar, S.K dhe D.L, Anëtarë.

Në lidhje me OE të shpallur fitues OE “D.R” me nipt-K.....V, dhe vlerë oferte 3,266,500.00 lekë pa TVSh, grupi i auditimit ka kryer verifikim të dosjes elektronike dhe asaj fizike për të përcaktuar përputhshmërinë e kriterëve të vendosura nga NJP, ku konstatoi se:

-Në lidhje me kriterin 2.3.2, të vendosur nga NJP, ku përcaktohet se: Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostra nga lista e artikujve të kërkuar nga preventiv (nga 1 copë/1 artikull) . Dorëzimi i mostrave do të bëhet ditën e hapjes së tenderit para Zyrës së Protokollit të Autoritetit Kontraktor, ato duhet të jenë të mbyllura në kuti jo transparente të vulosura, së bashku me mostrat, ofertuesi duhet të bëjë shoqërimin e mostrave me një shkresë të firmosur nga përfaqësuesi ligjor dhe vulosur ku të listohen mostrat që ndodhen në kuti. Mosparaqitja e të gjitha mostrave është kusht s’ kualifikimi.

Mostrat e kërkuara do të jenë:

- Materiale elektrike për zërat nr. 1-22-23-24-33-34-37
- Materiale hidraulike për zërat nr. 1-2-4-10-19-26
- Materiale ndërtimore dhe marangozie për zërat nr.4-5-15-19-20-21-39-40-46-47

Mallrat e dorëzuara të jenë sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në DST. Autoriteti kontraktor pasi të vlerësojë mostrat do t’ia kthejë operatorit ekonomik në respektim dhe në zbatim të dispozitave të LPP . Vlerësimi i mallrave të dorëzuara , mostrave do të jetë kusht për vlerësimin e operatorit ekonomik, bazuar në nenin 40, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në lidhje me këtë kriter dhe plotësimin e tij, KVO nuk ka mbajtur asnjë proces verbal mbi dorëzimin e këtyre mostrave, të cilat do të shërbenin si gjurmë auditimi për grupin e auditimit dhe të lejonin transparencë në vendimmarrje të drejtë dhe të paanshme nga KVO.

Gjithashtu në dosjen fizike mungojnë dëshmitë e penaltetit të përcaktuara në Kriteret e përgjithshme të Kualifikimit, si për Administratorin ashtu edhe për shoqërinë, konkretisht pikat:

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose Mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda

Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

Pra KVO ka vepruar në kundërshtim me DST e NJP, ku përcakton ndër të tjera se:

2.4.1 Për efekt të verifikimit të gjendjes gjyqësore Operatorët Ekonomik së bashku me dokumentacionin e kërkuar, duhet të sjellin edhe fotokopjen e certifikatës personale të administratorit ose të ortakëve të shoqërisë (nëse është rasti). Ky kriter plotësohet me dorëzimin e certifikatës personale të administratorit të shoqërisë ose të ortakëve të shoqërisë (nëse është rasti). Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s' kualifikim.

Për sa më sipër, kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik në kushtet kur nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar, është në kundërshtim me nenin 76 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, nenin 2 pika 2, shkronja (j), nenin 25, nenin 26 pika 6 dhe nenin 82, të VKM nr.285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së, janë të detyrueshme për t'u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Këto kritere synojnë sigurimin e ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës.

Referuar nenit 82, pika 2 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, përcaktohet se: "Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Konkluzion: Pra KVO ka kryer kualifikim të OE fitues në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Duke parë rëndësinë e ofertave më të mira ekonomishtë, KVO nuk ka kryer vlerësim të drejtë të OE fitues, për një devijim i cili nuk përbënte shkak për s'kualifikim nëse do t'i referoheshim parimit të economicitetit, efektivitetit dhe eficiencës, pasi mungesa e mostrave të cituara në proces verbal në lidhje me OE M. D, me NIPT K....T, i cili ka paraqitur edhe ofertën më të ulët në vlerën 3,183,860 lekë, mund të vërtetohej bazuar në nenin 92, të ligjit 162/2020 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3, i LPP 162/2020, i ndryshuar, pika 3, ku përcakton se:

KVO duhet të kishte kërkuar pasi....Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit".

Referuar ligjit mbi prokurimin publik, gjykohet se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë AK, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Ndërkohë konstatohet se edhe OE i shpallur fitues, D.R, nuk ka përmbushur kriteret e vendosura nga NJP, të sipër cituara dhe në këto kushte edhe ky OE duhet të ishte s' kualifikuar, për mosplotësim të DST-it, veprime në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar

vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave: A.M, Kryetar, S.K dhe D.L Anëtarë.

Zbatimi i kontratës me nr146/14.prot, datë 31.07.2024, me vlerë kontrate 3,919,800 lekë.

Emërtimi	Fletë hyrje	Akt Kolaudimi	Vlera me Tvsh	Likuiduar
Fatura nr.19/2024, datë 13.08.2024 hidraulike	nr.19 dt 13.08.2024	Nr.146/17 prot dt 13.08.2024	306,900.00	04.09.2024
Fatura nr.18/2024, datë 13.08.2024 ndërtimore	nr.20 dt 13.08.2024	Nr.146/18 prot dt 13.08.2024	595,620.00	04.09.2024
Fatura nr.21/2024, datë 20.08.2024 elektrike	nr.21 dt 20.08.2024	Nr.146/19 prot dt 20.08.2024	377,760.00	04.09.2024
Fatura nr.26/2024, datë 11.09.2024 elektrike	nr.22 dt 11.09.2024	Nr.146/20 prot dt 11.09.2024	468,480.00	07.10.2024
Fatura nr.27/2024, datë 11.09.2024 hidraulike	nr.23 dt 11.09.2024	Nr.146/21 prot dt 11.09.2024	401,880.00	07.10.2024
Fatura nr.30/2024, datë 13.09.2024 ndërtimore	nr.25 dt 13.09.2024	Nr.146/22 prot dt 13.09.2024	625,020.00	07.10.2024
Fatura nr.35/2024, datë 14.10.2024 elektrike	nr.29 dt 14.10.2024	Nr.146/24 prot dt 14.10.2024	300,240.00	21.11.2024
Fatura nr.34/2024, datë 03.10.2024 ndërtimore	nr.27 dt 03.10.2024	Nr.146/23 prot dt 03.10.2024	489,300.00	21.11.2024
Fatura nr.36/2024, datë 21.10.2024 ndërtimore	nr.30 dt 21.10.2024	Nr.146/25 prot dt 21.10.2024	354,600.00	21.11.2024
TOTALI			3,919,800.00	

Burimi i të dhënave, RSU. Nr.2, përpunoi grupi i auditimit.

Nuk u konstatuan shkelje në zbatimin e kontratës sipas planit të zbatimit të kontratës dhe marrjen në dorëzim të mallit nga magazina.

III. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, për procedurën e hapur të thjeshtuar me objekt “Objekti i prokurimit “ Blerje lëndë djegëse gazoil për kaldajat”, me fond limit: 3,565,276.00 (tre milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSh dhe REF-93634-01-23-2024”, me të dhënat si më poshtë, u konstatua se:

A. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse gazoil për kaldajat”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 16 datë 23.01.2024	3. Njësia e prokurimit A.DH B.K D.M	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Sipas Urdhrit: Nr.18, Datë 23.01.2024 A.M S.K D.M
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 3,565,276 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 3,565,156.22 lekë (99.99% e fondit limit)	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 119.78 lekë

8. Data e hapjes së tenderit Data 05.02.2024	9. Burimi i Financimit Të ardhurat e Shoqërisë	10. Operatorët Ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender a) Pjesëmarrës në tender 3; A.T Nipt, R.E Nipt, K Nipt b) S' kualifikuar K c) Kualifikuar 2.
11. Ankimime JO	12. Përgjigje e ankesës nga AK JO	13. Përgjigje ankesës nga KPP- N/A

Objekti i prokurimit “ Blerje lëndë djegëse gazoil për kaldajat ”, me fond limit: 3,565,276 (tre milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSh dhe REF-93634-01-23-2024.

Sipas shkresës me nr.11/prot, datë 16.01.2024, Drejtoria teknike në RSU nr.2, drejtuar Administratores, znj. Zh. D, përshkruan kërkesën për “Blerje lëndë djegëse gazoil për kaldajat”, për dy kaldaja të cilat shpërbejnë për përgatitjen e ujit të ngrohte, sanitar të godinave nr.1 dhe nr.2. Në këtë memo është parashikuar sasia e litrave gazoil të nevojshëm për vitin 2024, sipas muajve nga ku ka rezultuar që nevojiten 26,312 litra. Ndërkohë për vitin 2023 kanë planifikuar 23,961 litra pra 2,351 litra më pak. Nga grupi për përgatitjen e FL, nuk është argumentuar pse në vitin 2024 janë planifikuar 2351 litra më shumë.

Me urdhrin nr. 30/1.prot, datë 17.01.2024, është ngritur grupi për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit “ Blerje lëndë djegëse gazoil për kaldajat ” dhe me shkresën nr 30/2.prot, datë 19.01.2024 është kryer hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit për këtë procedurë.

Për argumentimin e fondit limit komisioni është bazuar në standardin SSHEN 590:2013+A:2017, të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit.

Grupi i auditimit auditori dosjen fizike dhe atë elektronike mbi përmbushjen e kritereve të DST-së dhe konstatoi mospërputhje si më poshtë vijon:

-Konstatim: Sipas pikës 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe teknik, në proces verbalin tip të NJP me nr.30/6, datë 23.01.2024/Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, citohet se: 2.2.1. *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore për vitet 2020,2021,2022 e cila duhet të ketë një vlerë jo më pak se 40% të fondit limit që prokurohet.*

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43 si dhe nenit 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

3,565,276 x 0.4= 1.426.110 (një milion e katërqind e njëzet e gjashtë mijë e njëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSh.

Kërkohet vlera jo më pak se 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, bazuar në pikë 4, të nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **3,565,276 x 0.2 = 713.055 (shtatëqind e trembëdhjetë mijë e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSh.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$3,565,276 \times 0.2 = 713.055$ (shtatëqind e trembëdhjetë mijë e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSh.

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje tregtimi ose licencë karburantesh me shumicë ose pakicë, për objektin e prokurimit (Gazoil).

Operatori ekonomik duhet të ngarkojë në sistem dokumentin e kërkuar provues bashkë me dokumentet e tjera kualifikuese.

Si dhe pika 4/b, për përvojat punëve të ngjashme:

Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Konkluzion: Pra NJP dhe më pas KVO kur verifikon ofertat nuk citojnë dhe të zbatojnë me përpikëri pikërisht bazën ligjore në të cilën ata vetë bazohen duke ndryshuar kontekstin si matematikisht ashtu edhe juridikisht në frazën jo më e vogël se 20%, apo jo më pak se 40%, ndërkohë ligji citon saktë dhe qartë shprehjen: nuk mund të tejkalohet që e thënë ndryshe jo më e madhe ose e barabartë me 40 % për xhiron dhe 20% për përvojat në punë të ngjashme.

Në procedurat e prokurimit “E Hapur e thjeshtuar”, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret e thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Brenda datës 05.02.2024, e përcaktuar si afati i fundit për pranimin e ofertave, nëpunësi i autorizuar i Njësisë së Prokurimit ka mundur të përfundimin e fazës **“Dorëzimi i ofertave”** për këtë procedurë prokurimi.

Anëtarët e Komisionit të Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave në datën 05.02.2024, e përcaktuar si afati i fundit i hapjes së ofertave, në portalin e APP <http://ëëë.app.gov.al> kanë hapur procedurën për vlerësim, ku operatorë ekonomikë pjesëmarrës, ishin 3 të pasqyruar në tabelën 1, sipas ofertës në rend rritës.:

Nr.	Emri i Operatorëve Ekonomik	NIPT	Vlera e ofertës e shprehur në lekë pa tvsh
1	A.T		3,565,156.22
2	R		çmim 147.887 (njëqind e dyzet e shtatë pikë tetëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë/litër
3	K		10,9 lekë për litër

Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave ka mbajtur Procesverbalin nr.2 datë 05.02.2024, ora 10.00 “Për hapjen publike të ofertave të dorëzuara”.

Sipas KVO-së, dhe shqyrtimit të ofertave nga të sjellë nga 3 OE, u arrit në konkluzionin se ka 1 operator të s’ kualifikuar dhe 2 OE fitues, ku është shpallur oferta më e vogël ekonomikisht e OE A.T, me nipt- dhe vlerë oferte 3,565,156.22 lekë ose sa 99,9 % e FL.

Sipas formularit të njoftim fituesit paraprak, datë **14.02.2024**, ka rezultuar se:

- 1. R.** nipt L.....V me çmim 147,887 (njëqind e dyzet e shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë/litër dhe me normë të fitimi të shprehur në vlerë absolute 7 (shtatë) lekë/litër.
- 2. A.T** nipt L.....H me vlerë **3,565,156.22** (tre milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, me çmim 144.07 (njëqind e dyzet e katër pikë zero shtatë) lekë/litër dhe me normë të fitimi të shprehur në vlerë absolute 6 (gjashtë) lekë/litër
- 3. K.** nipt K.....H me normë të fitimi të shprehur në vlerë absolute 10.9 (dhjetë pikë nëntë) lekë/litër.

Nga pjesëmarrësit janë s’ kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “**K**”. NUIS:

- Operatori ekonomik “**K**” nuk ka paraqitur dokumentet e kërkuar për kriterin ekonomik sipas pikës 2.2.2, çka bie në kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit në Dokumentet Standarde të Tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, **A.T me adresë:** Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Ibrahim Rugova”, Kulla "Sky Tower", Kati 7, Apartamenti Nr.3 me ofertë të paraqitur me vlerë totale prej **3,565,156.22** (tre milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë pike njëzet e dy) lekë pa TVSH dhe çmim 144.07 (njëqind e dyzet e katër pikë zero shtatë) lekë/litër dhe me normë të fitimi të shprehur në vlerë absolute 6 (gjashtë) lekë/litër është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Në zbatim të nenit 110 afatet për ankim, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 94, Kreut XII “Paraqitja e ankesave” të VKM-së nr.285 datë 19.02.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, KVO ka pritur afatin për ankesa të mundshme pranë Rezidencës Studentore Universitare Nr.2, Sh.A , ku rezultoi se nuk ka të tilla.

Si përfundim KVO ka shpallur fitues subjektin A.T me ofertën më të ulët ekonomikisht në vlerën **3,565,156.22** (tre milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë pike njëzet e dy) lekë pa TVSH.

Grupi i auditimit verifikoi dosjen fizike të OE, shpallur fitues dhe konstatoi se:

Dokumentacioni i dorëzuar nga operatori fitues “A.T, me nipt-” rezultoi i paplotë, referuar certifikatës pjesë të dokumentacionit të dorëzuar nga OE, në zbatim të kriterit teknik të vendosur nga NJP, OE "E." ka paraqitur certifikatën ISO nr. 046/21 të lëshuar nga ICDQ ShPK. Organi që ka lëshuar certifikatën ISO për OE fitues nuk rezulton në listën e organeve të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (<https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>). Për sa më sipër, kjo duhet të përbënte shkak për mospranimin e këtij dokumenti.

Për sa më sipër, kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik në kushtet kur nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar, është në kundërshtim me nenin 76 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 2 pika 2, shkronja (j), nenin 25, nenin 26 pika 6 dhe nenin 82, të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Referuar nenit 82, pika 2 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon

dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

-“Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;
 -“Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.”

Zbatimi i kontratës

Me Operatorin ekonomik fitues “A.T, me nipt- ” SHPK, është lidhur kontrata nr. 30/16 prot., datë 27.02.2024 me vlerë **3,565,156.22** lekë me TVSH, me afat deri në 31.12.2024, nga nënshkrimi i kontratës.

Më poshtë jepet edhe likuidimi sipas planit të zbatimit të kontratës.

Emërtimi	Fletë hyrje	Akt Kolaudimi	Vlera me TVSh	Likuiduar	Detyrime të vitit 2024
Fatura nr.431/2024, date 29.02.2024	nr.03 dt. 29.02.2024	Nr.30/20 prot dt. 29.02.2024	598,986.96	25.03.2024	
Fatura nr.540/2024, date 21.03.2024	nr.08 dt. 21.03.2024	Nr.30/21 prot dt 21.03.2024	491,205.00	04.04.2024	
Fatura nr.726/2024, date 25.04.2024	nr.10 dt. 25.05.2024	Nr.30/22 prot dt 25.04.2024	477,076.60	06.06.2024	
Fatura nr.932/2024, date 29.05.202	nr.12 dt. 29.05.2024	Nr.30/23 prot dt 29.05.2024	470,470.00	03.07.2024	
Fatura nr.1081/2024, date 27.06.2024	nr.15 dt. 27.06.2024	Nr.30/24 prot dt 27.06.2024	384,017.92	05.08.2024	
Fatura nr.1237/2024, date 25.07.2024	nr.17 dt. 25.07.2024	Nr.30/25 prot dt 25.07.2024	374,385.44	04.09.2024	
Fatura nr.1824/2024, date 30.10.2024	nr.32 dt. 30.10.2024	Nr.30/26 prot dt 30.10.2024	433,061.20	21.11.2024	
Fatura nr.1931/2024, date 27.11.2024	nr.37 dt. 27.11.2024	Nr.30/27 prot dt 27.11.2024	541,638.24	20.12.2024	
Fatura nr.2048/2024, date 27.12.2024	nr.46 dt. 27.12.2024	Nr.30/28 prot dt 27.12.2024	507,346.00	23.01.2025	507,346.00
TOTALI			4,278,187.36		507,346.00

Punoi grupi i auditimit

-Konkluzion: Nga auditimi i faturave të likuiduara nga ana e RSU Nr.2, u konstatua se 3 fatura janë likuiduar në tejkallim të afatit ligjor 30 ditor. Veprime në mospërputhje me Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” i ndryshuar, neni 52, Ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, si dhe UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 184 “Nëpunësit zbatues të njësjive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik”.

-Nga auditimi u konstatua, se dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar dhe e arkivuar në arkivën e shoqërisë sipas përcaktimeve ligjore, kjo në kundërshtim me Ligjin Nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar.

Nuk u konstatuan shkelje në zbatimin e kontratës sipas planit të zbatimit të kontratës nr.30/18 prot, datë 27.02.2024 dhe marrjen në dorëzim të mallit nga magazina.

IV. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, për procedurën e hapur të thjeshtuar me objekt “Blerje materiale elektrike, hidraulike, ndërtimore dhe marangozi”, me fond limit: 4,000,000 (katër milion) lekë pa tvsh dhe REF-5282506-30-2025”, me të dhënat si më poshtë, u konstatua se:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materiale elektrike, hidraulike, ndërtimore dhe marangozie”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 69 datë 19.06.2025	3. Njësia e prokurimit A.DH B.K I.XH	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Sipas Urdhrit: Nr.70, Datë 19.06.2025 A.M S.K D.M
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 4,000,000 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 3,340,000 lekë (83.5% e fondit limit)	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 660,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 11.07.2025	9. Burimi i Financimit Të ardhurat e Shoqërisë	10. Operatorët Ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender a)Pjesëmarrës në tender 4; D.R, E.L Nipt , O.M Nipt A.K Nipt b) S’ kualifikuar 0 ; c) Kualifikuar 4.
11. Ankimime JO	12. Përgjigje e ankesës nga AK JO	13. Përgjigje ankesës nga KPP- N/A
b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhje e kontratës nr. 139/18, datë 28.07.2025	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 4,008,000 lekë me TVSH	16. Likuiduar: 4,008,000 lekë

Burimi: Të dhënat AK dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE) punoi grupi auditimit.

Nga ana e AK është ngritur Njësia e Prokurimit, me Urdhrin e Prokurimit Urdhri nr. 69 prot., datë 19.06.2025, e cila ka filluar procedurën me objekt “Blerje materiale elektrike, hidraulike, ndërtimore dhe marangozie”, me nr. Reference të procedurës së prokurimit, Nr. Ref- 52825-06-30-2025. me fondi limit: 4,000,000 (katër milion) lekë pa tvsh. Sipas Urdhrit nr. 69 prot., datë 19.06.2025 Njësia e Prokurimit përbëhet nga:

- A.DH Kryetar
- B.K Anëtarë
- I.XH, Anëtar

Janë trajtuar në vijim:

- Planifikimi i nevojave për prokurim
- Llogaritja e fondit limit
- Nxjerrja e urdhër prokurimit
- Hartimi i dokumenteve të tenderit/kriteret e veçanta për kualifikim
- Vlerësimi i Ofertave.
- Zbatim i kontratës

Planifikimi i nevojave për prokurim - Autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me objekt: “Blerje materiale elektrike, hidraulike, ndërtimore dhe marangozie”.

Procedura është iniciuar me kërkesën nr. 139 prot., datë 10.06.2025 për nisjen e procedurës së prokurimit, “Blerje materiale elektrike, hidraulike, ndërtimore dhe marangozie drejtuar Administratorit. Duke u bazuar në parashikimet vjetore të hartuara në Projekt-Buxhetin e Drejtorisë Teknike për Vitin 2025, për riparimet si dhe shërbimet që duhen bërë në

godinat e “Rezidenca Studentore Universitare NR.2” gjatë muajit Gusht-Shtator është kërkuar miratimi për blerjen e "Materiale Ndërtimore, Marangozie, Elektrike dhe Hidraulike" për vitin 2025. Kjo kërkesë është bërë referuar gjendjes së godinave në sektorin Inxhinieri dhe Mjekësi dhe për faktin se në këto muaj, në godina nuk ka student të akomoduar dhe nga ana e Drejtorisë Teknike është e mundur kryerja e këtyre punimeve. Sasia e këtyre materialeve është vendosur sipas kërkesave të bërë nga Sektori Teknik dhe nevojave që kanë godinat pas kontrollit të kryer nga ana e specialistëve.

Llogaritja e fondit limit - Titullari i AK ka ngritur grupin e punës për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe argumentimin e fondit limit me Urdhrin nr. 63, dt. 12.06.2025. Me shkresën nr. 139/2 prot, dt. 16.06.2025 bazuar në Urdhrin e mësipërm janë hartuar specifikimet teknike dhe përllogaritja e fondit limit.

Nxjerrja e urdhër prokurimit - Mbështetur në ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 34, 36, dhe neni 76, të VKM –së nr. 285, dt. 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ka ngritur Urdhrin nr. 63, dt. 12.06.2025 për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit. Bazuar në Urdhrin nr.63, datë 12.06.2025 të Zv. Administratorit, mbi ngritjen e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, për procedurën e prokurimit “Blerje materiale elektrike, hidraulike, ndërtimore dhe marangozie”, grupi i punës ka hartuar specifikimet teknike. Me shkresën nr. 139/4 prot, dt. 19.06.2025 është nxjerrë Urdhri i Prokurimit nr. 69, dt. 19.06.2025 për procedurën e prokurimit “Blerje materiale elektrike, hidraulike, ndërtimore dhe marangozie”,

Data e zhvillimit të procedurës në sistem është datë 11/07.2025, ora 12:00 me Nr. Ref- 52825-06-30-2025. Kontrata e lidhur nr. 139/18 prot., date 28.07.2025 me vlerë 3,340,000 lekë pa Tvsh dhe 4,008,000 lekë me TVSH. Operatori fitues “E.L”, person fizik është likuiduar me faturën nr.321/2025, datë 29.08.2025m në vlerën 1,088,040, faturën nr.319/2025, datë 29.08.2025 në vlerën 1,286,680, faturën nr.320/2025, datë 29.08.2025 në vlerën 807,960, faturën nr.359/2025, datë 06.10.2025 në vlerën 825,120.

Hartimi i dokumenteve të tenderit/kriteret e veçanta për kualifikim.

Njësia e Prokurimit nëpërmjet shkresës Procesverbalit nr. 139/6 prot., datë. 26.06.2025, ka dërguar për publikim procesverbalin tip për argumentimin e specifikimeve teknike, kriteret e kualifikimit dhe dokumentet e tenderit (DST) për publikim.

Grupi i auditimit auditoi dosjen fizike dhe atë elektronike mbi përmbushjen e kriterëve të DST-së dhe konstatoi mospërputhje si më poshtë vijon:

Konstatim: Sipas pikës 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar, në procesverbalin tip të NJP me nr.139/6 prot., datë 26.06.2025 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, citohet se: 2.2.1. *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore për vitet 2022,2023,2024 e cila duhet të ketë një vlerë jo më pak se 40% të fondit limit që prokurohet...* Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: $4,000,000 \times 0.4 = 1,600,000$ (një milion e gjashtëqind mijë) lekë pa tvsh. Kërkohej vlera jo më pak se 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, bazuar në pikën 4, të nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në të njëjtën logjikë NJP, vazhdon me kriterin 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale, ku citon se: 2.3.1. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se $4,000,000 \times 0.2 = 800,000$ (tetëqind mijë) lekë pa tvsh, me argumentimin:*

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:
 $4,000,000 \times 0.2 = 800,000$ (tetëqind mijë) lekë pa TVSh.

NJP nuk interpreton saktë bazën ligjore për të dy kriteret e sipër cituara si për xhiron mesatare të OE për tre vitet ashtu edhe për përvojat në punët e mëparshme, pasi kjo bazuar në të njëjtën bazë ligjore që ata citojnë, në pikën 4 të nenit 40 të VKM nr. 285/2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Po kështu neni 55/ Procedurë e hapur e thjeshtuar, pika 4 e VKM nr. 285/2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, përcakton qartë se:

Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

Si dhe pika 4/b, për përvojat punëve të ngjashme:

Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Konkluzion: Pra NJP dhe më pas KVO kur verifikon ofertat nuk citojnë dhe të zbatojnë me përpikëri pikërisht bazën ligjore në të cilën ata vetë bazohen duke ndryshuar kontekstin si matematikisht ashtu edhe juridikisht në frazën jo më e vogël se 20%, apo jo më pak se 40%, ndërkohë ligji citon saktë dhe qartë shprehjen: nuk mund të tejkalojë që e thënë ndryshe jo më e madhe ose e barabartë me 40 % për xhiron dhe 20% për përvojat në punë të ngjashme.

Në procedurat e prokurimit “E Hapur e thjeshtuar”, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret e thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Në zbatim të nenit 110 afatet për ankim, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 94, Kreut XII “Paraqitja e ankesave” të VKM-së nr.285 datë 19.02.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, KVO ka pritur afatin për ankesa të mundshme pranë Rezidencës Studentore Universitare Nr.2, Sh. A , ku rezultoi se nuk ka të tilla.

Në datën 11.07.2025, në orën 12:00, e përcaktuar si afati fundit për pranimin e ofertave, nëpunësi i autorizuar i Njësisë së Prokurimit ka mundësuar përfundimin e fazës “**Dorëzimi i ofertave**” për këtë procedurë prokurimi.

Anëtarët e Komisionit të Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave në datën 11.07.2025, ora 12:00 e përcaktuar si afat i fundit i hapjes së ofertave, në portalin e APP <http://www.app.gov.al> kanë hapur procedurën për vlerësim, ku operatorë ekonomikë pjesëmarrës ishin 4 të pasqyruar në tabelën 1, sipas ofertës në rend rritës.:

Nr.	Emri i Operatorëve Ekonomik	NIPT	Vlera e ofertës e shprehur në lekë pa tvsh
1	E.L	K71707007Q	3,340,000.00
2	D.R	K41316001V	3,697,300.00
3	O.M	L71619028E	3,700,600.00
4	A.K	L61621027F	3,900,000.00

Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave ka mbajtur Procesverbalin nr.2 datë 11.07.2025, ora 12:00 “Për hapjen publike të ofertave të dorëzuara”.

Sipas KVO-së, dhe shqyrtimit të ofertave nga të sjellë nga 4 OE, u arrit në konkluzionin se nuk ka operator të s’ kualifikuar dhe sipas ofertave të dorëzuara, OE fitues është shpallur oferta më e vogël ekonomikisht e OE E.L, me NIPT dhe vlerë ofertë 3,340,000 lekë ose sa 83.5% e FL.

-Lidhja e kontratës. Me Operatorin ekonomik fitues “E.L”, person fizik, me nipt-, është lidhur Kontrata Nr.139/18 Prot , datë 28.07.2025 me vlerë me Tvsh 4,008,000 lekë., me afat deri në 31.12.2025, nga nënshkrimi i kontratës. Me Urdhrin nr. 81. 30.07.2025 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim. Me shkresën nr. 139/19 prot, 29.07.2025 është hedhur në SPE, Formulari i kontratës së nënshkruar.

Zbatimi i kontratës.

Me operatorin fitues “E.L” person fizik është lidhur Kontrata Nr.139/18 Prot , datë 28.07.2025, me vlerë me Tvsh 4,008,000 lekë. Me shkresën nr. 139/16 prot, dt. 25.07.2025 është përgatitur Raporti përmbledhës mbi shqyrtimin e vlerësimit të ofertave. Likuidimi është bërë sipas tabelës si më poshtë brenda afatit ligjor.

Emërtimi	Fletë hyrje	Akt Kolaudimi	Vlera me TVSh	Likuiduar
Fatura nr.321/2025, datë 29.08.2025	nr.20 dt. 29.08.2025	Nr.139/23 prot dt 23.08.2025	1,088,040.00	15.09.2025
Fatura nr.319/2025, datë 29.08.2025	nr. 18 dt 29.08.2025	Nr.139/21 prot dt 23.08.2025	1,286,680.00	15.09.2025
Fatura nr.320/2025, datë 29.08.2025	nr. 19 dt 29.08.2025	Nr.139/22 prot dt 29.08.2025	807,960.00	15.09.2025
Fatura nr.359/2025, datë 06.10.2025	nr.23 dt. 06.10.2025	Nr.139/24 prot dt 06.10.2025	825,120.00	24.10.2025
TOTALI			4,007,800.00	

Konstatim: Nga auditimi u konstatua se dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar dhe e arkivuar në arkivën e shoqërisë sipas përcaktimeve ligjore, kjo në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar.

-Për argumentimin e fondit limit komisioni është bazuar në testimin e tregut në operatorë të ndryshëm, konkretisht 3 OE: DH. A M dhe M Nga verifikimi elektronik i Qendrës Kombëtare të Biznesit <https://qbz.gov.al/> subjekti DH.A, rezulton me status të pezulluar dhe si pasojë nuk duhej marrë në konsideratë.

Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi anëtarët e argumentimit të fondit limit: Y.ZH; E.D; Q.B; A.V; M.T.

- Në dosjen fizike mungon Procesverbali i mbajtur nga komisioni për anulimin e procedurës së prokurimit me nr. REF-52567-06-26-2025, në kundërshtim me Nenin 2, pika 1, e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, *Dokumentimi i procesit 1. Autoriteti/enti kontraktor duhet të administrojë të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi i saj deri te zbatimi i kontratës. Për këtë qëllim, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera.*

Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave: A.M.; S.K; D.M.

V. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, për procedurën e hapur të thjeshtuar me objekt “**Blerje detergjent për pastrim dhe lavaxteri**” me fond limit: **1,011,197** (një milion e njëmbëdhjetë mijë e njëqind

e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH dhe dhe REF-51828-06-19-2025 me të dhënat si më poshtë, u konstatua se:

Objekti i prokurimit “Blerje detergjent për pastrim dhe lavanteri”

D. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje detergjent për pastrim dhe lavanteri”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 66 datë 19.06.2025	3. Njësia e prokurimit A,DH B.K A.L	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Sipas Urdhrit: Nr.67, Datë 19.06.2025 H.B D.M S.K
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 1,011,197 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 587,140 lekë (58% e fondit limit)	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 424,057 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 01.07.2025	9. Burimi i Financimit Të ardhurat e Shoqërisë	10. Operatorët Ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender a)Pjesëmarrës në tender 6; B, Nipt ,M Nipt, E.M Nipt A 3 Nipt, A Nipt J, B.K Nipt b) S’ kualifikuar B c) Kualifikuar 5.
11. Ankimime JO	12. Përgjigje e ankesës nga AK JO	13. Përgjigje ankesës nga KPP- N/A
b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhje e kontratës nr. 138/15, datë 25.07.2025	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 704,568 lekë me TVSH	16. Likuiduar: 77,340 lekë

Burimi: Të dhënat AK dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE) punoi grupi auditimit.

Nga ana e AK është ngritur Njësia e Prokurimit, me Urdhrin e Prokurimit Urdhri nr. 66 prot., datë 19.06.2025, e cila ka filluar procedurën me objekt “Blerje detergjent për pastrim dhe lavanteri”, me nr. Reference të procedurës së prokurimit, Nr. REF-51828-06-19-2025, me fond limit: **1,011,197** (një milion e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh. Sipas Urdhrit nr. 65 prot., datë 19.06.2025 Njësia e Prokurimit përbëhet nga:

1. A.DH Kryetar
2. B.K Anëtarë
3. A.L Anëtar

Janë trajtuar në vijim:

1. Planifikimi i nevojave për prokurim
2. Llogaritja e fondit limit
3. Nxjerrja e urdhër prokurimit
4. Hartimi i dokumenteve të tenderit/kriteret e veçanta për kualifikim
5. Vlerësimi i Ofertave.
6. Zbatim i kontratës

Planifikimi i nevojave për prokurim - Autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me objekt: “Blerje detergjent për pastrim dhe lavanteri”.

Procedura është iniciuar me kërkesën nr. 138 prot., datë.05.06.2025 për nisjen e procedurës procedurës së prokurimit, “Blerje detergjent për pastrim dhe lavanteri” drejtuar Administratorit. Duke u bazuar në parashikimet vjetore të hartuara në Projekt- Buxhetin e Drejtorisë Teknike për Vitin 2025, për nevojat e “Rezidenca Studentore Universitare NR.2” gjatë muajit Qershor është kërkuar miratimi për blerjen e "detergjent për pastrim dhe lavanteri" për vitin 2025. Kjo kërkesë është bërë për arsyen e mbajtjes pastër të ambienteve në godina, për krijimin e kushteve higjeno-sanitare të përditshme për studentët dhe shërbimin e lavanterisë në godinat e rezidencës studentore nr.2. Sasia e këtyre materialeve është vendosur sipas kërkesave të bërë nga Drejtoria Hotelarisë, për mbajtjen pastër të ambienteve në godina dhe shërbimin e lavanterisë.

Konstatim: Nga auditimi u konstatua se dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar dhe e arkivuar në arkivën e shoqërisë sipas përcaktimeve ligjore, kjo në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar.

Llogaritja e fondit limit - Titullari i AK ka ngritur grupin e punës për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe argumentimin e fondit limit me Urdhrin nr. 62, dt. 12.06.2025. Me shkresën nr. 138/2 prot, dt. 16.06.2025 bazuar në Urdhrin e mësipërm janë hartuar specifikimet teknike dhe përlllogaritja e fondit limit.

Nxjerrja e urdhër prokurimit

Mbështetur në ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 34, 36, dhe neni 76, të VKM –së nr. 285, dt. 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ka ngritur Urdhrin nr. 62, dt. 12.06.2025 për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit. Bazuar në Urdhrin nr.62, datë 12.06.2025 të Zv. Administratorit, mbi ngritjen e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit, për procedurën e prokurimit “*Blerje detergjent për pastrim dhe lavanteri*”, grupi i punës ka hartuar specifikimet teknike. Me shkresën nr. 138/4 prot, dt. 19.06.2025 është nxjerrë Urdhri i Prokurimit nr. 66, dt. 19.06.2025 për procedurën e prokurimit “*Blerje detergjent për pastrim dhe lavanteri*”.

Data e zhvillimit të procedurës në sistem është datë 01/07.2025, ora 12:00 me Nr. REF-51828-06-19-2025. Kontrata e lidhur nr. nr. 138/15, datë 25.07.2025 me vlerë 587,140 lekë pa TVSh dhe 704,568 lekë me TVSH. Operatori fitues “M”, person fizik është likuiduar me faturën nr.29/2025, datë 21.08.2025 në vlerën 77,340, faturën nr.47/2025, datë 27.11.2025 në vlerën 627,228.

Hartimi i dokumenteve të tenderit/kriteret e veçanta për kualifikim.

Njësia e Prokurimit nëpërmjet shkresës Procesverbalit nr. 138/6 prot., datë. 19.06.2025, ka dërguar për publikim procesverbalin tip për argumentimin e specifikimeve teknike, kriteret e kualifikimit dhe dokumentet e tenderit (DST) për publikim.

Grupi i auditimit auditoi dosjen fizike dhe atë elektronike mbi përmbushjen e kriterëve të DST-së dhe konstatoi mospërputhje si më poshtë vijon:

Konstatim: Sipas pikës 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar, në procesverbalin tip të NJP me nr.138/6 prot., datë 19.06.2025 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, citohet se: 2.2.1. *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore për vitet 2022,2023,2024 e cila duhet të ketë një vlerë jo më pak se 40% të fondit limit që prokurohet...* Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: $1,011,197 \times 0.4 = 404,478.8$ (katërqind e katër mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë pikë tetë) lekë pa tvsh. Kërkohej vlera jo më pak se 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, bazuar në pikën 4, të nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në të njëjtën logjikë NJP, vazhdon me kriterin 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale, ku citon se: 2.3.1. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se $1,011,197 \times 0.2 = 202,239.4$ (dyqind e dy mijë e dyqind e tridhjetë e nëntë pikë katër) lekë pa tvsh, me argumentimin:*

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$1,011,197 \times 0.2 = 202,239.4$ (dyqind e dy mijë e dyqind e tridhjetë e nëntë pikë katër) lekë pa TVSh.

NJP nuk interpreton saktë bazën ligjore për të dy kriteret e sipër cituara si për xhiron mesatare të OE për tre vitet ashtu edhe për përvojat në punët e mëparshme, pasi kjo bazuar në të njëjtën bazë ligjore që ata citojnë, në pikën 4 të nenit 40 të VKM nr. 285/2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Po kështu neni 55/ Procedurë e hapur e thjeshtuar, pika 4 i VKM nr. 285/2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, përcakton qartë se:

Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

Si dhe pika 4/b, për përvojat punëve të ngjashme:

Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Konkluzion: Pra NJP dhe më pas KVO kur verifikon ofertat nuk citojnë dhe të zbatojnë me përpikmëri pikërisht bazën ligjore në të cilën ata vetë bazohen duke ndryshuar kontekstin si matematikisht ashtu edhe juridikisht në frazën jo më e vogël se 20%, apo jo më pak se 40%, ndërkohë ligji citon saktë dhe qartë shprehjen: nuk mund të tejkalojë që e thënë ndryshe jo më e madhe ose e barabartë me 40 % për xhiron dhe 20% për përvojat në punët të ngjashme.

Në procedurat e prokurimit “E Hapur e thjeshtuar”, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret e thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Në zbatim të nenit 110 afatet për ankim, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 94, Kreut XII “Paraqitja e ankesave” të VKM-së nr.285 datë 19.02.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, KVO ka pritur afatin për ankesa të mundshme pranë Rezidencës Studentore Universitare Nr.2, Sh. A , ku rezultoi se nuk ka të tilla.

Në datën 01.07.2025, në orën 12:00, e përcaktuar si afati fundit për pranimin e ofertave, nëpunësi i autorizuar i Njësisë së Prokurimit ka mundësuar përfundimin e fazës “Dorëzimi i ofertave” për këtë procedure prokurimi.

Anëtarët e Komisionit të Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave në datën 01.07.2025, ora 12:00 e përcaktuar si afat i fundit i hapjes së ofertave, në portalin e APP <http://ëëë.app.gov.al> kanë hapur procedurën për vlerësim, ku operatorë ekonomikë pjesëmarrës ishin 6 të pasqyruar në tabelën 1, sipas ofertës në rend rritës.:

Nr.	Emri i Operatorëve Ekonomik	NIPT	Vlera e ofertës e shprehur në lekë pa tvsh
1	B	L82203011N	540,665.00
2	M	K42003004T	587,140.00
3	E	K91624505A	778,785.00
4	A	K22218003V	657,880.00
5	A	L81618008J	758,134.60
6	B.K	L42103023G	744,320.00

Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave ka mbajtur Procesverbalin nr.2 datë 01.07.2025, ora 12:00 “Për hapjen publike të ofertave të dorëzuara”.

Sipas KVO-së, dhe shqyrtimit të ofertave nga të sjellë nga 6 OE, u arrit në konkluzionin ka 1 (një) operator të s’ kualifikuar dhe sipas ofertave të dorëzuara, OE fitues është shpallur oferta më e vogël ekonomikisht e OE “M”, me NIPT dhe vlerë ofertë 587,140 lekë ose sa 58% e FL. -Referuar certifikatës pjesë të dokumentacionit të dorëzuar nga OE, në zbatim të kriterit teknik të vendosur nga NJP, OE “M” ka paraqitur certifikatën ISO të lëshuar nga IAF ShPK. Organi që ka lëshuar certifikatën ISO për OE fitues nuk rezulton në listën e organeve të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (<https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>). Për sa më sipër, kjo duhet të përbënte shkak për mospranimin e këtij dokumenti.

-Lidhja e kontratës. Me Operatorin ekonomik fitues “M”, person fizik, me nipt- K42003004T, është lidhur Kontrata nr. 138/15 Prot, datë 25.07.2025 me vlerë me Tvsh 704,568 lekë., me afat deri në 31.12.2025, nga nënshkrimi i kontratës. Me Urdhrin nr. 80. Date 30.07.2025 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim. Me shkresën nr. 139/18 prot, 28.07.2025 është hedhur në SPE Formulari i kontratës së nënshkruar.

Zbatimi i kontratës.

Me operatorin fitues “M”, person fizik është lidhur Kontrata Nr.138/15 Prot , datë 25.07.2025 me vlerë me Tvsh 704,568 lekë. Me shkresën nr. 138/10 prot, dt. 07.07.2025 është përgatitur Raporti përmbledhës mbi shqyrtimin e vlerësimit të ofertave. Likuidimi është bërë sipas tabelës si më poshtë brenda afatit ligjor.

Emërtimi	Fletë hyrje	Akt Kolaudimi	Vlera me Tvsh	Likuiduar
Fatura nr.29/2025, datë 21.08.2025	nr.17 dt 21.08.2025	Nr.138/18prot dt 21.08.2025	77,340.00	24.09.2025
Fatura nr.47/2025, datë 27.11.2025	nr.17 dt 21.08.2025	Nr.138/19prot dt 27.11.2025	627,228.00	11.12.2025
TOTALI			704,568.00	

Nuk u konstatuan shkelje në zbatimin e kontratës, dorëzimin e mallrave dhe marrjen e tyre në dorëzim nga Komisioni i marrjes në dorëzim.

VI. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, për procedurën e hapur të thjeshtuar me objekt “Objekti i prokurimit “Blerje lëndë djegëse gazoil për kaldajat”, për vitin 2025 me fond limit: 3,602,456 (tre milion e gjashtëqind e dy mijë e katër qind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSh dhe REF-36287-01-29-2025”, me të dhënat si më poshtë, u konstatua se:

A. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse gazoil për kaldajat”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 21 datë 27.01.2025	3. Njësia e prokurimit A.DH B.K	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Sipas Urdhrit: Nr.23, Datë 27.01.2025 A.M S.K D.M
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 3,602,456 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 3,501,372 lekë (97.2% e fondit limit)	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 101,084 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 10.02.2025	9. Burimi i Financimit Të ardhurat e Shoqërisë	10. Operatorët Ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender a)Pjesëmarrës në tender 3; A.T NipT, R, Nipt, K, Nipt K12511603H b) S’ kualifikuar 0 ; c) Kualifikuar 3.
11. Ankimime JO	12. Përgjigje e ankesës nga AK JO	13. Përgjigje ankesës nga KPP- N/A
b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhje e kontratës nr. 49/17, datë 25.02.2025	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 4,201,646.4 lekë me TVSH	16. Likuiduar: 2,478,645.56 lekë

17. Situacioni përfundimtar /faturë malli/shërbimi datë sipas listës.	18. Afati i kontratës në ditë Nga data 25.02.2025 deri në 31.12.2025	19. Zgjatja e kontratës me ditë JO
---	---	---------------------------------------

Objekti i prokurimit “Blerje lëndë djegëse gazoil për kaldajat ”, për vitin 2025 me fond limit: 3,602,456 (tre milion e gjashtëqind e dy mijë e katër qind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSh dhe REF-36287-01-29-2025.

Në shoqërinë "Rezidencës Studentore Universitare" nr.2 Tiranë, janë të instaluar dy kaldaja që përdorin lëndë djegëse gazoil të cilat shërbejnë për përgatitjen e ujit të ngrohtë sanitar të godinave nr. 1 dhe nr.2 sektori mjekësi. **Godina Nr. 1** Mjekësi. Në vitin 2010 në këtë godinë është instaluar një Kaldajë me këto të dhëna:350EN. **Godina Nr. 2** Mjekësi. Në këtë godinë është instaluar një Kaldajë gize 350 me fuqi 407 në vitin 2005, me pajisjet përkatëse dhe shërben për ngrohjen e godinës dhe përgatitjen e ujit të ngrohtë sanitar për dushe dhe lavanteri.

Për muajin gusht dhe shtator godinat e mjekësisë kanë qëndruar të mbyllura për akomodim veror për rrjedhojë konsumimi ka qenë zero. Referuar relacionit me nr.08/2 prot., datë 21.01.2025, për përcaktimin e normës së konsumit me gazoil të kaldajave dhe shkresës me nr.1744/1 datë 05.03.2020 nga Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial ku shprehen se: "Shkollat, spitalet dhe institucionet e tjera publike të cilat kanë kaldaja për ngrohje duhet të furnizohen vetëm me lëndë djegëse (gazoil) sipas përcaktimeve të shtojcës 1 të vendimin nr. 429, datë 26.6.2019 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial" me përmbajtje sqfuri më të vogël se 0.1% janë paraqitur si më poshtë të detajuar kërkesat për furnizim:

Muaji	Ditët e punës në muaj	Orët e punës në ditë	Harxhimi për 1 orë pune litra	Harxhimi për 1 orë pune litra	Konsumi mujor litra
Shkurt	26	3	22	1716	3432
Mars	26	3	22	1716	3432
Prill	26	2.5	22	1430	2860
Maj	26	2.5	22	1430	2860
Qershor	26	2	22	1144	2288
Korrik	26	2	22	1144	2288
Gusht	26	0	22	0	0
Shtator	26	0	22	0	0
Tetor	26	2.5	22	1430	2860
Nëntor	26	3	22	1716	3432
Dhjetor	26	26	22	1716	3435
Totali				13442	26884

Punoi grupi i auditimit.

Për muajin Janar nuk është llogaritur sasi gazoili për arsye se ka gjendje për mbulimin e nevojave për këtë muaj. Për muajt gusht, shtator është periudhë sezoni veror. Për mbulimin e nevojave me lëndë djegëse gazoil për kaldajat deri më 31.12.2025 janë nevojitur 26,884 litra gazoil. Me urdhrin nr. 49/1.prot, datë 23.01.2025, është ngritur grupi për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit “ Blerje lëndë djegëse gazoil për kaldajat ” dhe me shkresën nr. 49/2.prot, datë 23.01.2025 është kryer hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit për këtë procedurë.

Për argumentimin e fondit limit komisioni është bazuar në standardin SSHEN 590:2022 dhe në Vendimin nr. 429, datë 26.06.2019, (Për cilësinë e disave lëndëve djegshme, të lëngëta për përdorim termik, civil dhe industria.

Konstatim: Grupi i auditimit auditoi dosjen fizike dhe atë elektronike u konstatua se me shkresën nr.49/8 prot., datë 30.01.2025, procedura është anuluar. Në dosjen nuk gjendet proces

verbali i anulimit të procedurës, në kundërshtim me Nenin 2, pika 1, e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, *Dokumentimi i procesit 1. Autoriteti/enti kontraktor duhet të administrojë të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi i saj deri te zbatimi i kontratës. Për këtë qëllim, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera.*

-Gjithashtu u konstatua se : Sipas pikës 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe teknik, në proces verbalin tip të NJP me nr.30/6, datë 23.01.2024/Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, citohet se: *2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore për vitet 2020,2021,2022 e cila duhet të ketë një vlerë jo më pak se 40% të fondit limit që prokurohet*

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43 si dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

3,565,276 x 0.4= 1.426.110 (një milion e katërqind e njëzet e gjashtë mijë e njëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSh.

Kërkohet vlera jo më pak se 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, bazuar në pikë 4, të nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se ***3,565,276 x 0.2 = 713.055 (shtatëqind e trembëdhjetë mijë e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSh.***

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

3,602,456 x 0.2 = 720,491 (shtatëqind e njëzet mijë e katër qind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSh.

Konkluzion: Pra NJP dhe më pas KVO kur verifikon ofertat nuk citojnë dhe të zbatojnë me përpikëri pikërisht bazën ligjore në të cilën ata vetë bazohen duke ndryshuar kontekstin si matematikisht ashtu edhe juridikisht në frazën jo më e vogël se 20%, apo jo më pak se 40%, ndërkohë ligji citon saktë dhe qartë shprehjen: nuk mund të tejkalohet që e thënë ndryshe jo më e madhe ose e barabartë me 40 % për xhiron dhe 20% për përvojat në punë të ngjashme.

Në procedurat e prokurimit “E Hapur e thjeshtuar”, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Brenda datës 10.02.2025, e përcaktuar si afati i fundit për pranimin e ofertave, nëpunësi i autorizuar i Njësisë së Prokurimit ka mundur të përfundimin e fazës **“Dorëzimi i ofertave”** për këtë procedurë prokurimi.

Anëtarët e Komisionit të Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave në datën 12.02.2025, e përcaktuar në portalin e APP <http://www.app.gov.al> kanë hapur procedurën për vlerësim, ku operatorë ekonomikë pjesëmarrës, ishin 3 të pasqyruar në tabelën 1, sipas ofertës në rend rritës.

Nr.	Emri i Operatorëve Ekonomik	NIPT	Vlera e ofertës e shprehur në lekë pa tvsh
1	A.T		3.517.502,5
2	R		3.501.372
3	K		3.529.860

Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave ka mbajtur Procesverbalin nr.49/12 prot., datë 12.02.2025, “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të dorëzuara”, në zbatim të nenit 92 të ligjit 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" si dhe neni 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i Ofertave të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga Operatorët Ekonomikë si më poshtë vijon:

1. Operatori ekonomik "A.T" me nr. NIPT me vlerë 3,517,502.5 lekë pa TVSH, dhe me normë të fitimi të shprehur në vlerë absolute 2.8 lekë litër është kualifikuar. 2. Operatori ekonomik "R" me nr. NIPT me vlerë 3.501.372 lekë pa TVSh dhe me normë të fitimi të shprehur në vlerë absolute 1.9 lekë/litër është kualifikohet 3. Operatori ekonomik K me nipt me vlerë 3.529.860 lekë pa TVSh dhe me normë të fitimi të shprehur në vlerë absolute 12.8 lekë/litër është kualifikuar

Sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka bërë vlerësimin përkatës si më poshtë: Në vendin e parë: Operatori ekonomik "R" me nipt me vlerë 3.501.372 lekë pa TVSH, dhe me normë të fitimi të shprehur në vlerë absolute 1.9 lekë litër.

Në zbatim të nenit 110 afatet për ankim, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 94, Kreut XII “Paraqitja e ankesave” të VKM-së nr.285 datë 19.02.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, u prit afati për ankesa të mundshme pranë Rezidencës Studentore Universitare Nr.2, Sh. A dhe rezultoi se nuk ka të tilla.

Nga vlerësimi fitues i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse gazoil për kaldajat”, Procedurë e hapur e thjeshtuar me fond limit: 3.501.372 (tre milion e pesëqind e njëmijë e treqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa tvsh dhe REF-36387-01-30-2025 ,

Grupi i auditimit verifikoi dosjen fizike të OE, shpallur fitues dhe konstatoi se:

Dokumentacioni i dorëzuar nga operatori fitues “R” nipt L.....V Sh. A, rezultoi i paplotë, referuar certifikatës pjesë të dokumentacionit të dorëzuar nga OE, në zbatim të kriterit teknik të vendosur nga NJP, ka paraqitur certifikatën ISO nr. 9001:2015; EN ISO 14001:2015 të lëshuar nga IAF. Organi që ka lëshuar certifikatën ISO për OE fitues nuk rezulton në listën e organeve të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (<https://dpa.gov.al/organe->

te-akredituara/). Për sa më sipër, kjo duhet të përbënte shkak për mospranimin e këtij dokumenti.

Të dyja certifikatat e dorëzuara nga operatori ekonomik fitues mbajnë datën e skadencës 17.03.2025, shumë më përpara se afati i zbatimit të kontratës i cili është deri në dhjetori 2025. Për këtë KVO duhet të kishte kërkuar sqarim shpjegues operatorit ekonomik fitues në lidhje me garancinë që ai i jep në zbatimin me suksese të kontratës.

Për sa më sipër, kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik në kushtet kur nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar, është në kundërshtim me nenin 76 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 2 pika 2, shkronja (j), nenin 25, nenin 26 pika 6 dhe nenin 82, të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Referuar nenit 82, pika 2 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet se: *“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.*

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- *“Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;*

- *“Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.”*

Zbatimi i kontratës

Me Operatorin ekonomik fitues “R” nipt L.....V Sh. A, është lidhur kontrata nr. 19/17 prot., datë 25.02.2025 me vlerë **33.501.372** lekë me TVSH, me afat deri në 31.12.2025 nga nënshkrimi i kontratës.

Më poshtë jepet edhe likuidimi sipas planit të zbatimit të kontratës.

Emërtimi	Fletë hyrje	Akt Kolaudimi	Vlera me TVSh	Likuiduar
Fatura nr.208/2025, date 28.02.2025	nr.04 dt. 28.02.2025	Nr.49/21 prot dt. 28.02.2025	527,907.38	19.03.2025
Fatura nr.269/2025, date 28.02.2025	nr.05 dt. 25.03.2025	Nr.49/22prot dt. 25.03.2025	510,429.35	11.04.2025
Fatura nr.304/2025, date 16.04.2025	nr.8 dt. 16.04.2025	Nr.49/23prot dt.16.04.2025	397,641.79	14.05.2025
Fatura nr.340/2025, date 06.05.2025	nr.9 dt. 06.05.2025	Nr.49/24prot dt. 06.05.2025	382,902.91	04.06.2025
Fatura nr.381/2025, date 05.06.2025	nr.14 dt. 05.06.2025	Nr.49/25prot dt. 05.06.2025	322,278.53	03.07.2025
Fatura nr.428/2025, date 08.07.2025	nr.15 dt. 08.07.2025	Nr.49/26prot dt. 08.07.2025	337,485.60	05.08.2025
Fatura nr.536/2025, date 06.10.2025	nr.24 dt. 06.10.2025	Nr.49/27prot dt. 06.10.2025	408,614.98	24.10.2025
Fatura nr.582/2025, date 03.11.2025	nr.27 dt. 03.11.2025	Nr.49/28 prot dt. 03.11.2025	506,302.78	24.12.2025
TOTALI			3,393,563.32	

Punoi grupi i auditimit

-Nga auditimi i faturave të likuiduara nga ana e RSU nr.2, u konstatua se 1 fatura është likuiduar në tejkallim të afatit ligjor 30 ditor. Veprime në mospërputhje me ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” i ndryshuar, neni 52, ligjin nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, si dhe UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 184 “Nëpunësit zbatues të njësjive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit

dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik”.

Nuk u konstatuan shkelje në zbatimin e kontratës sipas planit të zbatimit të kontratës nr.30/18 prot, datë 27.02.2024 dhe marrjen në dorëzim të mallit nga magazina.

Nga subjekti i audituar RSU nr.2, nuk janë paraqitur observacione në fazën e Raportit të Auditimit.

VII. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, për procedurën e hapur të thjeshtuar me objekt “Objekti i prokurimit “ Blerje lëndë djegëse pelet për kaldajat ”, me të dhënat si më poshtë, u konstatua se:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse pelet për kaldajat”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 22 datë 27.01.2025	3. Njësia e prokurimit, sipas urdhrit nr.50/3, datë 24.01.2025	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Sipas Urdhrit: Nr.24., 50/5, datë 27.01.2025
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” REF-36370-01-30-2025	A.DH B.K I.G	A.M S.K D.M
5. Fondi Limit (pa tvsh) 5,428,800 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 3,477,777 lekë (60% e fondit limit)	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 1,951,023 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 10.02.2025	9. Burimi i Financimit Të ardhurat e Shoqërisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 7; A.P Nipt, W Nipt S.T Nipt S.K, Nipt, S.A Nipt, M, Nipt, A.M Nipt M Nipt b) S’ kualifikuar M; c) Kualifikuar 6.
11. Ankimime JO	12. Përgjigje e ankesës nga AK JO	13. Përgjigje ankesës nga KPP- N/A
b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhje e kontratës nr. 50/15, datë 27.02.2025	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 4,173,332.4 lekë me TVSH	16. Likuiduar: 2,446,302.64 lekë
	18. Afati i kontratës në ditë Nga data 27.02.2025 deri në 31.12.2025	19. Zgjatja e kontratës me ditë JO

Objekti i prokurimit “Blerje lëndë djegëse pelet për kaldajat”, me fond limit: 5,428,800 (pesë milion e katërqind e njëzet e tetë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH dhe REF-36370-01-30-2025. Për procedurën “Blerje lëndë djegëse pelet për kaldajat”, me fond limit 5,428,800 lekë, nga Drejtoria Teknike në RSU nr.2, është hartuar memo me nr.20, datë 20.01.2025, ku argumentohet se kjo blerje shërben për përgatitjen e ujit të ngrohtë sanitar të godinave nr. 3 dhe nr. 4, të sektorit mjekësi. Sipas përlllogaritjeve dhe tabelave të konsumit mujor të lëndës djegëse për vitin e mëparshëm 2024 e cila ka qenë 117,720 kg, për vitin 2025 dhe bazuar në kërkesat për furnizim nevojitet 135,720 kg lëndë djegëse për kaldajat.

Është ngritur grupi për përlllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike sipas urdhrit të Titullarit nr.50/1, datë 23.01.02025, me përbërje A.S, A.SH dhe B.SH.

Në procesverbalin e hartuar nga grupi i përlllogaritjes së fondit limit citohet se OE që janë testuar për çmimet janë 3:

A. me nipt; A.M me nipt- dhe A.P me nipt-

Në këtë proces verbal nuk citohen ofertat në vlerë që këta OE kanë paraqitur dhe për rrjedhojë mbetet e paqartë se si grupi për përlllogaritjen e fondit limit ka arritur në vlerën mesatare prej 5,428,000 lekë.

Në lidhje me vendosjen e kriterëve, grupi i auditimit auditoi dosjen fizike dhe atë elektronike mbi hartimin e tyre dhe konstatoi mospërputhje si më poshtë vijon:

-Sipas pikës 2.2.1/Kapaciteti ekonomik dhe teknik, në proces verbalin tip të NJP me datë 30.01.2025/Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, citohet se: 2.2.1. *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore për vitet 2021,2022,2023 e cila duhet të ketë një vlerë jo më pak se 40% të fondit limit që prokurohet Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43 si dhe nenit 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$5,428,800 \times 0.4 = 2.171.520$ (dy milion e njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e njëzet) lekë pa TVSh.

Në të njëjtën logjikë NJP, vazhdon me kriterin 2.3.1 Aftësitë teknike dhe profesionale, ku citon se:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se $5,428,800 \times 0.2 = 1,085,760$ (një milion e tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSh

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas NJP, bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

NJP nuk interpreton saktë bazën ligjore për të dy kriteret e sipër cituara si për xhiron mesatare të OE për tre vitet ashtu edhe për përvojat në punët e mëparshme, pasi kjo bazuar në të njëjtën bazë ligjore që ata citojnë, në pikën 4 te nenit 40 të VKM nr. 285/2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Po kështu neni 55/ Procedurë e hapur e thjeshtuar, pika 4 i VKM nr. 285/2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, përcakton qartë se:

Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

Si dhe pika 4/b, për përvojat punëve të ngjashme:

Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Konkluzion: Pra NJP dhe më pas KVO kur verifikon ofertat nuk citojnë dhe të zbatojnë me përpikëri bazën ligjore në të cilën ata vetë bazohen duke ndryshuar kontekstin si matematikisht ashtu edhe juridikisht në frazën jo më e vogël se 20%, apo jo më pak se 40%, ndërkohë ligji citon saktë dhe qartë shprehjen: nuk mund të tejkalojë që e thënë ndryshe jo më e madhe ose e barabartë me 40 % për xhiron dhe 20% për përvojat në punët të ngjashme.

Për këtë mbajnë përgjegjësi anëtarët e NJP-së: A.DH, B.K dhe I.G

- Në lidhje me vlerësimin e ofertave, në datën 10.02.2025, në orën 10.00, e përcaktuar si afati i fundit për pranimin e ofertave, nëpunësi i autorizuar i Njësisë së Prokurimit ka mundësuar përfundimin e fazës “Dorëzimi i ofertave” për këtë procedurë prokurimi.

Kanë ofertuar 7 OE, me oferta të paraqitura në rendin rritës, në tabelën në vijim:

Nr.	Emri i Operatorëve Ekonomik	NIPT	Vlera e ofertës pa tvsh
1	A	L97619302U	3,477,777.00
2	W	L23109601T	3,528,720.00
3	S.K	K01529003M	3,583,008.00
4	A.M	K36603807B	3,664,440.00
5	S.A	L64704601S	3,833,000.00
6	S.T	J64103483H	4,410,900.00
7	M	K42003004T	4,421,758.00

Punoi grupi i auditimit

Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave ka mbajtur Procesverbalin me nr. 50/10 datë 12.02.2025, “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, ku pas shqyrtimit ka vendosur:

Të kualifikojë 6 OE dhe të s’ kualifikojë 1 OE, si më poshtë vijon:

- Operatori ekonomik “A.P” me nr. NIPT me ofertë ekonomike me vlerë 3,477,777.00 lekë pa tvsh, kualifikuar;
- Operatori ekonomik “W” me nr. NIPT me ofertë ekonomike me vlerë 3,528,720 lekë pa tvsh, kualifikuar;
- Operatori ekonomik “S.K” me nr. NIPT me ofertë ekonomike me vlerë 3,583,008 lekë pa tvsh, kualifikuar;
- Operatori ekonomik “A.M” me nr. NIPT me ofertë ekonomike me vlerë 3,664,440.00 lekë pa tvsh, kualifikuar;
- Operatori ekonomik “S.A” me nr. NIPT me ofertë ekonomike me vlerë 3,833,000 lekë pa tvsh, kualifikuar;
- Operatori ekonomik “S.T” me nr. NIPT me ofertë ekonomike me vlerë 4,410,900 lekë pa tvsh, kualifikuar.
- Operatori ekonomik “M” me nr. NIPT me ofertë ekonomike me vlerë 4,421,758 lekë pa tvsh, s’ kualifikuar, pasi nuk ka plotësuar dokumentet e kërkuara sipas kriterit 2.3.1: “Dëshmi për furnizime të ngjashme” si dhe kriterin teknik sipas pikës 1, germa b/Sigurim Oferte.

Vlerësimi i ofertave bazuar në metodën e paracaktuar të vlerësimit-çmimi më i ulët.

Në zbatim të nenit 110 afatet për ankim, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 94, Kreut XII “Paraqitja e ankesave” të VKM-së nr.285 datë 19.02.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është pritur afati për ankesa të mundshme pranë Rezidencës Studentore Universitare Nr.2, Sh. A dhe rezultoi se nuk ka të tilla.

Sa më sipër, KVO ka paraqitur për miratim raportin përmbledhës “Për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave të procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse gazoil për kaldajat”, me nr. 50/13, me fond limit: 5,428,800 (pesë milion e katërqind e njëzet e tetë mijë e tetëqind) lekë pa TVSh dhe REF-36370-01-30-2025 në datën 26.02.2025, në 5 (pesë) faqe, në 3 (tre) kopje të barasvlershme, nga të cilat 1 (një) e mban KVO, 1 (një) kopje protokoll dhe 1 (një) administrohet në dosjen me shkrim të procedurës së prokurimit, të nënshkruar nga anëtarët e KVO-së.

Për sa më sipër OE fitues është shpallur OE “A.P” me NIPT dhe ofertë ekonomike me vlerë 3,477,777 lekë pa tvsh ose 4,173,332.4 lekë me TVSh.

Në lidhje me auditimin e dosje elektronike dhe fizike të OE fitues nuk u konstatuan mangësi përveç një dokumenti të tipit “Prokurë e Përgjithshme” e datës 23.08.2024, ku administratori i “A.P” me NIPT, autorizon vëllain e tij S.R të nënshkruajë dhe të kryejë çdo transaksion në lidhje me shoqërinë në të gjitha institucionet e shtetit si në bankat e nivelit të dytë. Kjo prokurë

është fotokopje, ndërkohë që duhet ishte e noterizuar ose origjinale, veprime në kundërshtim me nenin 74, pika gj) Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit, të VKM-së nr. 285 datë 19.02.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku citohet se:

Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit, kryen/jnë detyrat e mëposhtme: Administrimin e dokumentacionit në formë të shkruar, origjinal ose fotokopje të noterizuar të operatorit ekonomik fitues, përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti/enti kontraktor;

Zbatimi i kontratës me nr 50/15, datë 27.02.2025, ndërmjet AK dhe OE “A.P” me NIPT. Është kryer pagesa e sigurimit të kontratës në vlerën 417,333 lekë sipas formularit tip të datës 27.02.2025, e vlefshme deri në 31.12.2025.

Plani i zbatimit të kontratës me nr. 50/18, datë 27.02.2025, deri në 31.10.2025.

Emërtimi	Fletë hyrje	Akt Kolaudimi	Vlera me Tvsh	Likuiduar
Fatura nr.52/2025, datë 28.02.2025	nr.03 dt 28.02.2025	Nr.50/19prot dt 28.02.2025	719,538.77	19.03.2025
Fatura nr.78/2025, datë 28.03.2025	nr.06 dt 28.02.2025	Nr.50/20prot dt 28.03.2025	575,631.01	11.04.2025
Fatura nr.91/2025, datë 16.04.2025	nr.07 dt16.04.2025	Nr.50/21prot dt 16.04.2025	431,723.26	14.05.2025
Fatura nr.107/2025, datë 07.05.2025	nr.10 dt. 07.05.2025	Nr.50/22prot dt 07.05.2025	287,763.84	04.06.2025
Fatura nr.123/2025, datë 04.06.2025	nr.13 dt. 04.06.2025	Nr.50/23prot dt. 04.06.2025	287,763.84	03.07.2025
Fatura nr.147/2025, datë 10.07.2025	nr.16 dt. 10.07.2025	Nr.50/24prot dt. 10.07.2025	143,881.92	05.08.2025
Fatura nr.242/2025, datë 08.10.2025	nr.25 dt. 08.10.2025	Nr.50/25prot dt 10.07.2025	431,723.26	24.10.2025
Fatura nr.274/2025, datë 04.11.2025	nr.28 dt. 04.11.2025	Nr.50/26prot dt. 04.11.2025	575,631.01	
TOTALI			3,453,656.91	

Punoi grupi i auditimit

Nuk u konstatuan mangësi në shlyerjen e faturave si dhe në marrjen në dorëzim të materialit “pelet” sipas planit të zbatimit të kontratës.

Konkluzion:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në 3 procedurat e tipit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, të kryera gjatë periudhës 2024-2025, përkatësisht:

1. Procedura e hapur e thjeshtuar “Blerje lëndë djegëse pelet për kaldajat”, me fond limit 5,241,600 lekë pa TVSh, viti 2024;
2. Procedura e hapur e thjeshtuar “Blerje materiale elektrike, hidraulike, ndërtimore dhe marangozi” me fond limit 3,739,575 lekë pa TVSh, viti 2024;
3. Procedura “Blerje lëndë djegëse pelet për kaldajat”, viti 2025, me vlerë të fondit limit 5,428,800 lekë pa tvsh;

u arrit në konkluzionin e përbashkët se:

Njësia e Prokurimit nuk ka vendosur kriteret në përputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, datë19.05.2021, konkretisht:

1.1 Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik të llojit “E hapur e Thjeshtuar për periudhën 2024&2025, rezultoi se formulimi i përdorur nga Njësia e Prokurimit në dokumentacionin e tenderit, si vijon: “vlera e xhiros minimale vjetore duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së kontratës” është në kundërshtim me nenin 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i cili përcakton saktë se kjo vlerë nuk mund të tejkalojë 40% vlerës së kontratës. Përdorimi i shprehjes “jo më e vogël se 40%” nga ana e njësisë së prokurimit nënkupton një prag të barabartë ose më të lartë se 40%, duke transformuar plotësisht interpretimin e drejtë ligjor pasi shprehja në ligj “nuk mund të tejkalojë 40% vlerës së kontratës” është ekuivalente me shprehjen “më e vogël ose e barabartë me 40% të kontratës”. Si rrjedhojë, ky formulim përbën shkelje të dispozitës ligjore të sipërpërmendur duke sjellë kufizim të konkurrencës, veprime në kundërshtim me nenin 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

1.2 Njësia e Prokurimit ka përdorur në dokumentet e tenderit një formulim të kundërt më atë çfarë LPP 162/2020, i ndryshuar, citon, lidhur me kërkesën për përvojë të ngjashme, si pjesë e vlerësimit të kapacitetit teknik të operatorëve ekonomikë. Formulimi i përdorur: “dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera në vlerën jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit”, bie në kundërshtim me parashikimin e nenit 55 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i cili përcakton se vlera e kërkuar për furnizime të mëparshme nuk duhet të jetë më e madhe se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës. Përdorimi i shprehjes “jo më e vogël se 20%” nënkupton një prag minimal të barabartë ose më të lartë se 20%, duke tejkaluar kufirin maksimal të lejuar ligjorisht. Ky formulim përbën shkelje të dispozitës ligjore të sipërpërmendur dhe krijon kufizim të konkurrencës. Veprime në kundërshtim me nenin 2 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Në procedurat e prokurimit “E Hapur e thjeshtuar”, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret e thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

1.3 Nga auditimi i procedurës së prokurimit e Hapur e Thjeshtuar me objekt “Blerje lëndë djegëse pelet për kaldajat”, me fond limit 5,241,600 lekë pa tvsh, viti 2024 rezultoi se, operatori “A.P” pjesëmarrës në procedurë është kualifikuar dhe shpallur fitues në kushtet kur nuk ka dorëzuar dokumentacionin fizik për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit. Konkretisht mungonin: Vërtetime nga Gjykata dhe Prokuroria lidhur me gjendjen gjyqësore të subjektit; Vërtetim nga Bashkia për shlyerjen e detyrimeve vendore; Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për pagim detyrimesh; Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për mungesën e detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore; Vërtetim nga FSHU për shlyerjen e detyrimeve për faturat e energjisë elektrike. Veprime në kundërshtim me nenin 76 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 2 pika 2, shkronja (j), nenin 25, nenin 26, pika 6 dhe nenin 82 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Gjithashtu në dosje është edhe prokura e kryer nga administratori i “A.P”, me nipt- ShPK, z. E.R, i cili emëron përfaqësues të posaçëm z. R.R (babain e tij) dhe z. S.R (vëllain), me afat të pacaktuar duke i pajisur me tagër të plotë që të dy së bashku ose veç e veç, të kryejnë veprimet përpara i përket çdo nënshkrimi, përfaqësimi në të gjitha institucionet shtetërore.

Por kjo prokurë është vetëm kopje (data nuk lexohet) dhe normalisht duhet të ishte origjinale ose e noterizuar, veprime në kundërshtim veprime në kundërshtim me nenin 74, pika gj) Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit, të VKM-së nr. 285 datë 19.02.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku citohet se:

Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit, kryen/jnë detyrat e mëposhtme:
Administrimin e dokumentacionit në formë të shkruar, origjinal ose fotokopje të noterizuar të operatorit ekonomik fitues, përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti/enti kontraktor.

Pavarësisht faktit që kontrata është zbatuar me sukses nga operatori ekonomik fitues, kualifikimi i tij në kushtet e mos përmbushjes së kritereve ligjore për t'u shpallur fitues ka cenuar parimet themelore të prokurimit publik, përkatësisht transparencës dhe barazisë në procesin e vlerësimit.

1.4 Nga auditimi i procedurës së prokurimit e Hapur e Thjeshtuar, me objekt “Blerje materiale elektrike, hidraulike, ndërtimore dhe marangozi”, me fond limit: 3,739,575 lekë u konstatua se, operatori ekonomik fitues, “D.R” me nr. NIPT është kualifikuar dhe shpallur fitues në kushtet kur nuk ka dorëzuar dokumentacionin fizik për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit. Konkretisht mungonin: Vërtetime nga Gjykata dhe Prokuroria lidhur me gjendjen gjyqësore të subjektit, veprime në kundërshtim me nenin 76 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 2 pika 2, shkronja (j), nenin 25, nenin 26, pika 6 dhe nenin 82 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

1.5 Nga auditimi i procedurës së prokurimit e Hapur e Thjeshtuar me objekt “Blerje lëndë djegëse pelet për kaldajat”, viti 2025, me vlerë të fondit limit 5,428,800 lekë pa TVSh, u konstatua se dokumentet e përfaqësimit të OE në tender si dhe kontrata e lidhur janë firmosur nga vëllai i Administratorit të shoqërisë së shpallur fituese “A.P” Shpk, z. S.R sipas dokumentit të tipit “Prokurë e Përgjithshme” e datës 23.08.2024, ku administratori i “A.P”, autorizon vëllain e tij Sokol Roli të nënshkruajë dhe të kryejë çdo transaksion në lidhje me shoqërinë në të gjitha institucionet e shtetit si në bankat e nivelit të dytë. Kjo prokurë është fotokopje, ndërkohë që duhet ishte e noterizuar ose origjinale, veprime në kundërshtim me nenin 74, pika gj) Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit, të VKM-së nr. 285 datë 19.02.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

VIII. Objekti i prokurimit: “Blerje detergjent për pastrim dhe lavanteri për shoqërinë”

Të dhëna mbi objektin e prokurimit

C. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje detergjent për pastrim dhe lavanteri”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 49 datë 24.06.2024	3. Njësia e prokurimit A.DH B.K A.L	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Sipas Urdhrit: Nr.52, Datë 25.06.2024 M.N E.XH A.S
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 842,497 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 647,153 lekë (76.81% e fondit limit)	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 195,344 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 05.02.2024	9. Burimi i Financimit Të ardhurat e Shoqërisë	10. Operatorët Ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender a)Pjesëmarrës në tender 5; B Nipt, M Nipt, E.M, Nipt, A 3 Nipt, A Nipt b) S' kualifikuar M, A 3, A c) Kualifikuar 2.
11. Ankimime JO	12. Përgjigje e ankesës nga AK JO	13. Përgjigje ankesës nga KPP- N/A
b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhje e kontratës nr. 147/14, datë 07.08.2024	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 776,583.6 lekë me TVSH	16. Likuiduar: 776,583.6 lekë
17. Situacioni përfundimtar /faturë malli/shërbimi datë Sipas listës.	18. Afati i kontratës në ditë Nga data 07.08.2024 deri në 31.12.2024	19. Zgjatja e kontratës me ditë JO

Burimi: Të dhënat AK dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE)

Nga ana e AK është ngritur Njësia e Prokurimit, me Urdhrin e Prokurimit Urdhri nr. 49 prot., datë 24.06.2024, e cila ka filluar procedurën me objekt “**Blerje detergjent për pastrim dhe lavanteri**”, me nr. Reference të procedurës së prokurimit, REF 11135-06-25-2024, me fond limit: 842,497 lekë (tetëqind e dyzet e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH. Sipas Urdhrit nr. 49 prot., datë 24.06.2024 Njësia e Prokurimit përbëhet nga:

1. A.DH, Kryetar
2. B.L, Anëtar
3. A.L, Anëtar

Janë trajtuar në vijim:

7. Planifikimi i nevojave për prokurim
8. Llogaritja e fondit limit
9. Nxjerrja e urdhër prokurimit
10. Hartimi i dokumenteve të tenderit/kriteret e veçanta për kualifikim
11. Vlerësimi i Ofertave.
12. Zbatim i kontratës

Planifikimi i nevojave për prokurim - Planifikimi i nevojave për prokurim është parashikuar në Regjistrin e parashikimeve për vitin 2024, me shkresën nr. 22 prot, dt. 15.01.2024, Autoriteti kontraktor ka miratuar Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike të Autoritetit Kontraktor “Rezidenca Studentore Universitare” nr.2 Sha për vitin 2024, ku është pasqyruar dhe ky zë i prokurimit. Drejtoria e Hotelerisë me shkresën nr. 191 prot, dt. 10.06.2024 drejtuar Administratorit të shoqërisë ka kërkuar për blerje detergjent dhe material pastrimi për vitin 2024.

Llogaritja e fondit limit – Titullari i AK ka ngritur grupin e punës për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe argumentimin e fondit limit me Urdhrin nr. 46, dt. 14.06.2024. Me shkresën nr. 147/1 prot, dt. 21.06.2024 bazuar në Urdhrin e mësipërm janë hartuar specifikimet teknike dhe përllogaritja e fondit limit.

Nxjerrja e urdhër prokurimit - Në zbatim të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar, neni 77, VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 73, pika 1,2 dhe 76, Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhër Prokurimi nr. 51 datë 25.06.2024, për zhvillim e procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar – Prokurim Elektronik - Mallra*” me objekt “*Blerje detergjent për pastrim dhe lavanteri*”, me fond limit 842,497 lekë pa TVSH., për të cilën është ngarkuar Njësia e Prokurimit për ndjekjen dhe zbatimin e procedurës.

Konstatim: Referuar urdhrin të prokurimit, zgjedha e llojit të procedurë së prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar-Mallra* është përzgjedhur jo konform ligjin për LPP, nr. 162/2020, dt. 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Neni 55, Procedura e hapur e thjeshtuar është një procedurë me një fazë, që mund përdoret nga autoriteti kontraktor për kontrata nën kufirin e ulët monetar, sipas parashikimit në nenin 49, të LPP-së, si dhe neni 77, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, pra komisioni i prokurimit ka përzgjedhur “Procedura e hapur e thjeshtuar” por sipas përllogaritjeve vlera e fondit limit është 842,497.00 lekë pa TVSH, pra është blerje e vogël sepse është poshtë limitit 100.000 (njëqind mijë lekë), Neni 56, “Procedura e prokurimit me vlerë të vogël”, Autoriteti/enti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë/mallra/shërbime, kur vlera e përllogaritur është ndërmjet kufijve nga 100.000 (njëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë në vit, sipas përcaktimit në pikën 2, të neni 41, të LPP-së. Pra klasifikimi në këtë lloj procedure nuk është bërë sipas përcaktimeve ligjore por ky konstatim nuk ka efekt financiar.

Hartimi i dokumenteve të tenderit/kriteret e veçanta për kualifikim.

Njësia e Prokurimit nëpërmjet shkresës Procesverbalit nr. 147/5 prot., datë. 25.06.2024, ka dërguar për publikim procesverbalin tip për argumentimin e specifikimeve teknike, kriteret e kualifikimit dhe dokumentet e tenderit (DST) për publikim.

Konkluzion: Në dokumentet e procedurës së prokurimit, pika 2, (Kriteret e veçanta të kualifikimit), pika 2.2 Kapaciteti ekonomike financiar, Njësia e Prokurimit ka përcaktuar si

kriter kualifikues dorëzimit e vërtetimit për xhiron vjetore për tre (3) vitet e fundit financiare, me kusht që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar të jetë “jo më e vogël se 40%” të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ky formulim rezulton në kundërshtim me nenin 43 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i cili parashikon se: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë **nuk mund të tejkalojë: c. 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.**” Përdorimi i shprehjes “jo më e vogël se 40%” nënkupton një prag të barabartë ose më të lartë se 40%, duke tejkaluar kufirin maksimal të lejuar ligjërish. Si rrjedhojë, ky formulim përbën shkelje të dispozitës ligjore në kundërshtim me veprime në kundërshtim me nenin 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke sjell kufizim të konkurrencës.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e Njesisë së Prokurimit: A.DH, Kryetar, B.K, Anëtare, A.L, Anëtarë.

Vlerësimi i Ofertave

– Në zbatim të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 84, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ngritur me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr.52 prot, datë 25.06.2024, ka hartuar raportin përmbledhës për procedurën e prokurimit të sipërcituar, pas përfundimit të afateve të ankimit.

Në datën 08.07.2024, në orën 12.00, e përcaktuar si afati fundi për pranimin e ofertave, anëtarët e Komisionit të Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave (në vijim “KVO”), kanë hapur procedurën për vlerësim, ku ka rezultuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, ishin 5 OE si vijon:

Nr.	Emri i Operatorëve Ekonomik	NIPT	Vlera e ofertës në lekë pa tvsh
1	B		647,153.00
2	M		634,291.00
3	E.M		729,640.00
4	A3		786,860.00
5	A		789,660.00

Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave ka mbajtur Procesverbalin nr.2 datë 08.07.2024, ora 12.00 “Për hapjen publike të ofertave të dorëzuara”. Vlerat e ofertave ekonomike të dorëzuara nga ofertuesit pjesëmarrës janë si më poshtë:

- ✓ Operatori ekonomik “B” me nr. NIPT me ofertë ekonomikë në vlerën 647,153.00 lekë pa tvsh
- ✓ Operatori ekonomik “M” me nr. NIPT me ofertë ekonomikë në vlerën 634,291.00
- ✓ Operatori ekonomik “E.M” me nr. NIPT me ofertë ekonomikë në vlerën 729,640.00
- ✓ Operatori ekonomik “A.3” me nr. NIPT me ofertë ekonomikë në vlerën 786,860.00
- ✓ Operatori ekonomik “A” me nr. NIPT me ofertë ekonomikë në vlerën 789,660.00

Arsyet e s` kualifikimit të ofertuesve:

Operatori ekonomik “M” me nr. NIPT me ofertë ekonomikë në vlerën 634,291.00

Operatori ekonomik “M” nuk kishte paraqitur mostrat e kërkuar për kriterin teknik sipas pikës 2.3.2, çka bie në kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit në Dokumentet Standarde të Tenderit.

Më konkretisht:

Tek materialet detergjent mostra e kërkuar me numrin rendor 5 (anti kalkare) nuk është paraqitur nga operatori ekonomik.

Operatori ekonomik "A 3" me nr. NIPT me ofertë ekonomike në vlerën 786,860 lekë.

•Operatori ekonomik "A 3" nuk kishte paraqitur mostrat e kërkuar për kriterin teknik sipas pikës 2.3.2, çka bie në kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit në Dokumentet Standarde të Tenderit.

Më konkretisht:

Tek materialet e pastrimit mostra me numrin rendor 17 (maska) dhe mostra me numrin rendor 23 (qese për mbeturina) nuk është paraqitur nga operatori ekonomik.

Operatori ekonomik "A" me nr. NIPT me ofertë ekonomike në vlerën 789,660.00

•Operatori ekonomik "A" nuk kishte paraqitur mostrat e kërkuara për kriterin teknik sipas pikës 2.3.2, çka bie në kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit në Dokumentet Standarde të Tenderit.

Ofertuesit e kualifikuar dhe renditja përfundimtare janë si më poshtë:

1. "B" Vlera: 647,153.00 lekë pa TVSh

2. "E.M" Vlera: 729,640.00 lekë pa TVSh

Në zbatim të nenit 110 afatet për ankim, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", nenit 94, Kreut XII "Paraqitja e ankesave" të VKM-së nr.285 datë 19.02.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, rezultoi se nuk ka ankesa të tilla. Me shkresën nr. 147/11, dt. 18.07.2024 është shpallur formulari i njoftimit të fituesit paraprak dhe me shkresën nr. 147/13, dt. 29.07.2024 është shpallur formulari i njoftimit të fituesit.

Konstatim: Referuar certifikatës pjesë të dokumentacionit të dorëzuar nga OE B ShPK, në zbatim të kriterit teknik të vendosur nga NJP, OE B ShPK ka paraqitur certifikatën EN-ISO nr. 9001:2015 dhe certifikatën EN-ISO nr. 14001:2015. Organi që ka lëshuar certifikatën ISO për OE fitues nuk rezulton në listën e organeve të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (<https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>). Për sa më sipër, kjo duhet të përbënte shkak për mospranimin e këtij dokumenti.

-Lidhja e kontratës.

Kontrata midis AK dhe "B" ShPK, është lidhur me nr., 147/14 prot, datë 07.08.2024. Me shkresë nr. 147/15 prot datë 07.08.2024 është ngritur Urdhri për marrjen në dorëzim të materialeve.

- ✓ Me shkresën nr. 147/17 prot., datë 13.08.2024 është marrë në dorëzim malli me faturën nr. 78, datë 13.08.2024.
- ✓ Me shkresën nr. 147/18 prot., datë 06.11.2024 është marrë në dorëzim malli me faturën nr. 104, datë 06.10.2024.
- ✓ Me shkresën nr. 147/19 prot., datë 20.12.2024 është marrë në dorëzim malli me faturën nr. 121, datë. 20.12.2024.

Zbatim i kontratës

Me shkresën nr. 147/ prot. 15, dt. 07.08.2024, urdhrin nr. 66, datë 07.08.2024 "Për ngritjen e komisionit për marrje në dorëzim të materialeve detergjente për pastrim dhe lavaneri" bazuar në nenin 124 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenin 107, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Udhëzimin Nr.30 datë 27/12/2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", si dhe bazuar kontratës me nr. prot 147/14, datë 07.08.2024 "Blerje detergjent për pastrim dhe lavaneri" është ngritur

komisioni i marrjes në dorëzim i materialeve. Likuidimi është bërë sipas tabelës si më poshtë:

Tabela 15: Likuidimi i procedurës të prokurimit “Blerje detergjent për pastrim dhe lvanteri për shoqërinë”.

Emërtimi	Fletë hyrje	Akt Kolaudimi	Vlera me TVSh	Likuiduar
Fatura nr.78/2024, datë 13.08.2024	nr.18 dt. 13.08.2024	Nr.147/17 prot dt. 13.08.2024	138,243.60	03.09.2024
Fatura nr.104/2024, datë 06.11.2024	nr.34 dt 06.11.2024	Nr.147/18 prot dt 06.11.2024	176,133.60	21.11.2024
Fatura nr.121/2024, datë 20.12.2024	nr.41 dt. 20.12.2024	Nr.147/19 prot dt. 20.12.2024	462,206.40	26.12.2024
TOTALI			776,583.60	

Konkluzion: Nga verifikimi i procedurave të prokurimit “blerje e vogël”, për vitin 2024, u konstatua se nga auditimi me përzgjedhje mbi bazë risku (*referuar kontratës së lidhur me vlerë më të lartë*) si gjetje e përbashkët u konstatua se:

- Në dokumentet e procedurës së prokurimit, me objekti **“Blerje detergjent për pastrim dhe lvanteri”**, me REF 11135-06-25-2024, me fondi limit: 842,497 lekë (tetëqind e dyzet e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, pika 2, (Kriteret e veçanta të kualifikimit), pika 2.2 Kapaciteti ekonomike financiarë, Njësia e Prokurimit ka përcaktuar si kriter kualifikues dorëzimin e vërtetimit për xhiron vjetore për tre (3) vitet e fundit financiare, me kusht që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar të jetë **“jo më e vogël se 40%”** të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Ky formulim rezulton në kundërshtim me nenin 43 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i cili parashikon se: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c. 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.” Përdorimi i shprehjes “jo më e vogël se 40%” nënkupton një prag të barabartë ose më të lartë se 40%, duke tejkaluar kufirin maksimal të lejuar ligjërish. Si rrjedhojë, ky formulim përbën shkelje të dispozitës ligjore në kundërshtim me veprime në kundërshtim me nenin 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke sjell kufizim të konkurrencës.

- Në procedurën e prokurimit, me objekti “Blerje detergjent për pastrim dhe lvanteri”, me REF 11135-06-25-2024, referuar certifikatës pjesë të dokumentacionit të dorëzuar nga OE B ShPK, në zbatim të kriterit teknik të vendosur nga NJP, OE B ShPK ka paraqitur *certifikatën EN-ISO nr. 9001:2015 dhe certifikatën EN-ISO nr. 14001:2015. Organi që ka lëshuar certifikatën ISO për OE fitues nuk rezulton në listën e organeve të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (<https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>). Për sa më sipër, kjo duhet të përbënte shkak për mospranimin e këtij dokumenti. Për sa më sipër, kjo duhet të përbënte shkak për mospranimin e këtij dokumenti. Kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik në kushtet kur nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar, është në kundërshtim me nenin 76 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 2 pika 2, shkronja (j), nenin 25, nenin 26 pika 6 dhe nenin 82, të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.*

Parregullsitë e konstatuara janë në përputhje me përcaktimet ligjore e nënligjore:

- Ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;

- Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar;
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr.5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.

Auditimi i procedurave të prokurimit “Blerje e vogël”, për periudhën 2024-2025/09.

Mbi auditimin e ushtruar në Rezidencën Studentore Universitare Nr.2, sha (*këtu e më poshtë RSUNr.2 sha*) në bazë të Programit të Auditimit të Përputhshmërisë nr.1047/1 prot, datë 03.11.2025, i mbajtur në datë 19.12.2025. Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit, “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimit e kontratave (viti 2024), u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

13. *Regjistri i parashikimeve/ realizimeve të periudhës 01/01/2024 – 31/12/2024;*
14. *Dosjet e procedurave të prokurimit të përcaktuara për auditim të vitit 2024, blerjet e vogla sipas analizës së riskut;*
15. *Sistemi elektronik i prokurimeve (SPE) në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit publik sipas kodit të marrë nga APP si Auditues;*
16. *Urdhra/ Vendime të Titullarit të AK;*
17. *Dosjet fizike të OE/BOE shpallur fitues;*
18. *DST e hartuar nga NJP për procedurat e përcaktuara për auditim;*
19. *Urdhër shpenzimet e likuidimit të kryera nga Sektori i Financës;*
20. *Dokumentacioni shoqërues i marrjes në dorëzim.*

Auditimi i këtij drejtimi u bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe të gjitha aktet e nxjerra në zbatim të tij (VKM, udhëzime etj.).

Përsa i përket regjistrave të planifikimit dhe të realizimit të prokurimeve ato janë dërguar në APP sipas sistemit elektronik si dhe për çdo ndryshim të kryer në to gjatë vitit financiar janë dërguar edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit Financiar në bashkinë Tiranë, në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik¹” i ndryshuar, neni 3 dhe 4.

Rezidenca Studentore Universitare Nr.2, sha për vitin 2024, në zbatim të detyrimit ligjor përcaktuar në legjislacionin e prokurimit publik në fillim të vitit kalendarik ka ngritur komisionin e prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël me urdhër të titullarit të Autoritetit Kontraktor (AK). Në zbatim të Ligjin Nr.162/2020 i ndryshuar, VKM nr.285, datë 19.05.2021, neni 68 dhe Udhëzimit Nr.3, datë 18.06.2021, konkretisht me urdhrin nr. 02 prot, dt. 03.01.2024 Administratori ka deleguar kompetencat e titullarit të Autoritetit Kontraktor, të Rezidencës Studentore Universitare Nr.2, sha për vitin 2024 z.J.L me detyrë zv/Administratore për të gjitha procedurat e prokurimit publik të shoqërisë. Këto kompetenca do të ushtrohen për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij urdhri pra nga dt. 03.01.2024 deri në dt. 31 Dhjetor 2024. Për vitin 2024, me Urdhër nr. 7, datë 10.01.2024 është ngritur Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël me përbërje:

- A.DH Kryetar
- B.K Anëtar
- S.A Anëtar

Me Urdhrin nr.06, datë 10.01.2024 “Për caktimin e personit përgjegjës për prokurimet e vitit 2024 në Rezidencën Studentore Universitare Nr. 2, sha” është caktuar personi përgjegjës i prokurimeve z. A.DH dhe znj. B.K. Gjithashtu gjatë vitit 2024 me Urdhrat përkatëse janë krijuar “Komisionet e marrjes në dorëzim të mallrave të prokuruar gjatë vitit” me përbërje si vijon:

1. Blerje lëndë djegëse Gazoil për kaldajat

Grupi i marrjes në dorëzim me urdhër nr.30, datë 27.02.2024:

- A.S, Kryetar
- D.C, Anëtar
- I.F, Anëtar

2. Blerje lëndë djegëse Pelet për kaldajat

Grupi i marrjes në dorëzim me urdhër nr.29, datë 27.02.2024:

- Y.ZH Kryetar
- P.SH Anëtar
- B.SH Anëtar

3. Blerje materiale elektrike, hidraulike, ndërtimore dhe marangozeri

Grupi i marrjes në dorëzim me urdhër nr.65, datë 31.07.2024

- A.S Kryetar
- I.F Anëtar
- H.S Anëtar
- F.K Anëtar
- I.R Anëtar

4. Blerje detergjent për pastrim dhe lavanteri

Grupi i marrjes në dorëzim me urdhër nr.66, datë 07.08.2024

- E.M Kryetar
- M.D Anëtar
- B.A Anëtar
- DH.B Anëtar
- S.M Anëtar

Në lidhje me sa më sipër janë kërkuar elektronikisht dhe janë vënë në dispozicion regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike për periudhën 2024.

Për vitin **2024**, Rezidenca Studentore Universitare Nr.2, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor (AK) ka kryer gjithsej 27 procedura prokurimi “*Blerje me vlerë të vogël*”, me vlerë të fondit limit **19,602,730** lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate të nënshkruar **14,891,189** lekë. Në blerjet me vlerë të vogël, u përzgjodhën mbi bazë risku, vlera më e lartë, (vlera më e lartë e kontratës së lidhur) 11 procedura prokurimi me fond limit 6,182,626 lekë dhe realizim në vlerën 4,285,008 lekë, me të dhënat të detajuara në tabelën nr.1.

Tabela 1: Përmbledhëse e procedurave të prokurimeve me vlerë të vogël viti 2024

Nr	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik fitues	Operatorët Ekonomik pjesmarrës	Urdhër prokurimi Nr.Prot/dt.	Dt.P-verbal të OE fitues
1	Shpenzime për ekspert kontabël	468,000	441,240	P	7	Nr.25, datë 30.01.2025	05.03.2024

2	Blerje karburant diesel 10 ppm	380,000	366,000	A.T	5	Nr.32, datë 05.03.2024	19.03.2024
3	Shpenzime dezinfektimi 3D	1,041,644	522,000	A	20	Nr.35, datë 13.03.2024	05.04.2024
4	Rimbushje fikëse zjarri Abc dhe Bce	246,720	144,000	K.K	12	Nr.60, datë 16.07.2024	24.07.2024
5	Shpenzime shtypshkrime	482,262	282,720	A.P	16	Nr.69, datë 28.08.2024	09.09.2024
6	Blerje kancelari dhe tonera	1,188,000	600,000	L.D	30	Nr.78, datë 04.10.2024	15.10.2024
7	Blerje materiale punëtorie sinjalistike dhe veshje sigurimi në punë	252,000	196,980	A.K	28	Nr.91, datë 02.12.2024	18.12.2024
8	Blerje materiale për puset e ujit	205,000	150,000	J.M	15	Nr.92, datë 04.11.2024	16.12.2024
9	Blerje materiale për chillerat dhe panelet diellore	849,000	598,188	D.R	13	Nr.100, datë 11.12.2024	16.12.2024
10	Blerje uniforma pune për stafin	240,000	204,000	E.Z	22	Nr.106, datë 18.12.2024	30.12.2024
11	Blerje pompa për sistemin e chillerave dhe paneleve diellore	830,000	779,880	D.R	16	Nr.104, datë 17.12.2024	30.12.2025
	Totali	6,182,626	4,285,008				

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve të Brendshme në Rezidencën Studentore Universitare Nr. 2, sh.a, përpunuar nga KLSH

Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, të kryera në Rezidencën Studentore Universitare Nr.2, sha, rezultoi se:

- Procedura e prokurimit me vlerë të vogël për mallra/shërbime, përdoret nga AK, kur vlera e fondit limit është ndërmjet kufijve nga 100,000 (njëqind mijë) lekë deri në 1,000,000 (një milion) lekë në vit, sipas përcaktimit në pikën 2, të nenit 41, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik". Nga Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla nuk ka copëzim fondi.

➤ Përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit nga AK është kryer përllogaritja e fondit limit të procedurës blerje e vogël nga "Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël", bazuar në kërkesat për nevoja mallra/shërbime nga Drejtoritë e institucionit. Përllogaritja e fondit limit, është bazuar në ofertat e marra në treg dhe janë pasqyruar në dokumentin e hartuar për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike.

- Në të gjitha rastet është zbatuar kriteri i çmimit më të ulët për klasifikimin përfundimtar dhe nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël është mbajtur procesverbal për shpalljen e OE fitues, mbi bazën e ofertës më të ulët të shpallur nga sistemi.

➤ - Për të gjitha rastet e audituara të blerjeve si për shërbimet dhe mallrat është kryer procesi i marrjes në dorëzim të mallit dhe shërbimit nga komisioni i ngritur për çdo rast nga Nëpunësi Autorizues me detyrë Zëvendës Administrator.

➤ - Me urdhrin nr. 6, dt. 10.01.2024, është caktuar personi përgjegjës për prokurimet në Rezidencën Studentore Universitare Nr.2, sha.

- Bazuar në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", në VKM nr. 285 datë 19.05.2021, i ndryshuar, neni 3, pika 1 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", Udhëzimin nr.04, datë 18.06.2021, "Për Hartimin e Regjistrin të Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit Publik dhe Krijimin e tyre në Sistemin Elektronik", Vendimin e Këshillit

Mbikëqyrës nr.12 prot, datë 27.10.2023 "Për miratimin e Projekt Programit për vitin 2024" si dhe Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, nr.6 prot, datë 12.12.2023 "Për miratimin e Projekt Programit të Zhvillimit Ekonomik për vitin 2024", me shkresën nr. 22 prot, dt. 15.01.2024 Autoriteti kontraktor ka miratuar Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike të AK "Rezidenca Studentore Universitare" nr.2 Sha për vitin 2024.

- Me shkresën nr. 131 prot, dt. 27.05.2024 Autoriteti kontraktor ka dërguar Regjistrin e Realizimeve të Prokurimeve Publike të Autoritetit Kontraktor "Rezidenca Studentore Universitare" nr.2 Sha., për 4- mujorin e parë të vitit 2024.

- Me shkresën nr. 218 prot, dt. 03.10.2024, Autoriteti kontraktor ka dërguar Regjistrin e Realizimeve të Prokurimeve Publike të Autoritetit Kontraktor "Rezidenca Studentore Universitare" nr.2 Sha., për 8- mujorin e parë të vitit 2024.

- Me shkresën nr. 24 prot, dt. 10.01.2025 Autoriteti kontraktor ka dërguar Regjistrin e Realizimeve të Prokurimeve Publike të Autoritetit Kontraktor "Rezidenca Studentore Universitare" nr.2 Sha., për vitin 2024.

1. Objekti i prokurimit: **“Shpenzime për ekspert kontabël”**

Autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël me objekt: “Shpenzime për ekspert kontabël”. Procedura është iniciuar me kërkesën nr. 16 prot., dt.23.01.2024 për nisjen e procedurës së prokurimit, “Shpenzime për ekspert kontabël për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2023”, drejtuar Administratorit të shoqërisë, mbështetur në ligjin N.9901, datë 14.04.2008 ""Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, i ndryshuar në ligjin Nr.25/2018, "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" në ligjin Nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për Auditimin Ligjor; Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar" neni 41, ku citohet se: "Shoqëritë tregtare janë të detyruara të emërojnë për auditimin ligjor të pasqyrave financiare të tyre jo më pak se dy auditues ligjore", neni 42, pika 2 ku thuhet: "Shoqëritë tregtare, të parashikuara në shkronjat "a" e "b", të nenit 41, të këtij ligji, janë të detyruara të emërojnë për auditimin ligjor të pasqyrave financiare të tyre, të paktën, një shoqëri auditimi, që ka të regjistruar jo më pak se dy auditues ligjor, ose dy auditues ligjor persona fizikë; një auditues ligjor person fizik dhe një shoqëri auditimi, që ka të regjistruar, të paktën, një auditues ligjor, apo dy shoqëri auditimi, që kanë të regjistruar, përkatësisht, vetëm një auditues ligjor. " i ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.335, datë 04.05.2016, "Për transferimin 100% të aksioneve të shoqërive aksionare 'Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Sh. A. Tiranë: "Trajtimi i Studentëve nr. 2 Sh. A. Tiranë", "Trajtimi i Studentëve nr. 3 Sh. A. Tirane nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes te Bashkia Tiranë".

Mbështetur në ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 34, 36, dhe neni 76, të VKM –së nr. 285, dt. 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është ngritur Urdhri “Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit. Bazuar në Urdhrin nr.21, datë 25.01.2024 të Zv. Administratorit, mbi ngritjen e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit të kontratës, për procedurën e prokurimit "Shpenzime për ekspert kontabël", grupi i punës ka hartuar specifikimet teknike. Me shkresën nr. 40/2 prot, dt. 30.01.2024 është nxjerrë Urdhri i Prokurimit, Nr. 2, dt. 30.01.2024 “Për procedurën e prokurimit Shërbim ekspert kontabël.

Data e zhvillimit të procedurës në sistem është datë 01/02/2024, ora 13.30 me Nr. Ref- 94229-01-31-2024. Kontrata e lidhur nr. 40/9 prot., dt. 04.03.2024 me vlerë 367.700 lekë pa Tvsh dhe 441.240 lekë me TVSH. Operatori fitues Shoqëria Publike ASU &T SHPK, dhe Studio profesionale, E.H, person fizik. Likuidimi është bërë me faturën datë 02.05.2024.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe nëpërmjet verifikimit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan se:

-Sipas përcaktimeve në Ftesën për Ofertë, Operatori ekonomik i renditur i pari, duhet të paraqitet me dokumentacionin e kërkuar pranë autoritetit kontraktor brenda ditës së nesërme të punës nga momenti i publikimit njoftimit të fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Gjatë procesit të vlerësimit të ofertave, ka rezultuar se: Operatorët ekonomik "A.C", "V-C", pjesëmarrës në këtë procedurë ju është refuzuar oferta pasi janë mbi vlerën e fondit limit, të përlllogaritur nga autoriteti kontraktor, për këtë objekt prokurimi, e cila është në vlerën 390.000 lekë pa Tvsh.

Operatori ekonomik "E.S", pjesëmarrës në këtë procedurë i është refuzuar oferta pasi Referuar Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për Auditim Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar" dhe në zbatim të vendimit Asamblesë së Anëtarëve Nr.80, datë 29.06.2011 ku janë përcaktuar afatet kohore dhe tarifat orare të auditimit oferta juaj prej 297.000 lekë nuk përkon me afatin kohor që duhet të jetë minimalisht 100 orë pune për totalin e aktiveve të bilancit dhe të ardhurave gjithsej nga 1-2 miliardë lekë dhe tarifa orare 3000 (tre mijë) lekë për orë pune. Vlera e ofertuar është nën vlerë 300.000 mijë lekë e cila është minimalja për këtë shërbim. Operatorët ekonomik "M.M", "R.A", "H.A.A", pjesëmarrës në këtë procedurë u janë refuzuar oferta për arsye se nuk përmbushet kriteri sipas pikës I të ftesës për ofertë ku kërkohet se "Shoqëria audituese duhet të jetë një person juridik i licencuar për të ushtruar veprimtari audituese në Republikën e Shqipërisë" si dhe të ketë jo më pak se 5 (pese) vite eksperience".

Në përfundim të këtij vlerësimit të ofertave, sipas raportit të gjeneruar nga sistemi APP, ka rezultuar 1 (një) ofertë ekonomike e sukseshme "PAS" e themeluar në datë 22.02.2012 duke plotësuar kriteret e vendosura sipas ftesës për ofertë pra të ketë jo më pak se 5 (pese) vite eksperience dhe ka eksperiencë (Auditim të pasqyrave financiare) në institucionet të ngjashme me interes publik për 3 vitet e fundit.

Në përfundim të vlerësimit ka rezultuar fitues shoqëria audituese "PAS", nipt , me vlerë 367,700 (treqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind) lekë pa tvsh, me përfaqësues ligjor I.D, licencë nr.231, datë 08.11.2011 e cila për kryerjen e këtij shërbimi ka lidhur kontratë bashkëpunimi me audituesin ligjor Person Fizik E. H nipt me licencë nr.403, datë 31.05.2019. Me shkresën nr. 40/6 Prot, dt. 12.02.2024, "Propozim për miratimin e Audituesve ligjor për auditimin e Pasqyrave Financiare për vitin 2023 të Rezidencës Studentore Universitare Nr.2. autoriteti kontraktor i është drejtuar Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë, Bashkisë Tiranë për miratim. Në përfundim të procedurës së ndjekur, në zbatim të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e e rregullave të prokurimit Publik", (i ndryshuar) si dhe Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës, së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" është vijuar me lidhjen e kontratës pas miratimit të ekspertëve kontabël nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë. Me operatorin fitues Shoqëria Publike A.S.U është lidhur Kontrata Nr.40/9 Prot , datë 04.03.2024 me vlerë 367,700.00 lekë pa Tvsh dhe me vlerë me Tvsh 441,240.00 lekë. Me shkresën nr. 40/12 prot, dt. 08.03.2024 është përgatitur plani i zbatimit të kontratës. Me shkresën nr. 40/13 prot, dt. 02.04.2024 është përgatitur Raporti përmbledhës mbi mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës. Likuidimi është bërë sipas tabelës si më poshtë brenda afatit ligjor.

Tabela 2: Likuidimi i procedurës të prokurimit “Shpenzime për ekspert kontabël”

Emërtimi	Vlera me Tvsh	Likuiduar
Fatura nr.164/2024, datë 02.04.2024	220,620.00	02.05.2024
Fatura nr.22/2024, datë 02.04.2024	220,620.00	02.05.2024
TOTALI	441,240.00	

Konkluzion:

-Nga auditimi u konstatua se dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar dhe e arkivuar në arkivën e shoqërisë sipas përcaktimeve ligjore, kjo në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar.

-Nga auditimi i dosjes fizike të prokurimit u konstatua se dorëzimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik fitues BOE Shoqëria Publike A.S.U ShPK, dhe Studio profesionale, E.H, person fizik është fotokopje dhe jo e njehsuar me origjinalin siç është kërkuar në ftesën për ofertë (të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar) në zbatim të Udhëzimit nr. 5, dt. 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurave me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” në të cilin citohet se: .. ofertuesi i renditur në vendin e parë duhet të sjellë në formë të shkruar, origjinal ose kopje të noterizuar dokumentacionin e kërkuar në ftesën për ofertë si më poshtë:

- Licencat si Auditues Ligjor për të dy operatorët;
- Kartat e identitetit për të dy auditueset;
- Vërtetimin e regjistrimit në Regjistrin Publik të IEKA në sesionin e shoqërive të auditimit që nuk ka masë disiplinore ndaj shoqërisë.
- Operatoti E.H, person fizik, nuk i përmbush kushtet sipas ftesës për ofertë sipas të cilës në Specifikimet teknike, pika 1, Shoqëria audituese duhet të jetë person juridik i licencuar për të ushtruar veprimtari audituese në Republikën e Shqipërisë, si dhe të ketë jo më pak se 5 (pesë) vite eksperiencë, (data e regjistrimit si person fizik 13/10/2021).

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

Për sa më sipër, kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik në kushtet kur nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar, është në kundërshtim me nenin 76 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 2 pika 2, shkronja (j), nenin 25, nenin 26 pika 6 dhe nenin 82, të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së, janë të detyrueshme për t’u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Referuar nenit 82, pika 2 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;
- “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.”

Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave: A.DH; B.K; S.K.

2. Objekti i prokurimit: **“Blerje karburant diesel 10 ppm”**

Autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël me objekt: “Blerje karburant diesel 10 ppm”. Procedura është iniciuar me kërkesën nr. 65 prot.,

dt.27.02.2024 për nisjen e procedurës procedurës së prokurimit, “Blerje karburant diesel për automjetet e shoqërisë”, drejtuar, Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse. Sektori i Shërbimeve Mbështetëse bazuar në Projekt Programin Zhvillimit Ekonomik të Shoqërisë e vitit 2024, ka përcaktuar sasinë e karburantit në zërin "Blerje karburanti për automjetet". Shoqëria Rezidenca Studentore Universitare Nr. 2 Sh. A ka në përdorim 2 (dy) automjete:

- ✓ Automjeti Tip HYUNDAI me targë AA 394 JM.
- ✓ Automjeti Tip IVEKO, vetëshkarkues me targë AB 228 KG.

Referuar Relacionit nr.346/3/prot, datë 12.01.2024 nga komisioni për përcaktimin e normativave të konsumit të karburantit për automjetet e shoqërisë për vitin 2024 komisioni "Mbi përcaktimin e normës së konsumit të karburantit për automjetet e shoqërisë", janë përcaktuar normat e konsumit të karburantit për çdo automjet në vlerat si më poshtë:

- ✓ Automjeti Tip HYUNDAI me targë AA 394 JM konsumon 10 litra për 100 km
- ✓ Automjeti Tip IVEKO, vetëshkarkues me targë AB 228 KG konsumon 22 litra për 100 km

Bazuar në Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik", VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe Udhëzimit n.07, datë 30.07.2021 "Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike" dhe Projekt Programin të vitit 2024 ku është i parashikuar zëri "Blerje karburant" nga ana e Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse për plotësimin e nevojave me karburant për vitin 2024 sasia e mëposhtme:

- ✓ Naftë Blu Diezel 2,000 litra

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe nëpërmjet verifikimit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan se:

Me shkresën nr. 71 Prot, dt. 04.03 2024, është ngritur Urdhri nr. 31. Dt. 04.03.2024, “Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit” për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje karburant diesel 10 ppm për automjetet e shoqërisë". Me shkresën nr. 71/2 Prot, dt. 05.03 2024, është ngritur Urdhri Prokurimi nr. 32. dt. 05.03.2024. Me shkresën nr.71 prot, dt. 05.03.2024 Autoriteti kontraktor ka hartuar Ftesën për Ofertë. Data e zhvillimit të procedurës ishte 06.03.2024. Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, bazuar në Urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Zv/Administratorit, nr. 07, datë 10.01.2024 "Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlera të vogla", në zbatim të Urdhrit të prokurimit nr.32, datë 05.03.2024, në datën 06.03.2024 ka zhvilluar procedurën e vlerësimit, për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt "Blerje karburant diesel 10ppm për automjetet e Shoqërisë", me numër REF-97434-03-05-2024 për të cilën komisioni në përfundim të këtij vlerësimit të ofertave, kanë rezultuar 5 oferta ekonomike të suksesshme "G C GKG", "A&T", "D&J", "O", "S A". Në përfundim të këtij vlerësimit të ofertave, sipas raportit të gjeneruar nga sistemi APP, fitues i procedurës është shpallur operatori ekonomik "A&T" sha. Sipas përcaktimeve në Ftesën për Ofertë, Operatori ekonomik i renditur i pari, duhet të paraqitet me dokumentacionin e kërkuar pranë autoritetit kontraktor brenda ditës së nesërme të punës nga momenti i publikimit njoftimit të fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Dokumentacioni i kërkuar është administruar në dosje sipas përcaktimeve në Ftesë për Ofertë. Me shkresën nr. Nr. 88 prot.dt.20,03,2024, drejtuar Administratorit është dhënë informacion mbi procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt "Blerje karburant diesel 10 ppm për automjetet e

shoqërisë". Në zbatim të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik", (i ndryshuar) si dhe Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, është nënshkruar kontrata me numër 71/8 prot, datë 19.03.2024 me vlerë 305.000 lekë pa tvsh dhe 366.000 lekë me tvsh, e lidhur ndërmjet Rezidencës Studentore Universitare Nr. 2 Sha, përfaqësuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, z. J.L dhe Operatorit Ekonomik, Administratorin z. F.G. Bazuar në nenin 124 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 107, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Udhëzimi nr.5, datë 25.06.2021 "Mbi Përdorimin e Procedurës me Vlerë Të Vogël, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" me shkresën nr. 71/7 prot, dt. 18.03.2024 Nr. Prot është ngritur Urdhri Nr. 36, dt.18.03.2024 "Për ngritje komisioni për marrje në dorëzim "Blerje karburant diesel 10 ppm për automjetet e shoqërisë". Me shkresën nr. 71/10 prot, dt. 19.03.2024 është përgatitur Plani i zbatimit të kontratës. Likuidimi është bërë sipas tabelës si më poshtë jo brenda afatit ligjor.

Tabela 3: Likuidimi i procedurës të prokurimit "Blerje karburant diesel 10 ppm".

Emërtimi	Fletë hyrje	Akt Kolaudimi	Vlera me Tvsh	Likuiduar
Fatura nr.521/2024, datë 19.03.2024	nr.05 dt 19.03.2024	Nr.71/11 prot dt 19.03.2024	366,000.00	07.05.2024
TOTALI			366,000.00	

Burimi: Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës në RSU nr.2, përpunuar nga KLSH

Konkluzion:

-Nga auditimi u konstatua se dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar dhe e arkivuar në arkivën e shoqërisë sipas përcaktimeve ligjore, kjo në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat" i ndryshuar.

-Nga auditimi i faturave të likuiduara nga ana e RSU Nr.2, u konstatua se fatura është likuiduar në tejkalim të afatit ligjor 30 ditor. Veprime në mospërputhje me ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor" i ndryshuar, neni 52, ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7, si dhe UMFJE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 184 "Nëpunësit zbatues të njëjësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik".

3. Objekti i prokurimit: "Shpenzime dezinfektimi 3D"

Autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël me objekt: "Shpenzime dezinfektimi 3D". Procedura është iniciuar me kërkesën nr. 80 prot., dt.07.03.2024 për nisjen e procedurës së prokurimit, me Kërkesën për proceset "Dezinfektim, Deratizim, Dezinsektim (3 D-ve)" për vitin 2024. Nga ana e Drejtorisë Teknike për vitin 2024, është parashikuar në projekt-buxhet, me Prot. 253/3 nr, datë 13.10.23, kërkesa për proceset "Dezinfektim, Deratizim, Dezinsektim (3 D-ve)" e cila kërkohet për të garantuar kushte sa më të mira jetese në ambientet e Rezidenca Studentore Universitare Nr.2. Procesi 3D-ve, është parashikuar për sipërfaqet e brendshme dhe sipërfaqet e jashtme për të dy sektorët Mjekësi dhe Inxhinieri. Bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në VKM-në Nr. 285 datë 19.05.2021 "Mbi Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në Udhëzimin Nr.05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin

e saj me mjete elektronike" është kërkuar realizimi për proceset "Dezinfektim, Deratizim, Dezisektim (3 D-ve)" sipas 2 tabelave si më poshtë:

Tabela 4: "Sipërfaqet për Dezinfektim, Deratizim, Dezisektim (3 D-ve)"

Nr	Sipërfaqe e jashtme	Njësia	Sipërfaqe
1	Dezinfektim	M2	6672
2	Deratizim		6672
	Totali		13,344

Burimi: Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës në RSU nr.2, përpunuar nga KLSH

Tabela 5: "Sipërfaqet për Dezinfektim, Deratizim, Dezisektim (3 D-ve)"

Nr.	Sipërfaqe e jashtme	Njësia	Siperfaqe
1	Dezinfektim	M2	28630
2	Dezisektim		28630
3	Deratizim		4611
4	Magazina me qira		200
	Totali		62,071

Burimi: Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës në RSU nr.2, përpunuar nga KLSH

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe nëpërmjet verifikimit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan se:

Me shkresën nr. 80 Prot, dt. 11.03 2024, është ngritur Urdhri nr. 34. dt. 11.03.2024, "Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit" për procedurën e prokurimit me objekt "Shpenzime dezinfektimi 3D". Me shkresën nr. 80/2 Prot, dt. 13.03 2024, është nxjerrë Urdhri Prokurimi nr. 35. dt. 13.03.2024. Me shkresën nr.80/4 prot, dt. 13.03.2024 Autoriteti Kontraktor ka hartuar Ftesën për Ofertë. Data e zhvillimit të procedurës ishte 15.03.2024. Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, bazuar në Urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Zv/Administratorit, nr. 07, datë 10.01.2024 "Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlera të vogla", në zbatim të Urdhrit të prokurimit nr.35, datë 13.03.2024, komisioni i prokurimit me vlera të vogla, në datën 15.03.2024 ka zhvilluar procedurën e vlerësimit, për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt "Shpenzime dezinfektimi 3D" (Deratizim, Dezinfektim, Dizisektim)., me numër REF-98283-03-13-2024 për të cilën komisioni në përfundim të këtij vlerësimit të ofertave, kanë rezultuar ofertat si më poshtë:

- Operatorët ekonomik "Ami-Arli", "Clean Fast", pjesëmarrës në këtë procedurë i është refuzuar oferta pasi janë mbi vlerën e fondit limit, të përlllogaritur nga autoriteti kontraktor, për këtë objekt prokurimi, e cila është në vlerën 868.037 lekë pa Tvsh.
- Operatorët ekonomik "A", "A", "D.T", pjesëmarrës në këtë procedurë i i është refuzuar oferta pasi oferta ekonomike është ulur nën vlerën 50% të fondit limit, të përlllogaritur nga autoriteti kontraktor, për këtë objekt prokurimi, e cila është në vlerën 868.037 lekë pa Tvsh.
- Në përfundim të këtij vlerësimit të ofertave, sipas raportit të gjeneruar nga sistemi APP, kanë rezultuar 15 oferta ekonomike të suksesshme "S", "A", "K.L", "E.M", "A", "A P", "G.A", "M", "K.T", "P.S", "C", "B.C", "T.J "Akademia shëndetit publik", "M.M".
- Në përfundim të këtij vlerësimit të ofertave, sipas raportit të gjeneruar nga sistemi APP, fitues i procedurës është shpallur operatori ekonomik "S i cili është tërhequr. Më pas me shkresën nr. 80/6 prot, dt. 19.03.2024 komisioni ka mbajtur procesverbalin për kalimin te operatori tjetër i radhës AIR Shpk.

Sipas përcaktimeve në Ftesën për Ofertë, Operatori ekonomik i renditur pas "S", operatori tjetër i radhës AIR Shpk, duhet të paraqitet me dokumentacionin e kërkuar pranë autoritetit kontraktor brenda ditës së nesërme të punës nga momenti i publikimit njoftimit të fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Dokumentacioni i kërkuar është administruar në dosje sipas përcaktimeve në Ftesë për Ofertë.

Me shkresën nr. Nr. 116 prot.dt.05,04,2024, drejtuar Administratorit është dhënë informacion mbi procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt me objekt "Shpenzime dezinfektimi 3D" (Deratizim, Dezinfektim, Dizinsektim).. Në zbatim të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik", (i ndryshuar) si dhe Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, është nënshkruar kontrata me numër 80/8 prot, datë 05.04.2024 me vlerë 435.000 lekë pa tvsh dhe 522.000 lekë me tvsh, e lidhur ndërmjet Rezidencës Studentore Universitare Nr. 2 Sha, përfaqësuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, z. J.L, dhe Operatorit Ekonomik, Administratorin z. A.M. Bazuar në nenin 124 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 107, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Udhëzimi nr.5, datë 25.06.2021 "Mbi Përdorimin e Procedurës me Vlerë Të Vogël, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" me shkresën nr. 80/10 prot, dt. 05.04.2024 Nr. Prot është ngritur Urdhri Nr. 38, dt.05.04.2024 "Për ngritje komisioni për marrje në dorëzim "Shpenzime dezinfektimi 3D" (Deratizim, Dezinfektim, Dizinsektim).. Me shkresën nr. 80/11 prot, dt. 05.04.2024 është përgatitur Plani i zbatimit të kontratës. Likuidimi është bërë sipas tabelës si më poshtë brenda jo brenda afatit ligjor.

Tabela 6: Likuidimi i procedurës të prokurimit "Blerje materiale punëtorie sinjalistike dhe veshje sigurimi në punë"

Emërtimi	Monitorim kontrate	Vlera me Tvsh	likuiduar	
Fatura nr.177/2024, datë 29.05.2024	Nr.80/12 prot dt. 30.04.2024	178,440.00	10.07.2024	faza I-rë
Fatura nr.343/2024, datë 04.10.2024	Nr.80/14 prot dt. 02.10.2024	343,560.00	21.11.2024	faza II-të
TOTALI		522,000.00		

Konkluzion: Nga auditimi i faturave të likuiduara nga ana e RSU Nr.2, u konstatua se fatura nr.177/2024, datë 29.05.2024, është likuiduar në tejkalim të afatit ligjor 30 ditor. Veprime në mospërputhje me ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor" i ndryshuar, neni 52, ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7, si dhe UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 184 "Nëpunësit zbatues të njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik".

4. Objekti i prokurimit: **"Blerje materialë punëtorie sinjalistike dhe veshje sigurimi në punë"**

Autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël me objekt:

“Blerje material punëtorie sinjalistike dhe veshje sigurimi në punë”. Procedura është iniciuar me kërkesën nr. 246 prot., dt.19.11.2024 për nisjen e procedurës së prokurimit, me Kërkesën për “Blerje material punëtorie sinjalistike dhe veshje sigurimi në punë” për vitin 2024. Duke u bazuar në parashikimet vjetore të hartuara në Projekt- Buxhetin e Drejtorisë Teknike për vitin 2024, për të siguruar një mbarëvajtje sa më të mirë për vitin Akademik 2024-2025, për riparimet si dhe shërbimet që duhen bërë në godinat e "Rezidenca Studentore Universitare NR.2", është kërkuar miratimi për blerjen e "Materiale Punëtorie, sinjalistike dhe veshje sigurimi në punë për vitin 2024. Blerja e këtyre materialeve është e domosdoshme për kryerjen e të gjitha shërbimeve (riparime, mirëmbajtje etj.), si dhe mbarëvajtjen, sigurinë e punonjësve gjatë kryerjes së këtyre punimeve në të gjitha ambientet e brendshme dhe të jashtme të dy sektorëve të RSU2 nga elektrikistët, marangozët, hidraulikët, muratorët, elektromekanikët dhe kaldajistët.

Bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në VKM-në Nr. 285, datë 19.05.2021 "Mbi Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në Udhëzimin Nr.05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" është kërkuar realizimi për A.K, person fizik..

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe nëpërmjet verifikimit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan se:

Me shkresën nr. 246/1 Prot, dt. 21.11 2024, është ngritur Urdhri nr. 88. dt. 21.11.2024, Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje material punëtorie sinjalistike dhe veshje sigurimi në punë”.

Me shkresën nr. 246/3 Prot, dt. 02.12 2024, është ngritur Urdhri Prokurimi nr. 91. dt. 02.12.2024. Me shkresën nr. 246/4 prot, dt. 04.12.2024, Autoriteti kontraktor ka hartuar Ftesën për Ofertë. Data e zhvillimit të procedurës ishte 05.12.2024. Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, bazuar në Urdhrit të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Zv/Administratorit, nr. 07, datë 10.01.2024 “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlera të vogla”, në zbatim të Urdhrit të prokurimit nr.91, datë 02.12.2024, komisioni i prokurimit me vlera të vogla, në datën 05.12.2024 ka zhvilluar procedurën e vlerësimit, për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt "Blerje materiale punëtorie, sinjalistikë dhe veshje sigurimi ne punë" me numër REF-31915-12-04-2024.

► Operatorët ekonomik "E.V", "F", pjesëmarrës në këtë procedurë i kanë refuzuar ofertat pasi janë mbi vlerën e fondit limit, të përllogaritur nga autoriteti kontraktor, për këtë objekt prokurimi, e cila është në vlerën 210.000 lekë pa Tvsh. Në përfundim të këtij vlerësimit të ofertave, sipas raportit të gjeneruar nga sistemi APP. rezultuan 26 oferta ekonomike të suksesshme "R.A", "2-M", "2 R.G", "3V.A", "A.K", "A.K", "A.A", "A", "A", "B.B", "B", "B.L", "B", "E.K.M", "E.M", "G.D", "G", "J.M", "J". "KE.B", "M.M", "M.H", "O.M", "O.H", "P.N", "S.D". Në përfundim të këtij vlerësimit të ofertave, sipas raportit të gjeneruar nga sistemi APP, fitues i procedurës është shpall operatori ekonomik "G" i cili më pas është tërhequr nga gara. Komisioni ka mbajtur procesverbalin nr. 246/6 prot, dt. 12.12.2024 në të cilin është njoftuar operatori i radhës J. shpk i cili është tërhequr e më pas është njoftuar OE Alma Kodra, person fizik. Sipas përcaktimeve në Ftesën për Ofertë, Operatori ekonomik i renditur pas "S", operatori tjetër i radhës AIR Shpk, duhet të paraqitet me dokumentacionin e kërkuar pranë autoritetit kontraktor brenda ditës së nesërme të punës nga momenti i publikimit njoftimit të fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Dokumentacioni i kërkuar është administruar në dosje sipas përcaktimeve në Ftesë për Ofertë.

Me shkresën nr. Nr. 401 prot.dt.18,12,2024, drejtuar Administratorit është dhënë informacion mbi procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt me objekt “Blerje material punëtorie sinjalistike dhe veshje sigurimi në punë”. Në zbatim të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik", (i ndryshuar) si dhe Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, është nënshkruar kontrata me numër 246/9 prot, datë 18.12.2024 me vlerë 164.150 lekë pa tvsh dhe 196.980 lekë me tvsh, e lidhur ndërmjet Rezidencës Studentore Universitare Nr. 2 Sha, përfaqësuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, z. J.L, dhe Operatorit Ekonomik, Administratorin A.K, person fizik.

Bazuar në nenin 124 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 107, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Udhëzimi nr.5, datë 25.06.2021 "Mbi Përdorimin e Procedurës me Vlerë Të Vogël, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" me shkresën nr. 246/11 prot, dt. 18.12.2024 Nr. Prot është ngritur Urdhri Nr. 105, dt.18.12.2024 "Për ngritje komisioni për marrje në dorëzim nga Operatori Ekonomik fitues A.K, person fizik.

Me shkresën nr. 246/12 prot, dt. 20.12.2024 është përgatitur Plani i zbatimit të kontratës. Likuidimi është bërë sipas tabelës si më poshtë brenda afatit ligjor.

Tabelë 7: Likuidimi i procedurës të prokurimit “Blerje material punëtorie sinjalistike dhe veshje sigurimi në punë”

Emërtimi	Fletë hyrje	Akt Kolaudimi	Vlera me Tvsh	Likuiduar
Fatura nr.75/2024, datë 20.12.2024	nr.42 dt. 20.12.2024	Nr.246/12 prot dt. 20.12.2024	196,980.00	26.12.2024
TOTALI			196,980.00	

Konkluzion:

-Nga auditimi u konstatua se dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar dhe e arshivuar në arkivën e shoqërisë sipas përcaktimeve ligjore, kjo në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar.

-Nga auditimi i dosjes fizike të prokurimit u konstatua se dorëzimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik fitues kishte mangësi, Administratori A.K, person fizik ka autorizuar z. SH.Z për ta përfaqësuar në procedurën e prokurimit por nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezultoi se Oferta Ekonomike e paraqitur dhe Deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike ishin të nënshkruara nga z. M.K (jo personi i autorizuar sipas autorizimit). Kontrata nr. 246/9, dt. 18.12.2024, ishte e nënshkruar nga z. SH.Z Kopja e kontratës së paraqitur është fotokopje dhe jo e njehsuar me origjinalin siç është kërkuar në ftesën për ofertë (të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar) në zbatim të të VKM-së nr. 285 datë 19.02.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku citohet se: *Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit, kryen/jnë detyrat e mëposhtme:*

Administrimin e dokumentacionit në formë të shkruar, origjinal ose fotokopje të noterizuar të operatorit ekonomik fitues, përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti/enti kontraktor.

Si dhe Udhëzimit nr. 5, dt. 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurave me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” në të cilin citohet se: .. Ofertuesi i renditur në vendin e

parë duhet të sjellë në formë të shkruar, origjinal ose kopje të noterizuar dokumentacionin e kërkuar në ftesën për ofertë.

5. Objekti i prokurimit: “Blerje material për pusët e ujit”

Autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël me objekt: “Blerje material për pusët e ujit”. Procedura është iniciuar me kërkesën nr. 247 prot., dt.20.11.2024 për nisjen e procedurës së prokurimit, me Kërkesën për “Blerje material për pusët e ujit” për vitin 2024. Në godinat e sektorit Inxhinieri janë të instaluar dy puse uji të cilët kanë nevojë për shërbime mirëmbajtje pasi përdoren për vaditjen e ambienteve të gjelbëruara. Pusi në godinën CD ka qenë jashtë funksionit, pasi pompa zhytëse është e djegur dhe nuk mund të riparohet, gjithashtu duhet ndërruar dhe linja e tubave të ujit e cila është amortizuar. Duke u bazuar në parashikimet vjetore të hartuara në Projekt- Buxhetin e Drejtorisë Teknike për vitin 2024, për të siguruar një mbarëvajtje sa më të mirë për vitin Akademik 2024 2025, për riparimet si dhe shërbimet që duhen bërë për pusët e ujit në godinat e "Rezidenca Studentore Universitare NR.2", për blerjen e "Materiale Pjesë ndërrimi për pusët e ujit" për vitin 2024.

Bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në VKM-në Nr. 285 datë 19.05.2021 "Mbi Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në Udhëzimin Nr.05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" është kërkuar realizimi nga Operatori ekonomik "J.M", person fizik. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe nëpërmjet verifikimit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan se:

Me shkresën nr. 247/1 Prot, dt. 21.11 2024, është ngritur Urdhri nr. 89. dt. 21.11.2024, për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje material për pusët e ujit”. Me shkresën nr. 247/3 Prot, dt. 04.11 2024, është ngritur Urdhri Prokurimi nr. 92. dt. 04.11.2024. Me shkresën nr. 247/4 prot, dt. 05.11.2024 Autoriteti kontraktor ka hartuar Ftesën për Ofertë. Data e zhvillimit të procedurës ishte 06.12.2024. Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, bazuar në Urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Zv/Administratorit, nr. 07, datë 10.01.2024 “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlera të vogla”, në zbatim të Urdhrit të prokurimit nr.91, datë 02.12.2024, komisioni i prokurimit me vlera të vogla, në datën 11.12.2024 ka zhvilluar procedurën e vlerësimit, për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje material për pusët e ujit” me numër REF-32035-12-05-2024. Në zbatim të Urdhrit të prokurimit nr.92, datë 04.11.2024, komisioni i prokurimit me vlera të vogla, në datën 29.08.2024 ka zhvilluar procedurën e vlerësimit, në të cilën kanë marrë pjesë Operatorët ekonomik "B", "J", "E.Z", "3E .C "O.M". "A.", "B.C", "ZGA", "A.K", "2.R ", "E.B", "K.E.B". "E.V". Këta pjesëmarrës në këtë procedurë iu është refuzuar oferta pasi janë mbi vlerën e fondit limit, të përllogaritur nga autoriteti kontraktor, për këtë objekt prokurimi, e cila është në vlerën 170.833 lekë pa Tvsh. Në përfundim të këtij vlerësimit të ofertave, sipas raportit të gjeneruar nga sistemi APP, ka rezultuar 1 ofertë ekonomike e suksesshme "J.M".

► Në përfundim të vlerësimit të ofertave, sipas raportit të gjeneruar nga sistemi APP, fitues i procedurës është shpallur operatori ekonomik "J.M" person fizik.

Sipas përcaktimeve në Ftesën për Ofertë, Operatori ekonomik i renditur "J.M", person fizik duhet të paraqitet me dokumentacionin e kërkuar pranë autoritetit kontraktor brenda ditës së

nesërme të punës nga momenti i publikimit njoftimit të fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Dokumentacioni i kërkuar është administruar në dosje sipas përcaktimeve në Ftesë për Ofertë. Me shkresën nr. Nr. 395 prot.dt.16,12,2024, drejtuar Administratorit është dhënë informacion mbi procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt me objekt “Blerje material për pusët e ujit”. Në zbatim të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik", (i ndryshuar) si dhe Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, është nënshkruar kontrata me numër 247/7 prot, datë 16.12.2024 me vlerë 125.000 lekë pa tvsh dhe 150.000 lekë me tvsh, e lidhur ndërmjet Rezidencës Studentore Universitare Nr. 2 Sha, përfaqësuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, z. J.L dhe Operatorit Ekonomik, Administratorin "J.M", person fizik.

Bazuar në nenin 124 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 107, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Udhëzimi nr.5, datë 25.06.2021 "Mbi Përdorimin e Procedurës me Vlerë Të Vogël, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" me shkresën nr. 247/9 prot, dt. 16.12.2024 Nr. Prot është ngritur Urdhri Nr. 102, dt.16.12.2024 "Për ngritje komisioni për marrje në dorëzim të materialeve nga "J.M", person fizik.

Me shkresën nr. 247/10 prot, dt. 17.12.2024 është mbajtur Akt-kolaudimi. Likuidimi është bërë sipas tabelës 8, brenda afatit ligjor.

Tabelë 8: Likuidimi i procedurës të prokurimit “Blerje material për pusët e ujit”

Emërtimi	Fletë hyrje	Akt Kolaudimi	Vlera me TVSh	Likuiduar
Fatura nr.66/2024, datë 17.12.2024	nr.38 dt 17.12.2024	Nr.247/10 prot dt 17.12.2024	150,000.00	26.12.2024
TOTALI			150,000.00	

Konkluzion:

-Nga auditimi u konstatua se dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar dhe e arkivuar në arkivën e shoqërisë sipas përcaktimeve ligjore, kjo në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar.

6. Objekti i prokurimit: “Blerje materiale për chillerat dhe panelet diellore”

Autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël me objekt: “Blerje materiale për chillerat dhe panelet diellore”. Procedura është iniciuar me kërkesën nr. 249 prot., dt.20.11.2024 për nisjen e procedurës së prokurimit, me Kërkesën për “Blerje materiale për chillerat dhe panelet diellore” për vitin 2024.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe nëpërmjet verifikimit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan se:

Me shkresën nr. 249/1 Prot, dt. 21.11 2024, është ngritur Urdhri nr. 90. dt. 21.11.2024, për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale për chillerat dhe panelet diellore”. Me shkresën nr. 249/3 Prot, dt. 11.12 2024, është ngritur Urdhri Prokurimi nr. 100. dt. 11.12.2024. Me shkresën nr. 249/4 prot, dt. 11.12.2024 Autoriteti kontraktor ka hartuar Ftesën për Ofertë. Data e zhvillimit të procedurës ishte 12.12.2024.

Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, bazuar në Urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Zv/Administratorit, nr. 07, datë 10.01.2024 “Për krijimin e komisionit të

prokurimit me vlera të vogla", në zbatim të Urdhrit të prokurimit nr.91, datë 02.12.2024, komisioni në datën 12.12.2024 ka zhvilluar procedurën e vlerësimit, për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt "Blerje materiale për chillerat dhe panelet diellore" me numër REF-32602-12-11-2024. Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, në datën 12.12.2024 ka zhvilluar procedurën e vlerësimit, në të cilën kanë marrë pjesë Operatorët ekonomikë: "2.A.K Group", "3.E ", "A", "EKM ", "E.B", "E.Z", "J", "O.M", "S.RR ", "S.K", këtyre pjesëmarrësve në këtë procedurë i është refuzuar oferta pasi janë mbi vlerën e fondit limit, të përlogaritur nga autoriteti kontraktor, për këtë objekt prokurimi, e cila është në vlerën 707.500 lekë pa Tvsh.

Në përfundim të vlerësimit të ofertave, sipas raportit të gjeneruar nga sistemi APP, kanë rezultuar 3 oferta ekonomike e suksesshme "A", "D.R", "S.A". Në përfundim të vlerësimit të ofertave, sipas raportit të gjeneruar nga sistemi APP, fitues i procedurës është shpallur operatori ekonomik "S.A". Nisur nga fakti se operatori i shpallur fitues për këtë procedurë, konkretisht "S.A", ka paraqitur njoftim tërheqje në SPE, Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla vijoi me njoftimin e operatorit të radhës "D.R" shpk.

Sipas përcaktimeve në Ftesën për Ofertë, Operatori ekonomik i renditur "D.R" shpk duhet të paraqitet me dokumentacionin e kërkuar pranë autoritetit kontraktor brenda ditës së nesërme të punës nga momenti i publikimit njoftimit të fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Dokumentacioni i kërkuar është administruar në dosje sipas përcaktimeve në Ftesë për Ofertë. Me shkresën nr. Nr. 396 prot.dt.16.12.2024, drejtuar Administratorit është dhënë informacion mbi procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt me objekt "Blerje materiale për chillerat dhe panelet diellore". Në zbatim të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik", (i ndryshuar) si dhe Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, është nënshkruar kontrata me numër 249/8 prot, datë 16.12.2024 me vlerë 498,490 lekë pa tvsh dhe 598,188 lekë me tvsh, e lidhur ndërmjet Rezidencës Studentore Universitare Nr. 2 Sha, përfaqësuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, z.J.L dhe Operatorit Ekonomik, Administratorin "D.R" shpk.

Bazuar në nenin 124 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 107, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Udhëzimi nr.5, datë 25.06.2021 "Mbi Përdorimin e Procedurës me Vlerë Të Vogël, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" me shkresën nr. 249/10 prot, dt. 16.12.2024 Nr. Prot është ngritur Urdhri Nr. 103, dt.16.12.2024 "Për ngritje komisioni për marrje në dorëzim të materialeve nga operatori "D.R" ShPK.

Me shkresën nr. 249/11 prot, dt. 18.12.2024 janë marrë në dorëzim materialet sipas Akt-kolaudimit. Likuidimi është bërë sipas tabelës 9, brenda afatit ligjor.

Tabelë 9: Likuidimi i procedurës të prokurimit "Blerje materiale për chillerat dhe panelet diellore"

Emërtimi	Fletë hyrje	Akt Kolaudimi	Vlera me Tvsh	Likuiduar
Fatura nr.42/2024, date 18.12.2024	nr.40 dt. 18.12.2024	Nr.249/11prot dt 18.12.2024	598,188.00	30.12.2024
TOTALI			598,188.00	

Konkluzion:

-Nga auditimi u konstatua se dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar dhe e arkivuar në arkivën e shoqërisë sipas përcaktimeve ligjore, kjo në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar.

7. Objekti i prokurimit: “Blerje uniforma pune për stafin”

Autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël me objekt: “Blerje uniforma pune për stafin”. Procedura është iniciuar me kërkesën nr. 252 prot., dt.21.11.2024 për nisjen e procedurës së prokurimit, me Kërkesën për “Blerje uniforma pune për stafin” për vitin 2024.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe nëpërmjet verifikimit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan se:

Me shkresën nr. 252 /1 Prot, dt. 10.12 2024, është ngritur Urdhri nr. 98. dt. 10.12.2024, për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje uniforma pune për stafin”. Me shkresën nr. 252/3 Prot, dt. 18.12 2024, është ngritur Urdhri Prokurimi nr. 106. dt. 18.12.2024. Me shkresën nr. 252/4 prot, dt. 20.12.2024 Autoriteti kontraktor ka hartuar Ftesën për Ofertë. Data e zhvillimit të procedurës ishte 23.12.2024.

Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, bazuar në Urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Zv/Administratorit, nr. 07, datë 10.01.2024 “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlera të vogla”, në zbatim të Urdhrit të prokurimit nr.91, datë 02.12.2024, komisioni në datën 23.12.2024 ka zhvilluar procedurën e vlerësimit, për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje uniforma pune për stafin” me numër REF-34188-12-20-2024. Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, në datën 24.12.2024 ka zhvilluar procedurën e vlerësimit, në të cilën kanë marrë pjesë Operatorët ekonomikë: "Amel-E.Z", "Atlantik 3", "E.V", "H.S", "J", "M "M.O", ju është refuzuar oferta pasi janë mbi vlerën e fondit limit, të përllogaritur nga autoriteti kontraktor, për këtë objekt prokurimi, e cila është në vlerën 200.000 lekë pa Tvsh. Gjithashtu dhe Operatorit ekonomik "A.GJ", pjesëmarrës në këtë procedurë i është refuzuar oferta për arsye se nuk përmbushin specifikimin se nga verifikimi i ekstraktit në QKB ka rezultuar se operatori ekonomik nuk ka si fushë të veprimtarisë së tij objektin e prokurimit. Në përfundim të këtij vlerësimit të ofertave, sipas raportit të gjeneruar nga sistemi APP, rezultuan 14 oferta ekonomike të sukseshme "3.E, "3.V ", "A", "B", "B", "E.M", "E.B "E.Z", "M.M", "M.H", "N.H", "O.M", "O.H", "Përparim Agimi".

Në përfundim të vlerësimit të ofertave, sipas raportit të gjeneruar nga sistemi APP, fitues i procedurës është shpallur operatori ekonomik "O.M" i cili është tërhequr dhe është vijuar me operatorin e radhës E.Z, person fizik.

Sipas përcaktimeve në Ftesën për Ofertë, Operatori ekonomik i renditur E.Z person fizik, duhet të paraqitet me dokumentacionin e kërkuar pranë autoritetit kontraktor brenda ditës së nesërme të punës nga momenti i publikimit njoftimit të fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Dokumentacioni i kërkuar është administruar në dosje sipas përcaktimeve në Ftesë për Ofertë. Me shkresën nr. Nr. 420 prot.dt.30.12.2024, drejtuar Administratorit është dhënë informacion mbi procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt me objekt “Blerje uniforma pune për stafin”. Në zbatim të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", VKM. nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e e rregullave të prokurimit Publik", (i ndryshuar) si dhe Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, është nënshkruar kontrata me numër 252/8 prot, datë 30.12.2024 me vlerë 170.000 lekë pa tvsh dhe 204,000 lekë me tvsh, e lidhur ndërmjet Rezidencës Studentore Universitare Nr. 2 Sha, përfaqësuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, z. J.L, Operatorit Ekonomik, E.Z, person fizik.

Bazuar në nenin 124 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 107, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Udhëzimi nr.5, datë 25.06.2021 "Mbi Përdorimin e Procedurës me Vlerë Të Vogël, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" me shkresën nr. 252/10 prot, dt. 30.12.2024 është ngritur Urdhri Nr. 110, dt.30.12.2024 "Për ngritje komisioni për marrje në dorëzim të materialeve nga operatori E.Z, person fizik. Me shkresën nr. 249/11 prot, dt. 18.12.2024 janë marrë në dorëzim materialet sipas Akt-kolaudimit. Likuidimi është bërë sipas tabelës 10, brenda afatit ligjor.

Tabelë 10: Likuidimi i procedurës të prokurimit "Blerje uniforma pune për stafin"

Emërtimi	Fletë hyrje	Akt Kolaudimi	Vlera me TVSh	Likuiduar
Fatura nr.12/2024, date 31.12.2024	nr.47 dt 31.12.2024	Nr.246/11 prot dt 31.12.2024	204,000.00	14.01.2025
TOTALI			204,000.00	

Konkluzion:

-Nga auditimi u konstatua se dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar dhe e arkivuar në arkivën e shoqërisë sipas përcaktimeve ligjore, kjo në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat" i ndryshuar.

8. Objekti i prokurimit: "Blerje materiale për sistemin e chillerave dhe panelet diellore"

Autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël me objekt: "Blerje materiale për chillerat dhe panelet diellore". Procedura është iniciuar me kërkesën nr. 259 prot., dt.10.12.2024 për nisjen e procedurës së prokurimit, me Kërkesën "Blerje pompa për sistemin e chillerave dhe panelet diellore" për vitin 2024.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe nëpërmjet verifikimit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan se: Me shkresën nr. 259/1 Prot, dt. 11.12.2024, është ngritur Urdhri nr. 101. dt. 11.12.2024, për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje materiale për chillerat dhe panelet diellore". Me shkresën nr. 292/3 Prot, dt. 17.12.2024, është ngritur Urdhri Prokurimi nr. 104. dt. 17.12.2024. Me shkresën nr. 259/4 prot, datë 17.12.2024 Autoriteti kontraktor ka hartuar Ftesën për Ofertë. Data e zhvillimit të procedurës ishte 18.12.2024. Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, bazuar në Urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Zv/Administratorit, nr. 07, datë 10.01.2024 "Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlera të vogla", në zbatim të Urdhrit të prokurimit nr. 104. dt. 17.12.2024, komisioni në datën 18.12.2024 ka zhvilluar procedurën e vlerësimit, për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt "Blerje materiale për chillerat dhe panelet diellore" me numër REF-33689-12-17-2024. Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, në datën 18.12.2024 ka zhvilluar procedurën e vlerësimit, në të cilën kanë marrë pjesë Operatorët ekonomikë: Operatorit ekonomik "K.E.B", pjesëmarrës në këtë procedurë i është refuzuar oferta pasi janë mbi vlerën e fondit limit, të përlllogaritur nga autoriteti Kontraktor, për këtë objekt prokurimi, e cila është në vlerën 691,666 lekë pa Tvsh. Gjithashtu Operatorët ekonomik "R.A K", "3.E ", "3.V ", "A.E", "E.K", "E.Z", "J", "O.M". "T.K" pjesëmarrës në këtë procedure iu është refuzuar oferta për arsye se nuk përmbushin specifikimin nga verifikimi i ekstraktit në QKB ka rezultuar se operatori ekonomik nuk ka si fushë të veprimtarisë së tij objektin e prokurimit.

Në përfundim të këtij vlerësimit të ofertave, sipas raportit të gjeneruar nga sistemi APP, kanë rezultuar 6 oferta ekonomike e suksesshme "A", "D.R", "EKM ". "O.H", "T", "ZGA". Në përfundim të këtij vlerësimit të ofertave, sipas raportit të gjeneruar nga sistemi APP, fitues i procedurës është shpallur operatori ekonomik "ZGA" i cili është tërhequr dhe Komisioni ka kaluar te Operatori i radhës A, SHPK i cili është tërhequr dhe është njoftuar T, SHPK. Dhe ky Operator është tërhequr dhe komisioni ka kaluar tek Operatori tjetër "D.R" shpk. Në përfundim të këtij vlerësimit të ofertave, sipas raportit të gjeneruar nga sistemi APP, fitues i procedurës u shpall operatori ekonomik "D.R" shpk. Sipas përcaktimeve në Ftesën për Ofertë, Operatori ekonomik "D.R" ShPK, duhet të paraqitet me dokumentacionin e kërkuar pranë autoritetit Kontraktor brenda ditës së nesërme të punës nga momenti i publikimit njoftimit të fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Dokumentacioni i kërkuar është administruar në dosje sipas përcaktimeve në Ftesë për Ofertë.

Me shkresën nr. Nr. 421 prot.dt.30.12.2024, drejtuar Administratorit është dhënë informacion mbi procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt me objekt “Blerje materiale për chillerat dhe panelet diellore”. Në zbatim të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e e rregullave të prokurimit Publik", (i ndryshuar) si dhe Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, është nënshkruar kontrata me numër 259/10 prot, datë 30.12.2024 me vlerë 649.900 lekë pa tvsh dhe 779.880 lekë me tvsh, e lidhur ndërmjet Rezidencës Studentore Universitare Nr. 2 Sha, përfaqësuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, z. J.L dhe Operatorit Ekonomik, "D.R" ShPK. Bazuar në nenin 124 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 107, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Udhëzimi nr.5, datë 25.06.2021 "Mbi Përdorimin e Procedurës me Vlerë Të Vogël, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" me shkresën nr. 259/12 prot, dt. 30.12.2024 është ngritur Urdhri Nr. 111, dt.30.12.2024 "Për ngritje komisioni për marrje në dorëzim të materialeve nga operatori "D.R" ShPK.

Me shkresën nr. 259/13 prot, dt. 31.12.2024 janë marrë në dorëzim materialet sipas Akt-kolaudimit. Likuidimi është bërë sipas tabelës 11, jo brenda afatit ligjor.

Tabelë 11: Likuidimi i procedurës të prokurimit “Blerje materiale për chillerat dhe panelet diellore”

Emërtimi	Fletë hyrje	Akt Kolaudimi	Vlera me TVSH	Likuiduar
Fatura nr. 44/2024, dt. 31.12.2024	Nr. 02. Dt. 31.12.2024	Nr. 259/13 prot, dt. 31.12.2024	779,800.00	06.02.2025
Totali			779,800.00	

Konkluzion:

-Nga auditimi u konstatua se dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar dhe e arkivuar në arkivën e shoqërisë sipas përcaktimeve ligjore, kjo në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar.

9. Objekti i prokurimit: “Rimbushje fikëse zjarri Abc dhe Bce”

Autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël me objekt: “Rimbushje fikëse zjarri Abc dhe Bce”. Procedura është iniciuar me kërkesën nr. 204 prot., dt.20.06.2024 për nisjen e procedurës së prokurimit, për “Blerje uniforma pune për stafin” për vitin 2024.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe nëpërmjet verifikimit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan se:

Me shkresën nr. 164 Prot, dt. 15.07.2024, është ngritur Urdhri nr. 59. dt. 15.07.2024, për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt "Rimbushje fikëse zjarri Abc dhe Bce". Me shkresën nr. 164/2 Prot, dt. 16.07.2024, është ngritur Urdhri Prokurimi nr. 60. dt. 16.07.2024. Me shkresën nr. 164/3 prot, dt. 16.07.2024 Autoriteti Kontraktor ka hartuar Ftesën për Ofertë. Data e zhvillimit të procedurës ishte 17.07.2024.

Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, bazuar në Urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Zv/Administratorit, nr. 07, datë 10.01.2024 "Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlera të vogla", në zbatim të Urdhrit të prokurimit nr. 60. dt. 16.07.2024, komisioni në datën 17.07.2024 ka zhvilluar procedurën e vlerësimit, për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt "Rimbushje fikëse zjarri Abc dhe Bce" me numër REF-13248-07-16-2024. Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, në datën 17.07.2024 ka zhvilluar procedurën e vlerësimit, në të cilën kanë marrë pjesë Operatorët ekonomikë: "Formula", "B", "O.H", "Mbrotjtja dhe Shpëtim nga Zjarri", "E.P", pjesëmarrës në këtë procedurë ju është refuzuar oferta pasi janë mbi vlerën e fondit limit, të përlllogaritur nga autoriteti kontraktor, për këtë objekt prokurimi, e cila është në vlerën 205.600 lekë pa Tvsh.

Në përfundim të këtij vlerësimit të ofertave, sipas raportit të gjeneruar nga sistemi APP, kanë rezultuar 7 oferta ekonomike të sukseshme "K.K", "E.S", "3.E ". "S.A", "V.A", "E.Z", "HB-G.C".

Në përfundim të këtij vlerësimit të ofertave, fitues i procedurës rezulton operatori ekonomik "K.K" person fizik.

Sipas përcaktimeve në Ftesën për Ofertë, Operatori ekonomik i renditur i pari "K.K", person fizik, duhet të paraqitet me dokumentacionin e kërkuar pranë autoritetit Kontraktor brenda ditës së nesërme të punës nga momenti i publikimit njoftimit të fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Dokumentacioni i kërkuar është administruar në dosje sipas përcaktimeve në Ftesë për Ofertë.

Me shkresën nr. Nr. 164/10 prot.dt.29.07.2024, drejtuar Administratorit është dhënë informacion mbi procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt me objekt "Blerje uniforma pune për stafin". Në zbatim të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", VKM. nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik", (i ndryshuar) si dhe Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, është nënshkruar kontrata me numër 164/6 prot, datë 24.07.2024 me vlerë 120.000 lekë pa tvsh dhe 144.000 lekë me tvsh, e lidhur ndërmjet Rezidencës Studentore Universitare Nr. 2 Sha, përfaqësuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, z. J.L, dhe Operatorit Ekonomik, "K.K", person fizik.

Bazuar në nenin 124 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 107, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Udhëzimi nr.5, datë 25.06.2021 "Mbi Përdorimin e Procedurës me Vlerë Të Vogël, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" me shkresën nr. 164/9 prot, dt. 24.07.2024 është mbajtur procesverbali "Për marrje në dorëzim të materialeve" nga operatori K.K, person fizik. Me shkresën nr. 164/8 prot, dt. 24.07.2024 është ngritur komisioni për monitorimin e kontratës.

Në datë 29.07.2024, sipas kërkesës të paraqitur nga Dega Teknike dhe në zbatim të kontratës nr. 164/6 prot, datë 24.07.2024 janë marrë në dorëzim fikset e zjarrit me faturën nr.45, datë 29.07.2024 nga subjekti K.K me nipt M.....D me vlerë 120.000 lekë pa tvsh dhe 144.000 lekë me tvsh.

Sipas procesverbalit fikëset e zjarrit 6 kg ABC 40% (pluhur) 142 copë ishin të mbushura, me pullën sigurisë përkatëse me afatin kohor (1 vjeçar). Fikëse zjarri 5 kg BCE (shkumë LFA ose AFF mbi 3%) 36 copë, ishte mbushur, me pullën sigurisë përkatëse me afatin kohor (1 vjeçar) të subjektit K.K. Likuidimi është bërë sipas tabelës si më poshtë brenda afatit ligjor.

Tabela 12: Likuidimi i procedurës të prokurimit “Rimbushje fikëse zjarri Abc dhe Bce”

Emërtimi	Fletë hyrje	Akt Kolaudimi	Vlera me Tvsh	Likuiduar
Fatura nr.12/2024, date 31.12.2024	nr.47 dt 31.12.2024	Nr.246/11 prot dt 31.12.2024	204,000.00	14.01.2025
TOTALI			204,000.00	

Konkluzion:

-Nga auditimi u konstatua se dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar dhe e arkivuar në arkivën e shoqërisë sipas përcaktimeve ligjore, kjo në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar.

-Nga auditimi i dosjes fizike të prokurimit u konstatua se dorëzimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik fitues "K.K", person fizik është fotokopje dhe jo e njësuar me origjinalin siç është kërkuar në ftesën për ofertë (të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar) në zbatim të Udhëzimit nr. 5, dt. 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurave me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” në të cilin citohet se: .. ofertuesi i renditur në vendin e parë duhet të sjellë në formë të shkruar, original ose kopje të noterizuar dokumentacionin e kërkuar në ftesën për ofertë si më poshtë:

- Certifikatë për ushtrimin e profesionit Ekspert zjarrfikës M. P;
- Kartat e identitetit;
- Kontratë shërbimi dt. 16.02.2024 e lidhur midis Shoqërisë I.C.D, ShPK dhe personit fizik K.K e cila ka vulën e personit fizik, K.K dhe është e pa firmosur nga pala tjetër;
- Dy certifikatat nga F.I.A

Vepimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

Për sa më sipër, kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik në kushtet kur nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar, është në kundërshtim me nenin 76 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 2 pika 2, shkronja (j), nenin 25, nenin 26 pika 6 dhe nenin 82, të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së, janë të detyrueshme për t’u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

10. Objekti i prokurimit: **“Shpenzime shtypshkrime”**

Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël me objekt: “Shpenzime shtypshkrime”. Procedura është iniciuar me kërkesën nr. 263 prot., dt.20.08.2024 për nisjen e procedurës së prokurimit, me kërkesën për “Shpenzime shtypshkrime” për vitin 2024. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe nëpërmjet verifikimit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan se: Me shkresën nr. 179 Prot, dt. 26.08 2024, është ngritur Urdhri nr. 68. dt. 26.08.2024, për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Shpenzime shtypshkrime”. Me shkresën nr. 179/2 Prot, dt. 28.08.2024, është ngritur Urdhri Prokurimi nr. 69. dt. 28.08.2024. Me shkresën nr. 179/3 Prot, dt. 28.08.2024

Autoriteti Kontraktor ka hartuar Ftesën për Ofertë. Data e zhvillimit të procedurës ishte 29.08.2024.

Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, bazuar në Urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Zv/Administratorit, nr. 07, datë 10.01.2024 "Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlera të vogla", në zbatim të Urdhrit të prokurimit nr. 69. dt. 28.08.2024, në datën 29.08.2024 ka zhvilluar procedurën e vlerësimit, për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt me objekt "Shpenzime shtypshkrime" me numër REF-17249-08-28-2024 në të cilin kanë marrë pjesë (8 tetë) operatorë ekonomikë.

➤ Operatorët ekonomik "DH.V", "HB ", "K.E.B", "M.M", "M", "P", "Shtypshkronja A" pjesëmarrës në këtë procedurë ju është refuzuar oferta pasi janë mbi vlerën e fondit limit, të përlogaritur nga autoriteti Kontraktor, për këtë objekt prokurimi, e cila është në vlerën 401.885 lekë pa Tvsh.

➤ Përsa i përket Operatori ekonomik "S.S", pjesëmarrës në këtë procedurë i është refuzuar oferta për arsye se nuk përmbushin specifikimin nga verifikimi i ekstraktit në QKB rezulton se operatori ekonomik nuk ka si fushë të veprimtarisë së tij objektin e prokurimit.

Në përfundim të këtij vlerësimit të ofertave, sipas raportit të gjeneruar nga sistemi APP, kanë rezultuar 8 oferta ekonomike të suksesshme "A", "F", "I.SH", "J.O.T", "J.P.P", "N.P", "R.G", "S. 2022".

Në përfundim të këtij vlerësimit të ofertave, sipas raportit të gjeneruar nga sistemi APP, fitues i procedurës është shpallur operatori ekonomik "A.P" ShPK.

Sipas përcaktimeve në Ftesën për Ofertë, Operatori ekonomik i renditur i pari "A.P" shpk", duhet të paraqitet me dokumentacionin e kërkuar pranë autoritetit kontraktor brenda ditës së nesërme të punës nga momenti i publikimit njoftimit të fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Dokumentacioni i kërkuar është administruar në dosje sipas përcaktimeve në Ftesë për Ofertë.

Me shkresën nr.. 278 prot.dt.09.09.2024, drejtuar Administratorit është dhënë informacion mbi procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt me objekt "Blerje uniforma pune për stafin". Në zbatim të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik", (i ndryshuar) si dhe Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, është nënshkruar kontrata me numër 179/6 prot, datë 09.09.2024 me vlerë 235.600 lekë pa tvsh dhe 282.720 lekë me tvsh, e lidhur ndërmjet Rezidencës Studentore Universitare Nr. 2 Sha, përfaqësuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor dhe Operatorit Ekonomik, "A.P" ShPK .

Bazuar në nenin 124 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 107, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Udhëzimi nr.5, datë 25.06.2021 "Mbi Përdorimin e Procedurës me Vlerë Të Vogël, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" me shkresën nr. 179/8 prot, dt. 10.09.2024 është ngritur me Urdhrin nr. 73, dt. 10.09.2024 Komisioni për marrjen në dorëzim të materialeve.

Me shkresën nr. 179/9 prot, dt. 12.09.2024; nr. 179/10 prot, dt. 03.10.2024; nr. 179/11 prot, dt. 17.12.2024 janë mbajtur Akt kolaudimet përkatëse, ku komisioni ka konkluduar se malli është sipas specifikimeve teknike të kërkuara dhe më pas është bërë hyrje në magazinë.

Likuidimi është bërë sipas tabelës 13. Fatura nr.75/2024, datë 17.12.2024, është likuiduar jashtë afatit ligjor.

Tabela 13: Likuidimi i procedurës të prokurimit "Shpenzime shtypshkrime".

Emërtimi	Fletë hyrje	Akt Kolaudimi	Vlera me TVSh	Likuiduar	Detyrime të vitit 2024
Fatura nr.38/2024, datë 12.09.2024	nr.24 dt 16.09.2024	Nr.179/9prot dt 12.09.2024	70,538.00	07.10.2024	
Fatura nr.43/2024, datë 03.10.2024	nr.28 03.10.2024	Nr.179/10prot dt 03.10.2024	32,900.00	21.11.2024	
Fatura nr.75/2024, datë 17.12.2024	nr.39 17.12.2024	Nr.179/11prot dt 17.12.2024	132,162.00	06.02.2025	132,162.00
TOTALI			235,600.		132,162

Konkluzion:

-Nga auditimi u konstatua se dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar dhe e arkivuar në arkivën e shoqërisë sipas përcaktimeve ligjore, kjo në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar.

-Nga auditimi i faturave të likuiduara nga ana e RSU Nr.2, u konstatua se Fatura nr.75/2024, datë 17.12.2024 është likuiduar në tejkalim të afatit ligjor 30 ditor. Veprime në mospërputhje me ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” i ndryshuar, neni 52, ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, si dhe UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 184 “Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik”.

-Nga auditimi i dosjes fizike të prokurimit u konstatua se dorëzimi i dokumentacionit të Operatorit Ekonomik, "A.P" ShPK me administrator S.D është fotokopje dhe jo e njëzuar me origjinalin siç është kërkuar në ftesën për ofertë (të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar;) në zbatim të Udhëzimit nr. 5, dt. 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurave me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” në të cilin citohet se: .. ofertuesi i renditur në vendin e parë duhet të sjellë në formë të shkruar, origjinal ose kopje të noterizuar dokumentacionin e kërkuar në ftesën për ofertë si më poshtë:

- Certifikatë regjistrimi dt. 04.12.2020 (certifikate elektronike e fiskalizuar për tatimpaguesit që përdorin platformën qendrore të faturave të cilët lëshojnë fatura përmes zgjidhjes software);
- Kartat e identitetit;
- Kontratë shërbimi dt. 28.01.2024 e lidhur midis Shoqërisë BNT E. shpk dhe Operatorit Ekonomik, "A.P" ShPK me administrator S.D.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

Për sa më sipër, kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik në kushtet kur nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar, është në kundërshtim me nenin 76 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 2 pika 2, shkronja (j), nenin 25, nenin 26 pika 6 dhe nenin 82, të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së, janë të detyrueshme për t’u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

11. Objekti i prokurimit: “Blerje kancelarie dhe tonerave”

Autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël me objekt: “Blerje kancelarie dhe tonerëve”. Procedura është iniciuar me kërkesën nr. 293 prot., dt.25.09.2024 për nisjen e procedurës së prokurimit, me kërkesën për “Shpenzime

shtypshkrime” për vitin 2024. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe nëpërmjet verifikimit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan se:

Me shkresën nr. 216 Prot, dt. 30.09 2024, është ngritur Urdhri nr. 77. dt. 30.09.2024, për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje kancelarie dhe tonerëve”. Me shkresën nr. 216/2 Prot, dt. 04.10.2024, është ngritur Urdhri Prokurimi nr. 78, dt. 04.10.2024. Me shkresën nr. 216/3 Prot, dt. 04.10.2024 Autoriteti Kontraktor ka hartuar Ftesën për Ofertë. Data e zhvillimit të procedurës ishte 07.10.2024.

Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, bazuar në Urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Zv/Administratorit, nr. 07, datë 10.01.2024 “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlera të vogla”, në zbatim të Urdhrit të prokurimit nr. 78. dt. 04.10.2024, komisioni në datën 08.10.2024 ka zhvilluar procedurën e vlerësimit, për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje kancelarie dhe tonerëve” me numër REF-22876-10-04-2024.

► Operatorët ekonomik "CRF", "S.S" pjesëmarrës në këtë procedurë ju është refuzuar oferta pasi oferta ekonomike është nën vlerën 50% të fondit limit, të përlllogaritur nga autoriteti kontraktor, për këtë objekt prokurimi, e cila është në vlerën 990,000 lekë pa Tvsh.

► Operatori ekonomik "A.K", pjesëmarrës në këtë procedurë i është refuzuar oferta pasi është mbi vlerën e fondit limit, të përlllogaritur nga autoriteti Kontraktor, për këtë objekt prokurimi, e cila është në vlerën 990.000 lekë pa Tvsh.

► Operatorët ekonomik "R.A", "A.P" pjesëmarrës në këtë procedurë i është refuzuar oferta për arsye se nuk përmbushin specifikimin nga verifikimi i ekstraktit në QKB rezulton se operatori ekonomik nuk ka si fushë të veprimtarisë së tij objektin e prokurimit.

Në përfundim të këtij vlerësimit të ofertave, sipas raportit të gjeneruar nga sistemi APP, kanë rezultuar 25 oferta ekonomike të suksesshme "L.D", "I.O", "IT Gj ", "O.C", "E.O", "A.G", "B.S", "F", "E.L", "J.P.P", "R", "3E ", "E.Q", "C", "Z", "I", "J.O.T", "HB- ". "I", "H", "J", "A", "S", "O.M", "M.M", "A.A".

Në përfundim të këtij vlerësimit të ofertave, sipas raportit të gjeneruar nga sistemi APP, fitues i procedurës është shpallur operatori ekonomik "L.D" ShPK.

Sipas përcaktimeve në Ftesën për Ofertë, Operatori ekonomik i renditur i pari " L.D " shpk, duhet të paraqitet me dokumentacionin e kërkuar pranë autoritetit kontraktor brenda ditës së nesërme të punës nga momenti i publikimit njoftimit të fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Dokumentacioni i kërkuar është administruar në dosje sipas përcaktimeve në Ftesë për Ofertë.

Me shkresën nr. Nr. 321 prot.dt.15.10.2024, drejtuar Administratorit është dhënë informacion mbi procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt me objekt “Blerje kancelarie dhe tonerëve”. Në zbatim të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik", (i ndryshuar) si dhe Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, është nënshkruar kontrata me numër 216/6 prot, datë 15.10.2024 me vlerë 500.000 lekë pa tvsh dhe 600.000 lekë me tvsh, e lidhur ndërmjet Rezidencës Studentore Universitare Nr. 2 Sha, përfaqësuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, dhe Operatorit Ekonomik, "L.D" ShPK përfaqësuar me autorizim nga L.F.

Bazuar në nenin 124 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 107, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Udhëzimi nr.5, datë 25.06.2021 "Mbi Përdorimin e Procedurës me Vlerë Të Vogël, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" me

shkresën nr. 216/8 prot, dt. 15.10.2024 është ngritur me Urdhrin nr. 80, dt. 15.10.2024 Komisioni për marrjen në dorëzim të materialeve. Me shkresën nr. 216/10 prot, dt. 12.11.2024; nr. 216/9 prot, dt. 28.10.2024; nr. 2016/11 prot, dt. 24.12.2024 janë mbajtur Akt kolaudimet përkatëse, ku komisioni ka konkluduar se malli është sipas specifikimeve teknike të kërkuara dhe më pas është bërë hyrje në magazinë. Likuidimi është bërë sipas tabelës 14.

Tabela 14: Likuidimi i procedurës të prokurimit “Blerje kancelarie dhe tonerëve”

Emërtimi	Fletë hyrje	Akt Kolaudimi	Vlera me Tvsh	likuiduar	Detyrime të vitit 2024
Fatura nr.144/2024, datë 28.10.2024	nr.31 dt 28.10.2024	N.216/9 prot dt 28.10.2024	405,847.00	21.11.2024	
Fatura nr.167/2024, datë 12.11.2024	nr.35 dt 12.11.2024	N.216/10 prot dt 12.11.2024	55,236.00	11.12.2024	
Fatura nr.258/2024, datë 24.12.2024	nr.44 dt 24.12.2024	N.216/11 prot dt 24.12.2024	140,716.80	23.01.2025	140,716.80
TOTALI			601,799.80		

Konkluzion:

-Nga auditimi u konstatua se dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar dhe e arkivuar në arkivën e shoqërisë sipas përcaktimeve ligjore, kjo në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar.

-Nga auditimi i dosjes fizike të prokurimit u konstatua se dorëzimi i dokumentacionit të Operatorit Ekonomik, "L.D" shpk është fotokopje dhe jo e njësuar me origjinalin siç është kërkuar në ftesën për ofertë (të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar) në zbatim të Udhëzimit nr. 5, dt. 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurave me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” në të cilin citohet se: *ofertuesi i renditur në vendin e parë duhet të sjellë në formë të shkruar, origjinal ose kopje të noterizuar dokumentacionin e kërkuar në ftesën për ofertë si më poshtë:*

- Certifikatë regjistrimi dt. 03.09.2020;
- Kartat e identitetit (për administratorin dhe personit e autorizuar);
- Kontratë ofrim shërbimi, dt. 22.01.2024 e lidhur midis Shoqërisë D. - ETM dhe Operatorit Ekonomik, "L.D" ShPK përfaqësuar nga I.B.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

Për sa më sipër, kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik në kushtet kur nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar, është në kundërshtim me nenin 76 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 2 pika 2, shkronja (j), nenin 25, nenin 26 pika 6 dhe nenin 82, të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së, janë të detyrueshme për t’u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Konkluzion: Dosjet e prokurimit për periudhën 2024 “Blerje e Vogël”, gjithsej 11 dosje nuk janë të inventarizuara dhe të arkivuara, në kundërshtim me Ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar.

-Nga auditimi i faturave të likuiduara nga ana e RSU Nr.2, u konstatua se faturat në 5 raste në procedurën e prokurimit me objekt me objekt "Blerje karburant diesel 10 ppm për automjetet e Shoqërisë", me numër REF-97434-03-05-2024; “Shpenzime dezinfektimi 3D” (Deratizim,

Dezinfektim, Dezinfektim)., me numër REF-98283-03-13-2024; “Blerje materiale për chillerat dhe panelet diellore” me numër REF-33689-12-17-2024; "Shpenzime shtypshkrime" me numër REF-17249-08-28-2024; "Blerje karburant diesel 10 ppm për automjetet e Shoqërisë", me numër REF-97434-03-05-2024; u konstatua se 5-fatura janë likuiduar në tejkalim të afatit ligjor 30 ditor. Veprime në mospërputhje me Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” i ndryshuar, neni 52, Ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, si dhe UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 184 “Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik”.

Auditimi i Procedurave të prokurimit “Blerjet e vogla” për vitin 2025.

Me Urdhrin nr. 10, datë 09.01.2025 “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlera të vogla”, i përbërë nga:

1. A.DH, kryetar
2. B.K, anëtar
3. I.L, anëtar.

1. Procedura “Shërbim mirëmbajtje ashensori”

Bazuar në kërkesën nr. 132, datë 22.05.2025 “Kërkesë për Shërbim Mirëmbajtje Ashensori Godina 4 Mjekësi për vitin 2025” ka nisur procedura e prokurimit.

Me Urdhrin nr. 56, datë 23.05.2025 “Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim mirëmbajtje ashensori””:

Komisioni i përbëhet nga:

1. I.XH, Kryetar
2. K.H, Anëtar
3. M.T, Anëtar

Komisioni duhet të përgatisë materialet deri në 27.05.2025.

Me shkresën nr. 132/2, datë 27.05.2025 “Hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit për zërin “Shpenzime mirëmbajtje ashensori”” grupi i punës ka hartuar specifikimet dhe ka përllogaritur fondin limit me vlerë 190,000 lekë pa TVSH bazuar në ofertën më të ulët midis tre ofertave.

Me Urdhrin e prokurimit nr. 58, datë 27.05.2025, Titullari i Autoritetit Kontraktor ka urdhëruar prokurimin e shërbimit, në këtë urdhër prokurimi nuk është përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit si dhe jo sipas përcaktimeve të Neni 77, Vendimi nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

Komisioni i blerjeve të vogla ka hartuar specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të pranimit me Procesverbalin nr. 132/4, datë 27.05.2025.

Ftesa për ofertë nr. 132/5, datë 27.05.2025, ku janë përcaktuar afatet dhe specifikimet teknike. Në datën e përcaktuar janë paraqitur:

- C me vlerën e ofruar 149,000 lekë
- P-2016 me vlerën e ofruar 155,000 lekë
- A SHPK me vlerën e ofruar 158,000 lekë
- V me vlerën e ofruar 169,000 lekë
- dhe operatorët ekonomik të s kualifikuar:
- H E CO, s kualifikuar sepse ka tejkaluar fondin limit
- Sh. Group, s kualifikuar sepse ka tejkaluar fondin limit.

KVO ka hartuar procesverbalin e vlerësimit nr. 132/6, datë 28.05.2025, ku ka shpallur fitues operatorin C. Ashensor me vlerën e ofruar 149,000 lekë.

Operatori C.s Ashensor ka dorëzuar dokumentacionin në datën 29.05.2025 në protokollin e institucionit me nr. 132/7.

Me këtë operator është lidhur kontrata nr. 132/8, datë 05.06.2025 “Shërbim mirëmbajtje ashensori” me vlerë 149,000 lekë pa TVSH.

Me Urdhrin nr. 61, datë 09.06.2025 “Për ngritje komisioni për marrjen në dorëzim “Shërbim mirëmbajtje ashensori”, i përbërë nga:

1. A.S, Kryetar
2. I.F, Anëtar
3. E.D, Anëtar.

Nga KVO është hartuar procesverbali nr. 132/10 prot., datë 09.06.2025.

2. Procedura “Dezinfektim, Deratizim, Dezinsektim (3 D-ve)”

Bazuar në kërkesën nr. 133, datë 23.05.2025 “Kërkesë për Shërbim “Dezinfektim, Deratizim, Dezinsektim (3 D-ve)”” ka nisur procedura e prokurimit.

Me Urdhrin nr. 59, datë 02.06.2025 “Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Dezinfektim, Deratizim, Dezinsektim (3 D-ve)””:

Komisioni i përbëhet nga:

1. R.L, Kryetar
2. A.SH, Anëtar
3. M.D, Anëtar

Komisioni duhet të përgatisë materialet deri në 04.06.2025.

Me shkresën nr. 133/2, datë 04.06.2025 “Hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit për zërin “Dezinfektim, Deratizim, Dezinsektim (3 D-ve)”” grupi i punës ka hartuar specifikimet dhe ka përllogaritur fondin limit me vlerë 555,555 lekë pa TVSH bazuar në mesataren e ofertën.

Me Urdhrin e prokurimit nr. 60, datë 04.06.2025, Titullari i Autoritetit Kontraktor ka urdhëruar prokurimin e shërbimit, në këtë urdhër prokurimi nuk është përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit si dhe jo sipas përcaktimeve të Neni 77, Vendimi nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

Komisioni i blerjeve të vogla ka hartuar specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të pranimit me Procesverbalin nr. 133/4, datë 04.06.2025.

Ftesa për ofertë nr. 133/5, datë 04.06.2025, ku janë përcaktuar afatet dhe specifikimet teknike. Në datën e përcaktuar janë paraqitur:

- A me vlerën e ofruar 277,777 lekë,
- Th me vlerën e ofruar 283,111 lekë,
- K.L, me vlerën e ofruar 283,333 lekë,
- E.D me vlerën e ofruar 283,333 lekë,
- E.M me vlerën e ofruar 283,333 lekë,
- A.P me vlerën e ofruar 283,333 lekë,
- M.B me vlerën e ofruar 283,333 lekë,
- D.T me vlerën e ofruar 283,333 lekë,
- A me vlerën e ofruar 283,333 lekë,
- EB me vlerën e ofruar 283,664 lekë,
- 3E me vlerën e ofruar 498,000 lekë,
- E.Z me vlerën e ofruar 510,000 lekë,

- dhe operatorët ekonomik të s kualifikuar:
- M.M, s kualifikuar sepse ka tejkualuar fondin limit,
- Akademia e Shëndetit Publik, s kualifikuar sepse ka tejkualuar fondin limit,
- K.GJ, s kualifikuar sepse është ulur më shumë se 50% e fondit limit të përlogaritur,
- V.C, s kualifikuar sepse ka tejkualuar fondin limit,
- B.C, s kualifikuar sepse ka tejkualuar fondin limit.

KVO ka hartuar procesverbalin e vlerësimit nr. 133/6, datë 09.06.2025, ku ka shpallur fitues operatorin A, me vlerën e ofruar 277,777 lekë.

Operatori A ka dorëzuar dokumentacionin në datën 10.06.2025 në protokollin e institucionit me nr. 137/7.

Me këtë operator është lidhur kontrata nr. 133/8, datë 16.06.2025 “Dezinfektim, Deratizim, Dezinsektim (3 D-ve)” me vlerë 277,777.8 lekë pa TVSH.

Me Urdhrin nr. 64, datë 16.06.2025 “Për ngritje komisioni për marrjen në dorëzim “Dezinfektim, Deratizim, Dezinsektim (3 D-ve)””, i përbërë nga:

1. I.XH, Kryetar
2. A.L, Anëtar
3. G.S, Anëtar.

Nga KVO është hartuar procesverbali nr. 133/9 prot., datë 16.06.2025.

3. Procedura “Blerje shtypshkrime për vitin 2025”

Bazuar në kërkesën nr. 155, datë 01.07.2025 “Kërkesë për Blerje shtypshkrime për vitin 2025” ka nisur procedura e prokurimit.

Me Urdhrin nr. 73, datë 01.07.2025 “Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje shtypshkrime për vitin 2025””:

Komisioni i përbëhet nga:

1. R.L, Kryetar
2. G.S, Anëtar
3. A.SH, Anëtar

Komisioni duhet të përgatisi materialet deri në 03.07.2025.

Me shkresën nr. 155/2, datë 27.05.2025 “Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit për zërin Blerje shtypshkrime për vitin 2025” grupi i punës ka hartuar specifikimet dhe ka përlogaritur fondin limit me vlerë 325,775 lekë pa TVSH bazuar në mesataren e tre ofertave.

Me Urdhrin e prokurimit nr. 74, datë 04.07.2025, Titullari i Autoritetit Kontraktor ka urdhëruar prokurimin e shërbimit, në këtë urdhër prokurimi nuk është përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit si dhe jo sipas përcaktimeve të Neni 77, Vendimi nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

Ftesa për ofertë nr. 155/4, datë 04.07.2025, ku janë përcaktuar afatet dhe specifikimet teknike.

Në datën e përcaktuar janë paraqitur:

- R me vlerën e ofruar 166,667 lekë,
- F me vlerën e ofruar 186,000 lekë,
- F.L.E.SH me vlerën e ofruar 189,000 lekë,
- Shtypshkronja A. 2005 me vlerën e ofruar 190,000 lekë,
- K.KH me vlerën e ofruar 197,000 lekë,
- N.B me vlerën e ofruar 202,710 lekë,
- M.D me vlerën e ofruar 214,000 lekë,
- A.D me vlerën e ofruar 250,000 lekë,
- K.V me vlerën e ofruar 250,000 lekë,

- J.O.T me vlerën e ofruar 275,000 lekë,
- O, me vlerën e ofruar 290,000 lekë,
- R.T, me vlerën e ofruar 295,000 lekë,
- O.H me vlerën e ofruar 314,000 lekë,
- S me vlerën e ofruar 316,667 lekë,
- dhe operatorët ekonomik të s kualifikuar:
- A, s kualifikuar sepse ka tejkualuar fondin limit,
- A.P, s kualifikuar sepse është ulur më shumë se 50% e fondit limit të përlogaritur,
- E, s kualifikuar sepse ka tejkualuar fondin limit,
- N.H, s kualifikuar sepse ka tejkualuar fondin limit,

Operatori R.G, ka dorëzuar dokumentacionin në datën 08.07.2025 në protokollin e institucionit me nr. 155/6.

Me këtë operator është lidhur kontrata nr. 155/7, datë 21.07.2025 “Blerje shtypshkrime për vitin 2025” me vlerë 166,667 lekë pa TVSH.

Me Urdhrin nr. 79, datë 30.07.2025 “Për ngritje komisioni për marrjen në dorëzim “Blerje shtypshkrime për vitin 2025””, i përbërë nga:

1. A.L, Kryetar
2. A.S, Anëtar
3. E.D, Anëtar.

Nga KVO është hartuar procesverbali nr. 155/9 prot., datë 30.07.2025.

4. Procedura “Pastrim dhe Higjienizimit të dyshekëve”.

Bazuar në kërkesën nr. 189, datë 02.09.2025 “Kërkesë për Shërbim “Pastrimit të higjienizimit të dyshekëve” për vitin 2025” ka nisur procedura e prokurimit.

Me Urdhrin nr. 85, datë 04.09.2025 “Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Pastrimit të higjienizimit të dyshekëve”:

Komisioni i përbëhet nga:

1. M.S, Kryetar
2. D.N, Anëtar
3. K.K, Anëtar

Komisioni duhet të përgatisë materialet deri në 08.09.2025.

Me shkresën nr. 189/2, datë 08.09.2025 “Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit për zërin “Pastrimit të higjienizimit të dyshekëve” grupi i punës ka hartuar specifikimet dhe ka përlogaritur fondin limit me vlerë 580,000 lekë pa TVSH bazuar në mesataren e tre ofertave.

Me Urdhrin e prokurimit nr. 86, datë 10.09.2025, Titullari i Autoritetit Kontraktor ka urdhëruar prokurimin e shërbimit, në këtë urdhër prokurimi nuk është përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit si dhe jo sipas përcaktimeve të Neni 77, Vendimi nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

Ftesa për ofertë nr. 189/4, datë 11.09.2025, ku janë përcaktuar afatet dhe specifikimet teknike.

Në datën e përcaktuar janë paraqitur:

- K SHPK me vlerën e ofruar 293,000 lekë,
- D.H me vlerën e ofruar 420,000 lekë,
- O SHPK me vlerën e ofruar 469,000 lekë,
- J me vlerën e ofruar 514,000 lekë,
- K.E.B SHPK me vlerën e ofruar 515,000 lekë,
- O.H me vlerën e ofruar 528,000 lekë,
- A me vlerën e ofruar 537,000 lekë,
- M, me vlerën e ofruar 538,000 lekë,

- O.M, me vlerën e ofruar 565,000 lekë,
- HB.G me vlerën e ofruar 570,000 lekë,
- dhe operatorët ekonomik të s kualifikuar:
- B, s kualifikuar sepse ka tejkaluar fondin limit,
- J., s kualifikuar sepse ka tejkaluar fondin limit,
- 2-MJ, s kualifikuar sepse ka tejkaluar fondin limit,
- 2 G, s kualifikuar sepse ka tejkaluar fondin limit.

KVO ka hartuar procesverbalin e vlerësimit nr. 189/5, datë 15.09.2025, ku ka shpallur fitues operatorin K, me vlerën e ofruar 293,000 lekë.

Operatori K, ka dorëzuar dokumentacionin në datën 15.09.2025 në protokollin e institucionit me nr. 189/6.

Me këtë operator është lidhur kontrata nr. 189/7, datë 17.09.2025 “Pastrimit të higjienizimit të dyshekëve” me vlerë 293,000 lekë pa TVSH.

Me Urdhrin nr. 91, datë 18.09.2025 “Për ngritje komisioni për marrjen në dorëzim “Pastrimit të higjienizimit të dyshekëve””, i përbërë nga:

1. E.M, Kryetar
2. D.M, Anëtar
3. T.G, Anëtar
4. D.N, Anëtar
5. V.C, Anëtar.

Nga KVO është hartuar procesverbali nr. 189/8 prot., datë 17.09.2025.

5. Procedura “Rimbushje dhe kolaudim fikse zjarri ABC dhe BCE”

Bazuar në kërkesën nr. 195, datë 09.09.2025 “Kërkesë për Shërbim “Rimbushje dhe kolaudim fikse zjarri ABC dhe BCE” për vitin 2025” ka nisur procedura e prokurimit.

Me Urdhrin nr. 88, datë 17.09.2025 “Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Rimbushje dhe kolaudim fikse zjarri ABC dhe BCE””:

Komisioni i përbëhet nga:

1. I.XH, Kryetar
2. A.SH, Anëtar
3. M.D, Anëtar

Komisioni duhet të përgatisë materialet deri në 18.09.2025.

Me shkresën nr. 195/2, datë 18.09.2025 “Hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit për zërin “Rimbushje dhe kolaudim fikse zjarri ABC dhe BCE” grupi i punës ka hartuar specifikimet dhe ka përllogaritur fondin limit me vlerë 160,067 lekë pa TVSH bazuar në mesataren e tre ofertave.

Me Urdhrin e prokurimit nr. 89, datë 18.09.2025, Titullari i Autoritetit Kontraktor ka urdhëruar prokurimin e shërbimit, në këtë urdhër prokurimi nuk është përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit si dhe jo sipas përcaktimeve të Neni 77, Vendimi nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

Ftesa për ofertë nr. 195/4, datë 18.09.2025, ku janë përcaktuar afatet dhe specifikimet teknike. Në datën e përcaktuar janë paraqitur:

- K.K me vlerën e ofruar 110,000 lekë,
- B me vlerën e ofruar 120,000 lekë,
- GE, me vlerën e ofruar 122,000 lekë,
- J.M, me vlerën e ofruar 130,000 lekë,
- A.M, me vlerën e ofruar 146,800 lekë,

dhe operatorët ekonomik të s kualifikuar:

- F, s kualifikuar sepse ka tejkualuar fondin limit,
- B.C, s kualifikuar sepse ka tejkualuar fondin limit,
- F.C, s kualifikuar sepse ka tejkualuar fondin limit,
- O.H, s kualifikuar sepse ka tejkualuar fondin limit,
- J, s kualifikuar sepse ka tejkualuar fondin limit,
- Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri, s kualifikuar sepse ka tejkualuar fondin limit,
- V.A, s kualifikuar sepse ka tejkualuar fondin limit.

KVO ka hartuar procesverbalin e vlerësimit nr. 195/5, datë 22.09.2025, ku ka shpallur fitues operatorin K.K me vlerën e ofruar 110,000 lekë.

Operatori K.K ka dorëzuar dokumentacionin në datën 22.09.2025 në protokollin e institucionit me nr. 195/6.

Me këtë operator është lidhur kontrata nr. 195/7, datë 25.09.2025 “Rimbushje dhe kolaudim fikse zjarri ABC dhe BCE” me vlerë 110,000 lekë pa TVSH.

Me Urdhrin nr. 94, datë 25.09.2025 “Për ngritje komisioni për marrjen në dorëzim “Rimbushje dhe kolaudim fikse zjarri ABC dhe BCE””, i përbërë nga:

1. Y.ZH, Kryetar
2. E.D, Anëtar
3. K.H, Anëtar

Nga KVO është hartuar procesverbali nr. 195/8 prot., datë 25.12.2025.

Nuk u konstatuan gjetje në auditimin e procedurave të prokurimit “Blerje e vogël”, për vitin 2025/09.

Nuk janë paraqitur observacione në fazën e RPA-së, nga subjekti në auditim.

5. Të tjera çështje të dala gjatë auditimit.

Mbi auditimin e ushtruar në Rezidencën Studentore Universitare Nr.2, sha (*këtu e më poshtë RSU nr.2 sha*) në bazë të Programit të Auditimit të Përputhshmërisë nr.1047/1 prot, datë 03.11.2025, në zbatim të pikës 5 të programit të auditimit nr.1047/1 prot, datë 03.11.2025, “Të tjera çështje të dala gjatë auditimit”, për periudhën 01.01.2024-01.102.2025,u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

-Deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm.

-Rregullore e brendshme nr. 15, datë 20.12.2022;

-Shkresat për emërimin e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues;

-Regjistri i riskut;

-Kodi Etik i RSU nr.2

- Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar

- Ligji Nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”

-Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave Nr. 108, datë 17.11.2016,

Auditimit, u fokusua kryesisht në këto çështje:

☞ Vlerësimi i Mjedisit të Kontrollit

☞ Menaxhimi i riskut

☞ Veprimtaritë e kontrollit

☞ Informim komunikimi

☞ Monitorimi

Nga auditimi u konstatua:

I. Vlerësimi i Mjedisit të Kontrollit

Referuar legjislacionit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, “*Mjedisi i kontrollit*” është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Titullarët e njësive të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.

Vlerësimi i Mjedisit të kontrollit bazohet në komponentët:

1. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike;

Në lidhje me këtë komponent RSU Nr.2, ka të miratuar një Kod Etike me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm znj. ZH.D me nr.747, datë 20.09.2018 “Për miratimin e Kodit të Etikës” në përputhje me Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, si dhe sipas Vendimit të KM nr.76, datë 27.04.2018”Për miratimin e strukturës dhe organigramës së shoqërisë Trajtim Studenti nr.2” si dhe Rregulloren e Brendshme të RSU nr.2, nr.81, datë 27.06.2018.

Konstatohen ndryshime në rregulloren e brendshme si rezultat i ristrukturimit, ku për periudhën në auditim rezultoi se, struktura e fundit është miratuar sipas Vendimit të KM me nr.11, 27.10.2023, dhe rregullorja e fundit është miratuar sipas VKM me nr. 15, 20.12.2022.

Në këto kushte duhet të miratohej një Kod i ri Etike si dhe rregullore e re në bazë të ndryshimeve strukturore, e cila edhe sot në fund të 2025 nuk është përditësuar, veprime në kundërshtim me Ligjin 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar ”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 9/ pika 4, Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues, ku citohet se: *Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore: a) propozimin te nëpunësi autorizues i njësisë publike të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetorë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në njësi; b) hartimin e objektivave dhe zbatimin e planeve strategjike dhe vjetore, në përputhje me objektivat e miratuar nga titullari i njësisë publike; Pika 4 a) propozimin te nëpunësi autorizues i njësisë publike të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, si dhe Pika 4/f) Ndarjen e përgjegjësisë që lidhen me vendimmarrjen, kontrollin, zbatimin dhe vendosjen e linjave të raportimit, në përputhje me përgjegjësitë e deleguara.*

Ky detyrim ligjor gjen përcaktim dhe në Ligjin Nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”

2) Politikat menaxheriale dhe stilin e punës;

Referuar Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 9, pika 4, germa “a”, Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore:

a)propozimin te nëpunësi autorizues i njësisë publike të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetorë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në njësi...” si dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. IV, pika, 4.2.10, germa “a”.

Në përmbushje të këtij detyrimi ligjor nga RSU Nr.2, objektivat janë përcaktuar në PBA-të, 2023-2025 dhe 2024-2026, ku janë hartuar plane pune dhe janë kryer analiza vjetore të veprimtarisë.

1.*Nëpunësi Autorizues* është emëruar administratori i shoqërisë, znj. ZH.D, me vendimin nr.56/1 prot, datë 04.02.2021, nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, kontratë e lidhur me nr.56/2 prot, datë 04.02.2021 për administrimin dhe drejtimin e Rezidencës Studentore Universitare Nr.2 Sh.a.

2.Nëpunësi Autorizues ka marrë masa për caktimin e *Nëpunësit Zbatues*, znj. E.R, dhe të njoftojë Nëpunësin e Parë Autorizues (Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve të Shoqërisë) me vendimin 06, datë 24.06.2021 ku detyrat dhe përgjegjësitë e Nëpunësit Zbatues” realizohen sipas përcaktimeve të nenit 12, pika 2, të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

Kjo bazuar Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktivëve në njësitë e sektorit publik”, Udhëzimit Nr.21, datë 25.10.2016 “Për Nëpunësit Zbatues të të gjitha niveleve”, Strukturës së Shoqërisë miratuar në Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës Nr.113, Prot, datë 06.10.2020, Rregullores së Brendshme të Shoqërisë me Nr. 559/4 Prot, datë 13.01.2021.

Në lidhje me këtë komponent në zbatim të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, nenit 8, pika 8/b ku përcaktohet se:

Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:

b) ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike’, nga RSU Nr.2, në funksion dhe zbatim të këtij detyrimi ligjor çdo vit del urdhri i Titullarit për ngritjen e grupit strategjik (GMS).

GMS është ngritur sipas Urdhrit të Administratorit nr.09, datë 13.01.2020 “ *Mbi krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik*” (GMS) me përbërje si më poshtë:

- Drejtori i Përgjithshëm në cilësinë e Nëpunësit Autorizues
- Zv/Drejtor i Përgjithshëm
- Drejtori i Drejtorisë Ekonomike Menaxhimit Financiar dhe Aseteve në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.
- Drejtorët e Drejtorive pjesë e Strukturës së Rezidencës Studentore Universitare Nr.2, Sha, Tiranë.

Ndryshuar me Urdhrin e administratorit nr.114, datë 29.12.2022, “ *Për një ndryshim në Urdhrin Nr.09, datë 13.01.2020 “ Mbi krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) ”*” që konsiston në ndryshimin e emërimit nga Drejtor i Përgjithshëm në Administrator në cilësinë e NA-së, nga Zv/Drejtor i Përgjithshëm në ndryshim emërimi, por jo personi, në Zv/ Administrator.

Gjithashtu Drejtori i Drejtorisë Ekonomike të Menaxhimit Financiar dhe Aseteve në Drejtor të Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, do të kryejë funksionin e sekretarit të GMS, në bazë të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 12, pika 3; germa d (në cilësinë e Nëpunësit Zbatues).

Është hartuar udhëzimi për menaxhimin e riskut në shoqërinë e RSU Nr.2, SH.A, miratuar nga administratori me nr. 20/1, datë 14.01.2020.

Me vendimin nr.23, datë 26.08 2020, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*”, i ndryshuar; Ligjin Nr.10296, datë 8.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar, ka vendosur krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik të “Rezidencës Studentore Universitare Nr.2” Sh.a përbërja e të cilit është si më poshtë:

- Kryetari i Bashkisë, në cilësinë e përfaqësuesit të Asamblesë së Përgjithshme (Titullari i Njësisë Publike).
- Drejtori i Përgjithshëm në cilësinë e Nëpunësit Autorizues (Kordinator i Riskut).
- Drejtori i Drejtorisë Ekonomike Menaxhimit Financiar dhe Aseteve në cilësinë e Nëpunësit Zbatues
- Drejtorët e të gjitha Drejtorive pjesë e Strukturës të Rezidencës Studentore Universitare Nr.2, Sha, Tiranë.

Me vendimin nr. 24, datë 14.09 2020, bazuar në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*” i ndryshuar; Ligjin Nr.10296, date 8.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar, Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve të Shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare Nr.2”, Sha, ka miratuar “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut për Rezidencën Studentore Universitare Nr.2”. Administratori i shoqërisë ka nxjerrë Urdhrin me nr.100, datë. 14.09.2020 “ *Mbi zbatimin e Strategjisë së Riskut*”

për Rezidencën Studentore Universitare Nr.2 Sha". Me shkresën Nr. 407, dt. 16.12.2022, është bërë njoftimi për mbledhjen e Grupit të Menaxhimit Financiar dhe Strategjik drejtuar drejtorive nga titullari i shoqërisë , sipas Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*" i ndryshuar nenit 158, pika 3 germa "d", si dhe në kompetencat e Administratorit të RSU Nr.2, të përcaktuara në nenin 24 si dhe nenin 26 të Statutit të Shoqërisë si dhe Urdhrit nr.09, datë 13.01.2020.

Me shkresën nr. 407/1, dt. 28.12.2022 është mbajtur procesverbali i mbledhjes së grupit GMS. Me shkresën nr. 413, dt 29.12.2022 është ndryshuar, grupi i GMS-së, cituar edhe më sipër. Sipas memo-ve me nr.330 prot, nr.331prot , nr.332 prot, nr.333 prot, nr.334 prot, datë 18.12.2023 nga drejtoritë e shoqërisë është raportuar pranë titullarit, evidentimi i Risqeve për vitin 2024, nga Grupi i Menaxhimit Strategjik.

Me shkresën nr. 337 prot, datë 18.12.2023, të Titullarit të RSU-së nr.2, i është dërguar Këshillit Mbikëqyrës të RSU nr.2, Regjistri i Riskut për vitin 2024, përgatitur nga Grupi i Menaxhimit Strategjik ,duke u mbështetur në objektivat e vendosura dhe misionin e funksionimit të saj, duke kryer identifikimin e risqeve potenciale, vlerësimin e risqeve mbi bazën e probabilitetit për të ndodhur dhe impaktit që shkaktojnë, adresimin e risqeve tek personat përgjegjës, monitorimin e vazhdueshëm dhe raportimin mbi gjendjen e tij.

Referuar Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", i ndryshuar; Ligjit nr.10296 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin* " i ndryshuar; Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike*", i ndryshuar; Udhëzimit Nr. 16, datë 20.07.2016, "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike*", Urdhrit Nr.114, datë 29.12.2022 "*Për një ndryshim në Urdhrit Nr.09, datë 13.01.2020 "Mbi krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS)"*", Drejtoritë e Shoqërisë duhet të hartojnë regjistrin e riskut, duke u mbështetur në objektivat e vendosura dhe misionin e funksionimit të saj duke kryer identifikimin e risqeve potenciale, vlerësimin e risqeve mbi bazën e probabilitetit për të ndodhur dhe impaktit që shkaktojnë, adresimin e risqeve tek personat përgjegjës, monitorimin e vazhdueshëm dhe raportimin mbi gjendjen e tij.

Me shkresën nr. 257/1, datë 10.12.2024, drejtuar administratorit, Drejtoritë e Shoqërisë kanë hartuar regjistrin e riskut për vitin 2024 të Shoqërisë "*Rezidenca Studentore Universitare Nr.2*" Sha, duke u mbështetur në objektivat e vendosura dhe misionin e funksionimit të saj duke kryer identifikimin e risqeve potenciale, vlerësimin e risqeve mbi bazën e probabilitetit për të ndodhur dhe impaktit që shkaktojnë, adresimin e risqeve tek personat përgjegjës, monitorimin e vazhdueshëm dhe raportimin mbi gjendjen e tij.

Me shkresën nr. 257/2 prot, datë 11.12.2024 është njoftuar Grupi i Menaxhimit Strategjik për mbledhje ku çdo Drejtor duhet të përgatisë informacionin përkatës për çdo drejtori.

Me shkresën nr. 257/3 prot, dt. 11.12.2024 është mbajtur proces verbali i mbledhjes mbi evidentimin e risqeve dhe minimizimi i tij sipas Drejtorive, raportimin në lidhje me regjistrin e riskut sipas Drejtorive si dhe detyrat që do të lihen për vitin pasardhës.

Me shkresën nr.257/4 prot, datë 12.12.2024, Administratori i Shoqërisë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, ka përcjellë pranë Këshillit Mbikëqyrës regjistrin e riskut me Nr.257/1 Prot. Datë 10.12.2024 për Shoqërinë "*Rezidenca Studentore Universitare Nr.2*" Sha përgatitur nga Grupi i Menaxhimit Strategjik.

Me urdhrin nr. 88, datë 11.12.2023, Administratori, ka kërkuar përgatitjen e analizës vjetore për vitin 2023 dhe planin vjetor për vitin 2024.

Pas dërgimit të Titullarin, i planit vjetor për vitin 2024, me shkresën 325/7, datë 16.01.2024 nga drejtoritë respektive, (GMS) është miratuar me Vendimin 01, datë 26.01.2024, nga Këshilli Mbikëqyrës për RSU Nr.2.

Më pas është nxjerrë Urdhri i Titullarit me nr.24. datë 26.01.2024 “Mbi zbatimin e planit vjetor për vitin 2024”.

Konkretisht me shkresën nr. 27/1 prot., datë 13.01.2025 është hartuar plani vjetor për vitin 2025, nga Grupi i Menaxhimit Strategjik me përbërje nga drejtorët e drejtorive përkatëse në RSU nr.2 Sha.

Me shkresën nr. 27/4 prot., datë 22.01.2025 është marrë vendimi nr. 01, datë 22.01.2025 “Mbi miratimin e planit vjetor të punës për vitin 2025 në RSU nr.2 Sh.a” nga Këshilli Mbikëqyrës. Në mbështetje të Ligjit Nr. 7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare” i ndryshuar; Ligjit nr. 9901 datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar; VKM-së nr.335 date 04.05.2016 “Për transferimin 100% të aksioneve të shoqërive aksionare “Rezidenca Studentore Universitare Sh. A. Tiranë” “Trajtimi i Studentëve ur.2 Sh. A. Tiranë, Trajtimi Studentëve nr. 3 Sh. A. Tiranë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, tek Bashkia Tiranë, Strukturës së Shoqërisë miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.11 Prot, datë 27.10.2023 “Për miratimin e strukturës së Shoqërisë Rezidenca Studentore Universitare Nr.2, SH.A dhe Rregullores së Brendshme të Shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare Nr.2”, miratuar me Nr.400/1 Prot, datë 20.12.2022, pasi shqyrtoi Planin Vjetor të Punës për vitin 2025 për Rezidencën Studentore Universitare Nr.2, të paraqitur për miratim me Nr.27/3 Prot., datë 15.01.2025 nga Administratori i Shoqërisë, në cilësinë e Këshillit Mbikëqyrës ka vendosur të miratojë planin vjetor të punës për vitin 2025, veprime në zbatim të nenit 8 dhe nenit 27 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe në mbështetje të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, neni 158, pika 3 germa “d”, si dhe bazuar në kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm të Rezidencës Studentore Universitare Nr.2, Sha, Tiranë, të përcaktuara në nenin 24 dhe nenin 26 të Statutit të shoqërisë, me urdhrin nr. 9, datë 13.01.2020 “Mbi krijimin e grupit të menaxhimit strategjik” (GMS) është krijuar me përbërje si më poshtë:

- Drejtori i Përgjithshëm në cilësinë e Nëpunësit Autorizues
- Zv/Drejtor i Përgjithshëm
- Drejtori i Drejtorisë Ekonomike Menaxhimit Financiar dhe Aseteve në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.
- Drejtorët e Drejtorive pjesë e Strukturës së Rezidencës Studentore Universitare Nr.2, Sha, Tiranë.

Në mbështetje të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimit nr.28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”, Udhëzimit Nr.16, datë 20.7.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike ”; Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.54, datë 15.07.2010; Ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” janë dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit pranë Ministrisë së Financave shkresat :

-me shkresën nr. 326/2 prot, datë 26.02.2024, është dërguar raportimi vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm dhe plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit në Rezidencën Studentore Universitare Nr.2, Sha, Tiranë për vitin 2023.

-me shkresën nr.75 prot, datë 21.02.2025, është dërguar raportimi vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm dhe plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit për komponentët e

menaxhimit financiar dhe kontrollit në Rezidencën Studentore Universitare Nr.2, Sha, Tiranë për vitin 2024.

Rezultoi se GMS është mbledhur 1 herë në vit, për vitin 2024.

Bazuar në Udhëzimin Nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinorit të riskut në njësitë publike” përcaktohet se:

GMS duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit. Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike’.

Për vitin 2024, në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton që GMS ka marrë 1 vendim në mbledhjen e zhvilluar. Vendimi i GMS-së ka konsistuar në hartimin e regjistrit të riskut për vitin 2024 të Shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare Nr.2” Sha, duke u mbështetur në objektivat e vendosura dhe misionin e funksionimit të saj si dhe duke kryer identifikimin e risqeve potenciale, vlerësimin e risqeve mbi bazën e probabilitetit për të ndodhur dhe impaktit që shkaktojnë, adresimin e risqeve tek personat përgjegjës, monitorimin e vazhdueshëm dhe raportimin mbi gjendjen e tij.

Numri i mbledhjeve të GMS duhet të jetë të paktën 4 herë në vit sipas Udhëzimit Nr.16, datë 20.07.2016.

3) Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;

Në drejtim të objektivave të institucionit, struktura organizative në Rezidencën Studentore Universitare nr.2, ka funksionuar me Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës Nr.11, datë 27.10.2023, dhe Urdhrit të Administratorit Nr.77, datë 30.10.2023 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës në Rezidencën Studentore Universitare nr.2”, sipas së cilës numri i punonjësve është **156**.

Nga auditimi:

-Për vitin 2024, numri total i punonjësve në strukturë është **156** punonjës (**plani**), ndërsa numri **faktik** i punonjësve rezulton **151** (fakti).

-Për vitin 2025, numri total i punonjësve në strukturë është **156** punonjës (**plani**) ndërsa numri **faktik** i punonjësve rezulton **148** (fakti).

-Referuar të dhënave të marra nga *Spektori i burimeve njerëzore*, për vitin **2024**, numri i vendeve të lira/vakante në Rezidenca Studentore Universitare nr. 2, është **5**, nga këto vetëm për administratën, vende të lira/vakante është **1**.

-Referuar të dhënave të marra nga *Spektori i burimeve njerëzore*, për vitin **2025 (Janar-Shtator)**, numri i vendeve të lira/vakante në Rezidencën Studentore Universitare nr.2, është **8**, nga këto vetëm administratën, vende të lira/vakante janë **5**.

-Sipas strukturës së miratuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës, duke mos pësuar ndryshime të tjera strukturore, plani dhe fakti i rekrutimeve për periudhën e audituar është:

-Për vitin 2024, plani i rekrutimeve, në zbatim të Kodit të Punës është **6** vende (**plani**) ku janë realizuar **14** procedura rekrutimi, nga të cilat:

- **4** vende vakante për dalje në pension,
- **7** vende vakante si pasoje largime me dorëheqje,
- **1** vend vakant si pasojë e largim nga detyra me masë disiplinore dhe
- **1** vend vakant për ndarje nga jeta.

-Për vitin 2025, plani i rekrutimeve në zbatim të Kodit të Punës është **5** vende (**plani**). Deri në fund të 3/mujorit të tretë, janë realizuar **8** procedura rekrutimi, nga të cilat:

- 1 dalje në pension,
- 1 raport leje- lindje,
- 8 largime me dorëheqje.

4) Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;

Politikat e burimeve njerëzore dhe praktikat e ngjashme lidhen me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, ngritjen në detyrë dhe veprimet disiplinore, të cilat përbëjnë një pjesë të rëndësishme të kontrollit të brendshëm.

Burimet njerëzore, referuar strukturës së miratuar menaxhohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit. Sektori mbulon çështjet që kanë të bëjnë me procedurat e rekrutimit, emërimit dhe lirimit nga detyra apo shërbimi civil, procedurat disiplinore, administrimin e dosjeve të personelit, plotësimin e regjistrit qendror të personelit, përgatitjen e përshkrimeve të punës. Në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike administron trajnimet dhe kualifikimet e stafit.

5) Aftësitë profesionale të punonjësve.

Aftësitë profesionale të punonjësve janë në dinamikë të vazhdueshme, pasi nga ASPA organizohen trajnime të ndryshme në mënyrë që punonjësit të ngrihen profesionalisht. Megjithatë nga RSU nr. 2, nuk është hartuar plan vjetor trajnimesh në lidhje me ngritjen profesionale të punonjësve në fushat specifike që operon vetë ky subjekt, por është mjaftuar vetëm me trajnimet e planifikuara dhe organizuara nga ASPA.

b. Menaxhimi i riskut.

Në zbatim të Ligjit Nr.10296, i ndryshuar, datë 08.07.2010, i ndryshuar neni 21, duhet të identifikohen, vlerësohen dhe kontrollohen ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të RSU-së nr.2.

RSU ka hartuar dhe miratuar një regjistër të konsoliduar të risqeve për institucionin, duke vepruar në përputhje me nenin 8, germa “a” dhe nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, ku përcaktohet se :

“Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: a) miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave”

“Për t’i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike, (ose duke deleguar këtë detyrë) miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet, ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut...”.

c. Veprimtaritë e kontrollit.

Në përputhje me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, neni 16, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, pika 3.2, Hapi 5 “Gjurmët e auditimit”, është hartuar harta e proceseve të punës si dhe gjurmët e auditimit. Për vitin 2024 janë hartuar nga grupi i GMS-së me shkresën nr. 334/prot datë 18.12.2023 dhe janë miratuar nga KM, dhe për vitin 2025, janë hartuar sipas shkresës me nr258/1. Prot, datë 10.11.2024, me nr. Vendimi17, datë 23.12.2024, nga KM.

d. Informim komunikimi.

Shkëmbimi i informacionit realizohet ndërmjet punonjësve të institucionit si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht. Në Rregulloren e brendshme dhe Kodin e Etikës janë përshkruar proceset e punës dhe sjellja e etikës gjatë punës si dhe marrëdhëniet me njëri tjetrin. Komunikimi i informacionit realizohet përmes shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe përmes postës elektronike/e-mail.

Informacion periodik sigurohet në mënyrë të ndërsjellë, raportimet bëhen rast pas rasti mujore, IV mujore dhe vjetore.

Informacioni dhe komunikimi lidhen edhe me teknologjinë e informacionit dhe zbatimin e rregullave të tyre për gjenerimin, përpunimin, përdorimin dhe ruajtjen e informacionit në RSU, nr.2.

e. Monitorimi

Referuar përcaktimit ligjor të menaxhimit financiar dhe kontrollit “monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të afrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë ngritur”. Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë.

Monitorimi i sistemit të MFK nga titullari realizohet nëpërmjet plotësimit të pyetësorit të vetëvlerësimit të kontrollit të brendshëm. Duke ju përgjigjur pyetjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit, institucioni bën vlerësimin e zhvillimit të komponentëve të veçantë të kontrollit të brendshëm.

Për sa më sipër, për periudhën e audituar, RSU nr.2, ka përgatitur Deklaratën dhe Raportin vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm për vitin 2024, dërguar në MFE me shkresën

-me shkresën nr. 326/2 prot, datë 26.02.2024 është dërguar raportimi vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm dhe plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit në Rezidencën Studentore Universitare Nr.2, Sh.a, Tiranë për vitin 2023.

-me shkresën nr.75 prot, datë 21.02.2025 është dërguar raportimi vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm dhe plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit në Rezidencën Studentore Universitare Nr.2, Sh.a, Tiranë për vitin 2024.

Raporti vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm për vitin 2024-2025, është hartuar në bazë të formatit të miratuar në Shtojcën 2 të Udhëzimit të Titullarit të Financave nr. 28, datë 15.12.2011.

Për të realizuar objektivat si dhe për të pasur një proces transparent monitorimi në varësi të titullarit të RSU-së është dhe struktura e auditimit të brendshëm. Kjo strukturë për vitin 2024 nuk ka funksionuar me kapacitet të plotë pasi është i lirë vendi për pozicionin “specialist” si dhe “përgjegjës sektori i komanduar për një pjesë të vitit 2024”, duke sjellë si pasojë që sektori të mos jetë eficient plotësisht.

5/2 Mbi auditimin e veprimtarisë së NJAB-së në RSU nr.2, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Struktura organike, baza e të dhënave/data baza mbi personelin;
- Plani strategjik dhe vjetor 2024 dhe 2025 me ndryshimet përkatëse;
- Deklarata dhe raporti për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të RSU-së, për vitin 2024 dhe 2025.
- Certifikatat për përfundimin e trajnimeve të vijueshëm profesional në zbatim Ligjit Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar.
- Dosjet e auditimit.

Auditimi iu referua akteve ligjore e nënligjore në vijim:

- Ligji Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar.
- Ligji Nr.152/2013“Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar;
- VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”;

-Manuali i “Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016,

Auditimi i këtij drejtimi auditimi u fokusua kryesisht në këto çështje:

☒ organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm/Komitetit të Auditimit dhe i njësisë të varësisë. Niveli profesional i audituesve, certifikimi i tyre dhe trajnimet e detyrueshme,

☒ bashkëpunimi me Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, niveli i raportimit në këtë drejtori,

☒ realizimi i treguesve të planifikuar nga DAB,

☒ sigurimi i brendshëm i cilësisë së auditimit,

me qëllim vlerësimin nëse veprimtaria e auditit të brendshëm është në përputhje me kriteret ligjore dhe standardet e auditimit, konkretisht Ligjin Nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, “Manualin e Auditimit të Brendshëm”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100 datë 25.10.2016, Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

Veprimtaria e Njesisë së Auditimit të Brendshëm në shoqërinë, RSU nr.2.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në RSU nr.2, ushtron veprimtarinë audituese referuar ligjit nr.114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016; Kartën e Auditimit të Brendshëm të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me nr. 229/2 datë 23.10.2024; Kodin e Etikës të miratuar me vendim të KM si dhe të Administratorit të shoqërisë me nr.747 datë 20.09.2028 “Për miratimin e Kodit të etikës në RSU nr.2, SH.A”.

Struktura dhe organika e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (DAB) në RSU nr.2, e miratuar sipas Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr.11, datë 27.10.2023 si dhe urdhri i Administratorit nr .77, datë 30.10.2023 “Për miratimin e strukturës e organikës në RSU nr.2”, ka në organikë 3 punonjës nga të cilët: Përgjegjësi i njesisë dhe 2 specialistë (auditues).

Struktura për vitin 2025 është e plotësuar dhe nuk ka vende vakant. Ndërsa për vitin 2024, për shtatë mujorin e parë ka qenë e paplotësuar dhe në strukturë ka pasur një përgjegjës të komanduar dhe një specialist. Në gusht 2024, kjo strukturë është plotësuar.

Kjo njësi ka varësi organizative nga Këshilli Mbikëqyrës.

Profili profesional i audituesve është financiar.

Përgjegjësi i NJAB-së dhe një nga specialistët janë të certifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik, ndërsa specialisti tjetër është në fazë pranimit pasi ka kryer kursin përkatës. Trajnuesit kanë zhvilluar trajnimin e vazhdueshëm vjetor, të certifikuar nga MF (listuar në faqen zyrtare të MF) sipas kuadrit ligjor e rregullator (Ligjit nr.114, datë 22.10.2015 Neni 20 Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm) .

Organizimi i punës audituese

RSU nr.2 ka 5 Drejtori, objekt auditimi të cilat janë:

- Drejtoria Juridike & Burimeve Njerëzore (1+8);
- Drejtoria Ekonomike & Shërbimeve Mbështetëse (1+19);
- Drejtoria Hoteleri (1+ 38);
- Drejtoria Teknike (1 +35);
- Drejtoria Mirë administrimit (1+44);

Prioritetet e sektorit të auditimit në zbatim të kërkesave të ligjit për auditimin dhe rekomandimeve sipas Planit strategjik 2024-2026, në RSU sha, janë:

a. Identifikimi i sistemeve dhe fushave të llogarisë.

Struktura e Auditit të Brendshëm është në nivel sektori dhe është miratuar në vitin 2022. Auditimi i Brendshëm, ka mundur të njohë mjedisin në të cilin vepron dhe risqet kryesore që

ka, duke bërë të mundur identifikimin e risqeve dhe siguruar hartimin e një plani auditimi vjetor dhe strategjik gjithëpërfshirës, eficient dhe produktiv.

b. Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve.

Gjatë hartimit të planit strategjik 2024 – 2026, nga NJAB janë planifikuar për t'u audituar subjekte me risk të lartë, të mesëm, e me risk të ulët. Në planifikimin e nivelit të risqeve, janë bazuar në kompleksitetin e subjektit objekt auditimi, fushat e veprimtarisë, buxhetin, burimet njerëzore, periudhën e audituar, gjetjet e mëparshme të auditimit etj. Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve është bërë bazuar në gjykimin profesional të audituesve të brendshëm.

c. Programimi i veprimtarive, frekuencat e auditimeve dhe parashikimi i tyre sipas llojit dhe periudhës së kryerjes.

Pas identifikimit dhe analizës së sistemeve dhe fushave të llogarive, është përcaktuar frekuenca dhe afatet kohore për misionet e auditimit. Në planin strategjik është përfshirë auditimi me frekuencë njëherë në vit. Gjithashtu në planin strategjik, është parashikuar edhe auditim mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme deri në muajin mars të vitit pasardhës si dhe auditimi mbi detyrimet e prapambetura deri në muajin dhjetor të vitit pasardhës gjatë kryerjes së auditimeve.

Bazuar në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në vitin e parë janë parashikuar subjektet dhe fushat e vlerësuara me risk të lartë dhe të mesëm, po ashtu edhe në vitin e dytë dhe të tretë janë parashikuar të auditohen subjekte me risk të lartë dhe të mesëm duke respektuar edhe afatet e nevojshme të auditimit.

Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve nga NJAB, është bërë duke marrë parasysh disa faktorë si më poshtë:

1. Përgjegjësia e manaxhimit duke marrë në konsideratë mos zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.
2. Cilësia e sistemeve të kontrollit të brendshëm.
3. Përputhshmëria me bazën ligjore dhe rregullative.
4. Madhësia e subjektit të audituar.
5. Kompleksitetin e transaksioneve.
6. Mbikëqyrje e dobët e manaxhimit.

Për vitin 2024, me miratimin e KM (Këshilli Mbikëqyrës) sipas Vendimit nr. 02, datë 26.01.2024, është miratuar plani vjetor i angazhimeve për auditin e brendshëm me nr. 28/1 prot, datë 16.01.2024, ku janë përcaktuar 8 misione auditimi të cilat janë të paraqitura në tabelën në vijim:

Tabela 1: Programi i veprimtarisë vjetore të NJAB-së dhe realizimi i tij për vitin 2024

Nr	Subjekt	Nr. njoftimi	Nr. Datë, Projekt raport	Nr, datë RPA
1	Auditim mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme	Nr.70 prot Datë 01.03.2024	Nr.70/2 prot Datë 08.03.2024	Nr. 70/4 prot Datë 18.03.2024
2	Drejtorja e Hotelarisë	Nr. 256 prot Datë 27.11.2024	Nr.256/5 prot Datë 27.12.2024	Nr.256/7 prot Datë 30.12.2024
3	Drejtorja Teknike	Nr.234 prot Datë 22.10.2024	Nr.234/5 prot Datë 27.10.2024	Nr.234/8 prot Datë 25.11.2024
4	Drejtorja Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.			
5	Drejtorja Juridike dhe Burimeve Njerëzore.	Nr.192 prot Datë 11.09.2024	Nr.192/5 prot Datë 07.10.2024	Nr.192/8 prot Datë 14.10.2024
6	Drejtorja e Mirëadministrimit			

7	Auditim mbi sistemin e detyrimeve të prapambetura			
8	Auditim mbi sistemin e prokurimeve	Nr. 93 prot Datë 04.04.2024	Nr. 93/3 prot Datë 05.06.2024	Nr. 93/5 prot 11.06.2024

Punoi grupi i auditimit

Për vitin 2025, NJAB ka përgatitur propozimin në KMSH për miratimin e programit vjetor të veprimtarisë së SAB-së me nr.30/1, datë 15.01.2025, i cili ka marrë miratim sipas Vendimit nr.04, datë 22.01.2025 dhe firmosur nga anëtarët e KMSH (DH.F, K.L, E.O) ku janë përzgjedhur 9 misione auditimi të paraqitura në tabelën në vijim:

Tabela 2: Programi i veprimtarisë vjetore të NJAB-së dhe realizimi i tij për vitin 2025

Nr	Subjekt	Nr. njoftimi	Nr. Datë, Projekt raport	Nr, datë RPA
1	Auditim mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme	Nr.30/3 prot Datë 13.02.2025	Nr.30/8 prot Datë 10.03.2025	Nr.30/10 prot Datë 13.03.2025
2	Auditim mbi sistemin e prokurimeve	Nr.104 prot Datë 04.04.2025	Nr.104/5 prot 08.05.2025	Nr.104/8 Datë 19.05.2025
3	Drejtoria e Mirëadministrimit	Nr.134 prot Datë 23.05.2025	Nr.134/5 prot Datë 11.07.2025	Nr.134/7 prot Datë 14.07.2025
4	Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.	Nr.176 prot Datë 11.8.2025	Nr.176/5 prot Datë 22.09.2025	Nr. 176/7 prot Datë 28.09.2025
5	Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore.	Nr.225 prot Datë 15.10.2025	Nr.225/5 prot Datë 10.11.2025	Nr.225/7 prot Datë 21.11.2025
6	Drejtoria e Hotelerisë			
7	Drejtoria Teknike	Nr.239 prot Datë 18.11.2025	Në proces	
8	Auditim mbi sistemin e detyrimeve të prapambetura			
9	Auditim mbi sistemet e TI			

Punoi grupi i auditimit

Plani Vjetor dhe Plani Strategjik

Raporti mbi hartimin e Planit Vjetor dhe planit Strategjik së bashku me pasqyrat mbështetëse, për vitin 2024-2026 dhe 2026-2028, janë përcjellë brenda afatit të KMSH (brenda datës 30 shtator të vitit 2023 dhe 30 shtator të vitit 2025) si dhe te Drejtoria e Harmonizimit sipas Manualit të auditimit të brendshëm, Kap. III. “Planifikimi i veprimtarive të auditimit të brendshëm” pika 3.3:

“Afati i përgatitjes dhe miratimit të planit strategjik dhe planit vjetor”.

a. Konkretisht Plani strategjik 2024-2026 është dërguar në MFE/DHAB me shkresën nr 257/5, datë 17.10.2023.

b. Propozimi për planin strategjik 2026-2028 dhe planit vjetor

2026 drejtuar KMSH është kryer brenda afatit të përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave Nr.100 datë 25.10.2016, Kap. III. “Planifikimi i veprimtarive të auditimit të brendshëm” pika 3.3, sipas shkresës me nr 207/2 prot datë 24.09.2025 si dhe është miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me shkresën nr.207/4, datë 13.10.2025. Është dërguar në MFE sipas shkresës me nr. 207/6 datë 16.10.2025, brenda afatit ligjor.

Raportimi i veprimtarisë audituese të Drejtorisë së Auditimit

Raportimi i veprimtarisë vjetore pranë strukturës përgjegjëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit është kryer referuar ligjit nr.114, datë

22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 14 germa “ç”, Manuali i Auditimit të Brendshëm i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave Nr.100 datë 25.10.2016, Kap. IV “Kryerja e auditimit të brendshëm, ndjekja e procedurave dhe raportimi e komunikimi i auditimit” dhe shkresat përkatëse vjetore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Së bashku me paketën raportuese është dërguar edhe pyetësori i vetëvlerësimit të AB.

Raportimi i veprimtarisë audituese për vitin 2024, është dërguar nga NJAB në KMSH me nr. prot 29/1 datë 15.01.2025, si dhe elektronikisht dhe në mënyrë shkresore sipas shkresës me nr. 29/3 prot, datë 04.02.2025 pas miratimit nga këshilli Mbikëqyrës, është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në MFE.

Në lidhje me realizimin e planit vejtör të auditimeve për vitin 2024 si dhe raportin vjetör të dërguar në DHAB, u konstatua se:

Plani vjetör për vitin 2024 ka pasur si objektiv kryerjen e 8 auditimeve, dhe nga këto janë realizuar 5 auditime ose 62 % e planifikimit.

Nuk ka argumentim në raportimin vjetör për arsyet e mos realizimit të planit vjetör të auditimeve, në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, kapitulli III, pika 3.5, ku përcaktohet qartë se: *Ndryshimet në planin vjetör të Auditimit të Brendshëm duhet të arsyetohen me shkrim nga drejtuesi i NJAB, ndryshime të cilat miratohen nga titullari i njësisë, pasi të jetë marrë edhe mendimi i Komitetit të Auditimit, në rastin konkret i Këshillit Mbikëqyrës.*

“Të gjithë planet vjetore dhe strategjike të rishikuar të auditimit të brendshëm duhet t’i dërgohen strukturës përgjegjëse të harmonizimit për AB-në, së bashku me shpjegimet e ndryshimeve të bëra”.

Referuar Ligjit Nr.114/2015 i ndryshuar, në nenin 14, germa “ç”, përcaktohet se “Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm është përgjegjës për:

ç) Përgatitjen e raportit vjetör, i cili i dërgohet strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm dhe përmban të dhënat e mëposhtme, por nuk kufizohet vetëm në to”.

Sipas raportit vjetör për vitin 2024, nga NJAB janë cituar në seksionin 5.3, Gjetjet Kryesore sipas sistemeve, ku kanë rezultuar:

a. Mbi auditimin për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Sektori i Auditimit të Brendshëm gjatë auditimeve të mëparshme.

Nga auditimi rezultoi që nga 3 rekomandimet të dhëna gjatë auditimeve të kryera për vitin 2023, 2 rekomandime janë zbatuar plotësisht brenda afateve dhe 1 rekomandim është në proces zbatimi.

b. Mbi sistemet e Drejtorisë së Hotelerisë.

- Nga kontrolli i dosjeve të studentëve të akomoduar në godinat e sektorit të Inxhinierisë dhe të Mjekësisë, rezultoi që ka një numër të lartë prej tyre që kanë pagesa me këste, ku pjesa më e madhe e tyre kanë kryer pagesën e kuotës së qirasë në dy këste. Pagesa e kuotës së qirasë me këste mund të çojë në largimin e studentëve nga godinat para përfundimit të vitit akademik dhe mos realizimin e të ardhurave të planifikuara në fillim të vitit akademik.

- Nga kontrolli i ushtruar në dokumentacionin e dosjeve të studentëve në godinat e sektorit të Inxhinierisë rezulton se kontratat për studentët të cilët kanë bërë pagesën e qirasë me këste kanë kontratë vetëm për periudhën dy mujore, ndërsa për periudhën tjetër nuk kanë kontratë.

c. Mbi sistemet e prokurimeve në RSU Nr.2.

- Në pjesën më të madhe të procedurës të audituar në hartimin e urdhrin të prokurimit mungojnë elementët e përcaktuar në Nenin 77 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Për gjetjet e mësipërme janë dhënë rekomandimet respektive për çdo mision angazhim auditimi. Sektori i Auditimit të Brendshëm në Rezidencën Studentore Universitare Nr.2, Sh.a, Tiranë ka rekomanduar si më poshtë:

Mbi auditimin për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Sektori i Auditimit të Brendshëm gjatë auditimeve të mëparshme:

Nga ana e subjekteve të audituara të zbatohen të gjitha rekomandimet e lëna brenda afateve të përcaktuara.

Mbi sistemet e Drejtorisë së Hotelerisë:

Pagesat e kuotave të qirasë të kryhen të plota për 10 muajt e parashikuar të vitit akademik.

Për rastet specifike të kërkohet dokumentacion justifikues.

Lista e dokumenteve për rrethanat lehtësuese në të cilat ndodhen studentët për kryerjen e pagesës duhet ti bashkëlidhet rregullores së procedurës së akomodimit.

Të merren masa të menjëhershme që për të gjithë studentët që iu ka përfunduar kontrata e qirasë ose atyre që rezultojnë pa kontratë qiraje të plotësojnë kontratat e reja sipas kontratës tip të miratuar sipas shkresës nr. 169/4 datë 15.08.2024, Neni 19 pika 9.3.

Mbi sistemet e prokurimeve në RSU Nr.2:

Nga ana e personave përgjegjës për prokurimin të hartohet urdhri i Prokurimit duke vendosur përveç objektit të prokurimit, shumën e llogaritur të fondit limit llojin e procedurës së zgjedhur për prokurim bashkë me arsyet e kësaj zgjedhjeje si dhe emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit duke evidentuar personin përgjegjës apo edhe specialistin e fushës.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna drejtorive të sipërcituara, nga evidencat statistikore të marra nga NJAB, ka rezultuar se statusi i zbatimit të rekomandimeve paraqitet si më poshtë vijon:

Auditimi i dosjeve të auditimit kryer nga DAB në Rezidencën Studentore Universitare Nr.2, sha (këtu e më poshtë RSUNr.2 sha)”.

Grupi i auditimit duke pasur në fokus gjetjet e konstatuara në subjektet e audituara në vitin 2024 dhe 2025, zgjodhi të auditojë dosjet të cilat janë vlerësuar nga NJAB me nivel të lartë risku siç janë:

1. Dosja e auditimit të kryer në Rezidencën Studentore Universitare Nr.2, sh.a në Drejtorinë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, viti 2024;
2. Dosja e auditimit të kryer në Rezidencën Studentore Universitare Nr.2, sh.a në Drejtorinë Teknike 2024;
3. Dosja e auditimit të kryer në Rezidencën Studentore Universitare Nr.2, sh.a në Drejtorinë e Mirë administrimit viti 2025;
4. Dosja e auditimit të kryer në Rezidencën Studentore Universitare Nr.2, sh.a në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse viti 2025;

1. Nga auditimi i dosjes së auditimit të kryer në Rezidencën Studentore Universitare Nr.2, sha në Drejtorinë Juridike dhe Burimeve Njerëzore.

Auditim me zgjedhje, për periudhën 30.09.2023-31.08.2024, për probleme të veçanta periudha të mëparshme:

☞ mungon Dokumenti Standard “Takimi ballafaques/përmyllës”, jo në përputhje me Manualin e auditimit, Kap. VI, pika 8.

Nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer, rezulton se qëllimi i auditimit është vlerësimi i sistemeve:

☞ kontrolli i brendshëm për menaxhimin e riskut; zbatimin e ligjshmërisë

☞ menaxhimi i burimeve njerëzore për respektimin e strukturës organike të miratuar; administrimin e dosjeve personale, regjistrin themeltar të punonjësve; vlerësimin e performancës së punonjësve; mbajtjen, përpunimin dhe shfrytëzimin e dokumentacionit në arkivë.

Me shkresën Nr.192 prot, datë 11.09.2025 është njoftuar mbi fillimin e angazhimit të auditimit Mbi sistemet e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore.

Me shkresën Nr.192/1 prot, datë 11.09.2025 është hartuar programi i Auditimit të Përputhshmërisë, Auditim mbi sistemet e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore. Afati i auditimit është përcaktuar **12.09.2024 deri në 19.09.2024**.

Auditimi është kryer nga:

1. A.R, përgjegjës grupi;
2. P.K, anëtar;
3. M.LL, anëtar.

Disa nga gjetjet e konstatuara nga NJAB të vlerësuar me risk të lartë sipas sistemeve për:

☞ Sektori i Auditimit të Rezidenca Studentore Universitare Nr.2. Tiranë ka audituar Drejtorinë Juridike dhe Burimeve Njerëzore duke i kushtuar vëmendje të veçantë sistemeve të burimeve njerëzore dhe përputhshmërisë së veprimtarisë së kësaj drejtorie me procedurat dhe rregullat me mjedisin e kontrollit të brendshëm, legjislacionin në fuqi, rregulloren e brendshme, kodin e etikës, identifikimin e mangësive dhe ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese. Duke pasur parasysh edhe misionin e shoqërisë, kjo drejtori zë një peshë të madhe në strukturën përgjegjëse për rekrutimin, selektimin, formimin profesional, trajnimin e stafit të cilat bëjnë të mundur funksionimin normal të shoqërisë.

Për periudhën e audituar vëmendja kryesore është vendosur te nënsistemet e burimeve njerëzore përgjithësisht te pesë treguesit kryesorë por edhe në tregues specifikë të dalë gjatë procesit të auditimit. Nga auditimi i mëparshëm i kryer, **1 (një) masë e rekomanduar nuk është realizuar**.

☞ *Struktura e burimeve njerëzore dhe efektiviteti i funksionimit:*

Me anë të Vendimit me Nr. 11, datë 27.10.2023 prot me Nr. 287/1 prot, datë 27.10.2023 të Këshillit Mbikëqyrës së shoqërisë është miratuar struktura bashkë me kriteret e rekrutimit për secilin pozicion të punës. Është miratuar fondi i pagave si dhe efektet financiare të cilat shtrihen nga data 01.01.2024 në Rezidencën Studentore Universitare nr.2. Sha, Tiranë. Struktura e miratuar e shoqërisë ka një numër prej 156 punonjësish ku në këtë periudhë shoqëria R.SU, Nr. 2 sha ka të punësuar 151 punonjës. Nga këto pozicione pune, 3 vende janë të karakterit teknik, arsimit mesëm profesional (1 elektromekanik, 1 elektrikist, 1 punonjës gjelbërimi) dhe dy vende vakant, ku kriter kryesor është arsimit i lartë.

Në Kodin e Etikës të shoqërisë janë përcaktuar rregullat dhe mënyra e sjelljes në punë për punonjësit në ushtrimin e veprimtarive të brendshme dhe të jashtme në punë, për mënyrën e sjelljes dhe komunikimit me eprorët, vartësit, studentët dhe publikun sipas përcaktimeve të akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi. Referuar vendimit të Këshillit Mbikëqyrës me nr. 15, datë 20.12.2022 me nr. Prot, 400/1 datë 20.12.2022, në Rregulloren e Brendshme të shoqërisë janë të përcaktuara qartë dhe plotësisht procedurat dhe proceset e punës. Çdo vit është kryer procesi i vlerësimit të punës së punonjësve. Është hartuar një plan trajnimesh, zbatueshmëria e të cilit është ndjekur nga specialisti i trajnimeve dhe raportuar tek eprorët. Nga ana e specialistit të trajnimeve është kryer trajnimi i personelit të Drejtorisë së Administrimit, Drejtorisë së Hotelerisë,

☞ **Mbi menaxhimin e Burimeve Njerëzore, zbatimi i organikës në shoqëri.**

Procedurat e rekrutimit, emërimit dhe largimit të stafit janë kryer bazuar në ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Po ashtu niveli i pagës së punonjësve është përcaktuar në strukturën e vitit 2023 sipas ligjit nr.35/2023 "Për kompetencat përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucioneve e administratës Publike. Aktualisht, sipas strukturës së miratuar janë të plotësuar 151 pozicione dhe janë vakante 5 pozicione. Deri në plotësimin e vendeve vakant,

puna është mbuluar nga stafi ekzistues, nën mbikëqyrjen e Administratorit dhe drejtorëve të drejtorive nga të cilët është bërë edhe shpërndarja e punës. Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të punonjësve të rekrutuar rezultoi se stafi ishte i punësuar në përputhje me kriteret e vendosura për punësimin, si diplomimi, vjetërsia në punë etj. Regjistri themeltar i punonjësve është mbajtur sipas dispozitave në fuqi të Kodit të Punës dhe për periudhën nën auditim mbaron me numrin e punonjësit 667. Janë regjistruar kronologjikisht punonjësit aktual të shoqërisë, si dhe punonjësit që kanë qenë në punë dhe janë zëvendësuar me punonjës të tjerë. Në ndarjen e detyrave rezultoi që drejtorja i ka të ndara qartë funksionet dhe nuk janë konstatuar mbivendosje.

▣ Mbi zbatimin e detyrave të sektorit juridik.

Në intervalin e periudhës nën auditim rezultojnë tre çështje gjyqësore të përfunduara ku për dy çështje është kryer ekzekutimi i vendimit ndërsa për një çështje tjetër nga ana e gjykatës nuk është zbardhur vendimi i gjykatës. Ankimimet dhe rekursat janë kryer brenda afateve si dhe janë kryer në të gjitha shkallët e gjyqësorit.

▣ Opinioni i përgjithshëm: Grupi i auditimit për përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore arrin në konkluzionin se veprimtaria e kësaj drejtorie është në përputhje të plotë me kuadrin rregullator si dhe ligjet në fuqi.

▣ Mbi veprimtarinë e Protokoll – Arkivës:

Nga auditimi i veprimtarisë së Protokoll Arkivës, është konstatuar se librat e protokollit ishin mbajtur dhe plotësuar konform kërkesave të ligjit nr 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", VKM nr.4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njehsuar të punës me dokumentet ne Autoritetet Publike", Rregullores së normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në RSH, së hartuar nga Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave (DPA). Ishte hapur Libri postës ku në të pasqyrohen: Në zyrën e protokollit janë kryer veprimet për pranimin, evidentimin, shpërndarjen dhe nisjen e korrespondencës. Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre kanë marrë në regjistrin e korrespondencës numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që është krijuar nga vetë shoqëria apo që ka ardhur në adresë të saj, ka marrë numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me praktikën janë evidencuar me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës. Nuk janë konstatuar dy ose më shumë praktika të përafërta që janë të pavarura ndërmjet tyre sipas objektit me të njëjtin numër rendor. Janë hapur dosjet sipas pasqyrës emërtuese të çeljes së tyre dhe janë vendosur dhe sistemuar në to, në mënyrë të vazhdueshme, dokumentet që krijohen e vijnë gjatë vitit po ashtu është siguruar dorëzimi i plotë dhe në kohë i dokumenteve që krijohen apo hyjnë.

Me anë të Urdhrit nr. 72, datë 12.10 2023 prot. nr.276 datë 12.10.2023 të dalë nga Administratori, specialisti i protokollit i ngarkuar me punën me dokumentet administron edhe vulat e shoqërisë.

Sipas Urdhrit nr. 224 prot., datë 10.06.2021 është caktuar punonjësi i cili do të kryejë detyrat e specialistit të protokollit në rast mungese të përkohshme. Përpilimi, shtypja dhe shumëfishimi i dokumenteve është bërë brenda mjediseve zyrtare të shoqërisë. Dokumentet dalëse nga shoqëria kanë të paraqitur, Stemën e Republikës së Shqipërisë, intestimin Republika e Shqipërisë, emërtimin e shoqërisë, numrin e regjistrimit të korrespondencës, vendin dhe datën, shkurtimin e lëndës, adresën e korrespondentit, formulën në përgjigje" ose "në vijim të shkresës, funksionin, emrin dhe mbiemrin e personit që nënshkruan dhe nënshkrimin e tij, si dhe vulën. Data dhe numri i protokollit janë vendosur pas firmosjes nga Titullari. Po ashtu edhe dokumentet e brendshme të përpiluara kanë të paraqitura të gjithë elementët e dokumenteve dalëse, me përjashtim të adresës së korrespondentit dhe të formulës në përgjigje" ose në vijim të shkresës". Dokumentet e brendshme i janë paraqitur titullarit për firmë apo njohje pasi janë protokolluar. Me Urdhrit Nr.96 datë 29.12.2023 protokolluar me Nr.344 datë 29.12.2023, është ngritur Komisioni i Ekspertizës brenda ditës së 10-të të punës së çdo fillim viti. Nga ana

e komisionit të Ekspertizës të vlerës së ruajtjes së dokumenteve është miratuar tabela përkatëse, ku ky komision nëpërmjet relacionit që mban nr. prot. 344/2 date 24.01.2024 ka vënë në dijeni Administratorin e Shoqërisë. Nga ana e punonjësit të arkivës është bërë dorëzimi i dokumenteve arkivorë, sipas ligjit 9154 datë 06.01.2003 neni nr. 42 të këtij ligji. Dokumentet janë dorëzuar në bazë të kërkesës së arkivës për dorëzim që mbanë nr. prot.294/5 datë 21.11.2023.

Nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer ka rezultuar se për gjetjet e konstatuara në këtë subjekt nga NJAB nuk është lënë rekomandim nga grupi i auditimit për përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore dhe kanë arritur në konkluzionin se veprimtaria e kësaj drejtorie është në përputhje të plotë me kuadrin rregullator si dhe ligjet në fuqi.

Sigurimi i brendshëm i cilësisë është realizuar nga përgjegjësi i grupit të auditimit dhe nga Drejtori i NJAB pas përfundimit të punës në terren, pas raportimit tek titullari i subjektit të audituar dhe Këshilli Mbikëqyrës, për realizimin e angazhimit të auditimit të brendshëm në subjektin përkatës.

Kontrolli i cilësisë është kryer, duke evidentuar dhe sqaruar gjetjet dhe rekomandimet mbas përgatitjes së raportit përfundimtar të auditimit. Procedura e vlerësimit të cilësisë, mbulon aspekte të veprimtarisë së NJAB, duke përfshirë objektivin, vlerësimin e riskut, planifikimin, zbatimin e angazhimeve, raportimin, trajnimin, etj.

2. Dosja e auditimit të subjektit në Rezidencën Studentore Universitare Nr.2, sh.a, për auditimin e kryer në Drejtorinë Teknike, viti 2024.

☞ Mungon Dokumenti Standard “Takimi ballafaques/përmbyllës”, jo në përputhje me Manualin e auditimit, Kap. VI, pika 8, me Drejtorinë Teknike 2024.

Nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer, rezulton se qëllimi i auditimit është vlerësimi i sistemeve:

☞ planifikimi i investimeve dhe materialeve ndërtimore;

☞ kryerja e punimeve në objekte për vënien e tyre në shërbim të studentëve dhe garantimi i kushteve optimale të ambienteve të brendshme dhe të jashtme të rezidencës;

☞ menaxhimi i shpenzimeve të materialeve ndërtimore si dhe mbi zbatimin e detyrave të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme;

☞ Të tjera probleme që dalin gjatë procesit të auditimit lidhur me zbatim e programit.

Me shkresën Nr.234 prot, datë 22.10.2024 është njoftuar mbi fillimin e angazhimit të auditimit “Mbi sistemet e Drejtorisë Teknike 2024”.

Me shkresën Nr.234/1 prot, datë 22.10.2024, është hartuar programi i Auditimit të Përputhshmërisë, Auditim mbi sistemet e Drejtorisë Teknike. Afati i auditimit është përcaktuar nga **01.11.2024 deri në 10.11.2024**.

Auditimi është kryer nga:

1. A.R përgjegjës grupi;
2. P.K, anëtar;
3. M.LL, anëtar.

Metodat e auditimit, bazuar në llojin e auditimit me zgjedhje.

Disa nga gjetjet e konstatuara nga NJAB, të vlerësuar me risk të lartë sipas sistemeve, si më poshtë:

Grupi i auditimit i "Rezidenca Studentore Universitare nr. 2" Tiranë, ka audituar zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë në Drejtorinë Teknike për vitin 2024, duke i kushtuar vëmendje të posaçme çështjeve që lidhen me zbatimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e kësaj drejtorie. Është audituar në drejtimet kryesore të renditura si më poshtë vijon:

- ☒ Kryerja e punimeve në objekte për vënien e tyre në shërbim të studentëve dhe garantimi i kushteve optimale të ambienteve të brendshme dhe të jashtme të Rezidencës;
- ☒ Menaxhimi i shpenzimeve të materialeve ndërtimore;
- ☒ Mbi zbatimin e detyrave të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme;
- ☒ Ndërthurja me sektorë të tjerë të RSU Nr.2.

Kriteret e vlerësimit: Në vlerësimin e mekanizmave të kontrollit, janë marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

☒ Zbulimi i gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve, të cilat mund të ndodhin. Procedurat e mekanizmave të kontrollit, që i shërbejnë parandalimit dhe zbulimit të këtyre gabimeve, të metave, parregullsive dhe shkeljeve.

☒ Nëse janë miratuar procedurat e duhura dhe nëse niveli i respektimit të tyre është i kënaqshëm. Anët e dobëta të mekanizmave ekzistuese të kontrollit, që çojnë në mos zbulimin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve prej tyre.

Auditimi është kryer në përputhje me Kodin Etik dhe Standardet duke përfshirë testimet dhe procedurat që mendojmë se janë të nevojshme, për të dhënë një vlerësim objektiv, profesional dhe të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë të Drejtorisë Teknike, konform me parimet, normat, rregullat dhe legjislacionin në fuqi.

☒ Udhëzime të tjera, akte ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në zbatim të "Planit vjetor të sektorit të auditimit të brendshëm për vitin 2024 miratuar nga këshilli Mbikëqyrës me anë të vendimit Nr. 02 datë 26.01.2024 prot. Nr.28/2 date 26.01.2024 objekt i auditimit është dhe veprimtaria e "Drejtorisë teknike". Kjo drejtori sipas strukturës është e organizuar në një drejtor dhe pesë përgjegjës/ sektori sipas specifikave të çdo sektori.

Për vitin 2023-2024 kjo drejtori ka të përcaktuar edhe objektivat për funksionimin normal të administrimit dhe mirëmbajtjen e ambienteve akomoduese si terreneve sportive, etj.

Nga objektivat kryesorë për vitin 2023 dhe vitin 2024 është:

Mirë administrimi dhe mirëmbajtja e të gjithë sistemeve në funksion.

Po ashtu nga ana e kësaj drejtorie janë aplikuar programe trajnimi ku punonjësit e trajnuar kanë trajnuar punonjësit e pa trajnuar. Drejtoria teknike për periudhën objekt auditimi ka mbajtur në gjendje optimale të gjitha sistemet duke ndjekur në kohën të gjithë defektet teknike në ambientet e shoqërisë, duke organizuar kontrolle të vazhdueshme për mirëfunksionimin e të gjitha sistemeve si atyre mekanike po ashtu edhe ato elektrike.

Evidentimi në kohë i defekteve dhe riparimi i tyre ka bërë që kjo drejtori bashkë me stafin teknik të sigurojnë mbarëvajtjen e punës, duke siguruar kushte optimale për trajtimin e akomodimin e studentëve. Si rezultat i njohjes së sistemit nga ana e kësaj drejtorie kanë funksionuar sistemi i ajrimit dhe kondicionimit, sistemi hidraulik, funksionimi i paneleve diellorë, funksionimi i chillerave, sistemi i rrjetit CCTV, sistemi i detektimit të zjarrit, sistemi BMS, përdorimi me efikasitet të ujët të pijshëm si dhe energjisë elektrike.

Nga ana e shoqërisë është bërë e mundur edhe shërbimi për mirëmbajtjen nga kompani me të cilat kanë bërë të mundur mbarëvajtjen e chillerave dhe paneleve diellorë referuar kontratës me Nr.279/6 prot, datë 07.12.2023.

Duke qenë se materialet e përdorura në këto sisteme janë të një cilësie më të lartë, kjo ka sjellë edhe rritjen e kostove të nevojshme për mirëmbajtjen e tyre.

Në kërkesat e kësaj drejtorie është parashikuar edhe një rritje e shpenzimeve për konsumin e energjisë elektrike dhe ujit gjatë vitit 2023 dhe 2024 duke marrë parasysh futjen në funksionim të **tetë godinave të RSU2**. Drejtoria Teknike, ka drejtuar veprimtarinë për hartimin e politikave të zhvillimit të Rezidencës, kontrollit të investimeve të realizuara dhe veprimtarive të tjera në funksion të efektivitetit ekonomik financiar, konform ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

Drejtoria Teknike ka zbatuar gjurmët e auditit sipas shkresës nr. 334 datë 18.12.2023. Me anë të memos me nr.174 Prot, datë 29.05.2024, përgatitur nga ana e përgjegjësit të sektorit drejtuar Administratorit të shoqërisë është kërkuar blerje e materialeve për Materiale ndërtimi, elektrike ,hidraulike" si dhe pajisje për marangoz. Po ashtu me anë të memos me Nr. 29 prot, dhe memos Nr. 30 datë 16.01.2024 nga z. A M. Drejtor i Drejtorisë Teknike është kërkuar blerje "Lëndë djegëse pellet dhe blerje lëndë djegëse (Gazoil për kaldajat) për godinat Nr-1 dhe Nr-2, të fakultetit të Mjekësisë.

Drejtoria Teknike, ka drejtuar veprimtarinë për hartimin e politikave të zhvillimit të Rezidencës, kontrollit të investimeve të realizuara dhe veprimtarive të tjera në funksion të efektivitetit ekonomik financiar, konform ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi, vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës si dhe urdhrave të Administratorit të shoqërisë. Nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer ka rezultuar se nga analiza e punës u konstatua se janë kryer detyrat sipas kërkesave të rregullores së brendshme të shoqërisë. Nga grupi i auditit për periudhën e audituar është konstatuar performancë e mirë e Drejtorisë Teknike. Nuk janë zbuluar parregullsi gjatë kryerjes së veprimtarisë.

3. Dosja e auditimit të subjektit në Rezidencën Studentore Universitare Nr.2, sh.a (këtu e më poshtë RSUNr.2 sh.a)” për auditimin e kryer në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse:

☞ Mungon Dokumenti Standard “Takimi ballafaques/përmbyllës”, jo në përputhje me Manualin e auditimit, Kap. VI, pika 8, ndërkohë që në dosje duhet të ishte plotësuar Dokumenti përkatës nga RSUNr.2 sh.a duke shprehur qëndrimin e Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer, rezulton se qëllimi i auditimit është vlerësimi i sistemeve:

☞ Mbi vlerësimin e sistemit të kontabilitetit dhe raportimit financiar;

☞ Mbi sistemin e të ardhurave, veprimet me bankën dhe arkën;

☞ Mbi sistemin e pagave, mbi sistemin e menaxhimit të aktiveve, mbi miratimin dhe realizimin e programit ekonomik dhe financiar;

☞ Të tjera probleme që dalin gjatë procesit të auditimit lidhur me zbatim e programit.

Me shkresën Nr.176 prot, datë 11.08.2025 është njoftuar mbi fillimin e angazhimit të auditimit “Mbi sistemet e Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse”.

Me shkresën Nr.176/1 prot, datë 11.08.2025 është hartuar programi i Auditimit të Përputhshmërisë, Auditim mbi sistemet e Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse. Afati i auditimit është përcaktuar 11.08.2025 deri në 15.09.2025.

Auditimi është kryer nga:

1. A.R, përgjegjës grupi;

2. P.K, anëtar;

3. M.LL, anëtar.

Metodat e auditimit, bazuar në llojin e auditimit "i kombinuar" si dhe në sistemet e identifikuara për auditim, janë: Testimi hap pas hapi, Rishikim analitik dhe Rindërtimi i ngjarjeve.

Disa nga gjetjet e konstatuara nga NJAB të vlerësuar me risk të lartë sipas sistemeve si më poshtë:

Grupi i auditimit i "Rezidenca Studentore Universitare nr. 2" Tiranë, ka audituar zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë së Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse duke i kushtuar vëmendje të posaçme çështjeve që lidhen me:

- zbatimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e kësaj drejtorie, lidhur me hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomik-financiar,

-mbajtjen e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen, shqyrtimin dhe miratimin e bilanceve dhe saktësinë e tyre,

-rregullshmërinë dhe ligjshmërinë në evidentimin dhe pasqyrimin e shpenzimeve dhe të ardhurave; -Gjendjen, evidentimin, ndjekjen e sistemit të debi-kredive, mbi inventarizimin fizik të pasurisë, -zbatimin e dispozitave ligjore për detyrimet fiskale ndaj buxhetit të shtetit dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore;

-administrimin e marrëdhënieve të punës, zbatimin e dispozitave ligjore në dhëniet me qira, si dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Veç sa më sipër, është pasur në qendër të vëmendjes siguria e nivelit të menaxhimit. Për periudhën e audituar (Dhjetor 2023 deri Qershor 2025) është konstatuar performancë e mirë e Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Objektivi kryesor i "Rezidencës Studentore Universitare nr. 2" Tiranë, është:

☒ Vlerësimi nëse projekt programi i zhvillimit ekonomik është programuar, në përputhje me kriterin në fuqi dhe nëse programi i zhvillimit ekonomik është zbatuar sipas miratimit.

☒ Trajtimi i studentëve të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, të Mjekësisë, të Infermierisë dhe Universitetit të Sporteve Tiranë, për fjetje;

☒ Programi i zhvillimit ekonomik; sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhura dytësore; sistemi i menaxhimit të shpenzimeve; sistemi i kontabilitetit e raportit financiar, për periudhën Dhjetor 2023-Qershor 2025, për të vlerësuar kryerje veprimeve në përputhje me aktet ligjore në fuqi, si dhe saktësinë e regjistrimit financiar;

☒ Vlerësimi të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit;

☒ Auditimit të aktivitetit ekonomik financiar në mënyrë të përmbledhur.

Referuar periudhës së audituar, **Dhjetor 2023-Qershor 2025**, për auditimin e këtij sistemi janë përzgjedhur viti ushtrimor 1 janar- 31 dhjetor 2024.

Në funksionimin e sistemit të "Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Brendshëm ka rezultuar se:

☒ **Mjedisi i kontrollit:** Mjedisi i kontrollit përbën, integritetin personal dhe etiken profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjer të shoqërisë; politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësit dhe linjat e raportimit, politikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe të aftësive profesionale të punonjësve, planet strategjike apo vjetore të punës, delegimi i detyrave.

☒ **Menaxhimi i riskut:** Ka rezultuar se Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve mbështetëse ka hartuar Regjistrin e riskut për vitin 2024 dhe vitin 2025 të miratuar nga Administratori, ku është caktuar dhe koordinatori i riskut sipas urdhrin nr. 114 prot, datë 29.12.2022 2024.

Për rrjedhojë është bërë e mundur identifikimi dhe monitorimi i risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarisë.

☒ **Veprimtaria e kontrollit**

Në zbatim të nenit 22, pika 3, të ligjit 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" ka gjetur zbatim ndarja e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin kontabilitetin dhe kontrollin.

Të gjitha transaksionet financiare ishin me sistemin e dy nënshkrimeve, i cili nuk ka lejuar që angazhimi financiar të kryhet pa marrë nënshkrimet e nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues. Edhe pagesat e kryera janë bërë pas nënshkrimeve të nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues. Është konstatuar se procedurat për kontabilizimin e plotë të gjitha transaksioneve janë bërë në rregull.

☒ **Monitorimi:**

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të shoqërisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilën janë krijuar. Administratori si dhe Këshilli Mbikëqyrës informohej nga Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse me anë të relacioneve periodike.

Nëpunësi Zbatues, raporton tek Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori me anë të situacioneve buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin. Nëpërmjet shkresës 326/2 datë 26.02.2024 nga ana e subjektit është përgatitur dhe dërguar raporti vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm dhe plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit për komponentë të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Rezidencën Studentore Universitare nr 2 Sha. Bashkëlidhur shkresës nr. 75 prot, datë 21.02.2025 janë përgatitur deklaratat. Po kështu është përgatitur nga ana e Drejtorisë ekonomike dhe shërbimeve mbështetëse "Raporti mbi evidentimin e risqeve për vitin 2024 sipas memos nr.330 prot datë 18.12.2023". Në bazë të shkresës 257/1 datë 10.12.2024 është përgatitur regjistri i riskut për vitin 2025.

Nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer ka rezultuar se për gjetjet e konstatuara në këtë subjekt nga NJAB si dhe është lënë rekomandim që nga ana e Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse të merren masa në vazhdimësi për planifikimin sa më të saktë të buxhetit, detajimin e saktë të fondeve të akorduara, duke i dhënë prioritet financimit të nevojave parësore që ka shoqëria.

Gjithashtu të merren masa për realizimin e fondeve buxhetore sipas planit financiar të miratuar gjatë gjithë vitit.

4. Dosja e auditimit të subjektit në Rezidencën Studentore Universitare Nr.2, sha (këtu e më poshtë RSUNr.2 sha) ” për auditimin e kryer në Drejtorinë e Mirë administrimit, viti 2025:

☞ Mungon Dokumenti Standard “Takimi ballafaques/përmyllës”, jo në përputhje me Manualin e auditimit, Kap. VI, pika 8, ndërkohë që në dosje duhet të ishte plotësuar Dokumenti përkatës nga RSUNr.2 sha duke shprehur qëndrimin e Drejtorisë së Mirë administrimit.

Nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer, rezulton se qëllimi i auditimit është vlerësimi i funksionimit të sistemeve në Drejtorinë e Mirë administrimit. Përputhshmëria e veprimeve me rregullat dhe procedurat, mjedisi i kontrollit, risqet e përgjithshme me të cilat përballlet njësia që auditohet, identifikimi i mangësive dhe ndërmarrja e veprimeve korrigjuese:

- ☞ Miradministrimi i godinave;
- ☞ Rakordimet mbi pagesat e studentëve
- ☞ Mbi plotësimin e studentëve me bazë materiale;
- ☞ Ruajtja, kontrolli, dhe administrimi i bazës materiale;
- ☞ Kontrolli i dokumentacionit që del nga kjo drejtori duke filluar me memo, grafikët e receptionistëve dhe raportet e ndryshme;
- ☞ Realizimi i detyrave të caktuara në rregulloren e brendshme.

Me shkresën nr.134 prot., datë 23.05.2025, është njoftuar mbi fillimin e angazhimit të auditimit të përputhshmërisë “Mbi sistemet e Drejtorisë së Mirë administrimit”.

Me shkresën Nr.176/1 prot, datë 11.08.2025 është hartuar programi i Auditimit të Përputhshmërisë, Auditim mbi sistemet e Drejtorisë së Mirë administrimit. Afati i auditimit është përcaktuar nga data **04.06.2025 deri në 20.06.2025**.

Auditimi është kryer nga:

1. A.R, përgjegjës grupi;
2. P.K anëtar;
3. M.LL, anëtar.

Metodat e auditimit janë me zgjedhje.

Disa nga gjetjet e konstatuara nga NJAB sipas sistemeve janë si më poshtë:

☒ **Funksionimi organizativ, struktura, ndarja e detyrave dhe përgjegjësi,**

Vlerësimi i mjedisit të kontrollit, planifikimi dhe menaxhimi i riskut;

Veprimtaria e kontrollit, rregullat dhe procedurat e vendosura nga drejtuesit, në funksion të realizimit të objektivave, monitorimi i tyre si dhe vlerësimi i sistemit të drejtimit;

☒ Mbi zbatimin e detyrave të Rregullores në Drejtorinë e Mirë administrimit, mbi zbatimin e ligjit, dhe rregulloreve dhe procedurave të sektorëve, dokumentacioni i mbajtur për çdo rast;

☒ Mbi politikat e strehimit të akomodimit të studentëve, procedurat e strehimit dhe akomodimit, si dhe planifikimi i kapacitetit të strehimit;

☒ Mbi shërbimin ndaj studentëve, problemet e dala gjatë menaxhimit të tyre dhe administrimi i konvikteve.

Për periudhën e audituar (Janar 2024 - Maj 2025), është konstatuar performancë e mirë e kësaj drejtorie, e cila ka drejtuar veprimtarinë për hartimin e politikave të zhvillimit së bashku me stafin e saj të varësisë, gjatë periudhës së audituar, ka drejtuar politikat e strehimit dhe të akomodimit të studentëve në ambientet e sektorit Inxhinierisë dhe Mjekësisë.

Gjithashtu puna e saj është fokusuar edhe në mbarëvajtjen e godinave në drejtim të krijimit të kushteve optimale të jetesës për studentët duke bashkëpunuar ngushtë me Drejtorinë e Hotelerisë, Drejtorinë Teknike, si dhe drejtoritë e tjera të shoqërisë. Drejtoria e Mirë administrimit, së bashku me Drejtorinë Teknike kanë bërë të mundur mirëmbajtjen si dhe funksionimin e kuzhinave në sektorin e Inxhinierisë të cilat lehtësojnë studentët për një proces më të lehtë në gatim.

Janë hartuar planet vjetore, mujore, janë përcaktuar objektivat e planifikimit e zhvillimit. Drejtoria e Mirë administrimit, ka bashkëpunuar me Drejtorinë Teknike lidhur me:

☒ Kursimin e ujit dhe energjisë elektrike;

☒ Riparimin e defekteve në godina sipas specialiteteve;

☒ Strukturën organike të Drejtorisë së Mirë administrimit;

☒ Planifikimin e lejeve vjetore për punonjësit në varësi.

Nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer ka rezultuar se për dy gjetjet e konstatuara në këtë subjekt nga NJAB janë lënë 2 rekomandime, konkretisht:

Nga Drejtoria e Mirë administrimit:

-të merren masa në vazhdimësi të bashkëpunojnë me specialistin e hotelerisë , për rakordimin e pagesave të studentëve, plotësimin e dokumentacionit të tyre dhe ti raportojnë ato çdo datë pesë të muajit.

- të merren masa që të informohen punonjësit e recepsionit për rreziqet të cilët mund të ekspozohen në vendin e punës. Trajnimet teorike dhe praktike të kryhen gjatë orëve të punës. Trajnimi për mbrojtjen nga zjarri të kryhet sipas një programi.

Konkluzione:

Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar, kontrollit, u konstatua se:

Nuk është përditësuar rregullorja e brendshme e Institucionit, si rezultat i ristrukturimit, ku për periudhën në auditim rezulton se, struktura e fundit është miratuar sipas Vendimit të KM me nr.11, 27.10.2023, dhe rregullorja e fundit është miratuar sipas VKM me nr. 15, datë 20.12.2022.

Në këto kushte duhet të miratohej një Kod i ri Etike si dhe rregullore e re në bazë të ndryshimeve strukturore, e cila edhe sot në fund të 2025 nuk është përditësuar, veprime në kundërshtim me Ligjin 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Neni 9/ pika 4, Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues.

☒ Struktura organike nuk është plotësuar pasi vazhdon të ketë vende të lira/vakante, për

periudhën në auditim.

Nga verifikimi i procedurave të ndjekura për punësimin e punonjësve me Kod Pune, dhe verifikimi i faqes Web në RSU nr.2 rezulton se subjekti nuk ka shpallur vendet vakante për punësim në faqen zyrtare të internetit apo në mjete të tjera të aksesueshme publikisht. Kjo praktikë nuk është në përputhje me parimet e transparencës, barazisë dhe mos diskriminimit në punësim, të parashikuara në nenin 9 dhe nenin 10 të Kodit të Punës, sipas të cilave ndalohet çdo formë diskriminimi në punësim dhe garantohet trajtimi i barabartë i kandidatëve.

Mos shpallja e vendeve vakante kufizon konkurrencën e hapur dhe aksesin e barabartë të individëve të interesuar për punësim, duke cenuar parimet e praktikave të mira të administrimit të burimeve njerëzore.

Në lidhje me veprimtarinë audituese të NJAB në Rezidencën studentore Universitare Nr. 2, sha. Tiranë, për periudhën 2024-2025/09, u konstatua se:

- Dosjet e auditimeve për vitin 2024, nuk janë të inventarizuara dhe të arkivuara, në kundërshtim me Ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar.

-Në dosjet e përzgjedhura për auditim (2024-2025), mungon Dokumenti Standard “Takimi ballafaques/përmbyllës”, veprime jo në përputhje me Manualin e auditimit, Kap. VI, pika 8, ndërkohë që në dosje duhet të ishte plotësuar Dokumenti përkatës nga RSU Nr.2 SHA, duke shprehur qëndrimin e Drejtorive përkatëse të audituara.

Nuk janë paraqitur observacione në fazën e RPA-së, nga subjekti në auditim.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në Rezidencën Studentore Universitare nr. 2, SHA, është ndjekur i gjithë sistemi i pagesave që kanë të bëjnë me likuidimet e detyrimeve ndaj shoqërisë si dhe janë realizuar pagesat për detyrimet ndaj të tretëve dhe personelit të punësuar në shoqërinë. Pagesat ndaj të tretëve, janë likuiduar brenda afateve ligjore për të gjitha detyrimet e lindura në vitin 2024 ndaj Furnizuesit të Shërbimit Universal, Ujësjiellës Kanalizime Tiranë, furnitorit të gazoilit, peletit, siguracionit të automjeteve, taksës së automjeteve, taksat vendore etj. Gjithashtu Shoqëria duke qenë në një situatë likuiditeti më të mirë se vitet e kaluara, ka bërë të mundur likuidimin e detyrimeve të mbartura nga vitet e kaluara. Nga analizimi i zërit të furnitorëve rezulton se Rezidenca Studentore Universitare nr. 2 SHA, ka detyrime të prapambetura të krijuara në periudhën 2006-2014, në vlerën gjithsej 6,271,225 lekë. Këto detyrime përbëhen nga:

- Një detyrim në vlerën 4,504,079.00 lekë ndaj UKT SHA, i cili në kontabilitet rezulton i krijuar në vitet 2006-2007. Nga auditimi konstatohet se nuk ka një rakordim me Ujësjiellës Kanalizime Tiranë, me qëllim saktësimin e këtij detyrimi.

- Detyrime të tjera të krijuara në vitet 2011-2014 janë detyrime të cilat janë lënë në formën e garancisë për punimet që ka kryer secili operator ekonomik pranë shoqërisë “Trajtim Studenti Nr.2” në vlerën 1,767,146 lekë, pasi ata nuk kanë paraqitur kërkesën për çlirimin e vlerave të garancisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 12-22, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria Shërbimeve Mbështetëse e Rezidencës Studentore Universitare Nr.2 Tiranë, në bashkëpunim, të marrin masa të kryejnë analizimin dhe rakordimin e zërit të furnitorë, për detyrimet e prapambetura të krijuara, në vlerën prej 6,271,225 lekë, kryesisht me Ujësjiellës Kanalizime SHA Tiranë e furnitorë t tjerë për saktësimin, likuidimin dhe trajtimin ligjor e kontabël të tyre.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, me shkresën nr. 253/5 prot, datë 19.10.2023 “Relacioni shpjegues i projekt programit të zhvillimit ekonomik për vitin 2024 të Shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare nr. 2” Sha” Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Këshillin Mbikëqyrës Mbështetëse i ka dorëzuar relacionin Administratorit 4 ditë me vonesë dhe jo sipas afatit të përcaktuar në Urdhrin nr. 64, datë 18.09.2023 “Për ngritjen e Grupit të punës për përgatitjen e projekt programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë për vitin 2024”.

Gjithashtu, konstatohet se lidhur me realizimin e programit Janar-Dhjetor 2024, realizimi total i tij është 75%, ku zërat e programit me më pak realizim paraqiten si më poshtë:

- “Mallra, materiale të para dhe të tjera” është parashikuar 24,437,000 lekë dhe është realizuar 11,630,434 lekë, pra 48%,

- “Shpenzime për ekspert” është parashikuar 968,000 lekë dhe është realizuar 441,240 lekë, pra 46%,

- “Amortizim” është parashikuar 63,155,000 lekë dhe është realizuar 40,483,866 lekë, pra 64%,

- “Blerje vegla pune” është parashikuar 253,000 lekë dhe është realizuar 196,980 lekë, pra 78%.

Grupi i auditimit duke iu referuar mos realizimit të programit ekonomik, konstatoi se RSU Nr.2 SH A, nuk ka analizuar dhe parashikuar konform nevojave reale të saj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 12-22, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës si dhe struktura drejtuese e Rezidencës Studentore Universitare Nr.2 Tiranë të analizojë mosrealizimin e zërave të programit ekonomik të vitit 2024 dhe të marra masa lidhur me hartimin e programeve ekonomike në të ardhmen konform nevojave reale të saj.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procedurat e prokurimit publik për periudhën 2024-2025/09, rezultoi se dosjet e prokurimeve nga struktura përgjegjëse për prokurimet, nuk ishin të inventarizuara dhe të arkivuara duke sjellë si pasojë, parregullsi në administrimin e dokumentacionit të tenderit, veprime në kundërshtim me nenin 24 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”; nenin 21 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, si dhe nenin 16, pikat 2 dhe 3 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 42-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Sektori i Prokurimeve në Rezidencën Studentore Universitare Nr.2 Tiranë, të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve të prokurimit për periudhën 2024-2025/09, me qëllim sistemimin arkivor të dokumentacionit.

Deri në 31.06.2026

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik të llojit “E hapur e thjeshtuar”, mallra, për periudhën 2024 - 2025/09, rezultoi se, në 8 (tetë) procedura të audituara, përcaktimi nga Njësia e Prokurimit në dokumentacionin e tenderit i kriterit që “vlera e xhiros minimale vjetore duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së kontratës” është në kundërshtim me nenin 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i cili përcakton saktë se kjo vlerë nuk mund të tejkalojë 40% vlerës së kontratës. Si rrjedhojë, ky formulim përbën shkelje të dispozitës ligjore të sipërpërmendur duke sjellë kufizim të konkurrencës, veprime në kundërshtim me nenin 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

E njëjta situatë është në lidhje me Formulimin e përdorur nga Njësia e Prokurimit: “*dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera në vlerën jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit*”, bie në kundërshtim me parashikimin e nenit 55 të Vendimit të Këshillit të Ministrave

nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i cili përcakton se vlera e kërkuar për furnizime të mëparshme nuk duhet të jetë më e madhe se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës. Përdorimi i shprehjes “jo më e vogël se 20%” nënkupton një prag minimal të barabartë ose më të lartë se 20%, duke tejkaluar kufirin maksimal të lejuar ligjërisht. Ky formulim përbën shkelje të dispozitës ligjore të sipërpërmendur dhe krijon kufizim të konkurrencës, veprime në kundërshtim me nenin 2 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. (Më hollësisht trajtuar në drejtimin 4, faqe 42-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Njësia e Prokurimit të rishikojë dhe standardizojë formulimin e kriterëve të kualifikimit në dokumentacionin e tenderit, duke respektuar kufirin maksimal ligjor prej 40% të vlerës së kontratës për xhiron minimale vjetore, me qëllim garantimin e konkurrencës së lirë dhe përputhshmërisë ligjore.

Në vijimësi

4.2 Rekomandimi: Njësia e Prokurimit të rishikojë formulimin e kriterëve për përvojën e ngjashme në dokumentacionin e tenderit, duke respektuar kufirin maksimal prej jo më shumë se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe sigurimin e përputhshmërisë ligjore.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit e “Hapur e thjeshtuar” me objekt:

“Blerje lëndë djegëse pelet për kaldajat”, me fond limit 5,241,600 lekë pa TVSh, viti 2024

“Blerje materiale elektrike, hidraulike, ndërtimore dhe marangozi”, me fond limit: 3,739,575 lekë, viti 2025

Blerje lëndë djegëse pelet për kaldajat”, me vlerë të fondit limit 5,428,800 lekë pa tvsh, viti 2025

rezultuan se OE pjesëmarrës në këto procedura (përkatësisht A.P; “D.R” janë kualifikuar e shpallur fitues në kushtet kur nuk kanë dorëzuar dokumentacionin fizik për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit. Konkretisht në procedurat “Blerje lëndë djegëse pelet për kaldajat”, për vitin 2024&2025, mungonin: Vërtetime lidhur me gjendjen gjyqësore të subjektit; Vërtetim nga Bashkia për shlyerjen e detyrimeve vendore; Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për pagim detyrimesh; Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për mungesën e detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore; Veprime në kundërshtim me nenin 76 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 2 pika 2, shkronja (j), nenin 25, nenin 26, pika 6 dhe nenin 82 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Pavarësisht faktit që kontrata është zbatuar me sukses nga operatori ekonomik fitues, kualifikimi i tij në kushtet e mos përmbushjes së kriterëve ligjore për t’u shpallur fitues cenon, transparencën dhe barazinë në procesin e vlerësimit.

(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 4, faqe 42-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Administratori dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nw Rezidencën Studentore Universitare SHA, nr. 2, në bashkëpunim të marrin masa të garantojnë verifikimin dhe dokumentimin e plotë të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, në procedurat e prokurimit, për çdo operator ekonomik, në lidhje për garantimin e transparencës dhe barazisë në procesin e vlerësimit si dhe për të siguruar përputhshmëri të dokumentacionit të sjellë nga operatori ekonomik fitues me Dokumentet Standarde të Tenderit të përcaktuar nga Njësia e Prokurimit.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i faturave të likuiduara nga ana e RSU Nr.2, në procedurën e prokurimit me objekti “ Blerje lëndë djegëse gazoil për kaldajat ”, me fond limit:

3,565,276 lekë pa TVSH, u konstatua se 3-fatura me vlerë 1,228,873 lekë janë likuiduar në tejkalim të afatit ligjor 30 ditor, veprime në mospërputhje me Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” i ndryshuar, neni 52, Ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, si dhe UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 184. (Më hollësisht trajtuar në drejtimin 3, faqe 32-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa për forcimin e kontrollit të brendshëm financiar dhe monitorimin sistematik të afateve në kryerjen e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, parandalimin e krijimit të pagesave të vonuara, me qëllim shmangien e detyrimeve të prapambetura dhe interesave për vonesë.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Blerje lëndë djegëse gazoil për kaldajat”, për vitin 2025 me fond limit: 3,602,45 lekë pa TVSh, u konstatua se, me shkresën nr.49/8 prot., datë 30.01.2025, procedura është anuluar. Në dosje nuk gjendet proces verbali i argumentimit për anulimin e procedurës, në kundërshtim me Nenin 2, pika 1, e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- Dokumentacioni i dorëzuar nga operatori fitues “R.E” Sh A, ishte jo i plotë, referuar certifikatës ISO nr. 9001:2015; EN ISO 14001:2015 të lëshuar nga IAF. Organi që ka lëshuar certifikatën ISO për OE fitues nuk rezulton në listën e organeve të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (<https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>). Për sa më sipër, kjo duhet të përbënte shkak për mospranimin e këtij dokumenti. Kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik në kushtet kur nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar, është në kundërshtim me nenin 76 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 2 pika 2, shkronja (j), nenin 25, nenin 26 pika 6 dhe nenin 82, të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 4, faqe 42-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Komisioni i Vlerësimit të ofertave në Rezidencën Studentore Universitare SHA, nr. 2 të marrë masa për:

Plotësimin dhe administrimin e rregullt të dokumentacionit të procedurës së prokurimit, garantimin e dokumentimit të plotë dhe të gjurmueshëm të çdo faze të procedurës së prokurimit, nga planifikimi deri në anulim apo zbatim të kontratës.

Në vijimësi

7.2 Rekomandimi: Rezidenca Studentore Universitare, Nr.2, Tiranë/Njësia e Prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të forcojë procesin e administrimit të dokumentacionit të procedurës së prokurimit, duke siguruar që para shpalljes së ofertuesit fitues dhe lidhjes së kontratës, të jenë verifikuar plotësisht të gjitha dokumentet e paraqitura nga operatori ekonomik, në përputhje me kuadrin ligjor, duke garantuar transparencë dhe konkurrueshmëri të barabartë.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale elektrike, hidraulike, ndërtimore dhe marangozi”, me fondi limit: 4,000,000 lekë pa tvsh, u konstatua se:

- Komisioni i ngritur në AK, për argumentimin e fondit limit është bazuar në testimin e tregut në operatorë të ndryshëm, konkretisht 3 OE: DH.A, M dhe M. Nga verifikimi elektronik i Qendrës Kombëtare të Biznesit <https://qbz.gov.al/> subjekti DH.A, rezulton me status të pezulluar dhe si pasojë oferta e saj nuk duhej marrë në konsideratë.

- Në dosjen fizike të OE, fitues, mungonte Procesverbali i mbajtur nga komisioni për argumentimin e anulimit të procedurës së prokurimit, veprime në kundërshtim me Nenin 2,

pika 1, e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 4, faqe 42-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Njësia e Prokurimit (NJP) të marrë masa për respektimin e plotë të kërkesave ligjore dhe nënligjore në procesin e argumentimit dhe përcaktimit të fondit limit, duke u bazuar vetëm në të dhëna të vlefshme dhe të verifikueshme nga operatorë ekonomikë aktivë dhe të regjistruar rregullisht në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Të kryhet verifikimi paraprak i statusit ligjor të operatorëve ekonomikë, me qëllim shmangien e përfshirjes në testimin e tregut të subjekteve me status të pezulluar ose jo aktiv, në funksion të garantimit të ligjshmërisë, transparencës dhe eficiencës në përdorimin e fondeve publike.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 3 procedurave të prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me objekt:

- “Blerje detergjent për pastrim dhe lavanteri” me fond limit 1,011,197 lekë pa TVSH, viti 2025
- “Blerje detergjent për pastrim dhe lavanteri”, me fond limit 842,497 lekë pa tvsh, viti 2024,
- “Blerje lëndë djegëse gazoil për kaldajat”, me fond limit: 3,565,276 lekë pa tvsh, rezultoi se Operatorët ekonomikë fitues, përkatësisht: “M”, “B”, “A.T, shpk, kanë paraqitur në dosjen fizike: certifikatën ISO të lëshuar nga IAF ShPK, EN-ISO nr. 9001:2015, certifikatën EN-ISO nr. 14001:2015, certifikatën ISO nr. 046/21 të lëshuar nga ICDQ ShPK. Në të 3 rastet organi që ka lëshuar certifikatën ISO për OE fitues nuk rezulton në listën e organeve të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (<https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>). Për sa më sipër, kjo duhet të përbënte shkak për mospranimin e këtij dokumenti.

Kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik në kushtet kur nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar, është në kundërshtim me nenin 76 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 2 pika 2, shkronja (j), nenin 25, nenin 26 pika 6 dhe nenin 82, të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 4, faqe 54-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Titullari i autoritetit kontraktor/ Rezidencës Studentore Universitare Nr.2 Tiranë, të marrë masa për forcimin e kontrollit paraprak dhe të brendshëm gjatë fazës së vlerësimit të dokumentacionit të operatorëve ekonomikë, me qëllim garantimin e respektimit të plotë të kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e prokurimit publik.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Referuar urdhrin të prokurimit, në procedurën me objekt “Blerje detergjent për pastrim dhe lavanteri”, me fond limit 842,497 lekë, zgjedha e llojit të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar-Mallra” është përzgjedhur jo konform LPP, nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 55, nenin 49, të LPP-së, si dhe nenit 77, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Pra klasifikimi në këtë lloj procedure nuk është bërë sipas përcaktimeve ligjore edhe pse nuk ka efekt financiar.

(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 4, faqe 42-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Autoriteti kontraktor/ Rezidenca Studentore Universitare Nr.2 Tiranë, të marrë masa për respektimin e plotë të kriterëve ligjore në përcaktimin dhe zgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit, në përputhje kërkesat ligjore. Në të ardhmen, klasifikimi i procedurave të prokurimit të bëhet në bazë të vlerës së fondit limit dhe objektit të prokurimit, me qëllim garantimin e ligjshmërisë, transparencës dhe rregullsisë së procesit, edhe në rastet kur konstatimi nuk sjell efekt financiar.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve fizike të prokurimit “Blerje të vogël” për vitin 2024, u konstatua se dorëzimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik fitues në 5 procedura: dokumentacioni ishte fotokopje dhe jo i njehsuar me origjinalin siç është kërkuar në Dokumentet Standarde të tenderit. Ky veprim bie në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në nenin 82, pika 2 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurave me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 4, faqe 42-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Administratori dhe Sektori i Prokurimit në Rezidencën Studentore Universitare SHA, nr. 2, në bashkëpunim, të sigurojë që në procedurat e prokurimit, dokumentacioni i dorëzuar nga operatorët ekonomikë të jetë në përputhje me kërkesat ligjore dhe dokumentacionin standard të tenderit.

Autoriteti të forcojë kontrollet gjatë fazës së verifikimit administrativ për të shmangur parregullsitë që cenojnë ligjshmërinë dhe barazinë në prokurim gjatë vlerësimit të dokumentacionit për të garantuar barazi, transparencë dhe konkurrencë të ndershme në procesin e prokurimit.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i faturave të likuiduara nga ana e RSU Nr.2, në 4 procedura të prokurimit “Blerje e Vogël” të zhvilluara në vitin 2024, në verifikimin e zbatimit të kontratave dhe likuidimin e tyre, rezultoi se 5-fatura janë likuiduar në tejkalim të afatit ligjor 30 ditor, Veprime në mospërputhje me Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” i ndryshuar, neni 52, Ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, si dhe UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 184.

(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 4, faqe 42-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike e Shërbimeve Mbështetëse në Rezidencën Studentore Universitare SHA, nr. 2, të marrë masa forcimin e kontrollit të brendshëm financiar dhe monitorimin sistematik të afateve për paraqitjen e dokumentacionit justifikues dhe kryerjen e pagesave në afat ndaj operatorëve ekonomikë, parandalimin e krijimit të pagesave të vonuara, me qëllim shmangien e detyrimeve të prapambetura dhe interesave për vonesë.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm në Rezidencën Studentore Universitare, nr.2, për periudhën nën auditim, u konstatua se:

- Për tetë mujorin 2024, ky sektor ka qenë pjesërisht funksional si rezultat i vakancave me një punonjës nga 2 (dy) sipas organikës, si dhe me plotësimin e saj ky punonjës rezulton pa certifikatën e auditit të brendshëm.

- Dosjet e auditimeve për vitin 2024 dhe periudhën 9-mujore 2025, nuk janë të inventarizuara dhe të arkivuara, në kundërshtim me Ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar.

- Në dosjet e përzgjedhura për auditim (2024-2025), mungon Dokumenti Standard “Takimi ballafaques/përmbyllës”, veprime jo në përputhje me Manualin e auditimit, Kap. VI, pika 8, ndërkohë që në dosje duhet të ishte plotësuar Dokumenti përkatës nga RSU Nr.2 SH A duke shprehur qëndrimin e Drejtorive përkatëse të audituara.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 110-131, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Drejtori i Njësisë së Auditit të Brendshëm në Rezidencën Studentore Universitare Tiranë të marrë masa:

- për plotësimin e strukturës organike të auditit të brendshëm, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, me qëllim garantimin e ushtrimit efektiv të pavarur dhe të vazhdueshëm të funksionit të auditit të brendshëm.
- për inventarizimin, sistemimin dhe arkivimin e të gjitha dosjeve të auditimeve për vitin 2024 dhe periudhën 9-mujore 2025, për të parandaluar përsëritjen e mangësive të konstatuara.
- përfshirjen e dokumentit standard “Takimi ballafaques përmbyllës” i plotësuar dhe nënshkruar nga të gjithë punonjësit pjesëmarrës në të.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës në Rezidencën Studentore Universitare nr. 2, për periudhën 2023-2024, nuk kanë lidhur kontrata me Administratorin e shoqërisë, në kundërshtim me Nenin 16, të Statutit nr. 552/8 prot., datë 18.01.2021 në RSU nr.2. si dhe Nenit 12, të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 2, faqe 22-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1 Rekomandimi: Sektori i Burimeve Njerëzore të marrë masa për lidhjen e kontratës me Administratorin, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, duke përcaktuar qartë detyrimet dhe përgjegjësitë përkatëse.

Këshilli Mbikëqyrës të sigurojë dokumentimin e plotë të vendimmarrjes dhe të vendosë mekanizma monitorimi dhe raportimi periodik mbi zbatimin e detyrimeve kontraktuale të Administratorit, me qëllim garantimin e ligjshmërisë dhe shmangien e parregullsive në të ardhmen.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Rezidenca Studentore Universitare nr. 2, ka hartuar Rregulloren e Brendshme, miratuar me Vendimin nr.15, datë 20.12.2022, “Për miratimin e Rregullores për Organizimin dhe Funkcionimin e Rezidencës Studentore Universitare nr.2”. Për periudhën në auditim, institucioni ka vazhduar të funksionojë sipas kësaj Rregulloreje edhe pse ka pasur ndryshime të strukturës organizative sipas Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr.11, datë 27.10.2023, dhe Urdhrit të Administratorit Nr.77, datë 30.10.2023 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Rezidencës Studentore Universitare nr.2”. Pra në një hark kohor prej 2 vite nuk ka pasur një Rregullore të re për t’iu përshatur ndryshimeve strukturore të kryera dhe funksioneve të reja të krijuara. Nuk ka një ndryshim, përditësim në rregulloren aktuale, ka munguar përshkrimi i punës për sektorët si pjesë e Drejtorive të RSU nr.2, veprime në kundërshtim me Ligjin 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 9/ pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 2, faqe 22-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1 Rekomandimi: Administratori i Rezidencës Studentore Universitare nr. 2 në bashkëpunim me Këshillin Mbikëqyrës të marrë masa:

- për, hartimin, përditësimin dhe miratimin e Rregullores së Brendshme, në përputhje me strukturën aktuale organizative të institucionit dhe ndryshimet e ndodhura ndër vite.
- përfshirjen në rregullore të përshkrimeve të punës për çdo drejtori, sektor dhe pozicion pune, përcaktimin e qartë të ndarjes së përgjegjësisë, funksioneve dhe linjave të raportimit, me qëllim forcimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi strukturën organizative dhe burimet njerëzore të Rezidencës Studentore Universitare nr.2 (RSU nr.2), u konstatua se struktura nuk është

plotësuar sipas organikës për vitin 2024, në një total prej 156 pozicioneve të planifikuara në strukturë, numri faktik i punonjësve ka qenë 151, duke rezultuar në 5 pozicione vakante dhe për vitin 2025, në një total prej 156 pozicioneve të planifikuara në strukturë, numri faktik i punonjësve ka qenë 148 duke rezultuar në 8 pozicione vakante. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 2, faqe 22-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

16.1 Rekomandimi: Administratori i Rezidencës Studentore Universitare nr.2 në bashkëpunim me Sektorin e Burimeve Njerëzore të rishikojë dhe përforcojë procesin e planifikimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, për të shmangur mungesat në strukturë në të ardhmen duke siguruar rekrutimin ose emërimin e të gjithë pozicioneve të parashikuara dhe vakant.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i procedurave të ndjekura për punësimin e punonjësve me Kod Pune, dhe verifikimi i faqes web në RSU nr. 2 rezulton se subjekti nuk ka shpallur vendet vakante për punësim në faqen zyrtare të internetit apo në mjete të tjera të aksesueshme publikisht, në kundërshtim me nenin 9 të Kodit të Punës, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim, duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe kushtet e rekrutimit, të çfarëdo lloji dege të aktivitetit, e në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, si dhe ngritjen në detyrë. Veprime në kundërshtim me nenin 9, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, neni 12, pika 1, shkronjat a) dhe b) të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” (i ndryshuar), neni 5 të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, neni 9 pika 4, shkronja dh) të ligjit nr.10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

Nga kontrolli i dokumentacionit të dosjeve të personelit, është konstatuar se mungon raporti mjeko-ligjor i azhurnuar për disa punonjës, dokument i domosdoshëm për të vërtetuar përputhshmërinë me kërkesat e ligjit dhe të rregulloreve të brendshme për shëndetin dhe sigurinë në punë, veprime në kundërshtim me VKM Nr. 124, datë 17.02.2016.

(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 2, faqe . 22-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1 Rekomandimi: Sektori i Burimeve Njerëzore në Rezidencën Studentore Universitare nr.2, të marrë masa për shpalljen e vendeve vakante në faqen e saj zyrtare të web-it, për të garantuar transparencë, konkurrencë të hapur dhe trajtim të barabartë të kandidatëve, në përputhje me Kodin e Punës.

Në vijimësi

17.2 Rekomandimi: Sektori i Burimeve Njerëzore, të marrë masa të sigurojë për plotësimin në dosjet e personelit me raportet mjeko-ligjore të azhurnuara, për të siguruar që ata janë në gjendje të përballojnë detyrat e tyre profesionale në kushte të sigurisë dhe shëndetit të duhur.

Në vijimësi

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE E TË ARDHURA TË MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për zbatimin dhe likuidimin e vendimeve gjyqësore për të larguarit pa drejtësisht nga puna, në Rezidencën Studentore Universitare nr.2, për periudhën objekt auditimi, u konstatua se janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për 4 punonjës në

kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Konkretisht, largimet nga puna janë kryer pa respektuar procedurat ligjore për zgjidhjen e kontratës së punës. Sektori i Burimeve Njerëzore nuk ka zbatuar procedurat e parashikuara në nenin 143, pika 1, të Kodit të Punës, si dhe nenet 143, 144 dhe 153, pika 8.2, lidhur me procedurat disiplinore, afatet e njoftimit dhe përfundimin e marrëdhënieve të punës, duke mos garantuar njoftimin paraprak, të drejtën e mbrojtjes dhe respektimin e afateve ligjore. Bazuar në vendimet e gjykatës, shuma e kërkuar nga këta punonjës arrin në vlerën 2,695,050 lekë, e cila ndikon drejtpërdrejt në të ardhurat e shoqërisë duke shkaktuar efekte negative financiare në buxhetin e kësaj shoqërie. Për vitin 2024, nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor për gjyqëfituesin, është paguar tarifa përmbartimore në vlerën 33,600 lekë. Për vitin 2025 për ekzekutimet e vendimeve gjyqësore për gjyqëfituesit, janë paguar tarifatat përmbartimore në vlerën 81,600 lekë. Këto shpenzime në vlerën totale prej 115,200 lekë përbëjnë një kosto shtesë për institucionin dhe konsiderohen menaxhim pa eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet i fondeve të RSU, nr.2., veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Drejtësisë, nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisë të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit” pika 5.

(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 2, faqe 22-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Administratori i Rezidencës Studentore Universitare nr.2, të marrë masa për ndjekjen e proceseve gjyqësore, përcjelljen e informacionit, regjistrimin në kontabilitet të detyrimit të plotë të titullit ekzekutiv si dhe për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet të vlerës prej 115,200 lekë si kosto shtesë për institucionin nga pagesa e tarifave përmbartimore.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 geramat b, c dhe ç; Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 37 “Masa disiplinore”, **i rekomandojmë Administratorit të Rezidencës Studentore Universitare, nr.2, Sha, Tiranë**, t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT